

**“NDIKIMI I KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK NË
RESPEKTIMIN E STANDARDIT TË TË SHKRUARIT
TË GJUHËS SHQIPE NGA NXËNËSIT E ARSIMIT TË
MESËM TË LARTË”**

Elida Kurti

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës
në Shkenca Edukimi, në profilin Pedagogji,
për marrjen e gradës shkencore “DOKTOR”

Udhëheqës: Prof. Dr. Nikoleta Mita

Numri i fjalëve: 57 022

Tiranë, janar 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj nën përgjegjësinë time se ky punim doktoral është shkruar prej meje, nuk është prezantuar dhe as nuk është botuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara gjatë shqyrtimit të literaturës, apo argumentimit të diskutimit të çështjeve.

E drejtë e autorit © 2017. Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.

Elida Kurti

ABSTRAKT

Një nga shqetësimet më të mëdha në fushën e gjuhësisë në ditët e sotme mbetet çështja e standardit dhe e raportit të tij me prurjet e mëdha nga globalizimi i gjuhës dhe veçanërisht komunikimin elektronik. Kjo çështje është bërë objekt diskutimesh e debatesh në mjaft tubime shkencore, në shtypin e shkruar e atë viziv. Debatet kanë të bëjnë kryesisht me abuzimet kundrejt shqipes së shkruar dhe mënyrës se si ato trasmetohen në kulturën gjuhësore.

Duke marrë shkas nga kjo dukuri, kam zgjedhur që të bëj objekt studimi ndikimin që ka komunikimi elektronik në standardin e shqipes dhe veçanërisht të shqipes së shkruar nga nxënësit e shkollës së mesme. Qëllimi i studimit është të hulumtojë në ç'shkallë ndikon komunikimi elektronik tek nxënësit e shkollës së mesme në përdorimin e shqipes standarde dhe si po punon shkolla në këtë kontekst të ri për t'u mësuar nxënësve përdorimin e shqipes standarde.

Për arritjen e objektivave të këtij studimi u krye një anketim me nxënësit e shkollave të mesme të Tiranës (gjimnaz dhe profesionale), që ndodhen në qendër dhe periferi. Nxënësit, të cilët kanë marrë pjesë në këtë anketim, i përkasin klasave X, XI, XII. Në këtë anketim kanë marrë pjesë 900 nxënës.

Metodologjia e përdorur për këtë studim përputhet me qëllimin shkencor. Ajo kombinon të dhënat parësore me ato dytësore. Analiza e të dhënave është kryer nëpërmjet analizës deskriptive, tabelave të kryqëzuara (crosstabulations), testeve të pavarësisë, korrelimet midis variablave, ndërtimit dhe shqyrtimit të hipotezave, analizës së variancës (ANOVA) etj.

Tre gjetjet kryesore të studimit janë:

1. Përdorimi i fjalëve të huaja si ndikim i komunikimit elektronik nuk e pengon drejtshkrimin sipas rregullave standarde.
2. Përdorimi i shkurtimeve në gjuhën shqipe apo gjuhë të huaja, qofshin këto standarde apo jo, ka gjetur terren të gjerë kudo, duke u bërë gati-gati i pashmangshëm në komunikimin elektronik dhe jo vetëm.
3. Stili i komunikimit me SMS dhe Chat ndikon në standardin e shqipes së shkruar.

Fjalët kyçe: *shqipja standarde, komunikimi elektronik, të shkruarit, të folurit, rregulla drejtshkrimore.*

ABSTRACT

One of the biggest concerns in the field of linguistics today remains the issue of the standard and its report with great flow of language, particularly the globalization of electronic communication. This issue is the subject of a lot of discussions and debates in many scientific meetings as well as in the press of the visual. Debates mainly deal with abuses against the Albanian printed press and the way it is transmitted in the language culture.

Taking advantage of this phenomenon, I have chosen to study the impact of electronic communication in the Albanian language standard. The purpose of the study is to investigate at what extent the electronic communication affect students of the secondary education to use Albanian language standard and how the school is working in this new context to teach students to use the standard of Albanian language.

In order to achieve the objectives of this study, was conducted a survey with students of secondary schools in Tirana (gymnasium and professional), located at the centre and in the suburban area. Students who participated in the survey belong to the grades X, XI, XII. 900 students participated in this survey.

The methodology used for this study is consistent with the scientific purpose. It combines primary data with secondary ones. Data analysis was performed through descriptive analysis, cross tables (Cross-tabulations), tests of independence between variables correlated, construction and review of assumptions, analysis of variance (ANOVA) etc.

Three main findings of this study are:

1. The use of foreign words as an impact of electronic communications does not hinder the spelling according to standard rules.

2. The usage of abbreviations in albanian language or foreign one (whether or not standard language) has found wide use everywhere becoming almost inevitable in electronic communication and not only.

3. The style of communication through SMS and chat affects in the standard of written Albanian.

Key words: *standard language, electronic communication, writing, reading, spelling standard rules.*

DEDIKIM

....

FAMILJES

SIME

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Për realizimin e këtij punimi kam patur mbështetjen e shumë bashkëpunëtorëve dhe njerëzve të dashur. Të gjithë ata meritojnë mirënjohje dhe falenderime të veçanta.

Dëshiroj të shpreh konsideratën dhe vlerësimin maksimal për udhëheqësen time shkencore, Prof. Dr. Nikoleta Mita, për dashamirësinë dhe përkujdesjen e saj, për mendimet e sugjerimet që më ka dhënë me përvojën e vet të vyer shkencore dhe metodike në këtë studim doktoral .

Mirënjohjen time i shpreh Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit të Tiranës, Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut të Tiranës si dhe kolegëve të mi mësues në shkollat që u përfshinë në këtë studim, për mbështetjen dhe angazhimin e tyre maksimal.

Veçanërisht falenderoj të gjithë nxënësit e shkollave të mesme të qytetit të Tiranës dhe të periferisë së saj që morën pjesë në realizimin e anketave dhe bisedave, nëpërmjet të cilave u mblodhën të gjitha informacionet e nevojshme dhe të dhënat gjuhësore që u shfrytëzuan në këtë punim.

Familjarëve të mi u jam shumë mirënjohëse për gjithçka që më kanë dhënë dhe që ma lehtësuan punën me mbështetjen e tyre në kryerjen e këtij studimi.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

| | |
|---|-------------|
| DEKLARATA E AUTORËSISË | i |
| ABSTRAKT | ii |
| ABSTRACT | v |
| DEDIKIM | vii |
| MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME | viii |
| PËRMBAJTJA E LËNDËS | ix |
| LISTA E TABELAVE | xiii |
| LISTA E GRAFIKËVE | xiv |

KAPITULLI I HYRJJE

1

| | |
|---|----|
| 1.1 Hyrje..... | 1 |
| 1.2 Përshkrimi teorik..... | 5 |
| 1.3 Shtrimi i problemit | 12 |
| 1.4 Qëllimi i studimit | 22 |
| 1.5 Hipotezat dhe pyetjet kërkimore | 24 |
| 1.6 Variablat | 26 |
| 1.7 Rëndësia e studimit | 26 |
| 1.8 Struktura e punimit..... | 27 |

KAPITULLI II SHQIPJA STANDARDE.....

29

| | |
|--|----|
| 2.1 Koncepti i gjuhës standarde, tiparet themelore të saj..... | 29 |
| 2.2 Standardizimi i shqipes dhe planifikimi gjuhësor..... | 35 |
| 2.3 Zhvillimi historik i shqipes standarde | 43 |

| | |
|--|------------|
| 2.4 Shqipja në etapën e sotme, sfidat e gjuhës..... | 49 |
| 2.5 Mësimi i shqipes standarde në shkollë..... | 59 |
| KAPITULLI III KOMUNIKIMI ELEKTRONIK..... | 69 |
| 3.1 Koncepti i komunikimit elektronik..... | 69 |
| 3.2 Llojet e komunikimit elektronik..... | 70 |
| 3.3 Posta elektronike (E-mail)..... | 73 |
| 3.4 Internet Chat..... | 77 |
| 3.5 Tekstet e shkruara telefonike (SMS-të)..... | 79 |
| 3.6 Shkurtesat..... | 81 |
| 3.7 Fjalët e huaja dhe huazimet në gjuhën shqipe..... | 88 |
| 3.8 Ndërkombëtarizmat..... | 93 |
| 3.9 Tregues i fjalëve të huaja që mund të zëvendësohen plotësisht ose pjesërisht. | 97 |
| KAPITULLI IV METODOLOGJIA E STUDIMIT | 105 |
| 4.1 Metodat e kërkimit | 105 |
| 4.2 Subjektet e kërkimit | 107 |
| 4.2.1 Përzgjedhja e kampionit të shkollave..... | 107 |
| 4.2.2 Përzgjedhja e kampionit të nxënësve | 110 |
| 4.2.2.1 Përzgjedhja e kampionit të nxënësve për pyetësorët..... | 111 |
| 4.2.2.2 Përzgjedhja e kampionit të nxënësve për skedat..... | 113 |
| 4.2.2.3 Përzgjedhja e kampionit të nxënësve për esetë..... | 113 |
| 4.3 Instrumentet e kërkimit | 113 |
| 4.3.1 Hartimi i pyetësorit | 115 |

| | |
|--|------------|
| 4.3.2 Testimi i pyetësorit..... | 118 |
| 4.3.3 Besueshmëria e pyetësorit..... | 118 |
| 4.3.4 Esetë | 119 |
| 4.3.5 Skedat..... | 120 |
| 4.4 Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave..... | 124 |
| 4.5 Etika e kërkimit | 125 |
| 4.6 Kufizime të kërkimit | 126 |
| KAPITULLI V GJETJET E STUDIMIT DHE DISKUTIMI..... | 127 |
| 5.1 Gjetjet nga pyetësi dhe diskutimi..... | 127 |
| 5.1.1 Shkurtesat jostandarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre | 130 |
| 5.1.2 Shkurtesat standarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre..... | 136 |
| 5.1.3 Vlerësimi për respektimin e rregullave të shkrimit të gjuhës shqipe..... | 142 |
| 5.1.4 Fjalët e huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre | 144 |
| 5.1.5 Shkurtime të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre..... | 149 |
| 5.1.6 Vlerësimi i rregullave të shkrimit të fjalëve në gjuhë të huaj | 154 |
| 5.2 Gjetjet nga esetë dhe diskutimi | 156 |
| 5.2.1 Analizë e çështjeve të normës drejtshkrimore | 160 |
| 5.2.2 Analizë e çështjeve të normës morfologjike | 175 |
| 5.2.3 Analizë e çështjeve të normës sintaksore..... | 177 |
| 5.2.4 Analizë e çështjeve të normës leksikore | 179 |
| 5.3 Gjetjet nga hipotezat dhe pyetjet kërkimore dhe diskutimi | 186 |
| 5.3.1 Rezultatet e hipotezave dhe pyetjeve kërkimore..... | 187 |
| 5.3.2 Verifikimi i hipotezave | 197 |

| | |
|---|------------|
| KAPITULLI VI PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME..... | 198 |
| 6.1 Përfundime | 199 |
| 6.2 Rekomandime | 214 |
| REFERENCA..... | 217 |
| SHTOJCA I..... | 226 |
| SHTOJCA II..... | 241 |

LISTA E TABELAVE

| | | |
|-------------------|--|-----|
| Tabela 1 | Statistika përshkruese të moshës së nxënësve | 128 |
| Tabela 2/1 | Shkurtesat jostandarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre | 131 |
| Tabela 2/2 | Shkurtesat jostandarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre | 132 |
| Tabela 2/3 | Shkurtesat jostandarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre | 134 |
| Tabela 2/4 | Shkurtesat jostandarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre | 135 |
| Tabela 3/1 | Shkurtesat standarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre | 137 |
| Tabela 3/2 | Shkurtesat standarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre | 138 |
| Tabela 3/3 | Shkurtesat standarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre | 140 |
| Tabela 3/4 | Shkurtesat standarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre | 141 |
| Tabela 4 | Vlerësimi për respektimin e rregullave të shkrimit të gjuhës shqipe . | 142 |
| Tabela 5/1 | Fjalët e huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre | 144 |
| Tabela 5/2 | Fjalët e huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre | 146 |
| Tabela 5/3 | Fjalët e huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre | 147 |
| Tabela 5/4 | Fjalët e huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre | 148 |
| Tabela 6/1 | Shkurtesat jostandarde të fjalëve të huaja dhe përdorimi i tyre | 150 |
| Tabela 6/2 | Shkurtesat jostandarde të fjalëve të huaja dhe përdorimi i tyre | 151 |
| Tabela 6/3 | Shkurtesat jostandarde të fjalëve të huaja dhe përdorimi i tyre | 152 |
| Tabela 6/4 | Shkurtesat jostandarde të fjalëve të huaja dhe përdorimi i tyre | 153 |
| Tabela 7 | Vlerësimi i përdorimit të shkurtesave dhe fjalëve në gjuhë të huaj ... | 155 |
| Tabela 8 | Numri i gabimeve sipas çështjeve të normës drejtshkrimore | 161 |
| Tabela 9 | Shembuj të gabimeve të ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit | 162 |
| Tabela 10 | Shembuj të gabimeve të shkrimit të fjalëve njësh dhe ndaras | 163 |

| | | |
|------------------|---|-----|
| Tabela 11 | Shembuj të gabimeve të shkrimit të fjalëve me vizë në mes | 165 |
| Tabela 12 | Shembuj të gabimeve të përdorimit të apostrofit | 166 |
| Tabela 13 | Shembuj të gabimeve të përdorimit të shkronjës së madhe | 170 |
| Tabela 14 | Shembuj të gabimeve të përdorimit të shkronjës –ë. | 173 |
| Tabela 15 | Numri i gabimeve sipas çështje të normës morfologjike | 175 |
| Tabela 16 | Numri i gabimeve të normës sintaksore dhe leksikore | 180 |
| Tabela 17 | Shembuj të përdorimit të fjalëve të huaja në vend të fjalës shqipe | 182 |
| Tabela 18 | Shembuj të përdorimit të shkurtesave në vend të fjalës së plotë. | 184 |
| Tabela 19 | Shembuj të përdorimit të shkurtimeve të huaja në vend të fjalës shqipe | 185 |

LISTA E GRAFIKËVE

| | | |
|-------------------|---|-----|
| Grafiku 1: | Numri total i nxënësve që studiojnë në shkollat e Qarkut të Tiranës për vitin shkollor 2013-2014 | 111 |
| Grafiku 2: | Gjinia e nxënësve | 128 |
| Grafiku 3: | Shpërndarja e nxënësve sipas vendndodhjes qendër, periferi dhe shkolla profesionale | 129 |
| Grafiku 4: | Shpërndarja e nxënësve sipas profilit; gjimnaz, profesionale | 129 |
| Grafiku 5: | Përqindja e gabimeve sipas fushave përkatëse gjuhësore | 160 |

KAPITULLI I HYRJE

1.1 Hyrje

Në studimin tim unë kam zgjedhur që të trajtoj ndikimin që ka komunikimi elektronik në përdorimin e shqipes standarde dhe veçanërisht të shqipes së shkruar. Interneti po ushtron një ndikim të madh në mësimin e gjuhës standarde dhe më së shumti në fushën leksikore, fonetike dhe sintaksore të gjuhës. Nga ana tjetër shkolla përpiqet t'i mësojë nxënësit të përdorin gjuhën standarde. Gjuha e përdorur në disa nga llojet e komunikimeve elektronike nuk u përmbahet rregullave të standardit gjuhësor dhe normave bazë të drejtshkrimit të shqipes së shkruar.

Ky punim ka si objekt kryesor që të analizojë efektet dhe ndikimet e komunikimit elektronik në shqipen standarde nga nxënësit e shkollave të mesme, si dhe në riorientimin e politikës së mësimin të gjuhës shqipe në shkollë për të përvetësuar shqipen standarde. Gjetjet e faktorëve që ndikojnë në ruajtjen dhe përvetësimin e standardit, mënyrat dhe format më efikase për zbatimin dhe respektimin e rregullave gjuhësore dhe arritjen e standardeve të komunikimit të gjuhës, janë disa nga synimet kryesore që përfshin kërkimi ynë.

Në fund të shekullit të 20-të ne u futëm në një gjuhë të re, përkatësisht në gjuhën e mesazheve dhe komunikimit elektronik. Kjo gjuhë i ngjan të folurit me sintaksë të thjeshtë, me fjalë dhe fjali jo të plota dhe struktura joformale. Në gjuhën shqipe bisedat elektronike janë shumë të ndryshme nga shqipja standarde dhe përdorimi i shkurtesave është gjithmonë e në rritje. Gjatë të shkruarit të mesazheve telefonike frazat gjuhësore që përdoren nga nxënësit dhe studentët shpesh janë të pakuptueshme. Gjuha e përdorur në disa nga llojet e komunikimeve elektronike nuk u përmbahet rregullave të standardit

gjuhësor dhe normave bazë të drejtshkrimit të shqipes së shkruar. Ndër to mund të përmendim:

- Tekstet e përdorura nuk janë në gjuhën standarde dhe shpesh janë të mbushura me gabime ortografike.
- Tekstet e mesazheve në mënyrë të pashmangshme mund të dëmtojnë aftësinë e fëmijëve për t'u shprehur, për të dalluar format e rregullta të fjalëve dhe për të shkruar në mënyrë të saktë, një aftësi e cila po dëmtohet çdo ditë e më tepër.
- Nxënësit, në mënyrë të pashmangshme do t'i transferojnë këto zakone të reja në detyrat e tyre të shtëpisë (Crystal, 2008: 151).

Përvoja edukative e mësuesve dhe pedagogëve tregon se gjuha e teksteve të mesazheve është reflektuar në punët e tyre me shkrim në shkollë. Disa nxënës përdorin forma të shkurtuara dhe drejtshkrim jostandard në punët e tyre në shkollë, të cilat janë shumë tipike për gjuhën e teksteve të mesazheve. Nëse kjo gjendje ekziston në shkollat e sotme, atëherë kjo gjë nuk është diçka që mund të dallohet nga ato të cilët shkëmbejnë mesazhe, sepse ata e kanë të vështirë të dallojnë frazat e gabuara dhe madje të gjithë mesazhin e shkruar në mënyrë jo të saktë. Për të studiuar këtë fenomen do të analizohen punët me shkrim të nxënësve në mënyrë që të gjejmë dhe konstatojmë nëse është e vërtetë që nxënësit ndikohen nga tekstet e mesazheve dhe nga komunikimi elektronik apo jo.

Është e rëndësishme që gjuha standarde të ndahet nga gjuha e përdorur në komunikimin elektronik dhe këto dy forma komunikimi të mos përzihen apo të ndikojnë tek njëra-tjetra, por nuk duhet të harrojmë që kjo është shumë e vështirë të realizohet duke qenë se çdo ditë e më shumë shtohen rastet ku fëmijët më parë bien në kontakt me këtë lloj gjuhe sesa me shkrimin e dokumenteve në gjuhën standarde.

Kështu, në të tilla raste përgjegjësia për mungesën e njohurive apo praktikimit të gjuhës standarde bie mbi mësuesin apo pedagogun e nxënësit. Nga ana tjetër, studiuesit dhe akademikët flasin për një proces mësimor ku ora e mësimi të kthehet në një proces argëtues, gjatë të cilit është e kotë t'u kushtohet shumë rëndësi memorizimit të skemave gramatikore. Përplasja e këtyre dy ideve bëhet gjithnjë e më e fuqishme dhe mësime të përballesh me domosdoshmërinë për të dhënë instruksionet e duhura gramatikore nga njëra anë dhe nga ana tjetër me një mjedis të ri mësimor, i cili tenton të bëhet gjithnjë e më argëtues.

Mësimi i gramatikës nuk është një proces argëtues dhe është vërtetë e vështirë të kthehet në një lojë, duke qenë se ka shumë rregulla dhe skema, të cilat duhet të mbahen mend përmendsh, dhe kjo nuk mund të realizohet pa pasur totalisht vëmendjen e nxënësve. Prandaj mësimdhënia e gramatikës është gjithnjë e vështirë dhe sipas Crystal, ajo që duhet të kemi parasysh është respektimi i rregullave të gjuhës standarde, të paktën kur kemi të bëjmë me detyrat apo dokumentet të cilat kërkojnë një gjuhë standarde dhe shkrim formal. Në momentin që studentët apo nxënësit lënë mjedisin shkollor, atëherë mënyra sesi ata zgjedhin të shkruajnë është tërësisht në dorë të tyre dhe ne s'mund të bëjmë dot asgjë në lidhje me këtë. Për më tepër, duhet të pranojmë njëherë e mirë se ashtu siç gjuha e folur ndryshon shumë nga ajo e shkruar, edhe qëllimi për të cilin shkruajmë duhet të ndryshojë dhe të reflektohet në shkrimet tona. As ne, as gjuhëtarët dhe as njerëzit e thjeshtë nuk mund të presin që shkrimi elektronik dhe ai përmes kompjuterit të jetë i njëjtë me shkrimin formal apo me atë që përdorim në detyra, në shkollë, apo edhe në dokumentet e përditshme.

Nga ana tjetër, ashtu siç variante të ndryshme të gjuhës së folur ndikojnë tek njëra-tjetra dhe përzihen në një të vetme gjatë ligjërimit të përditshëm, edhe format dhe

llojet e gjuhës së shkruar do të ndikohen nga njëra-tjetra. Në këtë pikë nuk është ndërhyrja apo ndikimi i njërit lloj në llojin tjetër, por fakti se jo të gjithë e njohin gjuhën standarde. Kështu, shumë studentë apo nxënës të dobët, të cilët nuk kanë njohuri të mira të gramatikës dhe drejtshkrimit të një gjuhe e marrin për rregull standard atë që hasin çdo ditë në komunikimin e përditshëm dhe ndjekin vetëm këtë lloj shembulli. Ata gjithashtu, nuk janë të aftë të vlerësojnë nëse një tekst i caktuar është formal ose jo, nëse duhet të shkruajnë po ashtu siç shkruajnë në chat apo në e-mail edhe një dokument të rëndësishëm apo jo.

Ndikimi i tyre sipas Crystal nuk është i rrezikshëm për gjuhën standarde, por shembulli që ata përçojnë tek të tjerët është shumë i rrezikshëm, sepse kështu ata inkurajojnë të rinjtë e fëmijët, të cilët edhe pse nuk dinë ende të shkruajnë në mënyrë standarde, të udhëhiqen nga komunikimi elektronik të cilin duhet të pranojmë që është më pak formal, më i drejtuar nga gjuha e folur dhe komunikim i shpejtë. Shembulli është ai që ka më shumë rëndësi, sepse shkurtimet dhe simbolet e ndryshme që përdoren në shkrimin elektronik nuk janë risi dhe nuk erdhën me këtë lloj shkrimi. Ato kanë lindur që me lindjen e shkrimit dhe kanë vazhduar të ekzistojnë me gjithë kundërshtitë dhe përpjeket e shumta të gjuhëtarëve për t'i minimizuar ato deri në maksimum (Crystal, David. 2001: 26). Nuk ka shumë rëndësi se si shkruajmë ne kur duam të komunikojmë me miqtë tanë. Ajo që është vërtet e rëndësishme është që këto forma të mos ngatërrohen me njëra-tjetrën dhe të përdoren aty ku është e nevojshme. Shkolla, që është edhe institucioni ku të gjithë ne mësojmë të shkruajmë, duhet të jetë e kujdesshme në këtë aspekt dhe ne nuk duhet të harrojmë se në shkollë apo në institucione të tjera duhet të respektohen rregullat e drejtshkrimit.

Prandaj, edhe unë në këtë studim do të përqëndrohem më shumë në ndikimin që kanë

këto lloje shkrimi në punët me shkrim të nxënësve në shkollë e mesme dhe jo tek mënyra e të folurit dhe komunikimi në përgjithësi.

Pra, kam përcaktuar të analizoj këto aspekte duke qenë se shumë nxënës i pasqyrojnë këto forma të reja edhe në detyrat me shkrim që punojnë në shkollë.

1.2 Përshkrimi teorik

Krijimi i gjuhës letrare kombëtare ka bazën e vet historiko-shoqërore. Ajo lind si rezultat i kërkesës për një mjet të komunikimit shtetëror, zyrtar. Për përmbushjen e këtyre funksioneve duhet para së gjithash një trajtë e shkruar, e cila në zhvillimin e vet zakonisht e kapërcen trajtën e folur të gjuhës letrare. Dikur gjuha e shkrimit me gjuhën e folur nuk përputheshin. Kjo ndodhte për arsye se në shumë raste, si gjuhë shkrimi përdorehin ose gjuhë të vdekura, të quajtura “*gjuhë të kulturës e të shkencës*”, siç ishte latinishtja në Evropë deri në mesjetë, ose gjuhët të tjera të huaja. Ato kurrsesi nuk mund të shërbenin si mjete të komunikimit të përditshëm, përderisa kishte mospërputhje të plotë midis dy kodeve: kodit të gjuhës së folur dhe atij të gjuhës së shkruar.

Me termat e sotme të sociolinguistikës kjo gjendje mund të jepej kështu: pjesa dërrmuese e popullsisë përdorte vetëm L1 (=gjuhën e vet amtare në trajtën e folur) dhe nuk e kuptonte aspak L2 (= gjuhën e huaj që përdorej si gjuhë shkrimi, si gjuhë zyrtare). Vetëm një pakicë njerëzish, kryesisht grupe të kufizuara, që përfaqësonin klasën sunduese dhe specialistë të shkolluar në gjuhën e huaj përkatëse e përdornin atë (L2) në komunikimin me shkrim dhe vetëm në të rrallë (e në mjedise shumë të ngushta) mund të ushtrohej L2 edhe si gjuhë e folur (Shkurtaç, GJ. 2006 :13).

Përhapja e shpejtë e gjuhës letrare të njësuar në Republikën e Shqipërisë e në trojet që shtrihen përtej kufijve të saj, si edhe në ngulimet arbëreshe, *ka mbështetje dhe*

shpjegim të dyfishtë. Në njërën anë, kemi të bëjmë me pjesëtarë të një kombi të vetëm, të cilët kanë tradita të njëjta shumëshekullore dhe njëjtësi të kulturës popullore, që ruhen e trashëgohen brez pas brezi dhe zhvillohen nëpërmjet gjuhës amtare. Nga ana tjetër, të folmet e këtyre trojeve gjuhësore e të ngulimeve të diasporës janë forma të ekzistencës së një etnolekti të vetëm. Pra, në thelbin e vet, për të gjithë bartësit e të folmeve të shqipes, problemi që shtrohej ishte i njëjtë: *kalimi nga variante dialektore në një gjuhë letrare mbidialektore*, që është gjithashtu variant i etnolektit të përbashkët.

Në përpjesëtime të ndryshme, të folmet e dialektet e shqipes e gjejnë veten në variantin më të përpunuar, më të lartë e më me prestigj të këtij etnolekti në gjuhën letrare kombëtare. Megjithatë, të gjithë bartësit e të folmeve, si të Veriut, ashtu edhe të Jugut, duhet ta mësojnë gjuhën letrare kombëtare, sepse asnjë e folme e shqipes dhe asnjë dialekt i saj nuk barazohet me të. Dallimet që ka kjo ose ajo e folme nga gjuha letrare janë të ndryshme, pra çdo e folme ka dallimet e veta. Prandaj nuk është i drejtë mendimi se përpjekje për të zotëruar gjuhën letrare të njësuar duhet të bëjnë vetëm bartësit e të folmeve të Veriut dhe arbëreshët. Bartësit e çdo të folmeje, të Veriut e të Jugut, duhet të kapërcejnë dallimet e mospërputhjet në të gjitha nënsistemet gjuhësore për të arritur te gjuha letrare.

Shqipja letrare, që përdoret sot brenda e jashtë kufijve të Shqipërisë, është një sistem i njëjtë në të cilin vepron *një normë gjuhësore, pa variante territoriale brenda këtij sistemi.* Por natyrisht, në kontekstet e ndryshme shtetërore, kulturore e shoqërore, në të cilat funksionon sot kjo gjuhë letrare e përbashkët, jashtë kufijve të RSH-së, vihen re edhe ndërlikime të veçanta, depërtime të huaja, të cilat burojnë nga trysnia që ushtrojnë mbi shqipen gjuhët me të cilat ajo është në takim të drejtpërdrejtë, kryesisht serbo-kroatishtja për shqiptarët e Kosovës e të Malit të Zi,

maqedonishtja për shqiptarët e Maqedonisë dhe italishtja e greqishtja, përkatësisht për arbëreshët e Italisë dhe ata të Greqisë, anglishtja për shqiptarët e Amerikës, turqishtja për shqiptarët e Turqisë, gjermanishtja për shqiptarët e Zvicrës gjermanike dhe të Gjermanisë etj.

Edhe statusi zyrtar i shqipes letrare të njësuar nuk është i njëjtë në të gjitha trojet. Ai ndryshon sipas kontekstit shtetëror në të cilin ajo funksionon.

Sot, fatmirësisht, edhe në Kosovë shqipja është tashmë gjuhë e shtetit të ri e të pavarur dhe zbatohet kudo si gjuhë e shkruar dhe e folur nga shqiptarët e Kosovës. Tek arbëreshët e Italisë shqipja është gjuhë që lejohet, por që as nuk përkrahet (ose përkrahet në nivel vendor) as nuk pengohet zyrtarisht.

Natyrisht, krijimi i gjuhës letrare shqipe të njëjtë e të përbashkët për të gjithë shqiptarët kudo gjendeshin e gjenden ka ushqyer edhe diskutimin e debatin shkencor që nga gjysma e dytë e shekullit XIX, kohë kur siç dihet, veprimtarët më të shquar të Rilindjes sonë Kombëtare ideuan dhe shtruan për zgjidhje problemin e “mbrothësisë” së gjuhës shqipe, pajisjen e saj me një alfabet të njëjtë e të vetëm, krijimin e gjuhës letrare të përbashkët, që të kishte edhe atributet e gjuhës së shkollës dhe të administratës publike shqiptare në shtetin që do të krijohet pas çlirimit.

Kongresi i Drejtshkrimit, i mbajtur në Tiranë në nëntor të vitit 1972, me delegatë nga radhët e studiuesve, shkrimtarëve dhe veprimtarëve arsimorë e kulturorë që përfaqësonin të gjitha viset shqiptare, si dhe nga arbëreshët e Italisë, shënoi një pikë kulmore në procesin e gjatë e të vështirë të themelimit të gjuhës letrare të përbashkët, të njësuar dhe të zbatueshme nga të gjitha institucionet kulturore, arsimore dhe botuese të Shqipërisë dhe të trojeve shqiptare në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi e deri në diasporën historike shqiptare.

Kongresi miratoi një rezolutë, në të cilën pohohej me solemnitet e gëzim të ligjshëm se *“populli shqiptar ka tashmë një gjuhë letrare të njësuar”*. Në mbështetje të Rezolutës dhe si mishërim i saj, menjëherë pas Kongresit filloi puna për të përgatitur e botuar edhe veprat normative themelore për drejtshkrimin e shqipes. Së pari, doli në botim përfundimtar libri *“Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe”*, që përbënte në thelb projektin e botuar qysh më 1967, të mbështetur edhe nga Konsulta e Prillit (Prishtinë, 1968) dhe të zbatuar me lehtësi e dobi gati kudo në praktikën mësimore dhe botuese në Republikën e Shqipërisë dhe në Kosovë.

Në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XX e në vijim, kur edhe në shoqërinë shqiptare ndodhën përmbysje të mëdha, kur iu nënshtruan një gjykimi të ri ngjarje, vlera, dukuri e personalitete të ndryshme të historisë sonë kombëtare, nuk mund të mbetej jashtë shqyrtimeve kritike edhe gjuha shqipe e njësuar (standarde). Përmbysja e regjimit komunist dhe liria e fjalës dhe e shtypit, që erdhën bashkë me demokracinë në Shqipëri, u dhanë dorë edhe qëndrimeve kritike e qortimeve, ndonjëherë edhe të ashpra, sidomos për rrugën e format që u ndoqën pas Luftës së Dytë Botërore, për vendosjen e formës së sotme të gjuhës letrare të njësuar. Diskutimet më të shumta u përqëndruan rreth bazës dialektore të shqipes standarde dhe qëndrimeve të mbajtura ndaj variantit të gegërishtes letrare gjatë procesit të planifikimit gjuhësor të shqipes standarde.

Në mënyrë të veçantë duhet ta mbrojmë, ta pastrojmë shqipen e shkruar e të folur nga ndikimet e huaja dhe ta pasurojmë me fjalë të bukura të trojeve tona. Mendojmë se është e domosdoshme që t'i bëhen disa përmirësime drejtshkrimit, si dhe të rishikohen më gjerë disa trajta a aspekte të pjesshme të normës, të cilat me sa duket, nuk kanë gjetur trajtimin që duhet. Është pikërisht koha të mënjanohej nga

norma drejtshkrimore dhe morfologjike disa përjashtime të panevojshme, për të cilat ka pasur edhe mendime e propozime konkrete prej gjuhëtarëve.

Përvetësimi i gjuhës letrare në të vërtetë shpreh vetëdijen e krijuar se vetëm gjuha që përfaqëson krejt një komb, domethënë, vetëm gjuha e përbashkët gjithëkombëtare mund të përmbushë kërkesat e tij më të larta shpirtërore. Kjo vetëdije e formuar është sukses i madh në procesin e përvetësimit të normës letrare, sepse siguron ardhmërinë e gjuhës letrare. Shkalla e përvetësimit të gjuhës letrare, praktikisht bëhet tregues që provon nivelin e kulturës sonë në përgjithësi. Këtë ndërgjegje gjuhësore e kanë përforcuar edhe hapat që janë bërë për drejtshkrimin, njësimin dhe normatizimin e gjuhës letrare shqipe. Që gjatë Rilindjes e më pas, në shtypin shqiptar janë zhvilluar shumë diskutime për probleme të ndryshme të kulturës së gjuhës. Pas çlirimit, kujdesi për gjuhën letrare u bë një problem i përgjithshëm shoqëror.

Më 1956 doli si botim më vete libri *“Për pastërtinë e gjuhës shqipe”* i profesor A.Xhuvanit, që ushtroi ndikim të mirë për ngritjen e kulturës gjuhësore. Më 1967 u formua pranë Institutit të Gjuhësisë sektori i kulturës së gjuhës. Detyra kryesore e tij ishte organizimi i diskutimit popullor të *“Rregullave të drejtshkrimit të shqipes”*, si dhe hulumtimi i një vargu çështjesh të drejtshkrimit të normës gramatikore e leksikore. Aksioni më i madh shkencor në fushën e kulturës së gjuhës qe Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (nëntor 1972).

Në pajtim me vendimet dhe udhëzimet e shprehura në Rezolutën e tij u hartuan *“Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”* (1973) dhe *“Fjalori drejtshkrimor”* (1974). Vepra të rëndësishme në këtë fushë janë edhe *“Gjuha letrare shqipe për të gjithë”* (1976), përmbledhësit *“Norma letrare Kombëtare dhe kultura e gjuhës”* (1973), *“Çështje të normës letrare”* (1980), Revista *“Gjuha jonë”* etj.

Interesimi për problemet e kulturës së gjuhës dhe trajtimi i tyre në shtyp ka ardhur duke u rritur edhe në Kosovë. Në mënyrë të sintetizuar konceptin e sotëm të inteligjencës kosovare për gjuhën letrare dhe kulturën gjuhësore e ka shprehur akademiku Rexhep Qosja: “Gjuha është biografi e popujve, sepse në gjuhë dhe me gjuhën, më mirë se në çdo dokument material, ruhet historia e tyre intelektuale, sociale dhe morale.../ Gjuha e standardizuar letrare është institucioni më i rëndësishëm kulturor i shoqërisë dhe është një institucion aq i rëndësishëm, para së gjithash për dy arsye themelore: e para, se gjuha letrare e lehtëson komunikimin reciprok të një numri më të madh njerëzish, dhe e dyta, për arsye se ajo bën të mundur që thesari kulturor i një populli të vjetërohet gjuhësisht shumë më ngadalë seç do të vjetërohej po të shkruhej në dialekte; domethënë, bën të mundshme që thesari kulturor i një populli, i shënuar në të, të rrojë gjuhësisht shumë më gjatë se ç’rron thesari i shënuar në dialektet e asaj gjuhe. (Qosja, R. 1983 :146).

Me strukturën e saj gramatikore dhe me thesarin e pasur leksikor, gjuha shqipe është dëshmia më e mirë e prirjes, e fuqisë krijuese, e pasurisë shpirtërore dhe emocionale e popullit tonë. Gjuha në të vërtetë, është pasuria jonë më e madhe. Për këto arsye gjuhës i kushtohet një rëndësi e veçantë edhe në kulturën tonë. Shqipja, duke kaluar nëpër një rrugë të gjatë dhe plot pengesa, ka arritur sot në shkallën e një gjuhe të përpunuar, të kristalizuar në hallka të ndryshme të saj, të kodifikuara e të njehsuara, të pasura, të aftë për t’iu përgjigjur kërkesave të larta të një shoqërie të zhvilluar dhe për të ecur më tej përpara (Memishaj, V. Botime Albanologjike 2011 :538).

Në shkencën e gjuhës së folur, ka vend për të hulumtuar edhe etnografinë e të folurit, në të cilën trajtohen variantet e përdorimit të gjuhës, situata e të folurit,

ndikimi i faktorëve jogjuhësorë në gjuhë si p.sh.; faktorët arsimorë, kulturorë, kultura e komunikimit, kontaktet gjuhësore, edukimi gjuhësor në shkollë, etj. (Gjinari, J. & Shkurtaç, Gj. 2003 :245). Pra, përpjekja për të shpjeguar gjithë dukuritë gjuhësore vetëm me ligjet e brendshme të gjuhës, pa marrë parasysh edhe faktorët shoqëror, ku ajo jeton dhe zhvillohet është e gabuar.

Profesorët J. Gjinari e Gj. Shkurtaç pohojnë se zhvillimi i gjuhës standarde është një ilustrim i qartë ku duket ndikimi mjaft i madh i faktorëve shoqërorë mbi faktorët e normës letrare. Gjuha standarde ka funksion realizimin e komunikimit ndërjetimor përdoruesve të saj dhe ushtron ndikimin e saj me mjete të shumta gjuhësore në mjediset dhe shtresa sociale të ndryshme. Studiuesi Shkurtaç shpreh se: *“Me lindjen dhe formimin e gjuhës letrare kombëtare, dialektet paraqiten brenda gjuhës së përbashkët si mbeturina të fazave të mëparshme parakombëtare të gjuhës, kurse gjuha letrare paraqitet si mbikrahinore dhe si shkalla më e lartë e zhvillimit”* (Po aty, :245).

Por gjuha standarde nuk formohet vetvetiu, ajo nuk mund të mbajë vetvetiu unitetin e vet. Për kultivimin dhe ruajtjen e saj është e domosdoshme ndërgjegjja dhe përpjekja e gjithsecilit prej nesh për ta ruajtur dhe kultivuar atë. Gjuha nuk mund të normohet vetvetiu, norma e saj përcaktohet në mënyrë të vetëdijshme, prandaj gjuha standarde duhet të mësohet (Islamaj, Sh. 2002 :29). Natyrisht kjo nuk do të thotë se krijimi i gjuhës standarde është thjesht konstrukt arbitrar, veprim i pavarur nga rrjedha historike dhe nga fuqitë shoqërore. Ajo krijohet mbi bazën e një dialekti organik, dhe si gjuhë standarde e përcaktuar ajo natyrisht që dallohet nga ai dialekt, jo vetëm se bart elemente të një dialekti tjetër, por edhe për arsyen se në të zhvillohen veçori që në dialektin organik mbesin të pashfrytëzuara dhe të dobësuara, megjithatë ajo bart veçoritë e ekzistencës së

vet. (Po aty, :29)

Standardi gjuhësor është një variant i veçantë i gjuhës kombëtare të një bashkësie gjuhësore, i cili ka status më të lartë se sa variantet e tjera. Gjuha standarde mishëron zbatimin e rreptë, tërësinë e normave dhe rregullave fonetike, leksikore, gramatikore të gjuhës shqipe, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë folësit, pavarësisht nga mjedisi, qarqet akademike, politike, mediet dhe gjatë (Chrystal, D. 1969, :64). Norma standarde ka luajtur rol udhëheqës në procesin e zhvillimit gjuhësor, megjithatë është e parakohshme të mendohet se mjafton arsimi i detyrueshëm apo i mesëm që standardi të zotërohet nga populli (Lloshi, Xh. 2001 :150).

1.3 Shtrimi i problemit

Që nga fundi i shek. të 20-të dhe fillimi i shek. të 21-të shoqëria përballet me dukurinë e cilësuar si një “gjuhë e re“, gjuha e komunikimit elektronik. Ky komunikim realizohet me anë të kompjuterit dhe internetit si një medie e rëndësishme gjuhësore dhe sms-ve në telefonat celularë. Një nga shqetësimet më të mëdha në fushën e gjuhësisë në ditët e sotme mbetet çështja e standardit gjuhësor dhe e raportit të tij me ndikimin e globalizimit dhe veçanërisht të komunikimit elektronik.

Kjo çështje është bërë objekt diskutimesh e debatesh në mjaft tubime shkencore, në shtypin e shkruar dhe medien audiovizive dhe elektronike. Kërkimet shkencore në botë për ndikimin e komunikimit elektronik në gjuhën standarde janë të pakta, ndërsa në Shqipëri pothuajse nuk ka të tilla. Debati që lidhet me shqipen standarde është përqëndruar në shqipen standarde aktuale dhe mundësinë për ta ndryshuar atë, ndërsa diskutimet janë përqëndruar në ndikimin e gjuhëve të huaja dhe veçanërisht të gjuhës angleze në komunikimin publik dhe mediatik.

Komunikimi elektronik që përdoret nga të rinjtë e ditëve të sotme ndikon shumë në formimin gjuhësor të tyre, pasi ata janë edhe përdoruesit më të mëdhenj të këtij lloji komunikimi. Interneti po ushtron ndikim të dukshëm te nxënësit, sa që shpesh gjuha e komunikimit elektronik bëhet gjuha e komunikimit të tyre të përditshëm në shkolla. Debatet e vazhdueshme dhe studimet shkencore janë përpjekur që të hedhin dritë mbi dukurinë e bashkëjetesës së gjuhës standarde me gjuhën jostandarde, kurse ndikimi i komunikimit elektronik në shqipen standarde është një dukuri e re që nevojitet të studiohet.

Nga përvoja ime si mësuese kam vërejtur se nxënësit e shkollave të mesme janë shumë të varuar nga interneti dhe se përdorimi i komunikimit elektronik, ka ndikuar shumë në komunikimin e tyre gjuhësor, veçanërisht standardin gjuhësor të të shkruarit. Stili i të shkruarit në komunikimin elektronik pasqyrohet në detyrat me shkrim të nxënësve.

Kur bëhet fjalë për sjelljen gjuhësore të individit dhe të aktivitetit të tij gjuhësor brenda përdorimeve gjuhësore, duhet të merret parasysh edhe hapësira e medieve dhe internetit, të cilat në vitet e fundit kanë fituar një peshë të madhe për shkak të rëndësisë që kanë në jetën e njerëzve në përgjithësi. Rrisitë teknologjike në fushën e medieve kanë bërë që mediet të luajnë një rol shumë të rëndësishëm komunikues në shumicën dërrmuese të bashkësive të folësve nëpër botë, duke krijuar hapësira të përdorimit për shumë gjuhë botërore. Mjetet e informimit si; gazetat, radioja dhe televizioni, përveç komunikimit të informacioneve, janë shndërruar edhe në hapësira, ku ndodh ndërveprimi dhe ndërkomunikimi gjuhësor, dhe rrjedhimisht në këto hapësira mund të shfaqen po ato dukuri sociolinguistike, të cilat mund të hasen në komunikimin njerëzor të përditshëm.

Në dy dekadat e fundit, një rol të rëndësishëm, qoftë për jetën e njerëzve në përgjithësi, qoftë për aktivitetin dhe sjelljen e tyre gjuhësore, është duke e luajtur interneti. Duke qenë mjeti ndoshta më i sofistikuar për bartjen e shpejtë të informatave dhe korespondencës, interneti është bërë mjet i pashmangshëm i aktivitetit të njerëzve, ndërsa përhapja dhe shtrirja e tij në rrafshin global ka ndikuar në integrimin e hapësirave komunikuese botërore, dhe si rrjedhojë ka bërë që kontaktet midis gjuhëve të ndryshme të botës të shtohen në nivele që nuk janë parë më përpara në historinë e njerëzimit. Kësaj dukurie dhe këtij ndikimi të internetit nuk i ka shpëtuar as gjuha shqipe.

Periodha pas viteve 90-të dhe sidomos fillimi i shekullit të 21-të në Shqipëri solli ndryshime të mëdha, ndryshime të cilat u manifestuan në shumë fusha të jetës, po kështu edhe në gjuhë. Këto ndryshime, veç të tjerash, janë pasojë e ndryshimeve që kanë përfshirë edhe popuj të tjerë të Evropës dhe të Botës;

- zhvillimi i hovshëm i teknologjisë informative,
- rritja e nevojës për marrëdhënie tregtare e ekonomike,
- nevoja e bashkëpunimit ndërkombëtar në shumë fusha, e shumë faktorë të tjerë.

Në këtë kontekst të ri të krijuar duhet patur parasysh ndikimi i anglishtes si gjuhë globale, ndikim ky që shfaqet pothuajse në të gjitha gjuhët e botës. Një rol me peshë të madhe në zgjerimin e këtij ndikimi kanë luajtur dhe po luajnë kompjuteri dhe interneti. Edhe pse në Shqipëri përdorimi i internetit nuk ka kohë të gjatë në përdorim, përhapja dhe ndikimi i tij rrodhi shumë shpejt, sa që u kthye në domosdoshmëri pa u kuptuar mirë nga ne.

Përdorimi i internetit është një mundësi e mirë komunikimi, shërben si burim i rëndësishëm i informacionit, ta krijon mundësinë e qasjes në shumë të dhëna në mbarë

botën, të jep mundësi të krijosh lidhje me njerëz të vendeve të ndryshme, etj.. Me gjithë përparësitë që na krijon përdorimi i internetit, ndikimi i tij në gjuhë është i madh dhe po shtohet dita-ditës.

Në këtë kontekst, mund të thuhet se është krijuar një “komunitet” i veçantë i përdoruesve të internetit, të cilët me ose pa vetëdije kanë krijuar një “zhargon” të vetin, që funksionon jashtë normës së shqipes. Jetojmë prej më shumë se 20 vjetësh në një shoqëri të hapur, që po jep e merr “pa doganë” me shoqëri e kultura të tjera, kryesisht përmes takimesh gjuhësore.

Proceset e globalizimit, e në mënyrë të veçantë revolucioni në teknologjitë e informacionit e të komunikimit (TIK), së bashku me kthimin e anglishtes në një “lingua franca”¹ të përbotshme, e kanë vënë shqipen, ashtu si dhe shumë gjuhë të tjera të vogla (por jo vetëm), përpara sfidash mjaft të vështira. E keqja e madhe nuk qëndron, ashtu sikurse jemi mësuar rëndom të dëgjojmë, thjesht e vetëm te depërtimi dhe përdorimi pa kriter i fjalëve të veçanta prej gjuhësh të tjera. Sot ka një “mësymje” fushash të tëra terminologjike prej anglishtes, ku vendin e parë e zë natyrisht terminologjia e TIK, më pas ajo e financës dhe e ekonomisë etj. Në këto kushte gjuhët kombëtare, sidomos ato të popujve të vegjël, e kanë nevojë jetike mbrojtjen dhe kujdesin nga ana e shtetit dhe e shoqërisë. (Jorgaqi, K. :BalkanWeb 2014).

Sot bota është duke jetuar në një revolucion të vazhdueshëm të përparimit teknologjik dhe të teknologjisë informative në veçanti, dhe ky përparim ka bërë që njerëzit në katër anët e botës të afrohen me njëri-tjetrin si kurrë më parë. Në ditët e sotme, interneti luan rolin kryesor në globalizimin e jetës shoqërore të njerëzve dhe është bërë mjete kryesor i procesit të globalizimit.

¹ Një gjuhë që është miratuar si një gjuhë e përbashkët mes folësve, gjuha amtare e të cilëve është e ndryshme.

Por, cili është ndikimi i internetit në gjuhët e ndryshme dhe në komunikimin gjuhësor në përgjithësi? Hapësira e internetit është bërë dhe një medium tjetër për përdorimin e gjuhës. Studiuesi i mirënjohur David Crystal, autor i librit “Language and the internet”, në një shkrim të tij thekson se linguisti nuk ka se si të mos jetë i impresionuar nga interneti si një medium i jashtëzakonshëm, që hedh dritë në shumë anë të natyrës gjuhësore. (<http://www.cambridge.org>). Sipas Crystal, World Wide Web ka krijuar hapësira për përdorimin e të gjitha stileve të shkruara të gjuhës, të cilat janë zhvilluar deri tani në shkrim, por njëkohësisht është duke na njohur edhe me stile të reja të shprehjeve të shkruara, të cilat nuk kanë qenë të njohura deri tani, siç është p.sh. gjuha e animuar (Crystal, D. 2001 :12).

Sa i përket ndikimit të drejtpërdrejtë të internetit në gjuhë, Crystal e bazon këtë ndikim në tri karakteristika të këtij mediumi: *në karakterin formal të tij, në dobinë dhe në përdorimin e tij*. Në bazë të këtyre pohimeve mund të themi se interneti, krahas revolucionit që ka shkaktuar në informim, ka nxitur gjithashtu ndryshime domethënëse, strukturore edhe në gjuhë. Mund të thuhet se interneti ka krijuar një hapësirë të re virtuale, në të cilën është reflektuar i tërë diversiteti dhe variacioni gjuhësor që ekziston në botën reale, ndërkohë që ky ndikim shkon edhe më tej, në kuptim të krijimit të formave të reja komunikative, të cilat nuk janë të pranishme në botën reale. Këto ndikime të internetit vërehen sidomos në dimensionet e reja të komunikimit gjuhësor përmes mesazheve të çastit (instant messaging) në mesenxherë. Në këtë rast kemi riprodhim gjuhësor aty për aty të gjuhës së folur përmes shkrimit. Ky riprodhim pasqyron tërë variacionin stilistikor, i cili haset edhe në gjuhën e folur, pra përdorimin e varieteteve formale dhe joformale pavarësisht nga bashkëbiseduesi dhe tema e bisedës (Po aty :16-20).

Duke u nisur nga pohimet e mësipërme, mund të thuhet se ndërthurja dhe ndikimi i gjuhës dhe internetit, padyshim hapin horizonte të reja studimore sociolinguistike, të cilat do të ishin me shumë interes, sepse do të hidhnin dritë mbi aspekte të caktuara të komunikimit njerëzor në formë virtuale, pra në ato rrethana kur mungon prania fizike, kur mungon trysnia e faktorëve psiko-sociologjikë, të cilët shpesh kanë ndikim të fuqishëm në komunikimin njerëzor, dhe kur mungon reagimi i menjëhershëm.

Përsa i përket përhapjes dhe ndikimit të internetin në gjuhën shqipe, mund të themi se në vitet e fundit përdorimi dhe shtrirja e internetit në trevat shqiptare është rritur ndjeshëm. Janë krijuar faqe të shumta interneti në gjuhën shqipe, programe për të lehtësuar përdorimin e shqipes të cilat janë përkthyer edhe në gjuhën shqipe, duke e lehtësuar në masë të madhe edhe futjen e shqipes nën strehën e internetit dhe duke lehtësuar përdorimin e kompjuterave dhe internetit edhe për shqipfolës, të cilët nuk e njohin gjuhën angleze apo ndonjë gjuhë tjetër të huaj.

Në rrafshin e gjuhës shqipe, interneti ka pasur po të njëjtin ndikim, sikurse edhe në gjuhët e tjera. Ai i ka hapur rrugë variacionit gjuhësor të shqipes, duke mundësuar përdorimin e varieteteve të tjera të ndryshme dialektore e shoqërore të shqipes, krahas gjuhës standarde, e cila në internet përdoret kryesisht nëfaqet e internetit të institucioneve qeveritare e publike dhe në faqet e medieve në gjuhën shqipe. Ky përdorim ka ndikuar në krijimin e formave jo të qëndrueshme gjuhësore, të cilat përdoren në komunikimin e ndërmjetësuar me kompjuter. Në rrafshin gjuhësor, interneti ka ndikuar dhe në zgjerimin e variacionit stilistik gjuhësor, duke krijuar edhe stile të reja të komunikimit, kryesisht në anën joformale të spektrit komunikues.

Disa nga problematikat që lidhen me moszbatimin e standardeve të shqipes së shkruar janë:

- thyerja e rregullave drejtshkrimore
- mosrespektimi i shenjave të pikësimit
- përdorimi i periudhave dhe fjalive të paplota
- shkurtimi i fjalëve pa bazë në standardin e shqipes
- kontraktimi i gjymtyrëve të fjalive
- përdorimi i fjalëve të huaja
- mospërdorimi i shkronjave kapitale aty ku duhen etj.

Tashmë, në dekadën e parë në fillim të shekullit të 21-të gjuha e komunikimit elektronik është një realitet. Ky komunikim realizohet me anë të sms-ve në telefonat celularë ose në komunikimet nëpër rrjetet e ndryshme sociale. Gjuha e përdorur në tekstet e shkruara elektronike është kryesisht informale, jashtë rregullave dhe normave bazë të drejtshkrimit të shqipes së shkruar. Këto tekste ndikojnë shumë në formimin gjuhësor të brezit të ri, pasi ata janë edhe përdoruesit më të mëdhenj të rrjeteve sociale. Ky lloj komunikimi bëhet pjesë e punës së tyre të përditshme në shkolla. Referimi kryesor në këtë hulumtim janë pikërisht nxënësit e shkollave të mesme, pasi ata janë rritur me teknologjinë dhe internetin. Ata janë dhe përdoruesit më aktivë në komunikimin elektronik, në bisedat që zhvillojnë në chat si dhe shkëmbimin e sms-ve. Të qenurit aktiv nëpër biseda i detyron ata që të krijojnë një "gjuhë të tyre" për të arritur ritmin e bisedës dhe për t'iu përshtatur njëri-tjetrit. Gjithashtu fenomeni më shqetësues është fakti se këtë lloj gjuhe ato e përdorin në punimet e tyre, esetë apo projektet e ndryshme. Shpesh është e pamundur që të arrish të kuptosh domethënien e fjalëve që ata përdorin.

Çfarë masash duhen marrë për të evituar këtë fenomen global? A jemi në gjendje ne si shoqëri që të ekuilibrojmë sjelljet gjuhësore formale nga ato joformale? Sa dhe si duhet ndërhyrë?

Me futjen në përdorim të kompjuterit dhe krijimin e rrjeteve kompjuterike është shtuar pesha e asaj që zakonisht quhet “gjuhë e internetit”. Në të vërtetë, me gjuhë të internetit duhet kuptuar ligjërimi elektronik, një lloj i ri i shfaqjes së gjuhës, krahas ligjërimit të zakonshëm. Ashtu si ligjërimi i zakonshëm mund të jetë i folur ose i shkruar, edhe ligjërimi elektronik është i folur dhe i shkruar, po me rend të përmbysur për nga shpeshësia e përdorimit, pasi tekstet elektronike mbizotërojnë ndaj atyre zanore. Ngjashmëria midis këtyre dy formave të ligjërimit shkon edhe më tej, pasi edhe ligjërimi elektronik mund të jetë gjithashtu në lloje stilesh të ndryshme.

Elektronikisht sot publikohen gjithnjë e më shumë vepra shkencore, letrare, publicistike, fetare, fjalorë, krahas botimeve në letër apo edhe vetëm elektronikisht. Ligjërimi elektronik ka marrë një shtrirje të gjerë, duke u përdorur për komunikimin midis individëve në formën e imejlit, të sms-ve në telefonat celularë, të blogjeve sociale, si fejsbuku, twitter-i, linkedin-i etj., të komenteve nëpër artikuj gazetash etj. Madje, shpesh, me “gjuhë të internetit” kuptohen këto forma të komunikimit midis individësh a të individëve me grupe më të gjera sociale.

Debatet e vazhdueshme dhe studimet shkencore e akademike janë përpjekur që të hedhin dritë mbi këtë fenomen, megjithatë mbetet ende shumë për të bërë për faktin që kjo temë ka filluar të studiohet relativisht vonë. Prandaj mendoj që studimi im ka vlerë në këtë fushë dhe do të kontribuojë sado pak në zbatimin e normës së shqipes standarde.

Më poshtë do të shohim disa nga elementet përbërës të gjuhës që përfshijnë tekstet e mesazheve dhe që janë bërë pjesë edhe në instrumentet tona të kërkimit. Gjuha e mesazheve përfshin:

- shkurtesat (të cilat përfshijnë zëvendësimin e shkronjave me simbole me qëllim që të ruajnë një mënyrë të shkruari në telefonat celular),
- fjalët e huaja të huazuara nga gjuhë të ndryshme,
- fjali të paplota, kontraktimet,
- përdorime jo të rregullta të apostrofit,
- raste të përdorimit me shkronja të vogla,
- drejtshkrim jo sipas gjuhës standarde,
- përdorimi i ekzagjeruar i pikave, thirrjeve, pasthirmave, periudhave dhe pikëpyetjeve.

Sipas Crystal, interneti ka një ndikim të jashtëzakonshëm në shkrimin e gjuhës angleze. Duke qenë se kjo është një gjuhë e cila përdoret gjërësisht, tendencat e fundit në shkrimin e saj përmes internetit kanë patur ndikim në formën e saj standarde. Vetëm për një kohë kaq të shkurtër elemente të gjuhës së përdorur në e-mail kanë marrë një përdorim të gjerë edhe në komunikimin e përditshëm. Për shembull, nuk themi *you too*, por *u 2*, ose nuk thuhet më *thank you*, por *thnx...* Kështu pra, biem dakord se në një farë mënyre nga ky lloj komunikimi nuk preket vetëm gjuha e folur, por edhe ajo e shkruar. (Crystal, D. 2008 :88).

Nga ana gramatikore dhe e fjalorit të përdorur, shkrimi në një e-mail i përngjan më shumë gjuhës së folur sesa asaj të shkruar. Në shumicën e rasteve fjalët shkruhen të shkurtuara ose ashtu siç lexohen, pa respektuar asnjë nga rregullat e drejtshkrimit. Gjithashtu, edhe fjalori i përdorur nuk mund të themi se klasifikohet në

një fjalor të përzgjedhur. Fjalët që shkruhen nuk përzgjidhen fare dhe kjo e bën shkrimin automatikisht në një shkrim joformal. Gjithashtu, ka shumë raste ku edhe një fjali e tërë mund të shkruhet me shkurtime, me iniciale, me simbole apo edhe pa shenja pikësimi.

Në shumicën e rasteve në fjalitë e shkruara në e-mail nuk para hasen më fjalë apo fjali të plota, por shkurtime dhe simbole të cilat e bëjnë këtë komunikim më të shpejtë. Aty gjithashtu mund të gjejmë pafund shembuj mbi mungesën e foljeve modale, nyjeve shquese dhe mbi të gjitha një mungesë e theksuar e kryefjalës së shprehur me përemrin vetor në vetën e parë. Përsa u përket shenjave të pikësimit në këto lloje komunikimi kemi kontraditë në përdorimin e shenjave të pikësimit. Në fjalitë e shkruara hasim një ekzagjerim të përdorimit të shenjave të pikësimit, si për shembull, disa pikëçuditje radhazi në vend që të shkruhet vetëm një, ose e kundërta, asnjë pikë apo presje aty ku duhet (Po aty, 2008).

Edhe shprehja e emocioneve apo ndjenjave në shkrime të tilla është një karakteristikë më vete. Në shumicën e rasteve ndjenjat apo emocionet ose shkruhen të shkurtuara ose nuk shkruhen fare, pasi në vend të tyre përdoren simbole apo figura që tashmë njihen nga të gjithë si “emojcons”. Këto figura janë shumë të përhapura për vetë faktin se kryejnë më së miri funksionin e këtij komunikimi, përçojnë mesazhin e duhur në një kohë fare të shkurtër dhe pa u lodhur për të shpjeguar me shumë fjalë atë që ndien. Edhe pse në fillim këto figura përdorshin vetëm nga të rinjtë, në ditët e sotme po gjejmë një përdorim të madh edhe mes të rriturve, të cilët duket sikur janë infektuar nga përdorimi i këtyre simboleve.

Baron, thekson se këto ndryshime në lidhje me shkrimin dhe format e shkrimit të gjuhës angleze në vitet e fundit vijnë edhe si një rezultat social. Më parë njerëzit

mësoheshin me shumë rregulla dhe korniza sjelljesh dhe komunikimi aq sa shpeshherë është e pamundur t'i memorizosh të gjitha. Një lloj komunikimi me prindërit, një tjetër me shokët, një tjetër me eprorët, një tjetër lloj me të panjohurit e kështu me radhë (Baron, 2000 :213).

Pas Luftës së Dytë Botërore, u vu re një ndryshim rrënjësor jo vetëm në shkrim por edhe në sjellje. Më në fund njerëzit filluan t'i jepnin më shumë rëndësi mesazhit që transmetohej dhe idesë se sa vetë formës që përdorej për ta transmetuar këtë mesazh(Baron, 2000 :21). Kështu, pak nga pak edhe komunikimi mes njerëzve filloi të merrte trajta të tjera.

E njëjta gjë po ndodh edhe me shkrimin elektronik, i cili sipas Baron, në një farë mënyre është duke reflektuar ndryshimet sociale dhe gjuhësore, por është shumë e vështirë të përcaktohet nëse po ndikon elektronika në shkrimin dhe sjelljet e njerëzve apo është shoqëria ajo që ndikon dhe kushtëzon mënyrat e të shkruarit në internet (Baron, N.S. 2001, :2).

Pra, pamë që interneti ka një ndikim të fuqishëm jo vetëm si mjet për shkëmbimin e informatave, por edhe në kuptim të ndryshimeve shoqërore që është duke shkaktuar. Në këtë aspekt interneti e ka revolucionarizuar edhe komunikimin gjuhësor duke i dhënë dimensione të reja, dhe në kuadër të këtij revolucioni komunikues edhe gjuha shqipe është duke u përballur me një sërë situatash që shpesh bëhen problematike për zbatimin e normave dhe rregullave gjuhësore.

1.4 Qëllimi i studimit

Ky studim sjell në vëmendje të studiuesve, mësuesve dhe nxënësve kujdesin e madh që duhet të kemi për mbrojtjen e gjuhës, për vetë faktin se ajo është shumë e ndikuar si nga

globalizmi gjuhësor ashtu edhe nga risitë dhe teknologjitë e reja të shekullit të fundit.

Studimi synon:

- a) të hulumtojë në ç'shikullë ndikon komunikimi elektronik te nxënësit e shkollave të mesme në përdorimin e shqipes së shkruar standarde;
- b) të analizojë mënyrën se si nxënësit, nën ndikimin e komunikimit elektronik, përdorin shkurtesa të ndryshme fjalësh apo zhargone e fjalë të huaja, duke i bërë ato pjesë të komunikimit të tyre;
- c) të investigojë si po punon shkolla në kontekstin e ri të epokës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për t'u mësuar nxënësve përdorimin e shqipes standarde.

Punimi argumenton dhe qartëson më tej vlerën që merr mësimi dhe studimi i gjuhës shqipe sipas rregullave dhe normave bazë të saj, si dhe faktin se duhet të jemi në koherencë me zhvillimet e ndryshme të shoqërisë që për pasojë ndikojnë edhe në përdorimet gjuhësore.

Objektivat në të cilat u përqëndrua studimi janë:

- Të evidentojë nëpërmjet analizës statistikore faktorët që ndikojnë në shkeljen dhe mosrespektimin e rregullave të shqipes standarde.
- Të përcaktojë nivelin e ndikimit të komunikimit elektronik në standardin e shqipes së shkruar në veçanti.
- Të vlerësojë mënyrën dhe format e të shprehurit në gjuhën standarde.
- Të analizojë përdorimin e gjuhës së mesazheve telefonike dhe chat-it, si dhe ndikimin e tyre gjatë komunikimit formal në shkollë.
- Të masë nivelin e njohjes nga nxënësit e shkollave të mesme të shkurtesave të

shqipes së shkruar standarde dhe atyre jostandarde.

- Të krahasojë marrëdhëniet e gjuhës formale me atë joformale.

1.5 Hipotezat dhe pyetjet kërkimore

Studimi ka në qendër këto hipoteza dhe pyetje kërkimore.

Konteksti

Një pjesë e madhe e njerëzve besojnë se të rinjtë shpenzojnë shumë kohë duke komunikuar elektronikisht me njëri-tjetrin. Në këtë lloj komunikimi ata përdorin shumë shkurtesa, fjalë të huaja dhe kode të caktuara të diktuar nga hapësira kohore, shpejtësia e komunikimit dhe kostoja. Përvoja ime si mësuese dhe pedagoge në universitet, dëshmon se nxënësit po përdorin gjithnjë e më shumë gjuhën e mesazheve telefonike dhe chat-it në komunikimin shkollor. Të rinjtë, duke qenë përdoruesit më të mëdhenj të internetit, po përdorin në komunikimin shkollor shumë fjalë të huaja në vend të ekuivalentit të tyre në shqip, fjali të paplota, dhe struktura gjuhësore që nuk janë karakteristike për gjuhën shqipe.

Hipoteza 1:

Nxënësit e shkollave të mesme e përdorin gjuhën e mesazheve telefonike dhe të chat-it në punët e tyre me shkrim në shkollë duke mos u kujdesur për përdorimin e shqipes standarde.

Pyetja kërkimore 1

A ndikon stili i komunikimit me SMS dhe Chat në standardin e gjuhës shqipe të shkruar?

Hipoteza 2

Nxënësit nuk i njohin shkurtesat e shqipes së shkruar standarde.

Pyetja kërkimore 2

A i përdorin nxënësit shkurtesat e reja të formuara rishtazi pa bazë në standardin e shqipes?

Hipoteza 3:

Shkurtesat e fjalëve në gjuhë të huaj janë bërë pjesë e kulturës gjuhësore të nxënësve.

Pyetja kërkimore 3.1

A ka dallime midis nxënësve të shkollave të ndryshme lidhur me njohjen e shkurtesave standarde në gjuhën shqipe? Nëse po, nga cilët nxënës njohen ato më shumë?

Pyetja kërkimore 3.2

A vërehen dallime lidhur me përdorimin e shkurtesave standarde në gjuhën shqipe sipas nivelit të nxënësve (klasave). Nëse po, cilët nxënës i përdorin ato më shumë, nxënësit e klasave më të ulëta apo ata të klasave më të larta?

Pyetja kërkimore 3.3. A vërehen dallime në përdorimin e shkurtesave jostandarde në gjuhën e huaj midis nxënësve të klasave të ndryshme? Nëse po, ku janë më të përdorshme këto shkurtesa?

Hipoteza 4

Përdorimi i fjalëve të huaja gjatë komunikimit elektronik ka ndikuar në devijimin e drejtshkrimit të gjuhës standarde.

Pyetja 4: A ka dallime midis nxënësve të shkollave të qytetit dhe atyre në periferi lidhur me përdorimin e fjalëve të huaja? Nëse po kush i përdor ato më shumë, nxënësit e shkollave të qytetit apo ata të shkollave në periferi?

1.6 Variablat

Klasifikimi i variablave dhe grupimi i tyre në këtë studim i referohet mbledhjes së të dhënave të marra nga pyetësorët dhe esetë si dhe arritjes së qëllimit të këtij punimi.

Variablat e studimit janë cilësore dhe ndahen në dy grupe:

1. Njohja e shkurtesave standarde të shqipes dhe huazimeve e fjalëve të huaja
2. Përdorimi i shkurtesave standarde të shqipes dhe huazimeve e fjalëve të huaja.

Përsa u përket llojit të variablave, të varura dhe të pavarur, lidhja dhe analiza midis tyre bëhet tek pyetjet kërkimore dhe hipotezat. Specifikisht variablat dikotomike, të cilat u analizuan nëpërmjet hipotezave dhe pyetjeve kërkimore janë:

- Vlerësimi i standardeve të gjuhës shqipe
- Ndikimi i komunikimit elektronik
- Njohja e shkurtesave standarde
- Përdorimi i shkurtesave standarde
- Njohja e fjalëve të huaja
- Përdorimi i fjalëve të huaja

1.7 Rëndësia e studimit

Dukuria e komunikimit elektronik po gjen terren çdo ditë e më shumë në jetën e gjithsecilit, kështu që është mjaft e rëndësishme të trajtohet një fenomen i tillë duke u bazuar në aspektet gjuhësore. Gjetjet e këtij studimi i shërbejnë zgjerimit të

njohjes dhe qartësisht të problemeve në ndërveprimin e komunikimit elektronik me standardin e gjuhës.

Ky studim është i rëndësishëm, sepse argumenton dhe analizon ndikimin e komunikimit elektronik në përdorimin e shqipes standarde. Nëpërmjet këtij studimi kërkimor lidhur me faktorët dhe shkaqet që ndikojnë në përdorimin e shqipes standarde, zbulohen ndikimet e komunikimit elektronik në punët me shkrim të nxënësve.

Studimi jep informacion për nivelin e njohjes së gjuhës nga nxënësit tanë në shkollat e mesme, duke u fokusuar në llojet e rregullave drejtshkrimore që thyhen më së tepërmi në gjuhën shqipe.

Studimi ka rëndësi gjithashtu për faktin se ndihmon mësuesit të reflektojnë për përdorimin dhe aplikimin me sa më efektivitet të metodave dhe teknikave bashkëkohore të mësimit të shqipes standarde në shkollë.

1.8 Struktura e punimit

Punimi u organizua në gjashtë kapituj, ku brenda çdo kapitulli në përputhje me tematikën, problematikën dhe metodologjinë e ndjekur u nënrenditën nënkapituj dhe tituj të veçantë.

Në kapitullin e parë, të titulluar “*Hyrja*”, paraqitet sfondi historik, prezantimi i problemit, qëllimi i studimit, pyetjet e studimit, rëndësia e studimit dhe struktura e tij.

Në kapitullin e dytë shqyrtohet *literatura* e shfrytëzuar e punimit, si dhe bëhet një analizë e modelit analitik të temës, duke u ndalur veçanërisht në konceptin e gjuhës standarde, historikun e formimit të saj dhe evoluimin në ditët e sotme.

Në kapitullin e tretë është trajtuar në *kontekstin historik*, zhvillimi i teknologjisë së

komunikimit, duke u ndalur veçanërisht tek komunikimi elektronik dhe tek ai telefonik.

Në kapitullin e katërt trajtohet *metodologjia* e përdorur e punimit, zgjedhja e kampionit dhe popullatës, burimi i të dhënave, instrumentet e studimit, etika dhe kufizimet e tij.

Në kapitullin e pestë trajtohen *rezultatet e studimit*, gjetjet e tij nga pyetëtorët dhe esetë si dhe paraqitet diskutimi i të dhënave konkrete që rezultuan nga hipotezat dhe pyetjet kërkimore të studimit.

Në kapitullin e gjashtë jepen *përfundimet dhe rekomandimet* e punimit.

Punimi përmban bibliografinë dhe shtojcat.

KAPITULLI II: SHQIPJA STANDARDE

2.1 Koncepti i gjuhës standarde, tiparet themelore të saj

Në këtë pjesë të studimit do t'i kushtojmë një vëmendje të veçantë edhe konceptit të gjuhës standarde. Në studime të ndryshme gjuha standarde është emërtuar si gjuhë letrare ose gjuhë letrare e standardizuar, gjuhë letrare e njehsuar, gjuhë letrare e normatizuar, e kodifikuar, gjuhë letrare kombëtare e përbashkët, zyrtare (shtetërore) etj.. Si term më i saktë do të ishte gjuhë standarde ose gjuhë letrare e njehsuar.

Mënyra se si njerëzit e konceptojnë standardizimin e një gjuhe ndryshon nga ajo sesi e shohin gjuhëtarët. Njerëzit e thjeshtë, në ndryshim nga studiuesit dhe gjuhëtarët, e shikojnë standardizimin e një gjuhe të lidhur me fjalorin që përdorin njerëzit. Nëse je duke përdorur një regjistër të lartë me një gjuhë formale dhe të përzgjedhur, atëherë njerëzit mendojnë se kjo është pikërisht ajo që nënkupton gjuhën standarde. Ndërsa përsa u përket gjuhëtarëve, ata e lidhin standardizimin me korrektësinë e gjuhës, pra një dokument i shkruar, i cili nuk është i saktë nga ana gramatikore, drejtshkrimore, nuk mund të cilësohet si një shkrim në gjuhën standarde. Prandaj është shumë e rëndësishme edhe për studimin tonë që të veçohen këto të dyja, pasi është pikërisht keqkuptimi i koncepteve të ndryshme që sjell edhe probleme të tjera në lidhje me gjuhën e folur apo të shkruar.

Për studiuesit dhe gjuhëtarët nuk është e thjeshtë të flasin në lidhje me gjuhën standarde, pasi vetë gjuha ndryshon dhe evolon gjatë gjithë kohës. Edhe vetë fenomeni i shkrimit elektronik është një faktor i këtij ndryshimi. Gjuha standarde ka ardhur si rrjedhojë e një nevojë që ekzistonte sidomos në ato gjuhë ku variantet ishin të shumta,

si gjuha angleze për shembull, ku mund të numërojmë disa variante dhe do të ishte shumë e vështirë të komunikohesh nëse nuk do të shkriheshin të gjitha në një. Ky është një proces që ka filluar përpara shumë vitesh dhe vazhdon të evoluojë edhe sot.

“ Në gjuhë ka vetëm ndryshime”, - thotë Sosyri. Një gjuhë ekziston në një numër varietetesh dhe në një lloj kuptimi është shuma e këtyre varieteteve. Varietetet e një gjuhe janë të shumta, sepse edhe modalitetet që shkaktojnë lindjen e tyre janë të ndryshme dhe të larmishme. Përsa i përket larmisë dhe ndryshueshmërisë së pafundme të të folurit apo ligjërit të folur të njeriut në një bashkësi gjuhësore të dhënë mund të shqyrtojmë pohimin e Sosyrit: “Gjuha është një sistem ku gjithçka mbahet, ndryshon”.

Lidhur me këtë pohim sociolinguistët mund të pohojnë se është ashtu nga pikëpamja mirëfilli teorike dhe në një kuadër gjithsesi abstrakt, por duhet parë e dalluar mirë gjuha si sistem konkret, si e tërë, si një njësi gjithëpërfshirëse nga realizimet e saj konkrete në të folurit e individëve dhe në lidhjet e larmisë së pafundme të realizimeve e të ndryshimeve ligjërimore të njerëzve në përputhje me faktorë të shumtë shoqërorë, mjedisorë, kulturorë dhe përgjithësisht jashtëgjuhësorë. Me fjalë të tjera gjuha na del si sistem i ngulitur dhe i njëjtë vetëm nëse e shohim nga larg dhe duke u nisur nga abstraktja (la langue), përndryshe nëse mbështetemi në realizimet konkrete të gjuhës (la parole) na rezulton një pamje shumë e larmishme dhe e ndryshueshme.

Roli i gjuhës në shoqëri është shumë i rëndësishëm. Kur themi se gjuha është dukuri psiko-shoqërore, kemi parasysh faktin se ajo është tipar i qenieve njerëzore dhe jo i kafshëve, atyre qenieve që kanë ndërgjegje dhe ndjenja ose psikikë të shkallës më të lartë. Prandaj është pranuar nga shumica e gjuhëtarëve që njësia themelore e gjuhës është fjala. Fjalët, pa të cilat gjuha nuk mund të ekzistojë, janë sipas Pavlovit sinjal i

sinjaleve të para, veshje materiale e mendimit a veshje tingullore e koncepteve të ndërtuara mbi bazën e ndijimeve e perceptimeve (Memushaj, R. 2002 :329).

Gjuhët standarde janë interesante, sepse vendosin një raport të posaçëm me shoqërinë, një raport mjaft jonormal në qoftë se vështrohet në kontekstin e qindra mijëra vjetëve kur është përdorur gjuha. Ndërsa mendohet që zhvillimi normal i një gjuhe ndodh në mënyrë fare rastësore dhe për më tepër nën vetëdijen e folësve, gjuhët standarde janë produkt i një ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë dhe të paramenduar nga ana e shoqërisë. Një ndërhyrje e tillë e quajtur “standardizim” prodhon një gjuhë standarde, aty ku më parë kishte vetëm dialekt, pra varietet jostandard (Hudson, R. 2002 :43).

Sipas Hudson një gjuhë mund të quhet standarde tipike nëse kalon nëpër katër etapa të rëndësishme, të cilat do t’i paraqesim më poshtë:

1. *Selektimi* – Nga të gjithë variantet e mundshme të një gjuhe, zgjidhet njëri i cili konsiderohet si varianti më i thjeshtë për t’u kuptuar nga të gjithë, ose bëhet një shkrirje variantesh dhe prodhohet një variant gjuhësor që plotëson pritshmëritë e të gjithë folësve të asaj gjuhe dhe më tej, pasi është zgjedhur si variant aplikohet duke u përdorur fillimisht tek qeveritarët, deputet apo edhe intelektualët e një vendi. Arsyeja pse shpeshherë njerëzit e personifikojnë gjuhën standarde me fjalimet e një qeveritari është pikërisht, sepse ata janë të parët të cilët e aplikojnë këtë lloj gjuhe si për ta imponuar tek të tjerët.

2. *Kodifikimi* – Fjalorët dhe librat gramatikorë janë bërë pikërisht për të rregulluar variantin e zgjedhur si varianti standard i një gjuhe, në mënyrë që të pranohet dhe të kuptohet nga të gjithë folësit e asaj gjuhe. Kështu edhe njerëzit do ta kenë më të thjeshtë të korrigjojnë gabimet e tyre apo edhe të kuptojnë se çfarë është e saktë dhe çfarë jo. Kjo detyrë zakonisht u caktohet akademikëve ose agjencive të specifikuar

në lidhje me gjuhën dhe kërkimet shkencore. Pasi është kryer edhe procesi i kodifikimit të një gjuhe, janë pikërisht qytetarët e zellshëm e ambiciozë të cilët i respektojnë gjithnjë e më shumë këto rregulla dhe transmetojnë edhe tek njerëzit e thjeshtë rëndësinë e tyre, edhe pse sipas Hudson, kjo është praktikisht pak e vështirë për t'u arritur në një kohë të shkurtër, prandaj edhe arsimit bazë në të gjithë botën zgjat për vite me radhë, sepse gjuha qoftë kjo edhe gjuha amtare është shumë e vështirë të mësohet e më pas të praktikohet në mënyrën e duhur.

3. *Kultivimi i funksionit* – Në mënyrë që varianti i përzgjedhur i gjuhës të konsiderohet si variant standard është e nevojshme t'i shtohen edhe terma specifikë, gjuhësorë, shkencorë apo teknikë. Këto fjalë të reja, të cilat i shtohen variantit të përzgjedhur, janë shumë të rëndësishme, pasi jo vetëm që e pasurojnë atë, por edhe i hapin rrugë zhvillimit gjuhësor. Mbi të gjitha janë pikërisht këto fjalë të cilat do të përdoren më pas në letrat formale, në dokumente të ndryshme, në fjalime të ndryshme, në libra apo edhe në “rrjete” të ndryshme. Duke qenë se këto fjalë mund t'i lexojmë kudo, atëherë do të jetë më e thjeshtë për njerëzit të kuptojnë gjuhën standarde dhe rolin e saj.

4. *Pranimi* – Është shumë e rëndësishme që varianti i përzgjedhur të pranohet nga të gjithë, nga i gjithë populli, pavarësisht nivelit arsimor, sepse ky variant do të kthehet në gjuhën kombëtare, në gjuhën përfaqësuese, në gjuhën e cila simbolikisht forcon më shumë një komb, sidomos nëse ajo pranohet nga të gjithë.

Por ku konsiston pranimi? Për njerëzit dhe gjuhëtarët së bashku pranimi i gjuhës konsiston në faktin që rregullat gramatikore dhe kodifikimet e përcaktuara më parë të njihen e të zbatohen nga të gjithë (Po aty :45).

Standardizimi i gjuhës relativisht kalon nëpër disa etapa zhvillimi dhe për të

arritur në këtë shkallë ajo duhet të fitojë disa tipare të reja cilësore, si nga ana struktorore, ashtu edhe nga ana funksionale.

Në mënyrë të përmbledhur disa nga këto tipare janë:

1. *Përgjithshmëria dhe përbashkësia*, çka do të thotë se ajo është një gjuhë letrare e përbashkët dhe e përgjithshme, e përdorshme domosdoshmërisht nga të gjithë kombasit dhe shtetasit (Samara, M. 2005 :29). Pra, është një gjuhë shtetërore zyrtare, një faktor i rëndësishëm për komunikim ndërshtetëror, për në punë, në shkollë, në komunitet e në shoqëri.

2. *Identiteti* i gjuhës, i cili shprehet në specifikën kombëtare a kombëtarësinë e sistemit dhe të strukturës së saj, si dhe në origjinalitetin e anëtarësisë së saj, d.m.th. në veçoritë specifike të sistemit fonetik, gramatikor, fjalëformues e leksikor. Origjinaliteti ose amësia e saj shfaqet në trajtat morfologjike e sintaksore, në mjetet e saj shprehëse ose stilistike që përdoren të lidhura ngushtë me mjedisin, me synimet e folësit, duke shfaqur kështu një nivel të lartë kulturor, që u shërben të gjithëve.

3. *Norma letrare e gjuhës standarde*, e cila është tërësia e mjeteve më të qëndrueshme, më të përgjithshme të strukturës e të sistemit të saj, të zgjedhura si më të drejta dhe të fiksuara a të ngulitura në ligjërime. Është pikërisht ky tipar i normës që i jep gjuhës letrare karakterin standard, kurse neve na jep të drejtën ta quajmë atë gjuhë letrare të normatizuar ose gjuhë standarde.

4. *Karakteri normativ i gjuhës letrare në të folur dhe në të shkruar*. Historikisht kur formohet a lind një gjuhë e një etni e një populli, të folurit natyrisht i paraprin të shkruarit, rrjedhimisht në të folur norma kristalizohet më vonë, por të shkruarit i paraprin të folurit përse i takon procesit të standardizimit, meqë procesi i standardizimit fillon me gjuhën e shkruar dhe udhëhiqet prej saj.

Shfaqje e parë dhe më e dukshme është kristalizimi i normës drejtshkrimore. Kjo do të thotë se çdo gjuhë letrare unifikohet më shpejt në aspektin e shkruar se sa në atë të folur.

Atëherë lind pyetja se pse ndodh një gjë e tillë? Ndër arsytet më kryesore mund të përmendim:

a) Në aspektin e folur gjuha është më shumë në lëvizje, pëson zhvillime të vazhdueshme, madje edhe ndryshime, veçanërisht nga pikëpamja fonetike e leksikore, meqë folësi është më i shkuajdesur kur flet. Kurse në aspektin e shkruar bartësi i saj është më i përqëndruar dhe më i ndërgjegjësuar për të mos bërë gabime drejtshkrimore, gjuhësore, gjuha dhe norma në aspektin e shkruar është më e qëndrueshme, krijon një traditë të dokumentuar që ruhet sidomos në rregullat e kodifikuara gramatikore e drejtshkrimore.

b) Në aspektin e shkruar gjuha lidhet më shumë me shtresat e arsimuara, që e përvetësojnë normën në shkollë dhe prandaj e zbatojnë më lehtë atë. Ndërsa në aspektin e folur, sidomos pjesa e popullsisë që nuk e shkruan çdo ditë ose nuk ka shkruar në shkollë rregullisht, mund të ndikohet drejtpërdrejt nga të folmet e dialektit të vet. (Samara, M. 2005 :35-38)

5. *Funksionet e gjera shoqërore të gjuhës letrare.* Gjuha është polivalente, pra kryen funksione të gjera shoqërore si në sferat më të rëndësishme të jetës dhe veprimtarisë shoqërore, ashtu edhe në hapësirë, në të gjitha krahinat, brenda e jashtë vendit, kudo ku jetojnë e banojnë bartësit e saj si një e drejtë e tyre për të përdorur gjuhën amtare kombëtare për t'u shkolluar, për të kryer punë zyrtare, administrative në marrëdhënie me shtetin brenda të cilit jetojnë. Gjuha, megjithëse ekziston për të kryer një funksion shoqëror, komunikimin, është prapëseprapë e vendosur në

mendjen e individëve. (Guy, 1980).

”Gjuha i jep mundësinë njeriut që të përfshihet në një status të caktuar mbi bazën e të cilit ai vishet me një prestigj social (Sharl Bali, 2006 :33).

2.2 Standardizimi i shqipes dhe planifikimi gjuhësor

Gjuha shqipe, si një ndër gjuhët më të vjetra në Ballkan, ka kaluar nëpër shumë faza të zhvillimit dhe të transformimit të saj. Në këtë proces, shqipja ka qenë e ndikuar vazhdimisht nga faktorët e ndryshëm gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë, ndërsa rrethanat e ndryshme historike nëpër të cilat ka kaluar shqipja kanë ndikuar që hapësirat e saj të përdorimit herë të ngushtohen, herë të zgjerohen. Kjo ka ndikuar që pozita e shqipes dhe e varieteteve të saj, në raste të caktuara, të jetë mjaft e pavolitshme, ndërsa në rastet e përmirësimit të gjendjes ekonomiko-politike të popullit shqiptar, është përmirësuar edhe pozita e shqipes. Me fjalë të tjera, fati i shqipes në kohë dhe në hapësirë ka qenë i lidhur me fatin e bashkësisë shqiptare në përgjithësi dhe përmirësimi i pozitës së shqiptarëve është reflektuar edhe në përmirësimin e pozitës dhe të statusit të gjuhës shqipe.

Gjuha standarde është model i përdorimit të një gjuhe. Ajo mëshiron zbatimin e përpiktë të tërësisë së normave e rregullave fonetike, leksikore e gramatikore të gjuhës shqipe që janë të detyrueshme për çdo folës zyrtar të saj. Në rrafshin historik gjuha standarde shqipe ka qenë ëndërr dhe synim i brezave të tërë të dijetarëve, atdhetarëve dhe dashamirësve të saj. E parë në përgjithësi në “*sistemin gjuhësor*” gjithçka prodhohet nga njësia folëse e një populli (p.sh. e popullit shqiptar në rastin e shqipes). Kjo përbën atë që quhet gjuhë, por kjo gjuhë e parë nga afër, e vëzhguar në realizimet e saj konkrete gjatë të folurit të njerëzve, rezulton se është shumë e larmishme dhe jo e njëjtë. Gjuha mund të ndryshojë sipas krahinave nga ku dhe kemi dialektet, nëndialektet, grupet e të

folmeve, të folmet vendore etj. Gjithashtu ndryshimet gjuhësore varen edhe nga faktorët shoqërorë si: arsimimi, profesioni, bashkëbisedimi, mjedisi ku kryhet procesi i të folurit, etnitë, ndarjet fetare etj. (Shkurtaç Gj. 2009 :150)

Nga pikëpamja gjuhësore dialekti nuk ka dallime nga gjuha, secili dialekt i shqipes, qoftë gegërishtja, qoftë toskërishtja, në vetvete mund të quhen gjuhë shqipe. Kjo mund të thuhet, sepse dialekti nuk është ‘nënprodukt’ i gjuhës letrare kombëtare, por një pjesë tërësore e saj, një sistem komunikimi i kryer dhe i pavarur edhe pse ka një numër më të kufizuar folësish.

Vetë gjuha letrare ose gjuha e standardizuar nuk është gjë tjetër veçse një dialekt që është përkrahur, mbështetur dhe favorizuar në një situatë të caktuar dhe është ngritur në përdorim për të gjithë kombin, për të gjithë bashkësinë përkatëse. Gjuha letrare ka funksion komunikimi gjithëkombëtar, ushtron ndikim me mjete të ndryshme në mjedise dhe shtresa të ndryshme. Me lindjen dhe formimin e standardit, dialektet paraqiten si krahinore, kurse gjuha letrare si mbikrahinore dhe si shkalla më e lartë e zhvillimit. Procesi i shtrirjes së gjuhës letrare në të gjitha shtresat shoqërore është shumë i gjatë, sepse forca e trasmetimit të gjuhës dialektore nga një brez në tjetrin është shumë e madhe. Veprimi i ndikimit të gjuhës letrare mbi dialektet nuk është i njëjtë në shtresa të ndryshme shoqërore të popullsisë së një vendi. Standardi vepron ndryshe në brezin e ri e ndryshe në brezin e vjetër, ndryshe tek njerëzit e arsimuar e ndryshe tek ata pa arsim, ndryshe tek ata që lëvizin e ndryshe tek ata që nuk dalin prej krahinës, ndryshe në fshat e ndryshe në qytet.

Tanimë kur është formuar dhe është ngulitur standardi, ai shtrihet kudo dhe gjithmonë e më shumë kërkon të zotërojë e të përdoret nga më shumë individë e nga më shumë grupe shoqërore të bashkësisë kombëtare.

Në ditët e sotme dialektet ende kanë shtrirje territoriale e përdoren në jetën e përditshme brenda zonave ku shtrihen, por tanimë ato nuk janë si dikur. Bashkësitë shoqërore të këtyre grupeve nuk qëndrojnë vetëm brenda kufijve dialektorë, por tërhiqen nga individë dhe grupe shoqërore që e zotërojnë gjuhën letrare. Standardi është pjesë e sistemit të tyre gjuhësorë nëpërmjet ndikimit që ka gjuha letrare me anë të shtypit, librit, radios , televizionit etj.

Dialektet ndjekin rrugën e konvergimit të tyre me gjuhën letrare. Kjo është rruga e vetme nëpër të cilën kalojnë dialektet, sepse me ngulitjen e gjuhës së njehsuar letrare funksioni i tyre vjen duke u kufizuar nga pikëpamja gjeografike e shoqërore dhe tani i nënshtrohet funksionit të gjuhës letrare dhe normave të saj. Megjithëse prirja e dialekteve dallohet shpesh në gjuhën e folur, kjo nuk do të thotë se lidhjet dhe marrëdhëniet e tyre me gjuhën letrare janë të njëanshme. Në të vërtetë marrëdhëniet e tyre janë të dyanshme, sepse dialektet veprojnë mbi gjuhën letrare duke i dhënë asaj ato elemente për të cilët ajo ka nevojë të pasurohet edhe më tej. Mendoj se dialektet dhe gjuha standarde bashkëpunojnë me njëri-tjetrin gjithmonë në të mirë të normës, pasurimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të saj (Kostallari A. 1988 :14).

Ky zhvillim kryhet pjesërisht në mënyrë të vetvetishme për shkak të zhvillimit të brendshëm të gjuhës dhe pjesërisht në mënyrë të ndërgjegjshme duke vepruar shoqëria në përputhje me zhvillimin e vetë gjuhës. Procesi i ndërgjegjes kryhet me ‘ndërrhyrje’ nga jashtë duke vepruar me veprimtarinë e tyre shkrimtarët, gjuhëtarët, specialistët e ndryshëm të fushave të ndryshme. Marrëdhëniet e ndryshme midis gjuhës dhe dialekteve mund të shpjegohen duke përdorur edhe konceptet e pushtetit dhe solidaritetit. Pushteti kërkon disa lloje të marrëdhënieve asimetrike midis etnive (Hudson R. : 265). Dikush ka diçka më shumë se dikush tjetër si psh., statusin, paratë

ndikimin, etj.. Çdo gjuhë ka më shumë pushtet se secili dialekt ndërsa solidariteti është ndjenja e barazisë që njerëzit kanë me njëri-tjetrin kur përdorin gjuhën. Standardizimi lidhet me procesin nëpërmjet të cilit zgjidhet një varietet si model, më pas vjen kodifikimi në disa drejtime. Vetë procesi i standardizimit kryen një shumëllojshmëri funksionesh. Ai unifikon individë dhe grupe brenda një bashkësie të madhe, ndërsa në të njëjtën kohë i ndan ato nga bashkësitë e tjera. Prandaj, kjo është në gjendje të reflektojë dhe të simbolizojë disa lloje identitetesh si: krahinore, shoqërore, etnike dhe fetare.

Gjuha standarde ose letrare e njehsuar funksionon në formën e shkruar dhe në formën e folur. Midis këtyre dy varianteve ka edhe dallime dhe ndryshime gjuhësore, stilistikore, fonetike, gramatikore etj. Nga të dyja format e gjuhës letrare, më e zbuluar dhe më e ndjeshme ndaj trysnisë së përditshme të dialekteve është forma e folur e sidomos ligjërimi bisedor. Sferat më të prekura nga prurjet dhe shprehjet dialektore janë sfera e leksikut dhe e sintaksës. Ato janë gjithmonë të hapura ndaj veprimeve të dialekteve, kanë nevojë për variante funksionale, kanë ndërtime dhe fjalë sinonime që duhen pasuruar kohë pas kohe duke zëvendësuar fjalët dhe shprehjet e huaja me ato vendase, por që kanë një funksion të veçantë, duke mos prishur normën e fiksuar letrare, pasi standardi nuk do t'i pranonte ato.

Sferat e fonetikës e të morfologjisë i ndiejnë më ngadalë ndryshimet pasi ato gjejnë përdorim në gjuhën e folur letrare dhe pastaj mund të zënë vend në formën e shkruar duke e ndryshuar normën në mënyrë të pjesshme ose krejtësisht. Psh. dialektet ushtrojnë sot trysni mbi formën e shkruar për të mos përdorur zanoren –ë të patheksuar në rastet ku gjendet në fund të temës fjalëformuese si psh. (puntorë për punëtorë apo antarë për anëtarë,) ndërrimet historike të a>ë, (nana-nëna, hana-hëna), asimilimi i

grupeve mb, nd , ng, ngj (mush-mbush, nryshoj-ndryshoj, njesh-ngjesh). Një çështje mjaft e diskutuar është edhe përdorimi i paskajores gege në standardin e shqipes (me punue –për të punuar)

Këto dhe mjaft shembuj të tjerë vërtetojnë faktin se dialektet janë një burim shumë i rëndësishëm i pasurimit, pastrimit, dhe zhvillimit të standardit në fusha të ndryshme. Ato do jenë një burim i pashtershëm për gjuhën letrare, e cila do të marrë atje fjalë për t'u dhënë kuptimet e një termi dhe do të marrë formate e shëmbëlltura formimi fjalësh për të krijuar terma të rinj.

Gjuha është një dukuri që nuk rri në vend, ajo gjithmonë pasurohet e zhvillohet. Gjatë këtij procesi, sipas fazave të zhvillimit të gjuhës sonë të përbashkët gjuha letrare dhe dialektet, derisa të jetojnë do të jenë në lidhje dhe në marrëdhënie dialektike të caktuara. Një varietet me një normë të njëjtë drejtshkrimore të përbashkët për të gjithë bashkëkombasit shqiptarë dhe me një strukturë gramatikore e leksikore të përcaktuar nga norma të gjalla e të studiuara mirë, mund të përballojë nevojat kaq shumë të shtuara të shprehjes dhe të krijimit që u dalin sot shqiptarëve. Vetëm një gjuhë e tillë e fuqishme dhe e përpunuar, por dhe e mbrojtur përkushtimisht nga rreziqet gjithashtu aq të shumta dhe të shtuara dukshëm në ditët tona, mund të shpërfillë edhe ndarjen në shtete, mbylljen e kufijve ndërmjet shqiptarëve të Republikës së Shqipëri nga trojet shqiptare jashtë saj në shtetet fqinje apo në diasporë.

Gjuha letrare standarde dhe të gjitha varietetet dialektore të ndryshme brenda saj kanë qenë dhe do të mbeten kurdoherë në lidhje ndërveprimi me njëra-tjetrën. Ajo çka vjen nga anët dhe rrethinat (periferitë), qoftë edhe e turbullt apo e pakulluar, herë do të zbrapset nga vrulli i fuqishëm i ujërave të gjuhës letrare të njehsuar, herë do të shkrihet, përzihet e me kohë do të kthjellohet në përbërjen e gjuhës së përbashkët letrare. Pra,

mund të themi se standardi gjatë gjithë këtyre viteve e ka dëshmuar vlefshmërinë e tij, por ka nevojë që t'i nënshtrohet periodikisht shqyrtimeve shkencore lidhur me funksionimin e sistemit në të gjitha segmentet. Përsa i përket planifikimit gjuhësor të gjuhës shqipe, nuk ka dyshim që edhe ajo i është nënshtruar këtij procesi ashtu si të gjitha gjuhët e botës. Si pjesë e sociolinguistikës, planifikimi gjuhësor “përfshin punën normëzuese të akademive dhe komiteteve gjuhësore, të gjitha format e atij që zakonisht quhet kultivim i gjuhës dhe gjithë propozimet për reformën dhe standardizimin e gjuhës” (Haugen E 1966 :702)

Vende të ndryshme të botës, nëpërmjet politikës së tyre gjuhësore, kanë rregulluar sistemin e tyre gjuhësor duke krijuar një sistem mbrojtës kundrejt fjalëve të huaja, pra kundrejt huazimeve. Këtë sistem ata e kanë paraqitur në kodin e tyre ligjor duke e bërë të pakundërshtueshëm këtë të fundit. Një shembull i mirë i planifikimit gjuhësor është ai i Kebekut, ku shteti ka investuar mjaft në politikën e tij gjuhësore. Ligji për gjuhën, “Neni 101”, shpall karakterin njëgjuhësh të Kebekut dhe tregon mjetet për arritjet në mënyrë demokratike të këtij objekti, ku rolin kryesor e kanë institucionet gjuhësore (Rrokaj, Sh. 2007 :121).

Një tjetër shembull është ndërhyrja e shtetit francez mbi disa rregullime drejtshkrimore, botuar në Journal Officiel, më 6 dhjetor 1990. Shembull i politikës gjuhësore është edhe dekreti i Flander-it që e bën holandishten gjuhë tregtare, kushtetuta e ish- RDGJ-së e cila e bëri zyrtare gjuhën e minoritetit sorab në rreth 12 qytete, krahas gjermanishtes, etj,. Shumë shtete kanë ligje që rregullojnë përdorimin publik të gjuhëve, si në administratë, në marrëdhënie, në drejtësi, në masmedia, etj,. Një ligj kolumbian i 1980-ës ndalon përdorimin e fjalëve të huaja në tekstet zyrtare, por edhe përdorimin e ndërtimeve gramatikore të huaja të marra nga tekstet spanjolle (UT, Akte të konferencës

shkencore, 2004). Kjo gjë bëhet për shkak se zyrtarët, politikanët dhe gazetarët janë shembulli kryesor i përdorimit të gjuhës standarde, e megjithatë në shtetin shqiptar të lartpërmendurit janë shembulli më i keq si të thuash, sepse janë ata të cilët e keqpërdorin më shumë gjuhën.

Planifikimi gjuhësor ka qenë pjesë e politikave globale të shteteve dhe bashkësive të caktuara gjuhësore. Por edhe pas lindjes së gjuhës si shkencë më vete e madje edhe pas lindjes së sociolinguistikës, lidhja midis teorisë dhe praktikës ka qenë e dobët. Kjo gjë fare mirë mund të thuhet edhe për gjuhësinë shqiptare, ku përpjekjet për njehsimin e gjuhës kombëtare shqiptare janë mbështetur fare pak në teorinë e planifikimit gjuhësor, si një bazë e shëndoshë për të përcaktuar në mënyrë shkencore objektin, qëllimet, etapat dhe procedurat e planifikimit dhe për të argumentuar hapat e ndërmarrë në praktikë apo zgjedhjet e dhëna. (Memushaj, R. 2012 :13).

Problemeve të zotërimit dhe zbatimit të normave të gjuhës standarde u është kushtuar një vëmendje e veçantë që me Kongresin e Drejtshkrimit 1972. (Beci, B.2010 :113.) Një ndihmesë mjaft të madhe, përveç rretheve akademike, ka dhënë edhe shkolla duke ndërmarrë një varg masash për ruajtjen dhe pastërtinë e gjuhës. Përveç institucioneve arsimore, edhe ato joarsimore patën një rol të veçantë në përhapjen e normës në masat e gjera si; shtypi, shtëpitë botuese, radiot, televizioni etj.. Në këtë rast nuk duhet mohuar as roli i shtetit. Shqipëria ishte një shtet totalitar me një planifikim tepër të centralizuar. Teoricienët e planifikimit gjuhësor vënë në dukje se po në atë shkallë që ndryshimet shoqërore janë të organizuara dhe të kontrolluara në mënyrë të centralizuar, në të njëjtën mënyrë edhe ndryshimet gjuhësore do t'u nënshtrohen përpjekjeve të organizuara. (Fishman, J. 1973 :88) Shqipëria nuk përbën një rast të tillë të veçantë, pasi përmenden edhe shumë shembuj të tjerë të planifikimit gjuhësor të

suksesshëm të organizuar nga shtete si Japonia, Hungaria, Estonia, Turqia etj. (Beci B. po aty :34).

Megjithatë në ditët e sotme, në plan të parë kanë dalë disa çështje shumë të rëndësishme që duan një vëmendje dhe kujdes të veçantë. Qindra gazeta dhe revista sot nuk i nënshtrohen redaktimit dhe korrektimit gjuhësor, për të mos përmendur shtypin dhe mediet që lënë për të dëshiruar për mënyrën e përdorimit të gjuhës së tyre, shkeljet e panumërta që bëhen kundrejt normës së gjuhës shqipe, huazimet edhe fjalët e huaja të përdorura pa kriter etj. Ne të gjithë si përdorues të gjuhës duhet të jemi të vetëdijshëm për zbatimin e drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit të shqipes standarde dhe ribotimin e rregullave të drejtshkrimit duke i sjellë ato në përputhje me zhvillimet e reja strukturore e funksionale të shqipes së sotme.

Gjithashtu duhet një angazhim i madh i institucioneve shkencore e shtetërore, sidomos i medias së shkruar dhe elektronike, për zbatimin dhe përsosjen e mëtejshme të normës letrare të shqipes standarde, pasurimin e saj nga dialektet e nga variantet letrare me bazë dialektore dhe pastrimin e leksikut e të terminologjisë, si dhe të formave sintaksore të huaja e të panevojshme. Detyrë e të gjithëve mbetet ruajtja dhe përvetësimi i normës së saj, lëvrimi dhe zhvillimi i mëtejshëm, sepse ajo është dhe mbetet vetëqënia, burimi i frymëzimit dhe krenaria kombëtare për cilindo.

“Niveli i qytetërimit të një kombi, - ka shkruar Rexhep Qosja,- varet nga kujdesi që i kushton ai gjuhës së vet letrare kombëtare.... Me strukturën e saj gramatikore dhe me thesarin e pasur leksikor, gjuha shqipe është dëshmia më e mirë e prirjes, e fuqisë krijuese, e pasurisë shpirtërore dhe emocionale e popullit tonë. Gjuha, në të vërtetë, është pasuria jonë më e madhe.” (Qosja, R. 1983 :146).

2.3 Zhvillimi historik i shqipes standarde

Popuj të ndryshëm, në një shkallë të caktuar të zhvillimit të tyre historik, në kohën e ndërtimit të marrëdhënieve ekonomike e shoqërore, që karakterizojnë një shkallë të lartë të organizimit politik e kulturor, kanë ndier nevojën për të krijuar një formë të veçantë të gjuhës kombëtare, e cila të përdorej në shumë sfera të jetës si mjeti më i përhapur i komunikimit dhe këtu nuk bëhet fjalë për një komunikim çfarëdo, por për një komunikim do të thoshim të kulturuar në fushën e letërsisë, të dijes, e në jetën politiko-shoqërore. Pikërisht kjo formë e gjuhës, e krijuar në mënyrë të ndërgjegjshme e mbi forma të tjera të gjuhës, të cilat gëzonin ndonjë respekt apo epërsi të veçantë ndaj formave të tjera, ndër popujt e qytetëruar është emërtuar si gjuhë letrare, por e njohur edhe me të tjera emërtime si: gjuhë e kulturës, gjuhë e përgjithshme, gjuhë kombëtare etj. sidomos në gjysmën e dytë të shekullit që shkoi, u emërtua si gjuhë standarde.

Fillimisht cilësohej si gjuhë letrare (dhe kështu vazhdon të quhet ende në ditët tona në shumë mjedise kulturore). Pra, fillimisht do të jetë quajtur kështu, sepse ajo lidhej ose pandehej të kishte një lidhje shumë të ngushtë me letërsinë. Le ta themi se nocioni letërsi më përpara përdorej për të shënuar gjithë krijimtarinë dhe jo vetëm atë letrare. Por, emërtimi i kësaj forme të gjuhës duket edhe më shumë i lidhur me letërsinë sidomos në disa gjuhë evro-perëndimore e sllave (krahaso: gjerm. – Literatursprache, rus. – Literaturnij jazek e të tjera), për sa kohë që as në shqip nocioni literaturë nuk është i panjohur.

Gjuha shqipe, për të arritur deri në gjendjen e sotme në standardizimin e saj, është formuar duke kaluar nga një variant dialektor në një gjuhë gjithëkombëtare mbidialektore. Ndoshta duhet të theksojmë se Fjalori i Shqipes së Sotme jep këtë përkufizim për gjuhën letrare: Gjuha letrare është: -“Forma më e përpunuar e gjuhës së

një populli, e cila ka norma të caktuara, të ngulitura në të shkruar e në të folur dhe arrin njësimin më të lartë në kohën e krijimit të kombeve e të shteteve kombëtare” (Akademia e Shkencave, Tiranë, 1984, :391)

Nuk ka asnjë dyshim se gjuha letrare fushën më të përshtatshme dhe mundësitë më të mëdha të pasurimit i gjen pikërisht në krijimtarinë letrare dhe kjo për dy arsye që janë përgjithësisht të njohura:

E para, shkrimtarët janë njohësit më të mirë të thesarit gjuhësor dhe përdoruesit mjeshtërorë të këtij thesari, madje duke mbajtur parasysh gjithë përdorimet, qoftë në krijimtarinë popullore dhe qoftë në krijimtarinë e shkrimtarëve paraardhës.

E dyta, sepse pikërisht në letërsi gjuha gjen realizimin e të gjitha potencialeve të zhdërvjelltësisë deri në shkallën e përdorimit figurativ e të përmbysur të elementeve të veçanta gjuhësore e të lidhjeve nga më të pasurat e mundshme në njësi të ndryshme gjuhësore, sidomos në fushën e fjalëformimit dhe të ndërtimit të marrëdhënieve sintaksore.

Megjithatë, në letërsi, pra në një vepër letrare, krahas elementeve të standardizuar, autori mund të përdorë dhe zakonisht përdor edhe fjalë e njësi frazeologjike të marra nga dialekte të ndryshme të gjuhës, ndonjëherë edhe fjalë e shprehje arkaike a të një periudhe të shkuar të historisë, të cilat kanë kaluar në klasën e barbarizmave, e të tjera, që shkrimtari do t’i përdorë për të karakterizuar personazhe të një konteksti të caktuar historik, politik e kulturor, ose edhe për të shënuar luftën dhe dallimet midis brezave a klasave shoqërore në një të kaluar të afërt a të largët. Ndoshta edhe ky mund të jetë një nga shkaqet pse në vend të emërtimit gjuhë letrare, ka zënë të përdoret, sidomos në kulturën evropërendimore, nocioni gjuhë standarde ose standard gjuhësor.

Shqipja bën pjesë në grupin e gjuhëve që kanë marrë një zhvillim të hovshëm në fushën e shkrimit shumë vonë, prandaj edhe veprimtaria për themelimin ose standardizimin e shqipes ka nisur mjaft vonë. Arsyet dihen pothuaj nga të gjithë. Ato janë pasojë e drejtpërdrejtë e pushtimit për një kohë të gjatë të viseve shqiptare nga të huajt, të cilët ndalonin gjithsesi zhvillimin e shkollës në gjuhën shqipe, shkrimin e saj dhe përparimin kulturor të shqiptarëve.

Së pari themelet e gjuhës standarde u hodhën gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare. Për t'u përmendur është Kongresi i Manastirit (nëntor 1908) në të cilin u njehsua alfabeti i gjuhës shqipe. Megjithëse u kundërshtua me fanatizëm të madh nga forcat e huaja, arriti të fitojë vija gjuhësore e Rilindjes, sepse ishte një vijë historikisht dhe shkencërisht e drejtë dhe që u përgjigjej interesave jetësore të kombit e të popullit shqiptar.

Pavarësia dhe formimi i një shteti të pavarur kombëtar shqiptar më 1912, nuk mund ta zgjidhte menjëherë e në mënyrë të kënaqshme problemin e njësimimit të gjuhës shqipe e të një varieteti standard të vetëm e të përbashkët për të gjithë kombin. Me rëndësi është se pas Pavarësisë në përgjithësi u bënë hapa përpara edhe në lëmin e gjuhës, duke ecur në piketat përbashkuese që kishin ideuar me kohë Rilindësit dhe u realizuan dy variantet kryesore letrare të shkruara: njëri me bazë toskërishten dhe tjetri me bazë gegërishten.

Prova e parë për të standardizuar në njëfarë shkalle gjuhën shqipe do të bëhej në vitet 1916/17 nga Komisija Letrare Shqipe e Shkodrës, e cila afro dhjetë vjet pas themelimit të alfabetit të shqipes në Manastir, do të arrinte të hartonte Ortografinë e parë të shqipes. (Topalli, T. Haxhi, A. 1998 :208). Ajo komisi shtronte për të parën herë çështjen e zgjedhjes së dialektit që do të shërbente si bazë, mbi të cilën do të krijohej

shqipja standarde, e cila asokohe shkruhej në dy a tri variante: toskërishtja letrare, gegërishtja e ashtuquajtur e mesme letrare (me fare pak shkrime) dhe shkodranishtja letrare. Siç dihet, Ortografia e Komisionit Letraro të Shkodrës ishte ngritur mbi bazën e gegërishtes së mesme dhe, sado që kjo formë letrare nuk do të bëhej e vetmja, sepse do të vazhdonte përdorimi dhe lëvrimi i mëtejshëm i toskërishtes letrare, sidomos në fushë të letërsisë, dhe i shkodranishtes letrare (nga disa autorë), do të vazhdonte të zhvillohej e të zbatohet në administratë, në tekste shkollore dhe nga disa shkrimtarë.

Pas daljes nga Lufta e Dytë Botërore, gjuha shqipe u ndodh në një situatë të re, shumë më të favorshme, falë zgjerimit të sistemit të arsimit dhe një hovi të ri që mori letërsia dhe kultura përgjithësisht në Shqipëri (Shkurtaj, Gj. 2010 :145).

Në veri të Shqipërisë dhe në Kosovë e në viset e tjera jashtë Shqipërisë, vazhdoi të përdorej varianti i gegërishtes së mesme letrare, kurse në jugun e Shqipërisë dhe në institucionet qendrore politike, ushtarake, ekonomike, arsimore e të tjera përdorej kryesisht toskërishtja letrare. Në këtë fazë të zhvillimit të kulturës kombëtare, të arsimit e të letërsisë, u shtrua kërkesa për themelimin e një forme të vetme, që do të thotë e krijimit të shqipes, që në diskutimet e atëhershme quhej gjuhë e unifikuar dhe më vonë e njësuar letrare. Për këtë qëllim qenë organizuar dy sesione shkencore (1952 e 1953 në Tiranë) për Drejtshkrimin e gjuhës shqipe në vitin 1956.

Në të njëjtën mënyrë u veprua edhe në Prishtinë më 1957 e 1963, kur qenë hartuar edhe ortografi të gjuhës shqipe. Për shkallën e mbështetjes teorike e praktike të kodifikimit, dhe më pastaj të zbatimit për një periudhë të gjatë, shquhej sidomos Ortografia e gjuhës shqipe (Prishtinë 1964).

Në vitin 1967 Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Tiranës, në përpjekjet për njësimin e shqipes letrare, botoi një projekt të Rregullave të Drejtshkrimit të Shqipes, ku

për herë të parë nuk kishte forma të veçanta për toskërishten dhe të veçanta për gegërishten letrare (sikur veprohej më përpara) dhe ato rregulla u hodhën në diskutime të gjera publike, në institucione shkencore, arsimore e në qarqe letrare e të tjera, ku t'u bëheshin vërejtje ose të miratoheshin ashtu si ishin.

Edhe në Prishtinë, në një mbledhje të gjerë shkencore, e cila njihet si Konferenca Gjuhësore e Prishtinës (1968) objekt diskutimi u bënë ato rregulla me temë qendrore: “Të njësohej shqipja apo të vazhdonte përdorimi i variantit të gegërishtes letrare”? (Samara, M. 2005 :131). Pas shumë diskutimesh të mbështetura, konferenca doli në konkluzionin se “populli shqiptar është një, dhe gjuha letrare shqipe duhej të ishte një, e përbashkët”. Këtu mori rrugë edhe motoja e njohur atdhetare “Një komb – një gjuhë”(Shkurtaj, Gj. 2009 :145)

Për mënyrën e formimit të gjuhës letrare shqipe, dhe sidomos standardizimin e saj mbi bazë e variantit të toskërishtes letrare, ka pasur dhe ka mendime të ndryshme; disa e mbështesin plotësisht, të tjerët shprehin rezerva; nuk mungojnë edhe ata që janë krejtësisht kundër. Pasojë e gjithë këtyre veprimeve kulturore dhe një mbështetje për standardin që organizimi i Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, që u mbajt në Tiranë në nëntor 1972, ku merrnin pjesë një numër i madh delegatësh, studiues, shkrimtarë, punonjës kulture e profesorë (gjithsej 87, prej të cilëve 11 nga viset shqiptare në ish-Jugosllavi dhe dy-tre arbëreshë e të huaj).

Pas një diskutimi të gjerë e të gjithanshëm të të gjitha çështjeve lidhur me shqipen letrare dhe sidomos me drejtshkrimin, aty u nxorrën konkluzione, mbi të cilat do të hartoheshin më vonë të gjitha botimet gjuhësore normative (fjalorë, gramatika e libra shkollorë) dhe kështu do të thoshim se këtu merr fund procesi i themelimit, ose më drejt i njësimimit të shqipes standarde. (Raka, F. 1997 :17). Të tjera ngjarje të rëndësishme që

përforcuan dhe mbështetën Kongersin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) ishin edhe Konferenca Shkencore me rastin e 20-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit (nëntor 1992) dhe Konferenca Shkencore kushtuar 40-vjetorit të Konsultës së Prishtinës (2008).

Siç e përshkruam pak më lart, në rrugëtimin historik të gjuhës standarde shqipe, vihet re se shumica dërrmuese e shkrimeve, takimeve, kongreseve, kanë pasur për qëllim të arrijnë në një përcaktim të plotë të standardit të gjuhës shqipe në tërë territorin shqipfolës. Janë përcaktuar parime të ndryshme për një përvetësim të menjëhershëm të shqipes së shkruar, duke filluar nga parimi fonetik, parimi morfologjik dhe sintaksor (ku trajta e folur e gjuhës shqipe të ishte në afërsi të drejtpërdrejtë me gjuhën e folur të popullit).

Standardizimi përfundimtar i gjuhës shqipe në tërë territorin shqipfolës ishte i një domosdoshmëri historike dhe aktuale për njësimin kombëtar. Kjo gjë filloi në vitin 1972 me mbajtjen e Kongresit të Drejtshkrimit që u zhvillua në Tiranë, i cili duhet thënë pa mëdyshje se ishte si rezultat i përpjekjeve të shumta të tërë intelektualëve dhe të atdhetarëve të shquar për të cilët folëm më lart. Duhet theksuar se ky standard erdhi si një rezultat mbarëkombëtar, si një gjuhë e imponuar që edhe shqiptarët më në fund do ta kenë një gjuhë të përbashkët dhe do të jenë më në fund një komb më organik e më i njësuar se më parë.

Që nga koha e standardizimit përfundimtar të '72, kanë kaluar më shumë se 40 vjet që po i përmbahemi me mjaft korrektësi mbrojtjes së standardizimit, gjithmonë duke pasur parasysh sfidat politike që kaloi populli i Kosovës. Mund ta themi tashmë se kjo gjuhë u ka qëndruar dhe po vazhdon t'u qëndrojë sfidave të kohës.

“Kongresi i Drejtshkrimit i drejtohet në radhë të parë shkollës shqiptare si vatra themelore e formimit gjuhësor të brezave të rinj... që ajo ta vlerësojë përvetësimin e

normave të njësuara të gjuhës letrare e të drejtshkrimit të miratuar nga Kongresi si detyrë themelore dhe të zbatojë plotësisht rregullat e reja të drejtshkrimit, duke filluar nga viti 1973-1974. (Drejtshkrimi : 25).

Prandaj, ishte e një rëndësie të veçantë që të mësohet drejt dhe sistematikisht formimi gjuhësor duke filluar që nga 8-vjeçarët e asaj kohe të shkollave tona. Për ta përvetësuar drejt normën e gjuhës shqipe, rëndësi të madhe ka zbatimi i plotë i rregullave drejtshkrimore sidomos në tekstet shkollore.

2.4 Shqipja në etapën e sotme, sfidat e gjuhës.

Konteksti ku funksionon shqipja standarde sot është i ri dhe shumë më i gjerë se dje. Ballafaqimi i kulturës shqiptare me kultura të tjera ka vënë para saj sprovën e vetëqëndrueshmërisë. Në të vërtetë ndikimi i drejtpërdrejtë i gjuhëve e i kulturave të fuqishme për të paraqet sfida të madhe, në rend të parë për leksikun e saj. Pasurimi i leksikut sot paraqitet si njëri ndër problemet kryesore të saj dhe parakupton edhe modernizimin e saj. (Islamaj Sh : 3/2008)

Globalizmi tashmë dihet se ka prekur të gjitha fushat e veprimtarisë duke përfshirë edhe gjuhën. Ashtu siç qëndron gjendja në ekonomi, politikë e në fusha të tjera të veprimtarive shoqërore e kulturore, me globalizëm përfiton më shumë ai që është më i fuqishëm në fushën përkatëse. Kështu ka ndodhur edhe me gjuhën në përgjithësi. Si rrjedhojë e globalizmit gjuha që ka prestigj dhe aftësi të tjera më të mëdha, e ato varen nga niveli më i lartë i zhvillimit ekonomik, teknologjik, shkencor, politik etj., ushtron ndikim mbi gjuhë të tjera që kanë nivele më të ulëta në këto fusha dhe që janë më pak të zhvilluara.

Si pasojë e kësaj, gjuha shqipe, si një gjuhë me ndikim të ulët mbi gjuhë të tjera dhe

me zhvillim më të vogël, siç tashmë po shihet çdo ditë e më shumë, me aftësi të kufizuara për mbrojtjen e saj, ajo vetëm mund të pësojë nga dukuria e globalizmit. Ky globalizëm, qoftë formal ose joformal, tashmë ka përfshirë në përmasa të gjera gjuhën shqipe, sidomos nga gjuha angleze, e cila ka bazë dhe prestigj më të fuqishëm global.

Gjuha shqipe sot ka arritur në një gjendje të tillë ku ka shumë nevojë për mbrojtje dhe mbështetje maksimale. Ajo ka dalë nga suazat e normës letrare të caktuara në Kongresin e Drejtshkrimit të vitit 1972. Gjuha shqipe sot ka rrëshqitur nga norma në shumë drejtime dhe në shumë rrafshje. Shkeljet e gjuhës standarde shqipe sot janë dy llojesh kryesore:

a) Mosrespektimi i normave gjuhësore në rrafshet gramatikore, morfologjike, sintaksore, por sidomos në rrafshin leksikor, jo vetëm në gjuhën e folur, por edhe në atë të shkruar.

b) Përdorimi i fjalëve me prejardhje të gjuhëve të huaja, sidomos të anglishtes.

Natyrisht, objekt i shmangieve nga norma gjuhësore të shtjelluara në këtë punim është më shumë gjuha e folur në organe, forume e institucione zyrtare, në mjetet e informimit elektronik, në mësimin e standardit në shkollë, etj. Por ky diskutim nuk hedh poshtë faktin se gjuha shqipe ka nevojë për zhvillime të mëtejshme, sigurisht edhe për ndryshime të arsyeshme dhe të gjykuara drejt nga ekspertë të saj. Kjo është thënë shumë herë deri tani publikisht në konferenca dhe publikime të ndryshme gjuhësore. Prandaj në çdo gjuhë ka arsye dhe vend edhe për ndryshime brenda saj, por edhe përmes huazimeve të reja. Institucionet që duhet të marrin masa kundër këtyre shmangieve, shkeljeve normative të gjuhës, janë paksa të heshtur për shkak të mangësisë së madhe të burimeve financiare që atyre u duhen, por edhe për shkak të shmangieve shumë të

dendura që bëhen, prandaj edhe fuqia e tyre për të ndërmarrë masa përkatëse dhe të efektshme deri tani është treguar e dobët.

Duke pasur parasysh zhvillimet e fundit gjuhësore atëherë lind pyetja: Cilat janë ndikimet e globalizimit në proceset gjuhësore në botë? Më lart u tha që globalizimi është rezultat i zhvillimit industrial dhe teknologjik i vendeve perëndimore, sidomos i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gjithashtu, u tha që karakteristikë shoqëruese e proceseve globalizuese është shtrirja e korporatave të mëdha ndërkombëtare në të gjitha kontinentet, përhapja e mediave dhe internetit. Kur kemi parasysh që korporatat ndërkombëtare, mediet kryesore dhe interneti janë të dominuara në masë të madhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, atëherë mund të thuhet lirisht që anglishtja si gjuhë kryesore e SHBA-ve është gjuha dominuese në botë. Kur kësaj i shtohet edhe fakti që për disa shekuj me radhë Britania e Madhe ishte vendi me më shumë koloni në botë dhe me ndikim të madh politik, ekonomik e ushtarak, atëherë konstatimi se anglishtja është gjuha kryesore në botë bëhet i padiskutueshëm.

Sot, anglishtja po bëhet gjithnjë e më shumë gjuhë e globalizimit dhe e proceseve që ndërlidhen me të. Përhapja e mediave, e internetit dhe digjitalizimi e bëjnë anglishten në kuadrin e sotëm gjuhësor botëror gjuhën kryesore në botë. Supremacia politike, ekonomike dhe kulturore e SHBA-ve, por edhe e Britanisë së Madhe, ka bërë që anglishtja të imponohet si gjuhë e komunikimit masiv në nivel botëror, pra të bëhet një *lingua franca* botërore, e ngjashme me latinishten dikur. Sot anglishtja shërben si gjuhë kryesore për komunikim midis folësve që për gjuhë amtare kanë gjuhë të tjera. (Block, David. 2004).

Ky *ekspansionizëm* i anglishtes ka bërë që sot të flitet për anglishten si gjuhë globale (Global English), që lind nga nevoja për të pasur një gjuhë për komunikim

botëror. Sipas shpjegimit të David Crystal, “Global English” nënkupton përdorimin e anglishtes si gjuhë botërore, por njëkohësisht, edhe përdorimin e saj nga folësit burimorë, të cilët i përdorin varietetet e ndryshme të kësaj gjuhe. David Crystal thekson se një gjuhë arrin status me të vërtetë global, kur zhvillon një rol të posaçëm që njihet në secilin vend. Sot, anglishtja ka status të posaçëm administrativ në më shumë se 70 vende, si: Gana, Nigeria, India, Singapori, Vanutu (Crystal, 2007).

Crystal është i mendimit se anglishtja është zgjeruar e përhapur aq shumë, sa që është bërë e pavarur nga kontrolli shoqëror. Ky përfundim mbase edhe mund të vihet në dyshim, por realisht depërtimi i anglishtes nëpër botë i ka tejkaluar të gjitha parashikimet që ndokush mund t’i ketë pasur para dy dekadave.

Ekspansionizmi i anglishtes ka prekur pothuajse të gjitha fushat e jetës në Evropë dhe në Botë. Në mjediset evropiane ajo ka vënë nën tryzni edhe gjuhën frënge, e cila dikur ishte ndër gjuhët më të përhapura në botë. Dikur frëngjishtja ishte gjuhë e kulturës, e ekonomisë dhe e politikës në përmasa botërore dhe madje, ishte gjuhë e oborrit mbretëror anglez, Por sot edhe frëngjishtja në kuadrin botëror mbetet prapa anglishtes. Në të njëjtën tryzni janë edhe gjuhët e tjera të Evropës që kanë folës të shumtë, siç janë gjermanishtja, italishtja, spanjishtja e portugalishtja. Anglishtja sot është duke ndikuar në çdo aspekt të jetës së njerëzve jo vetëm në Evropë, por edhe në botë (Crystal, D. 2001).

Në shoqërinë shqiptare kanë ndodhur ndryshime të mëdha në dy dhjetëvjeçarët e fundit. Në shumicën e ndryshimeve në shoqëri kanë ndikuar ndryshimet politike, kalimi prej një sistemi shtetëror e politik në tjetrin, organizimi i sistemeve e bashkësive të reja politike e shtetërore. Këto ndryshime u reflektuan edhe në gjuhë. Në shoqërinë shqiptare erdhën edhe ndikime të reja për çka ajo u detyrua të

kërkojë lloje të ndryshme në shoqëri, sidomos atë perëndimore duke u përpjekur të formësohet e të zhvillohet sipas modeleve të veta dhe këto ndryshime u bënë burim dhe nxitje për zhvillime të reja edhe në gjuhë. Pikërisht pse leksiku është sistemi më i hapur dhe pse ndryshimet janë më të qartat aty, është me interes të hulumtohen ndryshimet që kanë ndodhur në këta dy dhjetëvjeçarë, për të parë shkallën e pasurimit të leksikut të shqipes, po edhe shkallën e modernizimit të tij.

Gjuha shqipe me një strukturë solide dhe të gjallë, është zhvilluar në shekuj brenda ligjësisë së saj, duke arritur në kohën e sotme si një gjuhë e standardizuar, brenda normave letrare të pranura në mënyrë institucionale. Kongresi i Drejtshkrimit, i mbajtur në Tiranë në vitin 1972, dhe më parë Konsulta e Gjuhës, e mbajtur në Prishtinë në vitin 1968, janë përpjekjet e para studimore shkencore për njehsimin e gjuhës letrare, duke e kthyer këtë veprimtari në një vlerë të arrirë me karakter kombëtar. Liria në demokraci, në rastin e analizës mbi pastërtinë e gjuhës shqipe në ligjërimin publik, rezulton të jetë kthyer “në një kaos gjuhësor”, pasoja këto të reflektuara nga vetë kaosi që ka mbizotëruar në fushat e zhvillimit të shoqërisë sonë njërëzore në një periudhë kalimtare të pranuar.

Në ndihmë të moscenimit të vlerave të pazëvendësueshme në pastërtinë e gjuhës shqipe është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998 (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, paragrafi nr. 14, neni nr. 59, gërma “g”,) e cila në hyrjen e saj, neni 14, dhe në mënyrë të veçantë në nenin e saj nr. 59, përmbledhet ruajtja e vlerave të trashëgimisë sonë kombëtare, kulturore dhe kujdesi i veçantë për gjuhën shqipe. Mbi këtë bazë, duke u mbështetur në rregullat e drejtshkrimit dhe të shprehjes, “...parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes, është parimi fonetik: në përgjithësi fjalët

dhe pjesët e tyre të kuptimshme shkruhen ashtu siç shqiptohen në ligjërimin letrar” (Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe”, Tiranë 1973, parime të përgjithshme, :35)

Në *Drejtshtkrimin e gjuhës shqipe* nuk ka mbetur jashtë vëmendjes as shqiptimi i fjalëve dhe emërtimeve të huja, të cilat “shqiptohen në gjuhën përkatëse, duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes” (Kreu III, paragrafi 37, :104). Pas viteve ’90, si në shumë sfera të jetës edhe në çështjen e gjuhës “demokracia u kuptua si anarki dhe liria si kaos”. Reagimi i shtresës së studiuesve dhe të intelektualëve, deri tek dëgjuesit dhe lexuesit e thjeshtë, ka evidentuar pakënaqësinë kundër një fenomeni social, i cili ka depërtuar jo vetëm në botime, sistemin mediatik, por është përfshirë edhe në ligjërimin publik të shtetarëve dhe politikanëve shqiptarë.

Gjuha është një sistem, sipas të cilit nuk lejohet të luhet me të sipas bindjeve apo koncepteve individuale, qofshin këto të përfaqësuara nga njerëz me pozita shoqërore apo politike, ashtu dhe për njerëzit e thjeshtë. Në shumë raste, kemi thirrje alarmante “*Shqip të lutem, shqip*”.

Gjuha shqipe ka trashëguar kohë pas kohe në shekuj “barbarizma” për shkak të pushtimeve të huaja mbi vendin tonë. Periudha e komunizmit trashëgoi dialektizmat, të cilat e pengonin standardizimin e gjuhës shqipe. U desh një kohë e gjatë, një punë shumë e vështirë për të kaluar në standardizimin e gjuhës, e cila në atë kohë u pranua në tërë hapësirën shqiptare, për shkak edhe të përfaqësimit të miratuesve të saj nga nivelet më të larta shkencore shqiptare.

Kongresi i Drejtshtkrimit nuk i vuri vulën Fjalorit të Gjuhës Shqipe, por e la atë një problem të hapur për rrethet shkencore duke konstatuar faktin se gjuha pasurohet në natyrën e vet, mbi bazën e zhvillimit të vetë shoqërisë njerëzore. Në këtë çështje, ndeshemi me një problem të veçantë; Shqetësues sot janë kundërthëniet për ta ndarë

gjuhën në dialekte gegë dhe toskë, si gjuhë të pavarura nga njëra-tjetra. Në thelb, ky qëndrim identifikohet me një separatizëm intelektual të natyrës lokale, i përfaqësuar nga individë, që më së shumti, e bëjnë këtë për ego “politike”.

Në periudhën e komunizmit, për shkak të vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit, iu dha rëndësi depërtimit të gjuhës letrare mbi bazën e Fjalorit të Gjuhës Shqipe, me kurse kualifikimi veçanërisht në sistemin arsimor dhe në administratë dhe u kërkuar me përgjegjësi zbatimi i rregullave të drejtshkrimit. Gradualisht filloi “krehja” ndaj “barbarizmave”, hera-herës deri në ekstrem, veçanërisht për zëvendësimin në çdo rast të fjalëve teknike, duke kërkuar me këmbëngulje shqipërimin e tyre. Ky fenomen çoi drejt një puritanizmi gjuhësor, i cili nuk lejoi shmangiet si produkt i zhvillimit të kohës. Megjithatë, edhe në atë kohë, mjaft fjalë nuk kishin fjalë shqipe zëvendësuese dhe u pranuan si të tilla në ligjërim.

Në terminologjinë e kohës dhe shembullin e pastërtisë së gjuhës, në këtë periudhë dallohen shkrimtarët e mëdhenj, Kadare, Qosja, Agolli e shumë të tjerë, të cilët në letërsinë artistike dhe gjuhësore, eliminuan frazeologjitë pa kuptim dhe fjalët e huaja e barbarizmat. Ata vazhdonin të shkruanin me një gjuhë të pastër shqipe dhe kërkonin me insistim për të gjetur në trevat shqiptare fjalët e duhura. Përballë tyre, atëherë dhe më dukshëm në kohën e sotme, pseudointelektualë, pa asnjë lloj argumenti shkencor, të ndikuar nga presione politike dhe krahinore, vazhdojnë të mbledhin dhe të hedhin pa kursim fjalë të huaja dhe dialektizma, për mendimet e tyre në tregun mediatik, si një reklamë për “mallin” e tyre të zhvleftësuar. Me këtë mënyrë të shprehuri, kjo kategori ka treguar nënvleftësimin deri në përbuzje të punës që është bërë në hedhjen e bazave të shëndosha të gjuhës shqipe me natyrën e saj të standardizuar e moderne. Situata jonë gjuhësore flet se në mjedisin tonë globalizimi kuptohet në mënyrë të gabuar, në të

vërtetë po keqkuptohet dhe si pasojë e kësaj po zhvillohen një varg procesesh rrënuese për gjuhën shqipe, për kulturën shqiptare, dhe madje për identitetin shqiptar.

Këto procese janë:

- statusi i shqipes në hapësirën shqiptare, brenda dhe sidomos jashtë kufijve, ashtu si edhe statusi i shqipes në vendet e huaja, ku numri i shqiptarëve me status emigranti ekonomik, politik etj. është shumë i madh, ndërsa shqipja si gjuhë amtare paraqitet e rrezikuar për arsyet e njohura;
- përpjekja për copëzimin e hapësirës gjuhësore dhe përpjekja për krijimin e gjuhëve të reja politike. Në këtë aspekt për shqipen dalin dy rreziqe: nga *globalizimi* dhe nga *krahinorizmi*, që të dyja vetëdije të dëmshme për shqipen standarde;
- mungesa e ligjit për gjuhën. Përpjekjet që të krijohen mekanizma të efektshëm që do të rregullonin përdorimin publik të shqipes standarde në gjithë hapësirën shqiptare mbeten vetëm projekt i dashamirësve të gjuhës.
- rrënimi i kulturës gjuhësore, posaçërisht i kulturës së shprehjes me shkrim e me gojë;
- depërtimi i shpejtë i fjalëve të huaja, sidomos i anglicizmave në shqipen.

(Islamaj, I. 2008 :5)

Ndikimi i anglishtes është mjaft i dendur, sidomos përmes disa formave gjuhësore të ngurta e shkurtesave, të cilat kanë përdorim tipik në chat dhe në internet , pra janë pjesë e stilit të komunikimit elektronik. Këtu po përmendim disa njësi, të cilat janë futur nga anglishtja, ashtu si në shumë gjuhë të tjera, edhe në shqipe: *ok (në rregull, mirë)*, *np (no problem – s'ka problem)*, *brb (be right back- kthehem menjëherë)*, *lol (laughing out loud - qesh me të madhe)*, *yeah (yes- po)*, *whazz up (whats up - ç'kemi)*, *u (you - ti)*, *u 2 (you too - ti gjithashtu)*, *4 u (for you- për ty) etj.*

Por, problemi i përdorimit të fjalëve të huaja nuk qëndron vetëm tek të rinjtë dhe “zhargoni“ i tyre në internet. Në kushtet e sotme të shoqërisë shqiptare trysnia e gjuhëve të vendeve të fuqishme politikisht dhe ekonomikisht me të cilat jemi në kontakt, është shumë e fuqishme. Kjo trysni është e pashmangshme në fazat e para të hapjes ndaj botës. Fjalët dhe strukturat e huaja vërshojnë nga të gjitha anët, aq sa të krijohet përshtypja se po ia marrin frymën gjuhës. Mirëpo, hap pas hapi, folësit do të fillojnë të reagojnë me vetëdijen e vetëmbrojtjes, do të shtien në punë kujtesën e përbashkët për të kërkuar brenda gjuhës që përdorin gjegjëset e tyre ,dhe vetëm kur bëhet i pamundur zëvendësimi, atëherë do të pranojnë t’i përdorin, duke ua nënshtruar sistemit të gjuhës së tyre. Sa më i plotë të jetë standardi i një gjuhe nga pikëpamja e gjithëpërfshirjes gjuhësore anekënd dhe masës së folësve që e përdorin, aq më shumë rritet qëndresa ndaj trysnisë së huazimeve (Rrokaj SH. Panorama, 23 Tetor, 2013).

Është e drejtë të shqetësohemi kur përditë veshët na dëgjojnë dhe sytë na shohin përçudnime të tilla në shtyp, si: *kishin mundur të fitonin duke aplikuar me emrin e firmës (duke përdorur emrin e ndërmarrjes), çamët do të diskutohen në Athinë (çështja çame do të diskutohet), bëj mjekun, bëj mësuesin (është mjek, mësues), konvertoj paratë (këmbej), bord (kryesi, komision), integritet (tërësi), krucial (i qenësishëm), kredibilitet (besim), fazë tranzicioni (kalimtare), takoi Bush (Bushin), (përshtas); primar (parësor), seleksionoj (përzgjedh), intermediar (ndërmjetës), përtej kësaj (pavarësisht nga kjo), premio (çmim), nacionale (kombëtare), pankinë (stol), GDP (PPB),etj. (Rrokaj Sh , 2013 :po aty)*

Ka raste kur të rinjtë të ndikuar nga përdorimi i tyre nëpër mediat lokale, ato i marrin apo i kopjojnë si një “modë e të shprehurit”, pa e ditur në të vërtetë se çfarë kuptimi kanë. Është një gjuhë e re, që shprehet me rregulla që shpesh bien ndesh me ato

të gjuhëtarëve. Sipas tyre, të përdorurit e këtyre fjalëve dhe të shkruarit e këtyre mesazheve, ka çuar në një rritje të gabimeve ortografike dhe në një abuzim të dukshëm me shenjat e pikësimit, të cilat në vend të përdorimit të tyre të drejtë, vijnë në funksion të “vizatimit” të “fytyrave” që duhet të shprehin emocione. Shembujt vijnë të shumtë nga bota akademike. Një nga disiplinat më të reja që aplikohen në universitete është edhe “Shkrimi akademik”. Pedagogët e kësaj lënde tregojnë se edhe fjalët më të thjeshta shkruhen po njësoj sikurse edhe shqiptohen, dhe ç’është më e keqja, në shumë raste ata as nuk e dinë sesi është drejtshkrimi i tyre. Studentët shkruajnë “shpi” për të thënë “shtëpi” dhe as që e marrin mundimin ta korrigjojnë këtë, sepse “është e njëjta gjë dreqi e martë...!!!” (Bendaj, G. revista Mapo 2012).

Pra, nga të gjitha këto dukuri që përmendëm më sipër a mund të themi se kanë lidhje me globalizimin? Nëse e pranojmë përgjigjen pozitive, natyrshëm, shtrohet pyetja - çka të bëjmë? Sigurisht që nuk duhet t’i shpallet luftë globalizimit, por duhet të përpiqemi për një globalizim në kuptim të mirë të fjalës, për globalizimin që nxit ndjenjat për respekt vetjak e kombëtar, për vetërespekt, për globalizim që do të na bashkojë me të tjerët me vlerat e ndërsjella, për globalizim në të cilin edhe shqipja dhe kultura shqiptare do të zhvillohen e do të kultivohen krahas vlerave në shtrirje të gjerë planetare. Do të duhej të shihnim edhe përtej vetes, çfarë bëjnë kombet e shtetet në kushtet e globalizimit? Si i pranojnë proceset pozitive e si u bëjnë ballë proceseve negative që i nxit globalizimi, si i ruajnë e si i përforcojnë vlerat e tyre, në të vërtetë si e ruajnë *identitetin* e tyre, sepse mënyra më e mirë për ta paraparë ardhmërinë tonë është ta krijojmë atë. Ta bëjmë shqipen mjet integrimi midis nesh dhe mjet integrimi me të tjerët. E thënë shkurt: të gjejmë rrugët që pajtojnë atdhetarizmin dhe globalizmin! (Islamaj, Sh. 2008 :8)

2.5 Mësimi i shqipes standarde në shkollë

Një ndër proceset më të rëndësishme të kultivimit të gjuhës shqipe standarde është mësimi dhe përvetësimi i gjuhës letrare kombëtare në shkollë. Në këtë aspekt rolin kryesor e luan lënda e gjuhës shqipe, e cila ka si qëllim kryesor zhvillimin e shprehive komunikative të gjuhës amtare shqipe në formën e vet standarde. Për këtë janë ndërmarrë një sërë hapash dhe reformash arsimore për trajtimin sa më efikas të lëndës së gjuhës shqipe, jo vetëm si lëndë mësimore, por edhe më gjerë. Standardet e hartuara nga institucionet përkatëse tregojnë se çfarë nxënësit dinë dhe janë në gjendje të bëjnë në fushën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Arritjet e nxënësve në gjuhë shqipe dhe letërsi janë përcaktuese edhe për fushat e tjera të kurrikulës, pasi mësimi i gjuhës dhe letërsisë i aftëson nxënësit në përdorimin korrekt të gjuhës së folur dhe të shkruar, i domosdoshëm për të gjitha lëndët mësimore. Duke pasur parasysh ndikimin e madh të gjuhës nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, ndër problemet më të evidentueshme të mësimi të gjuhës standarde në shkollë janë:

- roli i komunikimit elektronik dhe teknologjisë në komunikimin e përditshëm gjuhësor,
- si ndikon gjuha e internetit dhe mediave në formimin gjuhësor të nxënësve dhe studentëve ,
- çfarë politikash gjuhësore duhen ndërmarrë për ruajtjen dhe mbrojtjen e gjuhës shqipe nga këto faktorë.

Për këtë, mënyra më efikase është përmirësimi i standardeve dhe cilësisë së mësimdhënies në shkollë. Është detyrë e çdo shqipfolësi që të kontribuojë në përvetësimin e standardit gjuhësor, por veçanërisht detyra parësore u përket institucioneve arsimore përgjegjëse që të hartojnë kurrikula dhe standarde lëndorë sa

më efikase dhe të arrira. Pra, zotërimi dhe përdorimi i gjuhës standarde është një domosdoshmëri. Zhvillimi gjuhësor dhe letrar është themelor për rritjen intelektuale, sociale dhe emocionale të nxënësve. Standardet e kësaj fushe synojnë aftësimin e nxënësve në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tyre personale dhe shoqërore, si dhe për të plotësuar kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës. Standardet tregojnë se çfarë nxënësit dinë dhe janë në gjendje të bëjnë në fushën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Arritjet e nxënësve në gjuhë shqipe dhe letërsi janë përcaktuese edhe për fushat e tjera të kurrikulës, pasi mësimi i gjuhës dhe letërsisë i aftëson nxënësit në përdorimin korrekt të gjuhës së folur dhe të shkruar, i domosdoshëm për të gjitha lëndët mësimore. (IZHA, Tiranë, 2012)

Gjuha shqipe dhe letërsia janë bazë për procesin e të mësuarit, të komunikimit, të formimit të identitetit personal e kulturor, si dhe të lidhjeve njerëzore. Si të tilla, si një fushë të nxëni, gjuha shqipe dhe letërsia studiojnë artin e të lexuarit, të shkruarit, të folurit, dhe të të dëgjuarit, duke u mbështetur në tekste letrare, joletrare dhe vizuale. Zhvillimi i interesit të nxënësve për gjuhën dhe letërsinë, dialogu, kuptimi e vlerësimi kritik i teksteve të ndryshme letrare dhe joletrare si produkte gjuhësore janë boshte kryesore të kësaj fushe.

Rol themelor në formimin e aftësive të para të të shprehurit luan mësuesi i ciklit të ulët, i cili jo vetëm duhet të jetë shembull në zbatimin e normave të gjuhës standarde, por edhe duhet t'i përçojë fëmijët te normat e rregullta, duke qortuar ato forma e përdorime që janë në kundërshtim me normën. Në ciklin e lartë të nëntëvjeçares mësimi i gjuhës shqipe synon të zgjerojë njohuritë e nxënësve mbi sistemin gramatikor të gjuhës shqipe, duke u dhënë njohuri të plota sintaksore, morfologjike, drejtshkrimore si dhe për shenjat e pikësimit. Pra, përvetësimi i rregullave mbi normën përbën një kusht

të domosdoshëm, por jo të mjaftueshëm për zbatimin e normave gjuhësore. Njohuritë e fituara duhen ushtruar, me qëllim që të krijohen shkathtësitë e duhura në zbatimin e këtyre rregullave (Memushaj, R. 2010 :47). Mësimi dhe zotërimi i gjuhës standarde në shkollë dhe jo vetëm, ka rëndësi të veçantë dhe përbën një ndër pikësnyimet e çdo lënde mësimore, pasi shihet si tipar themelor i formimit ideo-kulturor të brezit të ri. Standardi shërben si një emërues i përbashkët i varianteve territoriale dhe sociale, shërben si një mjet komunikimi në përballje me mënyrat e ndryshme të informimit si dhe në marrëdhëniet zyrtare, institucionale, administrative etj. Pra, zotërimi dhe përdorimi i gjuhës standarde është një domosdoshmëri.

Gjuha letrare ose gjuha e standardizuar ka vlerë shoqërore, është një simbol dallues, simbol tregues i sjelljes së mirë intelektuale dhe i arsimimit të lartë.... thoshte Charl Bali dhe shtonte se: "Operacionet e gjuhës janë të tilla që nënkuptojnë edhe një inteligjencë kolektive dhe ky konsensus është shenjë e qartë e një bashkësie gjuhësore. (Shkurtaj, Gj. 2009 :143.)

Gjuha në përgjithësi (dhe gjuha standarde në veçanti) nuk është vetëm një mjet komunikimi, por është edhe një institucion me peshë në jetën e shoqërisë. Gjatë këtyre viteve të fundit në shoqërinë shqiptare kanë ndodhur ndryshime të thella politike, shoqërore dhe ekonomike. Në këto rrethana të krijuara si pasojë e ndryshimeve, ka ndryshuar edhe problematika e gjuhës shqipe. Por, pavarësisht nga këto ndryshime dhe përmirësime të vazhdueshme të kushteve dhe nivelit që ka arritur zhvillimi i gjuhës shqipe sot në vendin tonë, apo dhe për mundësitë e mëdha që ka shkolla, mbetet ende për t'u bërë që te brezi i ri të rritet kultura gjuhësore.

Shumë probleme të tjera që lidhen me këtë çështje kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe mësimdhënien e gjuhës shqipe në shkollë. Në kushtet e sotme, realizimit të kësaj

detyre po i shërbejnë nisma dhe lëvizje të vazhdueshme që merren me përmirësimin e përmbajtjes së lëndës së gjuhës shqipe në shkollë, lidhur me rinovimin e kurrikulës (programeve dhe teksteve), me kualifikimin e mësuesve, pasurimin e mjeteve didaktike etj. (Gjokutaj, M. 2010 :10-14)

Është theksuar me të drejtë se shkolla shqipe dhe gjuha standarde shqipe kanë përshkuar një rrugë të përbashkët, janë rritur dhe zhvilluar së bashku, kanë kapërcyer vështirësi dhe pengesa, kanë arritur fitore të mëdha. Dhe kjo lidhje nuk është e rastit, pasi lëvruesit e shquar të gjuhës shqipe kanë qenë njëkohësisht edhe veprimtarë të shkollës shqipe; nga ana tjetër, në shkollën shqipe janë përgatitur dhe përgatiten mjeshtërit dhe lëvruesit e gjuhës shqipe. Kjo përpjekje ka nisur që me gjuhën e shkruar shqipe dhe për t'u përforcuar më pas me idetë e mëdha të rilindasve, të hapjes së shkollave të para shqipe dhe njësimin të gjuhës shqipe. Në vazhden e përpjekjeve të paraqitimit për një gjuhë të përbashkët, një synim që përshkonte edhe punën e Komisionit letrar (1916-1917) e të Kongreseve Arsimore (1920-1924), në ditët e para të çlirimit, një nga problemet kryesore me të cilin u ballafaqua shkolla, ishte orientimi gjuhësor: A do të zbatohet një normë e vetme gjuhësore në shkollë, si në tekste ashtu edhe në veprimtarinë mësimore, duke filluar nga klasa e parë dhe në vazhdimësi?

Detyrë e shkollës shqiptare ishte që të ndihmonte për ta realizuar këtë njësim brenda një kohe shumë të shkurtër. Që në vitin 1949, me qëllim që mësimi i gjuhës shqipe të mbështetej në variantin e gjuhës letrare shqipe, e cila po konsolidohej për herë të parë në të gjitha shkollat e vendit u vu në përdorim teksti: “Gramatika e gjuhës shqipe” për klasat: V, VI, VII. Përdorimi i atij teksti i ktheu në një emërues të përbashkët, jo vetëm njohuritë gjuhësore që merrnin nxënësit në shkollën fillore, por edhe formimin gjuhësor të mësuesve. Ai tekst u bë një libër i përbashkët për nxënësit

dhe për mësuesit dhe ishte hapi i parë që u hodh për të shmangur përdorimin e dy varianteve dialektore në mësimin e gjuhës shqipe në shkollë, siç bëhej deri atëherë. (Poaty :11).

Në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe më 1972 u vendos përfundimisht norma letrare apo gjuha standarde, duke përcaktuar kështu faktin se tashmë gjuha shqipe do të kishte një normë drejtshkrimore të vetme dhe një gjuhë të njësuar standarde. Kështu, shkolla u bë mjete kryesor i përhapjes dhe i ngulitjes së normës letrare kombëtare nëpërmjet teksteve të shkruara e të botuara dhe ligjërimit të folur.

Aktualisht, në tekstet e reja po rindërtohet edhe paraqitja metodike e njohurive që jepen për gjuhën në përgjithësi, si dhe për sistemin gjuhësor në veçanti. Po luftohet prirja për t'ua mësuar nxënësve gjuhën në mënyrë akademike dhe synohet për një përvetësim dhe një aftësim më të madh në përdorimin praktik të gjuhës nga ana e nxënësve. Në rrafshin e përvetësimit të normave të drejtshkrimit si dhe të formimit të shprehive të përdorimit të lirshëm të gjuhës letrare në stile e ligjërime të ndryshme mbetet ende punë kundër ndikimeve dialektore dhe kundër trysnisë së ligjërimit, që janë të ndjeshme veçanërisht në të folur.

Ndërkaq në ditët e sotme, megjithëse shqipja është një gjuhë me një status të përcaktuar si gjuhë zyrtare, jo vetëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por edhe në Kosovë e Maqedoni, (Beci, B. 2010 :105) përsëri ajo është përfshirë në një vorbull të gjerë debatesh.

- A duhet të ndryshojë gjuha shqipe?
- A ka nevojë standardi të ndryshojë apo duhet të përmirësohet më tej?

Pavarësisht gjendjes reale apo parapëlqimeve të rrymave ose individëve të veçantë, mund të themi se gjuha shqipe e ditëve tona i ka të gjitha funksionet shoqërore

të një gjuhe të zhvilluar, ajo lëvrohet me shkrim në të gjitha stilet (letrar, administrativ, publicistik, shkencor, fetar) dhe përdoret në të folur në të gjitha nivelet e ligjërit (libror, bisedor e thjeshtligjërimit). Ndryshe nga më parë, kur këto stile për shkaqe politike apo ideologjike nuk lëvroheshin në shkallë të njëjtë, d.m.th. kishte asimetri në lëvrimin e tyre, tashmë është arritur simetria e stileve. Ajo vazhdon të jetë edhe variant i vetëm që mësohet në shkollë dhe që përdoret në jetën e përditshme të njerëzve.

Në stadin e sotëm të shkollës kërkohet që kjo punë të vihet në baza më të përparuara teorike e shkencore. Në modelin e fundit të programeve të gjuhës shqipe, i ndërmarrë nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, ndryshimet janë të dukshme dhe përfshijnë anën strukturore, si dhe atë përmbajtësore të lëndës së gjuhës shqipe. Shqipja letrare që ne përdorim sot shërben si shenja kryesore e identitetit tonë kombëtar.

Mënyrat e sotme të komunikimit dhe informimit kanë krijuar mundësi të mëdha shoqërore dhe kulturore për ngritjen e nivelit të arsimit, dhe si pasojë edhe përvetësimit të gjuhës standarde në shkollë. Zhvillimi i gjuhës së folur dhe të shkruar është një ndër qëllimet kryesore të programit të gjuhës shqipe. Standardet e gjuhës shqipe dhe të letërsisë mbështeten në parimin që gjuha qëndron në themel të procesit të të mësuarit, të komunikimit, të formimit të identitetit personal, kulturor e letrar, si dhe të lidhjeve ndërnjerëzore. Mësimi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë në shkollë ndihmon nxënësit në zhvillimin e aftësive komunikative, të domosdoshme këto për të realizuar të nxënit gjatë gjithë jetës. Fusha e gjuhës shqipe dhe e letërsisë integron mësimdhënien dhe të nxënit *e të lexuarit, të shkruarit, të folurit dhe të dëgjuarit.*

Integrimi reflektohet tek kurrikula, mësimdhënia dhe vlerësimi i gjuhës shqipe dhe letërsisë. Standardet janë parë si një e tërë, një fushë e njësuar, ku secili mbështet të tjerët dhe përmirëson nivelin e të menduarit dhe të mësuarit tek nxënësit. Nxënësi, i

ndërgjegjshëm për fuqinë që ka gjuha dhe letërsia në jetën e tij, e përdor atë në forma të ndryshme. Për rrjedhojë, ai do të përballet me të gjitha format e produkteve të shkruara (tekstin tregimtar, poetik, dramatik, shpjegues, përshkrues, argumentues/bindës dhe informativ) si dhe me format e produkteve mediatike. Nxënësi mëson t'i trajtojë këto produkte si tekste që mund të kuptohen dhe të ndërtohen. Nëpërmjet gjuhës shqipe dhe letërsisë nxënësi njihet e përvetëson kulturën e vendit të tij si dhe formon identitetin personal e kombëtar. Zhvillimi i interesit të nxënësit për letërsinë, lidhja me të, dialogimi, kuptimi e vlerësimi kritik i letërsisë e llojeve të tjera të produkteve gjuhësore janë boshte kryesore të kësaj lënde. (IZHA, Udhëzues 2010).

Gjuha shqipe dhe letërsia zgjerojnë njohuritë dhe zhvillojnë aftësitë e domosdoshme, që nxënësi të jetë i suksesshëm në të gjitha fushat e kurrikulës. Mësimi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë realizohet përmes gjithë procesit mësimor-edukativ, në të cilin njohuritë e fituara brenda dhe jashtë shkollës sistemohen dhe përmirësohen, duke rritur shkallën e vështirësisë dhe të përvetësimit të tyre.

Krahas standardizimit dhe përvetësimit të gjuhës letrare në shkollë, detyrë mjaft e rëndësishme e mësuesve, shkollës, hartuesve të teksteve apo edhe mjediseve të tjera, është shmangia e nxënësve nga elementet e gabuar jashtë normës dhe prurjet dialektore, që shpesh janë pjesë e gjuhës sonë të përditshme. Nxënësi duhet të ndërgjegjësohet për qëllimet e përdorimit të normës në gjuhë duke e përshtatur atë sipas stileve të të folurit dhe mënyrës së ligjërimit.

Edhe brenda teksteve të gjuhës apo letërsisë ndeshemi me variante të ndryshme, të cilat ndryshojnë nga norma pasi janë ndërtuar sipas një dialekti të caktuar. Është e nevojshme që fëmijët tanë të njohin diçka nga historia e gjuhës, nga ndarjet dialektore, duke i sistemuar hap pas hapi dallimet kryesore, jo vetëm për të përvetësuar mirë

normat e gjuhës dhe përdorimin e saj në mjediset e ndryshme të komunikimit, por edhe si pjesë të kulturës kombëtare për t'u rrënjësuar idenë se pavarësisht nga disa dallimet, ne i përkasim në thelb të njëjtit identitet kombëtar.

Qëllimi kryesor do të jetë kurdoherë një: *t'i bëjmë të vetëdijshëm nxënësit se ka një normë standarde për nevojat publike, se pa zotëruar atë na mungon themeli e do të kishim vështirësi komunikimi ndërmjet nesh.* Por ta dinë se ka edhe variante që nuk përbëjnë as gabime, as gjynahe, përkundrazi, duke pasur njohuri për to, do të na lehtësohet komunikimi me të gjithë bashkëkombasit kudo në botë dhe do të kemi një çelës për të shfrytëzuar gjithçka është shkruar në gjuhën shqipe gjatë shekujve. Ne duam që asnjë shqiptar të mos thotë se nuk e lexon dot Fishtën ose anasjelltas, se i duket i pakuptueshëm Fan Noli (Lloshi, XH. 2011).

Nga mësuesit kërkohet që të mos kufizohen vetëm me tekstin, por edhe të gjejnë vetë modelet më të mira të shqipes së shkruar e të folur, sidomos të ndjekin botimet e reja. Këto janë dukuri që sjellin përmirësimin e dukurive gjuhësore dhe shprehive komunikative. Nëpërmjet çdo folësi, sipas fushës së veprimtarisë gjuhësore, gjuha letrare krijon mundësi të pafundme komunikimi dhe realizohet nëpërmjet variantesh të shumëllojshme ligjërimore. Përdoruesit e gjuhës zgjedhin stile të ndryshme funksionale në ndihmë të përdorimit dhe përvetësimit të saj. (Lloshi, XH. Stilistika, 1985). Këto stile kanë të bëjnë me përvetësimin e njohurive nga stilistika gjuhësore, e cila është një degë shumë e rëndësishme në programin e gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Një problem tjetër mjaft i madh në shkollat tona në ditët e sotme është edhe ndikimi që ka komunikimi elektronik në procesin mësimor. Për shkak të përhapjes mjaft të madhe të teknologjisë dhe mjeteve elektronike shohim se nxënësit e shkollave janë edhe përdoruesit më të mëdhenj të këtyre rrjeteve sociale. Për pasojë ato ndikohen

shumë nga gjuha që përdorin në komunikimin elektronik edhe në punët e përditshme në shkollë. Interneti po ushtron një ndikim të madh në standardin leksikor, fonetik, sintaksor të gjuhës. Nga ana tjetër shkolla përpiket t'i mësojë nxënësit të përdorin gjuhën standarde. Interneti, duket se po ushtron ndikim të rëndësishëm edhe në mësimin e gjuhës. Gjuha e përdorur në disa nga llojet e komunikimeve elektronike nuk i përmbahet rregullave të standardit gjuhësor dhe normave bazë të drejtshkrimit të shqipes së shkruar.

Nga sa u parashtrua më sipër mund të themi se gjuha shqipe ka kaluar një proces të gjatë standardizimi duke u përballur me një sërë problemesh dhe sfidash. Megjithatë ajo zotëron të gjitha cilësitë e një mjeti mbarëkombëtar komunikimi, është e aftë për të përmbushur të gjitha funksionet e një gjuhe moderne. Zotërimi, lëvrimi, pasurimi dhe mbrojtja e saj janë detyra të shenjta për këdo që e ka shqipen gjuhë amtare.

Detyrë po aq të rëndësishme kanë edhe institucionet arsimore në vend. Pavarësisht aritjeve të deritanishme dhe përcaktimit e hartimit të një vizioni të ri kurikular në drejtim të mësimin të gjuhës shqipe, mbetet ende shumë punë për të bërë. Edhe pse programet e lëndës së gjuhës shqipe kanë një vend qendror në programet shkollore, janë rikonceptuar, përmirësuar dhe ristrukturuar, janë mbështetur në parime të reja gjuhësore dhe didaktike, duhen ende përpjekje për të rritur kulturën gjuhësore të nxënësve, kulturën e të folurit, të shkruarit, e jo vetëm të tyre, por edhe të të gjithë shqipfolësve. Shkolla duhet të mbështesë nxënësit për ta njësuar mësimin e gjuhës shqipe standarde, pasi nëpërmjet saj zhvillohen shprehitë komunikative që realizojnë aktin e komunikimit në tërësi.

Përmes shprehive synohet të aftësohen nxënësit:

- Për zhvillimin e dëgjimit të kujdesshëm,

- Për zhvillimin e të folurit saktë dhe me përpikmëri,
- Për zhvillimin e të lexuarit dhe të kuptuarit të tij,
- Për zhvillimin e të shkruarit standard të gjuhës dhe të modeleve të veta përfaqësuese (Gjokutaj M. :46-47).

Pra, përmes kërkesave të parashtuara në program për zhvillimin gjuhësor të nxënësve synohet që ata të komunikojnë me njerëz të moshave të ndryshme, në situata të ndryshme komunikuese duke rritur aftësitë e tyre gjuhësore, për të arritur deri në krijime të nivelit të lartë si dhe në një mësimdhënie me kërkesa mjaft të larta. Gjuha e teksteve ka udhëhequr gjithmonë gjuhën e folur të nxënësve dhe mësuesve, kështu që detyrë parësore e shkollës mbetet dhënia e nocioneve themelore për gjuhën si shkencë dhe ngulitja tek nxënësit edhe praktikisht të normave gjuhësore letrare të njësuar si sistem (Çeliku M. 2006 :371). “Veç duhet pranuar se është disi i vështirë, por jo i pamundshëm zotërimi i shpejtë, jo vetëm teorik, por edhe praktik i normave të gjuhës së njësuar (Çeliku M. po aty).

Zotërimi i gjuhës standarde në shkollë duhet vlerësuar si detyrë parësore, nga mësuesit dhe nxënësit kërkohet punë me përkushtim dhe pasion si dhe një përgatitje shkencore e pedagogjike e mësuesve, çka do t’i aftësojë ato për të punuar me tekstet e reja dhe për të mënjeluar tradicionalizmin. Futja e lëndës së gjuhës në shkollën e mesme do japë një zgjidhje më të drejtë të raporteve gjuhë/metagjuhë, nga cikli nëntë vjeçar në atë të mesëm. Në shkollën e mesme zënë një vend të rëndësishëm konceptet formuese në atë shkallë sa jepet një pasqyrë e plotë përshkimore e “botës shqipfolëse” në përputhje me aftësitë perceptuese dhe logjike të zhvillimit të fëmijës dhe të zhvillimit të identitetit të tij si shqipfolës (Rrokaj, Sh. 2007 :209).

KAPITULLI III KOMUNIKIMI ELEKTRONIK

3.1 Koncepti i komunikimit elektronik

Në këtë kapitull do të përpiqemi të japim një përfaqësim të komunikimit elektronik nëpërmjet internetit, pasi shohim që ai ka prirje të pandalshme për të qenë i padukshëm, domethënë veprimet që kryhen ndërmjet dërgimit të një mesazhi në rrjet dhe përgjigjes që vjen bëhen në mënyrë të padukshme për përdoruesin. Pra, ashtu si për të ngarë mirë një makinë që nuk është aq e nevojshme të dish se çfarë ndodh nën mbulesën e saj, edhe përdoruesi i veçantë i internetit nuk nxjerr ndonjë dobi të madhe nga informacionet teknike që mund t'i tregoheshin. Natyrisht mbetet e ligjshme kërkesa për të kënaqur kureshtjen e tij, pasi disa veprimtari profesionale kanë nevojë për dije të thelluara.

Sa për pyetjen se çfarë do të ndodhë me internetin në të ardhmen mund ta lëmë të lirë imagjinatën tonë ta gjejë siç ka bërë presidenti i Microsoft-i, Bill Gejts (Bill Gates). (Gates 1997). Në këtë rrjet mbarëbotëror komunikimet elektronike udhëtojnë pa pengesë dhe me shpejtësinë e dritës, përdoruesit komunikojnë në kohë reale dhe largësia nuk ka më rëndësi. Në ditët e sotme është rritur mundësia e informimit dhe komunikimit dhe janë zvogëluar mundësitë e kontrollit dhe censurës. Komunikimi me anë të internetit është në thelb multimedial dhe interaktiv. (Cristian Baylon. Xavier Mignot. :307).

Kundrejt shumicës së mediave që ekzistojnë para internetit, ndërveprimi përbën një risi. Radioja dhe televizioni kanë si parim që të lidhin marrës të panumërt me një transmetues, por komunikimi është “asimetrik” domethënë bëhet vetëm në njërin drejtim. Dëgjuesit ose shikuesit kënaqen duke parë emisionet, ata nuk mund të përgjigjen ndryshe, veçse duke e mbyllur aparatit ose duke ndryshuar kanalit. Vetëm

telefoni qysh në fillim i vinte pjesëmarrësit në kushte barazie, sepse secili që bën thirrjen, vendos një shkëmbim me të thirrurin. Pasiviteti i komunikuesve nuk përshtatet me internetin. Kemi parë se pajisjet janë në gjendje të zëvendësojnë telefonin me faksin, pra tashmë kemi pasur media ndërvepruese. Lidhur me viset(sitet) që mund të përdorim ato kuptohen dhe funksionojnë më mirë kur u drejton pyetje. Prandaj në themel interneti është dialogues. (Po aty, :308)

3.2 Llojet e komunikimit elektronik

Përparimi i industrisë dhe teknologjisë në botën perëndimore, jo vetëm që ka ndihmuar në përmirësimin e mirëqenies së njerëzve, por ka ndikuar edhe në ndryshimet shoqërore dhe në mënyrën e jetesës. Gjithashtu, të gjitha këto ndryshime dhe risitë teknologjike në fushën e komunikimit e kanë përmirësuar komunikimin dhe ndërveprimin shoqëror midis njerëzve, duke mundësuar jo vetëm bartjen e informacioneve nga njëri skaj i botës në tjetrin, por edhe bartjen e botëkuptimeve, vlerave e koncepteve të reja. Megjithatë, mund të thuhet se kthesa kyçe e këtyre ndryshimeve pozitive ka qenë avancimi dhe zhvillimi në fushën e teorisë së informacionit dhe të teknologjisë informative, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore. Në kuadër të këtij zhvillimi, një rol të rëndësishëm luajtën zbulimi i transistorëve (1947) dhe i qarkut të integruar (1957), që i hapën rrugë zbulimit të çipave të kompjuterëve, më 1971, dhe në këtë mënyrë u vunë themelet e teknologjisë informative dhe kompjuterave.

Interneti ka lindur si rrjet i komunikimit në kuadër të forcave mbrojtëse kombëtare të SHBA-ve, që në rast të sulmit në një zonë të caktuar të mos dëmtohet i tërë rrjeti i komunikimit të forcave mbrojtëse amerikane. Lidhja e parë midis kompjuterave (midis University College London dhe rrjetit akademik të SHBA-ve Arpanet) u bë më 1973,

ndërkohë që lidhjet e reja të kompjuterave filluan të shtohen edhe më tepër më 1975, kur filloi të zbatohet teknologjia e satelitëve. Grupet e para bisedimore (chat groups) dhe të shkëmbimit të email-eve u krijuan në vitet '70, midis një grupi të vogël shkencëtarësh të katër universiteteve amerikane (UCLA, University of California in Santa Barbara, Stanford dhe University of Utah). Ndërkaq, më 1990-1991, Tim Berners-Lee nga Instituti për Fizikë të Energjisë së Lartë – CERN në Gjenevë, e ndërtoi një sistem hipertekstor, i cili mundësonte që informatat të ndaheshin përgjatë rrjetit të kompjuterave, dhe kështu më 1992 u krijua World Wide Web (WWW), pra ueb faqja e parë (Block, 2004: 27-28).

Pas vitit 1992, Interneti pati një përhapje dhe shtrirje marramendëse nëpër botë, duke u zhvilluar dhe përsosur edhe më tepër. Funkcionet e tij u zgjeruan duke mundësuar shkëmbimin e informatave dhe komunikimin në të gjitha format. Sistemet e ueb-faqeve, të emali-eve, të bashkëbisedimit në grupe dhe veç e veç (chat), sistemet e mesazheve të çastit (instant messenger) dhe sistemi i komunikimit të ndërmjetësuar përmes kompjuterit vazhdojnë të përsosen edhe sot e gjithë ditën (Shkumbin, M. 2009 : 76-80).

Zhvillimi dhe përsosja e mëtejshme e internetit ka mundësuar që përveç formave të shkruara të gjuhës, të zhvillohen edhe format e komunikimit audio-vizual, përmes video- konferencave dhe thirrjeve telefonike kompjuter me kompjuter (PC-to-PC calls) në internet. Duke e parë gjithë këtë ndikim të internetit në ligjërimin njerëzor, David Crystal thekson se tashmë po lind një fushë e re e gjuhësisë, gjuhësia e internetit (Internet Linguistics). Ai e përkufizon këtë fushë si analizë sinkronike e gjuhës në të gjitha fushat e aktivitetit në internet, duke përfshirë email-et e ndryshme, dhomat e bisedave (chat rooms) dhe ndërveprimet përmes lojërave në internet, mesazhet e çastit

(instant messaging), ueb-faqet dhe duke përfshirë fushat e tjera të ndërlidhura të komunikimit të ndërmjetësuar me kompjuter (CMC, computer-mediated communication), siç është komunikimi me tekste mesazhesh, pra me SMS përmes telefonave celularë (Crystal, 2005).

Sipas tij, interneti ka mundësuar që në gjuhë të zhvillohet një medium i ri i komunikimit, kryesisht i ndryshëm nga format tradicionale, siç janë të folurit dhe të shkruarit. Tiparet që e dallojnë komunikimin e ndërmjetësuar me kompjuter (ang. CMC) nga të folurit, përfshijnë mungesën e feedback-ut, mungesën e fonologjisë josegmentare (siç janë zëri e intonacioni, të cilët mund t'i zëvendësojnë emotikonet, por këtë nuk mund ta bëjnë plotësisht) dhe mundësinë për ndërkomunikim të shumanshëm simultan (në dhoma bisedimesh). Tiparet që e dallojnë komunikimin e ndërmjetësuar me kompjuter nga shkrimi, përfshijnë dimensionin dinamik (siç janë efektet e tilla si animacioni dhe rifreskimi i faqeve), aftësia për të krijuar korniza tekstore (siç është funksioni cut / paste) dhe hipertekstualiteti. Interneti gjithashtu, i ka dhënë gjuhës varietete të reja stilistike, duke rritur gamën shprehëse të gjuhës në fondin joformal të spektrit të të folurit (Crystal, po aty).

Sa i përket përdorimit të gjuhëve të ndryshme në internet, deri vonë ka mbizotëruar pikëpamja se anglishtja si gjuhë dominuese botërore zë vendin kryesor në internet. Megjithatë, statistikat e fundit tregojnë se hapësira që zë anglishtja në internet ka filluar të zvogëlohet, ndërkaq hapësira e gjuhëve të tjera botërore ka filluar të rritet gjithnjë e më tepër. Crystal-i (2001) dhe Block-u (2004) ndajnë mendimin se për aq sa interneti i ka krijuar hapësira të mëdha përdorimi anglishtes, po aq është duke krijuar hapësira për gjuhët e tjera botërore, duke e bërë internetin në të vërtetë një “mjet shumëgjuhësh”.

Në katër studime të ndryshme të kryera në disa vende të botës (Ukrainë, Poloni, Maqedoni, Itali, Francë, Tanzani, Oman, Indonezi, Emirate të Bashkuara Arabe dhe Japoni) lidhur me përdorimin dhe qasjen në internet sipas gjuhëve (Gerrard; Holmes; Mafu; Peel; 2004), del se ndonëse anglishtja ka një përdorim të ndjeshëm, sidomos nga folësit bilingë, megjithatë gjuhët vendore mbizotërojnë pothuajse në të gjitha format e përdorimit në internet. Kjo dëshmon se interneti është bërë strehë dhe hapësirë pak a shumë për të gjitha gjuhët, folësit e të cilave e shfrytëzojnë internetin. Crystal-i thekson se; ndonëse nuk dihet saktësisht se sa gjuhë janë të pranishme në internet, ai shumë lehtë ka arritur t'i gjejë mbi 1000 gjuhë (Crystal, 2001). Me fjalë të tjera, megjithë dominimin e anglishtes si gjuhë globale, interneti ka shkaktuar një revolucion të vërtetë në afrimin e gjuhëve të ndryshme të botës, duke krijuar hapësirë për përdorimin dhe ruajtjen e tyre.

3.3 Posta elektronike (E-mail)

E-mail është bërë një nga mjetet më të popullarizuara të komunikimit gjatë dekadave të fundit, por fillimisht nuk ishte menduar për të shërbyer si një mjet që të transmetonte të dhënat personale. Fenomeni ishte rezultat i projekteve të ndryshme kërkimore gjatë kulmit të Luftës së Ftohtë. Ideja ishte për të zhvilluar një rrjet të decentralizuar të kompjuterave që mund të përdreshin për të transmetuar informacion në të gjithë Shtetet e Bashkuara në rast të një sulm bërthamor. Në qoftë se një objektiv do të goditej, kjo nuk do të dëmtonte aftësinë e vendit për të shpërndarë të dhënat e mbrojtjes në një vend tjetër (Baron 2000).

Nga 1968-ta, sistemi i decentralizuar informatik është realizuar si ARPANET (Advanced Research Projects Agency Network) dhe ishte e drejtuar nga Departamenti

Amerikan i Mbrojtjes. ARPANET iu nënshtrua një sërë transformimesh gjatë dy dekadave të ardhshme dhe në fillim të viteve 1990 ajo doli si Interneti (Baron 2000). Shkëmbimi i mesazhe elektronike nuk ishte pjesë e dizajnit origjinal të ARPANET-it, derisa dy programuesit eksperimentuan me dërgimin e mesazheve personale me njëri-tjetrin në fillim të viteve 1970 (Baron 2000).

Në vitet e para, të 1970 -1980, qasja në E-mail ishte kryesisht në duart e fakultetit dhe studiuesve të lidhur me komunitetin shkencor, shumë prej aktiviteteve profesionale të të cilit ishin të financuar nga Departamenti Amerikan i Mbrojtjes (Baron 2000 :226). Në vitet 1980, E-mail u prezantua në botën e biznesit në rrjetet e zonës lokale për t'u mundësuar punonjësve komunikimin në lidhje me çështjet e biznesit brenda organizatës së tyre. Disa punëdhënës dërguan mesazhe personale me E-mail. Megjithatë, përdorimi shoqëror ishte i kufizuar në mënyrë të drejtë (Baron 2000). Edhe pse interneti si një teknologji ka qenë ideuar që nga viti 1960 për e-mail dhe chat, shumë pak njerëz filluan ta shfrytëzonin atë rreth tridhjetë vjet më vonë. World Wide Web vetë erdhi në ekzistencë vetëm në vitin 1991. Por në një kohë jashtëzakonisht të shkurtër, njerëzit adoptuan dhe zotëruan teknologjinë, duke përshtatur dhe zgjeruar gjuhën e tij shumë të veçantë (Crystal 2005: 64).

Në mes të viteve 1990, kompjuteri dhe chat grupe të tilla si për shembull IRC, ishin shumë të popullarizuara. Ata ishin të lira me kusht që të ruanin anonimitetin nga zëra maskues dhe identitetin seksual. Ata lejuan njerëz nga e gjithë bota që të bisedonin me njëri-tjetrin dhe dikush mund ta krahasonte këtë me emocionet e të paturit të një stilolaps-Pal nga pjesë të ndryshme të botës. E-mail gjithnjë e më shumë është duke zëvendësuar telefonin (jo celular), dhe letrën tradicionale. Sipas "Wall Street Journal" (14 janar, 1999, :1), gati katër trilion mesazhe e-mail u dërguan në vitin 1998, krahasuar

me 107 miliard e-maile të postës First-class që u përcollën përmes zyrave postare në SHBA (Baron 2000: 241). Në vitin 1998, më shumë se dy miliardë e-maile janë dërguar çdo ditë në SHBA, dhe International Data Corporation parashikoi që numri do të rritet në tetë miliardë nga 2002 (Baron 2000).

Sipas Wolf (2007), numri është rritur nga 31 miliardë e-maile në ditë në vitin 2003 në 97 miliardë e-mail në ditë në vitin 2007 (Wolf 2007). Ka edhe arsye për të besuar se numri i teksteve të padëshiruara të dërguara në ditë është më i lartë se numri e-maileve personale të dërguara në ditë. Sipas Dunn (2007), Mbretëria e Bashkuar ka marrë rreth 20 miliard *spam*² e-maile në ditë në vitin 2007, ku secili biznes në *Inbox* ka marrë nga 100 dhe 1000 e-mail *spam* të përditshme. Në të gjithë botën, 120 miliardë Spam e-mail janë dërguar në ditë (Dunn 2007).

Teknikisht e-maili është një formë e të shkruarit, por konventat e tij të përdorimit janë më afër ose ballë për ballë me bisedat telefonike, sipas Baron (2000). "Në kontrast me një bisedë telefonike, kur shkruajmë një e-mail, kemi mundësi për ta redaktuar atë. Megjithatë, e-mailet dërgohen shumë shpesh pa asnjë redaktim . Në e-maile dhe ndërveprimet chat-gruop, ku presioni për të komunikuar shpejt është shumë i fortë, mungon kujdesi për të shkruarit, mungojnë ndërtimet e përpunuara gjuhësore, të cilat janë karakteristike e të shkruarit. Nga njëra anë, kjo mund edhe të duket edhe si një revolucion që është gjithmonë duke u zhvilluar.

Disa njerëz janë aq të lumtur që dërgojnë mesazhe dhe nuk marrin mundimin aspak për t'i rishikuar ato, nuk kujdesen për gabimet gjuhësore, drejtshkrimi është i parregullt, dallojmë mungesën e shenjave të pikësimit dhe anomali të tjera që mund të përfshihen në to "(Crystal 2005: 79).

² Spam e-mail janë e-mail që janë pothuajse identike, shpesh me një përmbajtje tregtare, dhe që janë dërguar për shumë marrës njëherësh.

Në vitin 1999, u publikua një histori në “The Washington Post” duke u thënë lexuesve të saj në lidhje me një virus që është përhapur në të gjithë internetin. Ai u quajt Virusi Strunkenwhite dhe refuzonte që të shfaqte e-maile, të cilat përmbanin gabime gramatikore (Truss 2003). Historia mbeti thjesht kalimtare (...). Të rriturit mund të shkarkojnë për tekstet e tyre edhe programe që kanë të bëjnë me korrigjimin e rregullave gramatikore, por më shqetësuese janë fëmijët e vegjël të cilët janë në zhvillim e sipër duke u rritur dhe varësia mbi mjete të tilla i bën që të mos njohin dhe interesohen fare për rregullat, ashtu si me makinën llogaritëse dhe aftësitë themelore në matematikë. Mund të thuhet se ne jemi duke u bërë fëmijëve tanë një dëmtim të madh arsimor, duke dekurajuar zhvillimin e aftësive që janë ende pjesë e arsimit bazë (Baron 2000: 213).

Mendimi i përgjithshëm është se e-mail ka elemente të dy stileve, të të folurit dhe të të shkruarit. Kufiri mes gjuhës së folur dhe të shkruar vazhdon të zbehet në Amerikë (Baron 2000: 259). Megjithatë, Crystal (2004), thotë se interneti ende nuk ka një ndikim të madh në fjalorin angleze dhe përdorimin e tij (Crystal 2004:). Ai thotë se kjo nuk është për t'u habitur, duke pasur parasysh se interneti ka relativisht një kohë të shkurtër që është në përdorim. Kjo nuk korrespondon me atë që cituam më sipër, me raportet e Baron (2000), dhe është e çuditshme se interneti në fakt ka pasur një ndikim në gjuhën angleze, duke pasur parasysh se ai është ndërtuar disa dekada më parë. Shkurtesat si SU për shihemi së shpejti, L8R për shihemi më vonë, dhe LOL për të qeshur me zë të lartë, kanë hyrë në përdorim në chat grupe në internet. Kam dëgjuar shumë të rinj duke thënë lol në jetën e vërtetë në vend të të qeshur me zë të lartë. Kam dëgjuar edhe njerëz duke imituar një C, një U, L, 8 dhe R me gishtat e tyre për të përcaktuar CU, L8R, kur

largohen shokët ose miqtë e tyre. Kjo tregon qartë se interneti ka një ndikim të madh në përdorimin tonë të gjuhës dhe në sjelljen e përditshme.

Në lidhje me gramatikën dhe fjalorin dikush mund të thotë se mail-i është më afër fjalës së shkruar konvencionale. Nga ana leksikore, mesazhet kanë tendencë të jenë jashtëzakonisht joformale, përfshirë edhe fjalë të shkurtuara (të tilla si prob. për problemin), dhe përdorimi i fjalëve si flm për faleminderit, apo klm për kalofsh mirë etj.. Kështu pra, biem dakord se në një farë mënyre nga ky lloj komunikimi nuk preket vetëm gjuha e shkruar, por edhe ajo e folur. (Crystal 2008: 151)

3.4 Internet Chat

Komunikimi elektronik, i cili sa vjen e bëhet gjithnjë e më i përdorur dhe realizohet në rrugë të ndryshme, nga të cilat përveç e-mailit mund të përmendim edhe çat-in apo mesazhet e celularit. Në fund të viteve '80 dhe në fillim të viteve '90 të dyja këto rrugë komunikimi fituan një përdorim dhe popullaritet të madh mes njerëzve në të gjithë botën. Komunikimi që realizohet përmes këtyre dy rrugëve u dha mundësi njerëzve të shkëmbejnë ide, eksperiencë dhe emocione në kohë reale dhe mbi të gjitha të mos pengoheshin nga asnjë lloj kufiri gjeografik apo edhe kulturor. Teknologjia dhe logjika e përdorur në lidhje me shkëmbimet e mesazheve telefonike nuk ka ndryshuar shumë, ndërsa komunikimi on-line në rrjete të ndryshme ka pësuar ndryshime të mëdha, ku disa prej tyre reflektohen shumë edhe në mënyrën sesi shkruajnë njerëzit kur komunikojnë ndërmjet tyre.

Nëse i referohemi fillimeve të çateve në internet duhet të kemi parasysh që nuk shkruhej sikurse shkruhet në ditët e sotme. Përpara se përdoruesi i një rrjeti social të bënte regjistrimin duhet të respektonte disa rregulla, të cilat në vetvete përbënin atë që quhet "Etika e Rrjetit". Kjo nuk përfshinte vetëm mënyrën sesi duhej të silleshe (pra, të

mos ofendoje miqtë e tu në komunikim, të mos shfaqje shenja agresiviteti apo dhune), por edhe të shkruaje në mënyrë të rregullt.

Kur njerëzit filluan të praktikonin komunikimin elektronik nuk e mendonin se do të varehin kaq shumë prej tij. Kjo varësi nuk nënkupton vetëm atë që ne sot e njohim si konotacion negativ. Varësia, e cila është edhe më e rëndësishmja, është varësia kulturore dhe gjuhësore që krijohet mes përdoruesit dhe mjetit. Me siguri që as edhe një përdorues nuk do ta merrte dot me mend se pikërisht nga komoditeti që ofronte ky lloj komunikimi ata do ta praktikonin gjithnjë e më shumë. Sa më shumë që të përdorej komunikimi elektronik, aq më shumë opsione dhe mundësi të reja komunikimi zhvilloheshin.

Në fillim të shekullit të 21-të, në vitin 2004, me krijimin e Facebook komunikimi online ndryshoi tërësisht. (<http://www.intomobile.com>). Kjo mënyrë e re komunikimi jo vetëm që u dha mundësi njerëzve të kontaktonin më shumë, të shkëmbejnë më shumë informacion rreth tyre, por ndryshoi gjithashtu edhe kulturën tonë. Përtej fenomenit “Facebook”, ajo që i shqetëson gjuhëtarët sot është gjuha e re që ka sjellë kjo mënyrë komunikimi. Duke përdorur çatin, lindi edhe një formë e re komunikimi, një “minialfabet” që përbëhej nga simbole dhe shkurtime, por që përdorimi i shpeshtë i tij i dha mundësi të praktikohej edhe më gjerësisht.

Teknikisht, nëse u hedhim një sy hapësirave që vë në dispozicion faqja e çat-it, duket sikur është krijuar enkas për të shkruar shkurt. Nuk mund të themi nëse qëllimi ka qenë të shkruhet me shkurtime apo të shkruash shumë pak, ajo që është e sigurt është se fjalët dhe fjalitë sa vijnë e shkurtohen duke kapërcyer çdo lloj rregulli gramatikor. Edhe shkronja e madhe në të tilla komunikime pothuajse është zhdukur nga përdorimi, me përjashtim të atyre rasteve kur një fjalë shkruhet me shkronjë të madhe

edhe në mes të fjalisë, sepse duhet të theksohet.

Gjithashtu, shenjat e pikësimit, të cilat i përmendëm edhe pak më lart luajnë të njëjtin rol duke u përdorur vetëm për të theksuar diçka. Ndërkohë, ajo që vihet re rëndom nëpër komunikimet elektronike është edhe përsëritja e së njëjtës shkronjë disa herë në një fjalë si për të treguar që po thërras apo theksoj këtë gjë. Të gjithë këto shembuj tipik të komunikimit elektronik përmes çat-it në internet tregojnë për një ndryshim të madh që ka pësuar shkrimi në kompjuter. Duke qenë se njerëzit e përdorin gjithnjë e më shumë këtë komunikim dhe sidomos të rinjtë, ata priren të ndjekin shembullin dhe kodet e tij të shkruarit edhe në shkollë apo në të folurin e përditshëm. Kështu kjo ndikon edhe në përgatitjen apo edhe ndërgjegjësimin e të rinjve në shkrimin e gjuhës dhe ruajtjen e gjuhës standarde.

3.5 Tekstet e shkruara telefonike (SMS-të)

Një tjetër mjet komunikimi po aq i përdorur dhe i famshëm në shkrimin dhe komunikimin elektronik është edhe telefoni celular, i cili për herë të parë doli në treg në 6 mars të vitit 1983 dhe atëherë kushtonte plot 3995 \$. Edhe pse madhësia dhe sistemi i tij nuk e bënte aspak komod, ai ishte një nga arritjet njerëzore më të lakmuara duke i dhënë shtysë shkencëtarëve dhe informaticienëve të punonin akoma më shumë për ta përsosur atë. Në fillim celulari përdorej vetëm për komunikim gojor dhe bateria e tij nuk mbante më shumë sesa 1 orë komunikim pa ndërprerje dhe 8 orë në qetësi. Pavarësisht kësaj, ai ishte shumë i kërkuar, por jo aq i kërkuar sa ç' rezultoi me ndryshimet që pësoi në vitin 1988 kur telefoni celular u pajis edhe me komunikim të shkruar.

Tekstet e mesazheve njihen ndryshe si SMS, të cilat në fakt janë një shkurtime i

emërtimit të tij të gjatë “komunikimi me mesazhe të shkurtra (short message communication)”. Kështu gjuha e përdorur në shkrimin dhe komunikimin e njerëzve përmes mesazheve të telefonit nuk bëri gjë tjetër veçse e theksoi akoma më shumë modelin e shkrimit elektronik. Rrjedhimisht format e të shkruarit në mesazhet telefonike u kushtëzuan nga dy arsye kryesore; e para për shkak të numrit të kufizuar të karaktereve që ka një mesazh (zakonisht 160) dhe së dyti për shkak të çmimit të atij mesazhi. Nëse karakteret e përdorura e kalonin numrin e përcaktuar për një mesazh, atëherë automatikisht ti kalon në një mesazh tjetër duke paguar dyfish, trefish e kështu me radhë në varësi të numrit të karaktereve. Janë pikërisht këto arsye të forta, të cilat çojnë edhe në ndryshimin e gjuhës standarde me të cilën komunikojnë njerëzit. (University of Cambridge, survey 2009)

Ashtu si në komunikimin me e-mail apo në çat, edhe përmes mesazheve telefonike gjuha standarde ndryshon duke marrë trajta të reja përdorimi si më poshtë;

- zhdukja e shkronjës *g* gjatë përdorimit të gerund – *goin* dhe jo *going*
 - shkurtimi i fjalëve duke hequr zakonisht shkronjën e fundit - *afte* dhe jo *after*
 - inicializim i shprehjeve më të përdorura – *LOL laughing out loud*
 - përdorimi i numrave në vend të fjalëve – *B4* dhe jo *before*
 - përdorimi i homofoneve përmes shkronjave – *u* dhe jo *you*
 - drjetshkrim i gabuar ose zakonisht ashtu siç shqiptohet dhe jo siç shkruhet – *nite* dhe jo *night*
 - mungesa e shkronjës së madhe në fillim të fjalisë
- përdorimi i simboleve në vend të shprehjes së emocioneve - □ dhe jo *jam i gëzuar*
(po aty:2009)

Sipas Owens, është shumë e rëndësishme që t’i kushtohet një vëmendje e veçantë

arsimit dhe shkrimit në gjuhën angleze, qoftë kjo si gjuhë e parë ose si gjuhë e dytë, pasi komunikimi elektronik është shumë i përhapur dhe gjen përdorim më së shumti tek adoleshentët dhe të rinjtë, të cilët shpeshherë edhe pse nuk janë në dijeni të njohurive dhe rregullave gjuhësore, janë gjithnjë e më të ekspozur ndaj moszbatimit të tyre. Shpeshherë hasim fenomene të çuditshme, nxënës ose studentë të cilët nuk dinë asnjë rregull gramatikor apo drejtshkrimor dhe shkruajnë detyrat e tyre sikur të jenë duke shkruar një e-mail apo në çat.

Ajo që duhet të kemi parasysh është se përdorimi i këtyre mjeteve teknologjike në shkolla është një çështje shumë kritike. Përtej rëndësisë dhe avantazheve që krijon, ekziston edhe rreziku se mos ndoshta kjo lloj praktike mund të influencojë negativisht tek studentët. Në vazhdimësi, ajo që Owens propozon është një ndarje e barabartë e rëndësisë së teknologjisë dhe shkrimit me dorë në mjediset akademike. Ndonjëherë duke u munduar të ndreqim diçka, mund të përfundojmë duke e shkatërruar atë dhe tani nuk kemi shumë kohë për të eksperimentuar. Është shumë e rëndësishme që përpara se të rinjtë apo fëmijët të ekspozohen me lloje të tilla komunikimi duhet të mësojnë më parë se çfarë është gjuha standarde, sesi ndikon teknologjia tek ajo dhe ajo tek teknologjia dhe më pas ata janë më të aftë për të zgjedhur atë mënyrë të shkruarit, e cila u duket më e përshtatshme. (Owens, 2006)

3.6 Shkurtesat

Sipas autorëve të ndryshëm (për shembull Crystal 2008 dhe Stedje 2001), shkurtesa kanë ekzistuar për aq kohë sa gjuha e shkruar ka ekzistuar. Tekste të shkruara me dorë nga mesjeta përmbajnë shumë shkurtesa për shkak të kostove të larta të materialit të shkruar. Më parë shkurtesat i përkisnin vetëm gjuhës së shkruar (të tilla si; etj., p.sh.),

por tani ka një sasi më të madhe të shkurtimeve që janë theksuar si fjalë dhe funksionojnë si fjalë (të tilla si; lol, sorry, emo).

Në shekullin XXI, ka një tendencë për të shprehur veten sa më shpejt, gjë që është veçanërisht e dukshme në reklama, në shtyp dhe në shkrimet e internetit. (Stedje 2001). Gjuha e shkurtesave, sipas Stedje ka lidhje me një tendencë që është përhapur shumë në dekadën e fundit. Ky është një fenomen ndërkombëtar, është bërë aq i fortë sa që studime dhe libra të shumtë kanë filluar të shkruhen për shkurtesat dhe përdorimin e tyre. Crystal ka shkruar disa prej tyre (Crystal, 2001, 2005, 2008).

Në gjysmën e parë të viteve 1800, vëllezërit Grimm ishin të parët të cilët sugjeruan krijimin e disa shkurtimeve në gjuhën gjermane duke qenë se shumë fjalë që i përkasin asaj gjuhe janë ose të gjata ose thujse të njëjta, duke ndryshuar vetëm parafjalët. Edhe pse ata njihen më shumë për përrallat e tyre të famshme, vëllezërit i kushtuan një rëndësi të veçantë edhe gramatikës dhe drejtshkrimit të gjuhës gjermane. Për shembull, për fjalët Lehrer dhe Lehrerinner ata sugjeruan që të shkruheshin LehrerInner me “I” të madhe, si për të treguar që të dyja fjalët ishin të përfshira.

Por, ky lloj shkurtimi nuk u pranua nga studiuesit dhe gjuhëtarët gjermanë përveç disa gazetarëve, të cilët mbështetën idenë e vëllezërve. Megjithatë, edhe sot e kësaj dite fjalët shkruhen veç e veç pa u shkurtuar. Tani gati tre shekuj më vonë, shkurtime janë pjesë e pothuajse çdo komunikimi, qoftë ky formal ose jo, i shkruar ose i folur. E gjitha kjo sipas studiuesve lidhet ngushtë edhe me shoqërinë njerëzore të këtyre viteve që shumë prej studiuesve e konsiderojnë si më sipërfaqësore. Gjithashtu, krijimi i këtyre shkurtimeve konsiderohet si një shpikje e brezit të ri, të cilit duket sikur nuk u intereson shumë gramatika apo drejtshkrimi i gjuhës, por vetëm fakti që ata duhet të shprehen.

Por sipas Crystal, kjo është një deklaratë e gabuar, pasi komunikimi elektronik nuk është pasqyrim i një mendjeje dembele, përkundrazi e vetmja arsye pse ai duket i tillë është kufizimi monetar (kur bëhet fjalë për shkrimin e mesazheve), ndërsa kur flasim për e-mailin apo çatin e internetin, shkurtimet ndodhin për shkak se personi me të cilin komunikojmë është i afërt me ne dhe kjo nuk na pengon të shprehemi siç duam, dhe këtu përfshijmë edhe mënyrën se si shkruajmë. Ashtu siç ne nuk mund të pretendojmë që të flasim në mënyrë letrare dhe me një regjistër të zgjedhur gjatë ditës me miqtë apo të afërmit tanë, ashtu edhe në komunikimin elektronik nuk mund të pretendojmë të shkruajmë gjatë. Për këtë arsye, edhe teknologjia e fundit ka dhënë ndihmën e saj në korrigjimin e shkrimit dhe mbi të gjitha atij elektronik, siç është ai i mesazheve telefonike.

Së fundmi, edhe në këtë lloj komunikimi ekziston opsioni “T9 predicative”, i cili bën të mundur rregullimin e fjalës që ju doni të shkruani. Për shembull, nëse fillon të shkruash “*I am*” por nga shpejtësia e shkruan „*im*” atëherë, përmes këtij opsioni fjala juaj i nënshtrohet një procesi vetëkorrigjimi i cili “gjen” se çfarë donit të shkruanit dhe e kthen atë në formën e rregullt gramatike, *I am* ose *I’m*. Teknologjia e ka bërë shumë të lehtë për ne për të ruajtur konventat ortografike, por shumë tekste mesazhesh dërgohen pa redaktimi. Kjo korrespondon me atë që Baron (2000) raportoi në lidhje me e-mail.

Një veprim gjuhësor kërkon ndërveprim dhe bashkërendim në shumë nivele në mënyrë që të jetë i suksesshëm. Grice (1989) ka formuluar parimin kooperativë, në të cilën ai rendit disa rregulla të ligjërit bisedor. Në mënyrë që të angazhohemi në një bisedë të suksesshme duhet të ndiqni disa rregulla të caktuara, të tilla si; "të shmangni paqartësinë e të shprehurit dhe të shmangni dykuptimësinë (Grice 1989: 27). Ne duhet

të shprehemi sa më qartë që mendojmë se është e nevojshme dhe të përdorim fjalë që dëgjuesi ynë të na kuptojë. Në mënyrë të qartë, tekstet e mesazheve janë një tendencë për të thyer këto ligjërime me shkurtesa që mund të shkaktojnë keqkuptime të hapura dhe të lënë shteg për interpretime të ndryshme të qëllimeve të folësit.

Njerëzit në përgjithësi janë të shqetësuar për gjuhën e teksteve të mesazheve dhe internetit, chat-it, pasi është një gjuhë që do të prishë gjuhën standarde. Të gjitha shkurtesat shihen shpesh si një simbol i analfabetizmit dhe shumë prej nesh kemi pyetur veten se pse njerëzit ndiejnë nevojën për të shkurtuar gjithçka. Në gazeta dhe në faqe të ndryshme interneti mund të lexohen pothuajse çdo ditë deklarata të tilla si ; "Unë e urrej gjuhën e internetit dhe mesazheve!" dhe "Unë i urrej ata shkurtesat budallaqe!"(Crystal 2008).

Kur u pyetën se pse njerëzit i përdornin këto shkurtesa, pamë që shumë prej të intervistuarve hasën vështirësi për të dhënë përgjigjen e duhur, gjithashtu shumë prej tyre janë të shqetësuar se studentët i përfshijnë këto shkurtesa në shkollë dhe për këtë arsye gjuha standarde e shkruar do të bjerë. Atëherë pse njerëzit i shkurtojnë fjalët? Përgjigjja mund të jetë që njerëzit e gjejnë si mënyrë për t'u zbavitur. Ai është i përshtatshëm ky lloj shkrimi dhe a mund të përshpejtojë ky fakt procesin e shkrimit? Crystal (2008) thotë se shpesh, mund ta kuptojmë nga konteksti se çfarë nënkuptohet në një mesazh elektronik, por në disa raste tekstet e mesazheve dërgohen pa shumë kontekst, sepse disa njerëz shkurtojnë pothuajse çdo fjalë dhe shkruajnë mesazhe duke shkurtuar më shumë se ç'duhet.

Në ditët e sotme, nëse fokusohemi në gjuhën shqipe dhe përdorimin e saj në media apo në të folurin e përditshëm, ndeshemi hera-herës me fjalë që kapërcejnë kufijtë e standardit dhe të vetë gjuhës shqipe (duke përdorur fjalë të huaja). Por, përveç

përdorimeve të tilla, kohët e fundit, kemi ndeshur në të shkruar disa fjalë të shkurtuara, të cilat gjejnë hapësirë në komunikimin elektronik në internetit. Përgjithësisht e përkufizojnë këtë lloj komunikimi si një mënyrë të shpejtë komunikimi, si një komunikim “që të zgjidh punë”, si një komunikim spontan mes njerëzve apo edhe si një mënyrë komunikimi “pa e vrarë mendjen”. Këto përkufizime të çojnë rrjedhimisht në mendimin se në chat “me patjetër” mund të ndeshemi me fjalë apo shprehje të shkurtuara, meqenëse dhënësi i informacionit kërkon të përçojë mesazhin e tij tek marrësi në një kohë sa më të shkurtër.

Fjalët dhe shprehjet në këtë lloj të folure janë nga më të ndryshmet. Ka përdorime fjalësh a shprehjesh të huaja ose në shqip të shkurtuara, të cilat mund t’i klasifikojmë sipas mënyrave më të shpeshta të përdorimit në:

1. fjalë a shprehje përshëndetëse “hyrëse”, të tilla, si: ciao, hi, hello, hola (në vend të “përshëndetje” në shqip), çkemi (vëmë re dhe mungesën e apostrofit), spk (në vend të “si po kalon”), stk? (si të kam?), prsh (në vend të përshëndetje) etj.
2. fjalë a shprehje përshëndetëse “mbyllëse”: tpf (në vend të “të puth fort”), klm (në vend të “kalofsh mirë”), flm (në vend të fjalës “faleminderit”), bacio/baci, puc/pufi (në vend të “të puth”), hugs (në vend të “përqaftime”), c u (see you) etj.
3. fjalë a shprehje të tjera të shkurtuara të tipit: tl (në vend të “të lutem), sh (në vend të shumë), mrsh (në vend të marshalla - mashalla) etj.

Pa u larguar nga grupimi i mësipërm i fjalëve dhe shprehjeve përshëndetëse në MSN mes të rinjve na bën përshtypje dhe mënyra se si ata i drejtohen njëri-tjetrit me përkëdheli, duke i quajtur p.sh.: ylli (por kemi ndeshur edhe thirroren yllo), zemra, zogu, shpirti, zemrush, pitushi, motre/motrush (për të shfaqur afri mbi caqet shoqërore në ato familjare), shoqë, rrusho etj. (në shqip) dhe tesoro, dear, darling (në italisht apo

anglisht). Vlen të përmendim edhe rastin kur femrat i drejtohen njëra-tjetrës, përveçse meshkujve, me: o shoku apo o lali ose o lal. Në të shumtën e rasteve nuk kemi vënë re përdorimin e shkronjave të mëdha kur niset një fjali e re apo edhe kur lipset përdorimi i tyre në rastin e shkrimit të emrave të përveçëm. Shpeshherë në fjali të tilla nuk vihet as pika për të ndarë njëren fjali nga tjetra, por në këtë rast rolin e saj e luajnë paragrafët e rinj që veçohen herë pas here me anë të tastit “Enter” në tastierë e që në MSN dalin më vete dhe janë lehtësisht të dallueshëm.

Gjithashtu, përpos përdorimeve të shkurtimeve të sipërpërmendura të gjuhës shqipe, ndeshemi shpesh edhe me përdorimin e shkurtimeve të huazuara, kryesisht nga italishtja dhe nga anglishtja. P.sh. thnx (në vend të “thanks”), pls/plz (në vend të “please”), ok (në vend të “dakord”), bc (baci), tvb (ti voglio bene), tvtb (ti voglio tanto bene), tvumdb (ti voglio un mondo di bene), bc (baci), gg (oggi), cmq (comunque), c 6? (ci sei?), lol (laugh out loudly) etj. Në disa raste kemi ndeshur dhe përdorimin e x-së në vend të ks-së në fjalë të ndryshme, si: Alexandër (për Aleksandër), anex (për aneks), text (për tekst), fix (për fiks), lexion (për leksion) etj. Për paralelizëm, mund të sjellim faktin që në Itali, në të tilla situata, italianët shpeshherë përdorin k në vend të ch apo c, në varësi të fjalës (p.sh. “perke” për “perche” etj.). Siç edhe dihet, secili “përdorues” i chat-it i përdor fjalët në shërbim të përcjelljes së informacionit në mënyrë të tillë që marrësi ta kuptojë tërësisht atë që ai kërkon të shpjegojë në një kohë sa më të shpejtë. Por ka edhe raste kur për të njëjtën shkronjë ka interpretime të ndryshme të saj. P.sh. nëse ndeshim një formë të tillë: “1 x” në shqip do të kuptohej si “një herë”, ndërsa në italisht “një për” (uno per uno).

Shkurtimeve e mësipërme janë bërë tashmë një kod lehtësisht “i përkthyeshëm” nga mijëra përdorues të chat-it në Shqipëri. Gjuha si një mekanizëm në lëvizje, pasurohet

dita-ditës dhe ashtu si pa kuptuar, pëson ndryshime në kontekste të ndryshme. Kontekst tjetër të ndeshjes së formave të tilla të gjuhës janë edhe mesazhet (sms-të) që dërgohen me anë të telefonave celularë. Përveç përdorimit të shkurtimeve të mësipërme, ndeshim edhe tekste si në vijim: *“M prit n mens. Do vij pr 5 min. Ka sh trafik ktu. M co 1 zile kur t lex. sms.”* Po të vëmë re këto fjali të thjeshta të tekstit të mesazhit, kuptojmë lehtësisht se ç’është shkruar, por ndryshimi nga “normalja” është pikërisht se disa fjalëve në të shkruar u mungon zanorja *ë* (e cila në shqiptim përfaqësohet nga bashkëtingëlloret që i paraprijnë); në vend të fjalës së plotë shumë është përdorur shkronja *sh*, në vend të foljes *lexosh* (veta e së cilës nënkuptohet nga konteksti) është shkruar *lex.*, si dhe në vend të shkronjës *ç* është përdorur *c*. Lidhur me ndryshimin e fundit, ku në vend të shkronjës *ç* përdoret *c*, mund të themi të njëjtën gjë edhe për shkronjën *e* që përdoret në vend të *ë*-së në raste të tjera, qoftë edhe në media sot (sidomos në median televizive).

Pra, përdorime të fjalëve a shprehjeve në kontekste të këtilla nuk mund dhe nuk duhet të kenë ndikim në gjuhën standarde shqipe, pasi këto shkurtesa vihen në ndihmë të “folësit elektronik” (në rastin konkret, shkruesit) vetëm dhe thjesht për arsye të shpejtësisë së përcjelljes së informacionit me shkrim apo për “kursim” të hapësirave në mesazhet që shkruhen mes miqsh (kryesisht tek të rinjtë). Gjuha e internetit a e chat-it është një formë e posaçme konvencionale e gjuhës së përgjithshme, qoftë kjo shqipja, italishtja, frëngjishtja, anglishtja etj. Ajo nuk mund të zëvendësojë gjuhën standarde në funksionet e saj.

3.7 Fjalët e huaja dhe huazimet në gjuhën shqipe

Një nga problemet kryesore të shqipes standarde në ditët e sotme është huazimi dhe përdorimi i gjerë i fjalëve të huaja, si dhe ndikimi i madh që kanë ato në përditshmërinë dhe komunikimin e çdonjërit prej nesh. Ekzistojnë shumë fjalë që kanë hyrë në leksikun e gjuhës shqipe si të nevojshme, të domosdoshme, të cilat akoma edhe sot nuk e kanë gjetur gjegjësen e tyre në gjuhën shqipe dhe që normalisht vazhdojnë të përdoren edhe sot. Të tilla fjalë janë; kompjuter, biznes, biznesmen, fondacion, globalizim, internet, media, teletekst etj.. Por gjithashtu, kemi shumë fjalë të huaja të panevojshme, të cilat po përhapen çdo ditë e më shumë dhe po i zënë frymën gjuhës shqipe si; selektoj, evitoj, dedikoj, aparendë, likuidim, etj.

Shembuj të tillë tregojnë bindshëm që ka ardhur koha që duhet të bëjmë diçka për të mbrojtur këto shkelje të rënda kundrejt normave të gjuhës letrare zyrtare. Mbrojtja e gjuhës në radhë të parë i përket shtetit dhe institucioneve shtetërore, politikave gjuhësore që ndërmerren për ruajtjen e saj, si dhe çdo përdoruesi të shqipes standarde.

Fjalët e huaja, ose thënë ndryshe huazimet, në një gjuhë janë kalimet e elementeve nga sistemi A në sistemin B, pra kalimi i fjalëve nga një gjuhë në një tjetër në bazë të disa faktorëve ndikues. Këto kalime janë të pranishme në të gjitha kohët, kur gjuhët vihen në kontakt (Rrokaj, Sh. 2007 :120)

Veç këtyre, kanë hyrë edhe fjalë të cilat kanë qenë të nevojshme në fillim, por më vonë janë zëvendësuar me gjegjëset e tyre në shqip, e megjithatë vazhdojnë të përdoren edhe sot, edhe pse janë të panevojshme, si p.sh. bipartizan për dypalësh, bipartiak për dypartiak, etj.,

Gjithashtu në gjuhën shqipe kanë hyrë edhe fjalë që e kanë pasur gjegjësen e tyre në shqip, por shqiptarët për t'u dukur "më evropian", më të civilizuar, më të zgjuar, nuk përdorin fjalën shqipe, por në vend të saj përdorin atë të huaj. Të tillë janë më së shumti politikanët dhe gazetarët. Shumë persona juridikë, shumë intelektualë, por edhe masa në përgjithësi, jo vetëm që nuk e përdorin fjalën shqipe, por mundohen që edhe ato fjalë që janë të pazëvendësueshme t'i zëvendësojnë me fjalë të huaja të panevojshme.

Si po nëpërkëmbet gjuha shqipe në ditët e sotme ?

"Sot po shohim një turmë të errët prej analfabetësh me diplomë në xhep, që po i vërsulen shqipes dhe duan t'i vënë thikën në kurriz, që ta gdhendin pas formës që u pëlqen atyre; se të gJORËT kujtojnë që gjuha është një copë dru pa shpirt. Nuk dinë që ajo është jo vetëm e gjallë, po edhe shumë e hollë, aq sa po i shtrembërove pakëz një nyjë a një dell, trupi i tërë i tronditet, vuan dhe humb forcën bashkë me bukurinë".

Kështu shprehet Faik Konica për analfabetët me diplomë. Po shtohen dita-ditës intelektualë, personalitete të shquara të fushave të ndryshme, politikanë dhe qytetarë të thjeshtë që e flasin në mënyrën më mizore gjuhën shqipe, këtë gjuhë kaq të bukur për të cilën shumë patriotë e atdhetarë u kujdesën që ta ruanin sa më mirë, u kujdesën që ta ruanin si një lule të vyer e plot aromë (Shkurtaj GJ. 2004 :17).

Përdorimi i madh përgjithësisht i fjalëve dhe i elementeve të huaja, sikur po lëkund dhe po dobëson strukturat gramatikore të shqipes. Problemet në rrafshin e terminologjisë duken të pakapërcyeshme në këtë shkallë të zhvillimit të gjuhës dhe në këtë shkallë të përpjekjeve institucionale e individuale për ta trajtuar problemin seriozisht e me ndjeshmëri. Hartimi i fjalorëve terminologjikë është shumë i paktë, ndonëse ky problem nuk zgjidhet vetëm me hartimin e fjalorëve dhe krijimin e

komisioneve. Problemet në këtë fushë i ka shtuar e ndërlikuar interneti me “super invazionin” e termave të tij. Në mediat, sidomos në ato elektronike, ka rënë ndjeshëm prestigji i shqipes standarde, si rrjedhojë jo vetëm e disiplinës së vogël gjuhësore, padijes e papërgjegjësisë së folësve, përkthyesve, redaktorëve dhe realizuesve të emisioneve, po edhe për arsye të rënies së ndjeshmërisë dhe nderimit për kategoritë elementare të qenësisë sonë kombëtare (Islamaj, Sh. 2008 :7).

Një tjetër problem mjaft i rëndësishëm është varfërimi i larmisë dialektore për arsye të tërheqjes së shumë të folmeve. Shpesh harrohet se dialektet, si bërthama themelore gjuhësore, mbeten mbështetje dhe burim i rëndësishëm për pasurimin e shqipes standarde. Nga gjuha e popullit për t’u përdorur në fusha të ndryshme të veprimtarisë, merren kryesisht fjalët e burimit amtar dhe jo ato që kanë hyrë nga gjuhët e huaja fqinje, si greqishtja, gjuhët sllave italishtja, etj..

Sa më i plotë të jetë standardi i një gjuhe nga pikëpamja e gjithëpërfshirjes gjuhësore dhe e masës së folësve që e përdorin, aq më shumë rritet trysnia e huazimeve dhe fjalëve të huaja. Standardi i shqipes ka nevojë të pasurohet edhe më tej. Ajo që quhet normë e standardit nuk mund t’i vihet prerazi përdorimit mbarëkombëtar, që ka në themel parimin e komunikimit dhe të kuptuarit në shqipe. Midis tyre ekziston një ecejak i pandërprerë me prirje afruese dhe jo një ndarje e ngurtë me prirje përjashtimore.

Faktorët që ndikojnë në huazim

Në historinë e vonë të shqipes dallohen tri lloje ndikimesh të mëdha nga gjuhët e huaja në leksik e pikërisht : fjalë (a)nga turqishtja, (b)nga gjuhët neolatine, (italishtja e frengjishtja), dhe së fundmi, (c) nga anglishtja.

Faktorët që ndikojnë në huazime janë të shumtë, por asnjëri prej tyre i marrë më vete nuk është përcaktues. (Rrokaj Sh. :117)

1. *Faktori i parë është thjesht gjuhësor dhe roli i tij është shumë i vogël. Ky është i ndjeshëm në gjuhët në kontakt dhe në gjuhët me afri gjenetike.*

2. *Faktori i dytë është ekonomik. Me ardhjen e demokracisë dhe marrjen fund të socializmit dhe kornizës së tij, shumë shqiptar emigruan jashtë vendit. Pas kthimit të tyre në Shqipëri, ata sollën me vete edhe produkte të reja nga vendi ku kishin emigruar. Këto produkte u futën në tregun shqiptar me emra të huaj, domethënë huazimi erdhi së bashku me produktin, por jo vetëm kaq. Përhapja e anglishtes në komunikimin e sotëm lidhet pa dyshim, me epërsinë ekonomike të SHBA-ve në tregun botëror. Ky faktor ka qenë padyshim i hershëm dhe kjo vërtetohet me përhapjen e greqishtes në tërë pellgun e mesdheut. Ky faktor nuk është plotësisht ai që vendos për fatin e gjuhëve. Kjo ndodh për arsye se ekspansioni ekonomik krijon mundësinë e dy qëndimeve ndaj ekspansionit gjuhësor. Qëndrimi i parë lidhet me mikpritjen, pranimin e ekspansionit gjuhësor nga vendi i cili kryhet ky ekspansion. Qëndrimi i dytë lidhet me një reagim pakënaqësie prej folësve të gjuhës pritëse për shkak të trysnisë së vazhdueshme të gjuhës ardhëse dhe të pamundësisë së përshtatjes së tyre.*

3. *Faktori i tretë është faktori i politikës ndërkombëtare. Shpesh faktori politik është i lidhur me faktorin ekonomik dhe të dy së bashku ndikojnë drejtpërsëdrejti në kulturë dhe në gjuhë. Kjo duket për shembull në interesimin aktual të gjermanishtes në Evropë.*

4. *Faktori i katërt është faktori psikologjik e sociologjik. Rol të madh në këtë drejtim luajnë marrëdhëniet historiko-kulturore të atyre popujve. Kjo ka të bëjë me mënyrën se si pritët dhe se si shihet gjuha në ekspansion, pra lidhet me anën psikologjike të folësve të gjuhës pritëse të ekspansionit psikologjik e*

sociologjik.

5. Faktori i pestë është faktori demografik. Ky faktor ka të bëjë me lëvizjen masive të njerëzve për arsye ekonomike, politike, fetare apo me synimin për të pushtuar tregje të reja. Kjo lëvizje mbart me vete edhe pasoja, qoftë për gjuhën e tyre, qoftë për gjuhën pritëse. Të tilla janë emigracionet shqiptare, spanjolle, italiane, portugeze etj.

Politikat gjuhësore bëhen zakonisht nëpërmjet institucioneve publike. Në formën e saj më të hapur ajo shprehet nëpërmjet dispozitave kushtetuese, me ligje të caktuara. Shumë shtete kanë ligje që rregullojnë përdorimin publik të gjuhëve në administratë, në media në marrëdhënie etj.. Sot politika gjuhësore synon të jetë gjithmonë e më e hapur.

Në përgjithësi ndërhyrja gjuhësore përqëndrohet në dy drejtime :

- Në vetë kodin e gjuhës
- Në kushtet e përdorimit

Në fushën e leksikut ndërhyrja gjuhësore gjen terren më të përshtatshëm, kur orientohet kryesisht në shmangien e fjalëve të huaja si dhe në procesin e fjalëformimit sipas modelit të gjuhës. Në një shoqëri të hapur politikisht dhe ekonomikisht, siç është shoqëria shqiptare sot, ndihet edhe trysnia e gjuhëve të vendeve të fuqishme politikisht dhe ekonomikisht me të cilat jemi në kontakt. Kjo trysni është e pashmangshme në fazat e para të hapjes ndaj botës. Fjalët dhe strukturat e huaja vërshojnë nga të gjitha anët, aq sa të krijohet përshtypja se po ia marrin frymën gjuhës. Mirëpo, hap pas hapi, folësit do të fillojnë të reagojnë me vetëdijen e vetëmbrojtjes, do të shtien në punë kujtesën e përbashkët për të kërkuar brenda gjuhës që përdorin gjegjëset e tyre dhe vetëm kur bëhet i pamundur zëvendësimi, atëherë do të pranojnë t'i përdorin, duke ua nënshtruar sistemit të gjuhës së tyre.

Në gjendjen e sotme të gjuhës shqipe, mendoj se duhet të mbahen këto qëndrime ndaj huazimeve:

1. Të marrim vetëm atë që është e nevojshme dhe që i shërben funksionimit të jetës në bashkësinë shqipfolëse.
2. Të vendosim rregulla të qarta për zbatimin e parimit fonetik në drejtshkrim.
3. Të vendosim rregulla të qarta për zbatimin e parimit gramatikor.
4. Institucionet e shtetit (administrata, shkollat, qendrat kërkimore, mediat dhe letërsia, aktet normative etj.) duhet të mbrojnë me përgjegjësi kombëtare gjuhën amtare
5. Vetë shoqëria duhet të nxisë vetëdijen gjuhësore shqipfolëse nëpërmjet kulturimit të përhershëm në gjuhën amtare,
6. Të vazhdohet me zgjerimin e standardit me prurje dialektore për të hapur edhe më shumë bazën e tij gjuhësore e për të rritur në këtë mënyrë aftësinë e tij qëndrestare (RROKAJ, Sh. :Panorama 23 Tetor, 2013)

3.8 Ndërkombëtarizmat

Me globalizimin e shoqërisë ndryshimi në leksik sa vjen e bëhet gjithmonë e më i madh, mirëpo ky ndryshim jo gjithmonë ndodh në të mirë të leksikut. Me lëvizjen e lirë të njerëzve, zhvillimet ndërkombëtare, me përsosjen e teknologjisë në leksikun e shqipes, kanë hyrë shumë fjalë të huaja, të cilat me kalimin e kohës janë bërë pjesë e leksikut. Këto fjalë janë kryesisht emërtime të teknologjive të ndryshme, të cilat kanë hyrë në Shqipëri me atë emërtim dhe kanë mbetur të tilla, sipas vendit të origjinës apo prejardhjes. Këto fjalë quhen ndërkombëtarizma, sepse janë me përdorim të njëjtë në shumë vende të botës. Ndër të tjera mund të përmendim: kompjuter, televizor, skaner, celular, camera, printer, laptop, DVD, etj..

Për të mbajtur një qëndrim të drejtë ndaj fjalëve me burim të huaj, kërkohet në radhë të parë njohje e mirë e shtresëzimit të tyre, e vendit që ato kanë zënë në gjuhë, e vlerave kuptimore dhe stilistike që ato kanë pasur në gjuhën prej nga janë marrë dhe të atyre kuptimeve të reja që mund të kenë fituar pasi janë bërë pronë e shqipes. Duhet të dimë gjithashtu edhe shtrirjen e tyre hapsinore etj... me fjalë të tjera duhet bërë një vështrim historik nëpërmjet të cilit mund të nxjerrim si përfundim se qëndrimi ndaj fjalëve me burim të huaj nuk mund të jetë i njëjtë. (Shkurtaç, Gj 2006 :169). Huazimet nga gjuhët e huaja, ndryshe nga fjalët e huaja të panevojshme e të parrënjosura në gjuhë, e kanë gjetur tashmë vendin e tyre në gjuhë. Mbi këtë bazë mund të dallojmë:

a. *Fjalë me burim të huaj që janë përvetësuar nga shqipja* e që janë bërë njësoj si fjalët e tjera të leksikut të shqipes. Hyjnë këtu huazimet e vjetra si; *qytet, shëndet, mjeshtër, karrocë*, etj. Dhe fjalët ndërkombëtare si; analizë, gramatikë, kongres, diktaturë, komedi, peizazh, akualet, teatër, etj.. Përbërja kuptimore e ndërkombëtarizmave në gjuhën shqipe ka marrë zhvillim origjinal, duke u gërshetuar me sistemin origjinal të shqipes. Ato vlerësohen si mjete e vlera të nevojshme që pasurojnë leksikun. Ato tashmë kanë depërtur thellë në gjuhë, janë bërë pjesë e pandashme e shqipes dhe zëvendësimi i tyre disa herë është i pamundshëm, e disa herë i padobishëm, sepse mund të dëmtojë shprehjen e qartë të nocioneve përkatëse. (Shkurtaç, Gj. 2010 :213)

Ndër parimet kryesore në zëvendësimin e fjalëve të huaja është maturia. Të njëjtës ide i mëshon edhe studiuesi kosovar, akademiku R. Qosja: “ Mund të thuhet se përdorimi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe, si dhe në gjuhët e popujve të tjerë, është i domosdoshëm. Purizmi, që bazohet në parimin e përjashtimit prej gjuhës kombëtare të të gjitha fjalëve të huaja, është i dëmshëm, po ashtu është i dëmshëm siç është edhe përdorimi i tyre, natyrisht në rastet kur nuk janë vërtet të domosdoshme. Gjuha, më në

fund, i përvetëson fare lehtë dhe fare natyrshëm dhe i hedh ato që nuk i përgjigjen dhe që nuk i duhen (Qosja, R. 1983 :74).

Shumë gjuhëtarë janë përpjekur që fjalëve të huaja në gjuhën shqipe t'ua gjejnë gjegjësen e tyre në shqip. Në momentin që këtyre fjalëve u gjendet gjegjësjë në gjuhën shqipe, këto fjalë nuk mbeten më në kufijtë e ndërkombëtarizmave, por kalojnë në grupin e fjalëve të huaja. Megjithatë, kur fjalëve të huaja nuk u gjendet gjegjësjë, ato përdoren të tilla dhe në këtë rast këto fjalë të huaja, jo vetëm që nuk e rëndojnë gjuhën shqipe, po përkundrazi, ato e pasurojnë fjalorin e gjuhës shqipe duke shtuar në repertorin e fjalëve të fjalorit fjalë të reja. Kjo do të thotë me pak fjalë që, huazimet jo gjithmonë janë në dëm të leksikut të gjuhës, por mirë do ishte që të gjitha fjalët e huaja ta kishin gjegjësen e tyre në gjuhën shqipe. Studiuesit vazhdojnë akoma me studimin dhe hartimin e fjalorëve në gjuhë shqipe duke e pasuruar herë pas here leksikun me të gjitha trajtat dhe format e tij.

b. Fjalë me burim të huaj, të cilat me kohë kanë dalë nga përdorimi i gjerë, për shkak se janë zhdukur vetë sendet a nocionet që shprehin ato (xhandar, kumbara, etj.). Ndodh që brenda çerdhes së fjalëve të huazuara, disa fjalë janë zëvendësuar me fjalë shqipe, kurse disa të tjera të së njëjtës çerdhe nuk janë zëvendësuar, p.sh. nacion, nacionalitet dhe internacional janë zëvendësuar me fjalët shqipe komb, kombësi, ndërkombëtar, kurse nationalist, nacionalizëm dhe internacionalizëm, nuk janë zëvendësuar dhe me sa duket nuk kanë për t'u mënjeluar asnjëherë.

c. Fjalë të huaja të panevojshme, të cilat janë zëvendësuar dhe po zëvendësohen ditë-ditë me fjalë shqipe ekzistuese ose të krijuara me brumin e shqipes sipas modeleve të gjuhëve të tjera. Si p.sh., fundjavë në vend të weekend, (Shkurtaj, Gj. 2010 :214-215).

Këto shembuj i gjejmë më së shumti edhe në media, e cila është përfaqësuesja e

parë më kryesore dhe më e ndjekur nga masat. Njerëzit janë të interesuar për çka ndodh në Shqipëri dhe në Botë. Duke qenë të interesuar kaq shumë, dritarja e tyre e vetme për ta arritur këtë qëllim është masmedia. Radioja, televizioni, gazetat revistat, etj. janë mjetet kryesore të komunikimit midis individit dhe mjedisit, botës që e rrethon. Duke qenë mjeti kryesor, masmedia bëhet shembull i ligjërit. Por, nuk është masmedia ajo që komunikon me njerëzit, janë gazetarët ata të cilët luajnë rolin e kanalit në lidhjen mesazh-marrës. Në fakt, a e luajnë mirë këtë rol gazetarët me shkrimet dhe ligjërimet e tyre? Tashmë kjo gjë është bërë e dukshme. Nuk arrij ta kuptoj mirë se përse ekziston prirja e gazetarëve për të përdorur fjalët e huaja kur ekziston fjala shqipe.

Mediat përfaqësojnë një situatë të zhvillimit të Shqipërisë. Në çdo vend të qytetëruar punonjësit e mediave janë përhapës dhe tejçues të gjuhës së shkruar dhe të normës së gjuhës së folur, të shqiptimit e të intonacionit standard. Ritheksoj se gjithmonë i kam vlerësuar lart ndihmesat e gazetarëve dhe folësve më të mirë të radios e të televizionit shqiptar. Ne duam që gazetarët të jenë mbështetës të gjuhës standarde shqipe. *“Nuk mund të kemi një standard të mirë nëse do të kemi gazetarë që nuk e shkruajnë gjuhën shqipe mirë dhe nuk mund të kemi kulturë gjuhe nëse nuk kemi njerëz që flasin bukur në radio dhe televizion. Njerëzit e thjeshtë e marrin gjuhën e gazetave si model të shkruari, gjuhën e radios e të televizionit si model të foluri.”* (Shkurtaç, Gj. Kumtesë, 2009).

Pra, unë mendoj se ka media që nuk bëjnë sa duhet bërë për gjuhën shqipe dhe çdo media është mirë të ketë një korrektor letrar që duhet ta shikojë artikullin e çdo gazetari nga ana drejtshkrimore, pa i ndryshuar përmbajtjen, por duke mos lejuar gabime drejtshkrimore e gramatikore ose fjalë të huaja të panevojshme.

Gjithashtu, edhe përfaqësuesit e shtetit, politikanët duhet të kenë rreth vetes redaktore

ose redaktorë të përgatitur mirë gjuhësisht, të cilët t'u përgatisin sa më mirë fjalimet e tyre në mënyrë që kur të dalin përpara njerëzve të jenë vërtet një shembull i mirë nga ana gjuhësore, një shembull për t'u ndjekur.

3.9 Tregues i fjalëve të huaja që mund të zëvendësohen plotësisht ose pjesërisht.³

Puna për pastrimin e gjuhës sonë të njësuar letrare nga fjalët dhe ndërtimet e huaja të panevojshme, që mbështetet në një traditë të pasur duke nisur që nga Rilindja, ka ardhur duke u forcuar gjithnjë e më tepër pas Çlirimit të vendit. Në shtypin tonë, jo vetëm në organet gjuhësore e periodike, por edhe në shtypin e përditshëm, janë botuar dhe vazhdojnë të botohen artikuj e materiale të ndryshme për këto çështje. Këto kanë qenë dhe janë një ndihmë e madhe për punën me gjuhën. Në fazën e sotme të zhvillimit të gjuhës letrare, kur kjo gjuhë është bërë pronë e masave të gjera punonjëse dhe kur edhe terminologjia teknike e shkencore ka marrë një përdorim mjaft të gjerë, del nevoja që puna për pastrimin e gjuhës letrare kombëtare nga huazimet e panevojshme të marrë një karakter më të organizuar dhe përmasa më të gjera. (Revita “Gjuha jonë”, 1-2, 2000-2002)

Kundër fjalëve të tilla të huaja të panevojshme është drejtuar sot lufta e puna e “Komisionit të përhershëm për pastrimin e pasurimin e gjuhës shqipe”, nën drejtimin e të cilit ka nisur të botohet te “Gjuha jonë” rubrika “Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj”. Këtu përfshihen si fjalë të leksikut të përgjithshëm ashtu edhe fjalë që përdoren si terma në fushat e ndryshme të shkencës, të teknikës, të prodhimit dhe në fusha të tjera të veprimtarisë shoqërore.

³ Shkurta, GJ. “Kultura e gjuhës” SHBLSH, Tiranë 2006 f. 179-210

Nga fjalët e huaja të panevojshme, të cilat tashmë janë zëvendësuar dhe po zëvendësohen me fjalë shqipe mund të përmendim disa prej tyre:

ABONIM,-I, ABONOHET, I ABONUAR, çerdhe fjalësh me burim nga gjuhët neolatine, mund të mënjanohet plotësisht nga fjalët shqipe përkatëse; *pajtim, pajtoj, pajtohem, i pajtuar*; po kështu mund të mënjanohet fjala ABONENT, duke përdorur fjalën *pajtimtar*.

ABSORBOJ, ABSORBOHET, ABSORBIM-I, I ABSORBUAR, fjalë të huazuar nga frëngjishtja, mund të mënjanohen të gjitha duke u zëvendësuar me fjalët shqipe përkatëse: *thith e përthith, përthitje, i përthitur*.

ADAPT, ADAPTOJ, ADAPTOHEM, ADAPTIM-I, I ADAPTUESHËM, çerdhe fjalësh e huazuar nga frëngjishtja, mund të mënjanohen duke përdorur fjalët shqipe përkatëse: *i përshtatshëm, përshtat, përshtatet, përshtatje, i përshtatur*.

AKORDIM-I, AKORDOJ, AKORDOHET, grup fjalësh nga gjuhët neolatine, duke qenë se nuk kanë pasur rrënjosje të thellë mund të zëvendësohet nga fjalët shqipe përkatëse: *dhënie, jap, i jepet*.

AKTIV, AKTIVIST, AKTIVITET, janë fjalë që kanë hyrë nga frëngjishtja dhe mund të zëvendësohen me fjalët shqipe përkatëse: *veprues ose i gjallë, veprimtar, veprimtari*.

ANGAZHIM, ANGAZHOJ, ANGAZHOHEM, I ANGAZHUAR, çerdhe fjalësh të huazuara nga frëngjishtja, mund të mënjanohen duke u zëvendësuar me fjalët shqipe përkatëse: *zotim, zotohem, marr zotim, i dal për zot, përfshij, ngarkoj, etj..*

ASIMILOJ, ASIMILOHET, ASIMILIM, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *përvetoj, përvetohet, përvetim*. Por nuk mund të zëvendësohet kur është fjala për shkrirjen e popujve me njëri-tjetrin, *asimilimin me dhunë, politikë asimiluese*.

ATRIBUT,-I mund të zëvendësohet nga fjala shqipe përkatëse: *cilësi, cilësim, veti, tipar*.

AVANGARDË, mund të zëvendësohet nga fjala shqipe përkatëse: *pararobjë*.

AVANTAZH, mund të zëvendësohet nga fjalët shqipe përkatëse: *epërsi, përparësi*.

AZHURNOJ, AZHURNOHEM, AZHURNIM, I AZHURNUAR, mund të zëvendësohet nga fjalët shqipe përkatëse: *përditësoj, përditësohem, përditësim i përditësuar*.

BALANCË-A, BALANCOJ, BALANCOHET, I BALANCUAR, çerdhe fjalësh e huazuar nga frëngjishtja, mund të zëvendësohet nga fjalët shqipe përkatëse: *është në balancë, barazpeshoj, barazpeshë*.

BARRIERË, zëvendësohet me fjalën shqipe: *pengesë*.

BIOGRAFI,-A, BIOGRAFIK,-E, fjalë që ka përhapje të gjerë në shumë vende të tjera të botës, gati sa të quhet ndërkombëtare. Megjithatë, në shumë raste mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *jetëshkrim, jetëshkrimor,-e*.

BORD,-I, huazimi i kohëve të fundit nga anglishtja; nuk është fjalë ndërkombëtare dhe mund të zëvendësohet me fjalë të barasvlefshme me të, si: *këshill, komision*.

BRUTAL, BRUTALITET, BRUTALISHT, në shumë raste mund të mënjanohen duke përdorur: *i vrazhdë, i ashpër, i egër, brutalitet* mënjanohet me *vrazhdësi, ashpërsi, egërsi*. Po ashtu *brutalisht* jepet plotësisht me ndajfoljen *ashpërsisht*.

CENTRALIZOJ, CENTRALIZIM,-I, I CENTRALIZUAR, fjalë të huazuara nga gjuhët neolatine, pjesërisht edhe të ngulitura, por edhe mund të mënjanohen nga fjalët shqipe përkatëse: *përqendroj, përqendrim, i përqendruar*.

CIVILIZOJ, CIVILIZOHET, CIVILIZIM,-I, mund të jepet në shqipen me fjalët përkatëse: *qytetëroj, qytetërohet, qytetërim*.

DEDIKOJ, DEDIKOHET, DEDIKIM,-I, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *i kushtoj, kushtohet, kushtim*.

DESKRIPTIV,-E, term i huazuar nga gjuhët neolatine, mund të mënjanohet plotësisht nga fjala shqipe: *përshkrues*.

DEZILUZION,-I, DEZILUZIONOJ, DEZILUZIONOHET, I DEZILUZIONUAR, mund të zëvendësohen me fjalët shqipe përkatëse: *zhgënjim, zhgënjëj, zhgënjehem, i zhgënjyer*.

DISPONOJ, mund të mënjanohet plotësisht nga fjala shqipe përkatëse: *kam, zotëroj, kam në zotërim*.

DUBËL, fjalë e huazuar nga frëngjishtja, mund të zëvendësohet shumë mirë nga fjala shqipe përkatëse: *dyfish, i dyfishtë*.

EDITOR,-I, EDITORIALE, mund të zëvendësohet me fjalën *botues*, me kuptimin *artikulli i botuesit, ose kryeartikull*.

EKSPERIENCË, mund të zëvendësohet me fjalën përkatëse: *përvojë*.

EKZEKUTIM,-I, EKZEKUTOJ, EKZEKUTOHET, çerdhe fjalësh e huazuar nga frëngjishtja, mund të mënjanohen duke u zëvendësuar me fjalët shqipe përkatëse: *zbatim, zbatoj, vë në jetë*. Në fushën e muzikës në vend të *ekzekutoj* mund të përdoret folja *luaj*; luan në violinë ose në piano. Po ashtu edhe në sport *ekzekutoj* mund të zëvendësohet me *gjuaj, bëj*.

ELABORIM, ELABOROJ, ELABOROHET, fjalë me burim nga gjuhët neolatine, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *hartim, përpunim, hartoj, përpunoj*.

ELEKTORAT, mund të mos përdoret fare dhe në vend të saj të thuhet, *zgjedhësit*.

EVAKUOJ, EVAKUOHEM, EVAKUIM,-I, mund të zëvendësohen me fjalët shqipe përkatëse: *shpërngul, largoj, shpërngulem, largohem, shpërngulje, largim*.

FENOMEN, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *dukuri*.

FONDAMENT,-I, FONDAMENTAL,-E, mund të zëvendësohen me fjalët shqipe përkatëse: *bazë, themel, themelore*.

FREKUENCË, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *denduri, shpeshtësi*.

FREKUENTIM, FREKUENTOJ, FREKUENTOHEM, FREKUENTUES,-E, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *ndjekje, ndjek, ndiqet, ndjekës*.

FRONTAL, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *ballor*.

GARANTOJ, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *siguroj*.

GLOBAL,-E, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *përgjithshëm,-e, (i,e) tërësor,-e*.

GRATIS, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *pa shpërblim, pa pagesë, falas*.

GREKOFON,-E, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *greqishtfolës,-e*.

GUSTO, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *pëlqim*.

GJENERATË, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *brez, brezni*.

GJENEZË, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *zanafillë, që në fillim*.

GJITON,-I, GJITONE,-JA, GJITONI,-A, fjalë të huazuara nga greqishtja, me shtrirje edhe në gjuhën popullore, mund të zëvendësohen me fjalët shqipe përkatëse: *fqinj, fqinje, fqinjësi, fqinjëri*.

HEZITTOJ, HEZITIM, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *ngurroj, ngurrim*.

HIPOKRIZI, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *dyfytërsi, dyfaqësi*.

HIPOTEZË, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *hamendje*.

HUMAN,-E, HUMANITAR,-E, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *njerëzor, i njerëzishëm.*

IDENTIFIKOJ, IDENTIFIKOHET, IDENTIFIKIM, fjalë me burim nga italishtja, mund të zëvendësohen me fjalët shqipe përkatëse: *njëjtësoj, njëjtësohet, njëjtësim.*

ILARITET, fjalë me prejardhje nga frëngjishtja, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *të qeshura, të qeshura tallëse.*

IMEDIAT,-E, fjalë e huazuar nga gjuhët neolatine, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *i menjëhershëm, i ngutshëm, i pandërmjetëm.*

IMPLIKOJ, IMPLIKOHEM, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *ngatërroj, përziej, kam gisht, kam dorë, ngatërrohem, përziem.*

INKASOJ, INKASIM, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *arkëtoj, arkëtim.*

INTERURBAN,-E, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *ndërqytetës.*

JUSTIFIKOJ, JUSTIFIKOHEM, JUSTIFIKIM,-I, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *përligj, shfajësoj, përligjem, shfajësohem, përligje, shfajësim.*

KAKOFONI,-A, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *keqtingëllim.*

KALKULOJ, KALKULOHET, KALKULIM,-I, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *njehsoj, njehsohet, njehsim.*

KAUZË,-A, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *çështje.*

KOMPLIKOJ, KOMPLIKOHET, KOMPLIKIM, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *ndërlikoj, ngatërroj, koklavit; ndërlikohet, ngatërrohet, koklavitet.*

KONFUZ, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *i pësjtjelluar, i turbullt, i ngatërruar.*

KREDIBILITET,-I, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *besueshmëri.*

LEGJITIM, LEGJITIMITET, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: i ligjshëm, ligjshmëri.

LIKUIDOJ, LIKUIDOHET, LIKUIDIM,-I, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *shlyej, zhduk, asgjesoj; shlyhet, zhduket, asgjesohet; shlyerje, zhdukje, asgjesim.*

MENTALITET,-I, MOMUMENT,-I, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe *përmendore*, edhe fjala *monumental,-e*, mund të zëvendësohet me *madhështor,-e*.

NEGLIZHENCË,-A, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *pakujdesi, lënë pas dore, nuk i kushtoj kujdes.*

NOVACION,-I, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *risi.*

OKUPACION,-I, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *pushtim.*

ORIENTOJ, ORIENTOHEM, ORIENTIM,-I, mund të zëvendësohet me fjalët shqipe përkatëse: *drejtoj, drejtohem, drejtim.*

PATRONAZH, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *kujdestari.*

PERMANENT, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *i përhershëm.*

PRECEDENTË, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *përparësi.*

PRINCIP, PRINCIPALE, PRINCIPALITET,-I, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *parim, parimor, parimorësi ose parimësi.*

RACIONAL, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *i arsyeshëm.*

RECIPROK, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *i ndësjellë, i dyanshëm, i shoqishoq më.*

RIGOROZ, RIGOROZITET,-I, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *i rreptë, rreptësi.*

SATISFAKSION,-I, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *kënaqësi, shpagim.*

SINJIFIKATIV, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *kuptimplotë, domethënës.*

SPORADIK,-E, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *i rrallë, i veçuar.*

SURVEJOJ, SURVEJIM, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *mbikëqyr.*

TRANZITOR,-E, TRANZICION,-i, TRANZITIV,-E, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *kalimtar, periudhë kalimtare.*

TROMAKS, TROMAKSEM, I TROMAKSUR, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe: *tremb, tmerroj, trembem, tmerrohem, trembje, tmerrim.*

UNILATERAL,-E mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *i njëanshëm, e njëanshme.*

URGJENT, URGJENTISHT, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *i ngutshëm, menjëherë, me shumë ngut.*

VIOLENCË,-A, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *dhunë.*

VIGJILENCË,-A, VIGJILENT,-E, VIGJLUES,-E, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *syhaptësi, syçeltësi, syhapët, syçelët, sypafjetur, etj..*

XHENTIL, XHENTILESË, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: *i sjellshëm, i njerëzishëm, mirësjellje.*

KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E STUDIMIT

Ky kapitull prezanton metodologjinë, strategjinë dhe teknikat e ndjekura në këtë studim. Në këtë përshkrim janë përfshirë metodat e studimit dhe instrumentet e përdorura, popullata dhe kampionimi, si dhe procedurat e ndjekura për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave.

4.1 Metodatat e kërkimit

Qasjet metodologjike të ndjekura në kryerjen e këtij studimi janë në funksion të realizimit të qëllimit të punimit, që është hulumtimi i shkallës së ndikimit të komunikimit elektronik mbi përdorimin e shqipes standarde nga nxënësit e shkollës së mesme. Për këtë arsye janë zgjedhur si metoda hulumtimi metodat sasiore të kombinuara me ato cilësore në një numër mënyrash të ndryshme, të cilat kanë si qëllim mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave në varësi të pyetjeve tona të hulumtimit.

Qasja e metodave të përziera për mbledhjen e të dhënave duhet të vijë nga pyetjet hulumtuese dhe të tregojë se atyre mund t'u jepet përgjigje më mirë përmes dy llojeve të të dhënave (Matthews & Ross 2010 :144). Kërkimi sasior ka qenë një ndër format më kryesore të kërkimit deri në vitet 1970, kur filloi të rritet ndikimi i metodologjisë sasiore në kërkimin social (Bryman, A. 2004: 62). Metodatat sasiore janë të lidhura ngushtësisht me anketat dhe pyetësorët dhe prej tyre mblidhen të dhëna që mund të analizohen nga ana statistikore. Kombinimi i metodave sasiore me ato cilësore na ndihmon në dhënien e përgjigjeve sa më të sakta dhe më të qarta të pyetjeve të hulumtimit dhe vërtetësinë e hipotezave, si dhe për të provuar korrelacionin midis variablave.

Por, me qëllim që kërkimi i përzier të rezultojë sa më efektiv, studiuesi duhet të marrë parasysh dhe të shqyrtojë karakteristikat e të dyja qasjeve. Sipas Johnson and

Onwuegbuzie (2004, :18), karakteristikat kryesore të kërkimit sasior tradicional janë përqëndrimi tek deduksioni, konfirmimi, testimi i teorisë / hipotezës, shpjegimi, parashikimi, mbledhja e të dhënave të standardizuara dhe analiza statistikore. Ndërsa karakteristikat kryesore të kërkimit cilësor tradicional janë induksioni, zbulimi, hulumtimi, prodhimi i teorisë / hipotezës, studiuesi si "instrument" parësor i mbledhjes së të dhënave dhe analiza cilësore.

Duke iu referuar studimit tonë, për t'i bërë sa më konkrete këndvështrimet teorike të mësipërme, mund të themi se pyetësorët dhe esetë e përdorura për qëllime studimi na shërbyen për të mbledhur të dhënat e grumbulluara me anë të analizës përmbajtësore. Analiza e përmbajtjes është një teknikë për shqyrtimin e kategorive që përmbajnë të dhënat dhe kondensimin e tyre në një numër më të vogël kategorish, në mënyrë që të kuptohen më lehtë. Pra, ajo është një teknikë për nxjerrjen e përfundimeve përmes identifikimit sistematik dhe objektiv të karakteristikave specifike të mesazheve/teksteve (Holsti 1969 :14), është një analizë sistematike, objektive, sasiore e karakteristikave të mesazheve (Neuendorf 2005 :1). Pjesa e numërimit të fjalëve në analizën e përmbajtjes mund të mendohet si sasiore, por procesi mund të ketë lidhje me shumë më tepër se sa thjesht numërim fjalësh dhe ka shumë studiues që argumentojnë se avantazhi i këtij procesi qëndron në kategorizimin dhe kodimin e të dhënave për analizë.

Weber (1990 :37) i përshkruan kategoritë si “një grup fjalësh me kuptime ose nënkuptime të ngjashme” dhe vëren se ato duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme dhe të lidhen vetëm me një koncept.

Para se të fillonim kërkimet në terren u planifikua procedura e kryerjes së tij dhe më pas u hartuan strategji kërkimi për mbledhjen e të dhënave në terren, duke përcaktuar kështu elementet kryesore të kërkimit siç janë; përcaktimi i vendit dhe kohës së

mbledhjes së të dhënave, përcaktimi i popullatës dhe kampionit, hartimi dhe testimi i pyetësorëve. Studimi u orientua nga hipotezat dhe pyetjet kërkimore. Mbi bazën e pyetjeve kërkimore dhe hipotezave u hartuan instrumentet e matjeve. Këto instrumente u shqyrtuan me ekspertë të fushës së edukimit dhe shkencave gjuhësore, si dhe me ekspertë të statistikave. Për t'i kontrolluar nëse pyetjet ishin të qarta dhe të kuptueshme ato u testuan për të provuar besueshmërinë dhe vlefshmërinë statistikore. Prandaj nëpërmjet këtij testimi u synua dhe shmangia apo minimizimi i paqartësive apo keqinterpretimeve të termave, frazave apo koncepteve të parashtruar në artikujt e anketave .

Një veçori tjetër e metodologjisë së përdorur në studimin tonë është edhe kombinimi i të dhënave parësore me ato dytësore. Të dhënat parësore janë rezultatet e marra nga pyetësorët, skedat dhe esetë që janë zhvilluar në disa shkolla të mesme të qytetit të Tiranës, ndërsa të dhënat dytësore janë rezultat i rishikimit të një literature të gjerë dhe bashkëkohore, si dhe mbështetjes në disa studime të tilla në rajon dhe më gjerë, lidhur me ndikimin e komunikimit elektronik në punët me shkrim të nxënësve dhe formimit të tyre gjuhësor.

4.2 Subjektet e kërkimit

4.2.1 Përzgjedhja e kampionit të shkollave

Ky studim është përqendruar te nxënësit e shkollave të mesme të qytetit të Tiranës, duke përfshirë shkollat e qytetit, por edhe shkollat në periferi të tij. Kjo përzgjedhje u bë për disa arsye.

Së pari për arsyen se Tirana është rrethi që ka numrin më të madh të shkollave në vend, me një popullsi me përbërje heterogjene, ku ndërthuren brenda saj elemente të

dialekteve dhe krahinorizmave me ato të prurjeve të mëdha globaliste. Gjithashtu ka një diversitet të dukshëm, përsa i përket nivelit kulturor dhe gjuhësor të komunikimit të nxënësve.

Së dyti, si banore dhe mësimdhënëse e arsimit të mesëm në këtë qytet jam e përfshirë në problemet e shumta gjuhësore që has gjatë punës sime.

Së treti, në qytetin e Tiranës gjeta një terren më të njohur dhe më të mundshëm për mbledhjen dhe administrimin e të dhënave që më nevojiteshin për këtë studim.

Së katërti, studimi i shtrirë në të gjithë vendin kërkonte burime financiare më të mëdha.

Për qëllime të këtij studimi, nga lista e shkollave të mesme të marrë nga DAR Qytet Tiranë dhe DAR Qark Tiranë, sipas kampionimit me kuotë u përzgjedhën gjashtë shkolla të qytetit të Tiranës, sipas kategorive: shkollë e qendrës - e periferisë, gjimnaz -shkollë profesionale. Kampioni përbëhet nga tri shkolla të qendrës dhe tri të periferisë, përkatësisht katër gjimnaze dhe dy shkolla profesionale. Dhe konkretisht kemi zgjedhur si shkolla të qendrës gjimnazet publike “Andon Zako Çajupi” dhe “Qemal Stafa” dhe si shkollë profesionale, Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë, kurse si shkolla të periferisë u zgjedhën gjimnazet “Isa Boletini “ në Vorë dhe “Feti Vogli” në fshatin Baldushk, Tiranë, dhe si shkollë profesionale u zgjedh Shkolla e Sporteve “Loro Boriçi” në Kamëz.

Këto shkolla u përzgjedhën, pasi siguronin një përfshirje të lartë të disa kategorive të nxënësve në përpjestim të drejtë me popullatën e nxënësve. Dihet se qyteti i Tiranës ka një numër të madh shkollash, por në studimin tonë ne u përqëndruam në ato shkolla, të cilat na jepnin mundësinë më të madhe të marrjes së informacionit të duhur.

Një nga kriteret më të rëndësishme përzgjedhëse për gjimnazet e qendrës së Tiranës ishte numri i lartë i nxënësve, në mënyrë që kampioni të ishte sa më përfaqësues, por edhe fakti që janë ndër shkollat e qytetit të Tiranës që përmbajnë nxënës cilësorë, me një bagazh dhe formim të përgjithshëm intelektual në fusha të ndryshme dhe me mundësi më të shumta të përdorimit të teknologjisë. Por fakti që ato ndodhen në qendër të qytetit nuk do të thotë se në ato shkolla nuk u evidentuan raste të përdorimit jo të drejtë të standardit, sepse prurjet e nxënësve në këto shkolla janë të kategorive të ndryshme, nuk janë vetëm të qendrës së qytetit, por edhe nga rrethinat e saj, të cilët për arsye të ndryshme kanë zgjedhur që të studiojnë në këto shkolla.

Si gjimnaze të periferisë u zgjodhën gjimnazi në fshatin Baldushk, për arsye se kishte nxënës që i përkisnin pothuaj të njëjtës krahinë dhe duke mos u ndikuar shumë nga prurje të ndryshme gjuhësore, në krahasim me atë të qytetit të Vorës ku hasen përdorime të ndryshme gjuhësore sipas perjardhjes së tyre dhe shtresave të ndryshme sociale që ato përfaqësojnë.

Në mënyrë që kampioni ynë të përfshinte kategori të ndryshme në përzgjedhëm edhe dy shkolla profesionale, pasi këto shkolla duke mos pasur si bazë formimin e përgjithshëm i kushtojnë më pak rëndësi aspekteve gjuhësore dhe punëve me shkrim në shkollë. Gjithashtu këto shkolla na siguruan të dhëna mjaft të rëndësishme për sa i përket diversitetit të tyre gjuhësor, pasi nxënësit e këtyre shkollave vijnë nga rrethe të ndryshme të vendit, duke sjellë kështu karakteristika të veçanta të gjuhës që ata përdorin. Veçanërisht në këto shkolla u dallua një ndërthurje e “gjuhës së të rinjve”, zhargoneve që ata përdornin, me gjuhën standarde dhe të asaj që ne e quajtmë një “gjuhë e re”, gjuha e komunikimit elektronik si dhe një moskujdesje ndaj drejtshkrimit të standardit.

4.2.2 Përzgjedhja e kampionit të nxënësve

Kampioni i nxënësve është përzgjedhur nga popullata e nxënësve që ndoqën arsimin e mesëm të lartë në gjashtë shkolla publike të qytetit të Tiranës për vitin shkollor 2013-2014. Arsyeja pse unë zgjedha nxënësit e arsimit të mesëm të lartë ka të bëjë me faktin se ata janë grupmosha më aktive në përdorimin e internetit dhe rrjeteve të ndryshme sociale, janë përdoruesit më të mëdhenj të sms-ve dhe komunikimit elektronik.

Gjithashtu, për shkak të punës sime si mësuese dhe konkretisht në profilin e gjuhësisë unë jam në kontakt të vazhdueshëm me punimet dhe esetë e nxënësve. Shpesh evidendohen thyerje të rregullave dhe shmangie nga norma e standardit të shqipes dhe ky është një problem shqetësues, i cili sa vjen e bëhet më i dukshëm. Ishte kjo një nga arsyet kryesore që më shtyu të ndërmarra një studim të tillë për të nxjerrë në pah disa nga shkaqet kryesore që ndikojnë në respektimin e standardit të shkruarit të gjuhës shqipe nga nxënësit e arsimit të mesëm.


Studimi u realizua në qytetin e Tiranës, pasi popullata e nxënësve të këtij qyteti me karakteristikat që mbart është mjaftueshëm përfaqësuese për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe për të vërtetuar hipotezat. Përcaktimi i targetit të popullatës u realizua në bazë të të dhënave të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale Qytet Tiranë dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale Qark Tiranë.

Sipas këtyre të dhënave, për vitin shkollor 2013-2014, përkatësisht në 23 gjimnaze publike në DAR Qytet, studiojnë 14.495 nxënës, kurse në 19 shkolla në DAR Qark, prej të cilave 5 janë gjimnaze dhe 14 janë shkolla të mesme të bashkuara, studiojnë 4.207 nxënës, pra, gjimnazist në periferi. Shkolla profesionale janë gjithsej 8 shkolla të

profileve dhe profesioneve të ndryshme, në të cilat studiojnë rreth 5.397 nxënës.

Këto të dhëna paraqiten si më poshtë:

Grafiku 1: Numri në total i gjimnazistëve (qytet/periferi/profesionale) për vitin shkollor 2013-2014



4.2 2.1 Përzgjedhja e kampionit të nxënësve për pyetësorët

Për qëllime të këtij studimi u përdorën dy mënyra të përzgjedhjes së kampionit: mënyra probabile e rastësishme dhe mënyra joprobabile e kampionimit, kampionimi me kuotë. Mënyra probabile, e rastësishme u përdor për të përzgjedhur nxënësit që do të anketoheshin. Ndërsa mënyra e kampionimit me kuotë u përdor për të përzgjedhur shkollat, numrin e nxënësve brenda shkollës dhe numrin e nxënësve për esetë.

Një prej qasjeve të kampionimit bazohet në teorinë e propabilitetit ose asaj statistikore, që synon një kampionim sa më përfaqësues të popullatës ose të rasteve potenciale të propabilitetit në bazë të disa kriterëve domethënës. Në studimin tonë kampionimi propabël, i rastësishëm u përdor për të përzgjedhur nxënësit që do të

anketoheshin, pasi kishim si synim që popullata e nxënësve të përfaqësohej sa më mirë dhe të bënim analizën statistikore të të dhënave .

Kampioni i zgjedhur përfundimisht përmban përgjigjet e 900 nxënësve, të cilat janë llogaritur me një koeficient besueshmërie 95% dhe gabim 3.2%. Fillimisht, për qëllime të studimit kanë marrë pjesë mbi 950 nxënës të anketuar, por databaza përfundimtare përmban përgjigjet e vetëm 900 prej tyre, 150 për çdo shkollë, 50 për çdo vit studimi, pasi pjesa tjetër nuk kishte informacionin e nevojshëm për t'u përfshirë në studim.

Gjithashtu për të bërë dallimet ndërmjet klasave dhe shkollave sipas vendndodhjes janë përzgjedhur si grupe në kampionim;

(1) nxënësit ndërmjet klasave, përkatësisht të klasave të X-ta, XI-ta, XII-ta.

(2) nxënësit ndërmjet shkollave, qendër-periferi.

Për të testuar testuar diferencën ndërmjet grupeve (mesataret ndërmjet tyre) është përdorur analiza *ANOVA*, e cila është analiza e variancës dhe përdoret për të treguar nëse ka dallime midis vlerës mesatare të këtyre grupeve në lidhje me vlerësimin e njohjes së shkurtesave standarde të gjuhës shqipe.

Duke patur parasysh faktin se intervali i besimit për kampionin është 95% dhe diferenca e gabimit 3.2 % sipas llogaritjeve na rezulton si më poshtë:

$$SS = z^2 * p * (1-p) / c^2$$

Ku $z = 1.96$ $p = 0.6$ dhe $(1-p) = 1-0.6 = 0.4$ dhe $C = 0.032 = 3.2\%$ marzhi i gabimit dhe sipas llogaritjeve del që *Sample Size* (numrin e kampionit) $n=900$, pothuaj i i njëjtë me përllogaritjet e kampionimit edhe në varësi të numrit të përgjithshëm të nxënësve në 6 shkollat e përzgjedhura të qytetit të Tiranës.

4.2 2.2 Përzgjedhja e kampionit të nxënësve për skedat

Fillimisht është marrë leje nga DAR Qytet Tiranë dhe DAR Qark, Tiranë për aplikimin e skedave të shkurtesave dhe fjalëve të huaja, e më pas të pyetësorëve dhe eseve. Skedat e hartuara u përdorën në mënyrë që të grumbullonim sa më shumë të dhëna për hartimin e pyetësorëve. Është kontaktuar Drejtuesi i shkollës dhe pastaj janë aplikuar instrumentet e cituar më lart. Studimi i tyre është realizuar në janar 2014 dhe më pas pyetësorët dhe esetë u realizuan në periudhën prill-maj 2014.

Kampioni i nxënësve për skedat u përzgjedh në mënyrë të rastësishme në shkollat e përmendura më lart, ku morën pjesë 90 nxënës në raport prej 1 me 10 me kampionin e nxënësve të përzgjedhur për pyetësorin.

4.2.2.3 Përzgjedhja e kampionit të nxënësve për esetë

Për qëllime të këtij studimi u parashikua mbledhja dhe analizimi i të dhënave nga esetë. Përzgjedhja e nxënësve për realizimin e eseve u bë me kuotë. Nga 900 nxënësit e përzgjedhur për kampionin e pyetësorëve, u përzgjedhën 180 nxënës për kampionin e eseve, 30 nxënës për secilën shkollë, 10 nxënës për secilin vit studimi.

4.3 Instrumentet e kërkimit

Instrumentet e matjeve u përcaktuan nga nevoja për të siguruar të dhëna në këndvështrime të ndryshme, për ta bërë më kuptimplotë krahasimin midis rezultateve të tyre. Në këtë paketë përfshihen pyetësi për nxënësit, skedat për shkurtesat dhe fjalët të huaja, si dhe esetë. Sipas Khandella (1976) nuk ka një metodë kërkimi që mund të konsiderohet si më e mira. Secila nga metodat e përdorura shoqërohet me avantazhe dhe disavantazhe. Zgjedhja e metodës mund të bëhet duke u mbështetur në disa kriteret. Mundësia për të përgjithësuar të dhënat duke përdorur metodën e kërkimit me pyetësorë

vlerësohet e lartë në rastin e pyetësorëve.

Si rezultat, përdorimi i pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave në këtë punim mundëson (1) hetimin e lidhjeve të mundshme ndërmjet variablave të marrë në studim, dhe (2) tenton për të “plotësuar” studimet e mëparshme që kanë përdorur kryesisht metoda cilësore, si psh. analiza situatash. Sipas Field (2005) ekzistojnë shumë rregulla përsa i përket vëllimit të zgjedhjes, por si rregull i përgjithshëm duhen 10-15 përgjigje për variabël (ky rregull vlen si për regresionin ashtu edhe për analizën faktoriale).

Përdorimi i pyetësorit për mbledhjen e të dhënave ka avantazhet dhe disavantazhet e veta. Shqetësimet kryesore në përdorimin e pyetësorëve kanë të bëjnë me vlerësimin e vlefshmërisë dhe besueshmërisë së tyre (Saunders et al. 2009). Sipas Shoqatës Amerikane të Psikologjisë 1985 (cituar tek Hinkin 1995), njësitë matëse të pyetësorit duhet të tregojnë vlefshmëri të përmbajtjes, vlefshmëri të lidhur me kriteret, vlefshmëri të konstruktit dhe qëndrueshmëri të brendshme. Tre kriteret e para lidhen me vlerësimin e vlefshmërisë së brendshme të pyetësorit, e cila tregon aftësinë e pyetësorit për të matur atë që kërkuesi synon të masë (Saunders et al. 2009).

Vlefshmëria e përmbajtjes i referohet shtrirjes në të cilën pyetësori ofron mbulimin e duhur të pyetjeve hetuese. Një mënyrë për ta realizuar këtë është përdorimi i një paneli individësh për vlerësimin e pyetësorit. Vlefshmëria e lidhur me kriteret ka të bëjë me aftësinë e pyetjeve për të bërë parashikimet e duhura. Për këtë mund të përdoret analiza statistikore e korrelacionit. Besueshmëria (testimi i besueshmërisë) ka të bëjë me faktin nëse pyetësori do prodhojë ose jo rezultate të qëndrueshme në kohë të ndryshme dhe në zgjedhje të ndryshme. Një mënyrë për ta vlerësuar atë është matja e qëndrueshmërisë së brendshme p.sh. nëpërmjet llogaritjes së Cronbach alfa.

4.3.1 Hartimi i pyetësorit

Pyetësori për “*Ndikimin e komunikimit elektronik në respektimin e standardit të të shkruarit të gjuhës shqipe nga nxënësit e arsimit të mesëm të lartë*” u hartua duke u bazuar në sondazhe dhe anketa të zhvilluara nga disa autorë të huaj, dhe veçanërisht tek studimet e kryera nga gjuhëtari i mirënjohur anglez David Crystal, (Crystal 2004, 2008), i cili në studimet e tij është marrë kryesisht me komunikimin elektronik dhe gjuhën e teksteve të mesazheve. Në librin “*Txtng: the Gr8 Db8*” (Texting: The great debate) Oxford University Press 2008, ai shqyrton përdorimin e teksteve të mesazheve dhe efektin e tyre në gjuhën e shkruar dhe të folur. Për këtë unë i jam referuar modelit të disa prej shkurtesa të përdorura prej tij (Crystal 2008 :189), por duke i përshtatur ato me kushtet e vendit si dhe me qëllimin kryesor të studimit.

Pyetjet janë formuluar në mënyrë të tillë që të jenë sa më të kuptueshme nga nxënësit duke zgjedhur përgjigjen nëpërmjet alternativave të parashikuara në pyetësor. Alternativat ndjekin shkallën dikotomike, si pyetje pohuese dhe mohuese. Gjatë hartimit të pyetësorit një rëndësi të veçantë iu kushtua jo vetëm strukturimit të pyetjeve, por edhe formulimit të tyre në formën e duhur, në mënyrë që edhe përgjigjet të ishin të vlefshme dhe në dobi të synimit kryesor.

Pyetësori për nxënësin përbëhet nga tre seksione: *Të dhëna të përgjithshme, Shkurtesat në gjuhën shqipe, Shkurtesat e fjalëve të huaja.*

Seksioni A - *Të dhëna të përgjithshme*, siguron informacion të përgjithshëm lidhur me qytetin ku është kryer anketimi, moshën e nxënësve, gjininë e tyre si dhe klasën në të cilën ata studiojnë.

Seksioni B - *Shkurtesat në gjuhën shqipe* përbëhet nga dy pjesë:

Pjesa I – Përdorimi dhe kuptimi i shkurtesave jostandarde – e cila jep një panoramë të përgjithshme për sa i takon disa prej shkurtesave jostandarde, të cilat përdoren shpesh në komunikimin e përditshëm elektronik dhe jo vetëm, si psh: *Sps, Klm, Flm, Tkxh* etj. Në këtë pjesë ne kemi menduar të zgjedhim 20 prej shkurtesave më të rëndësishme dhe më të përdorshme nga nxënësit. Por, fillimisht duhet të theksojmë se është kryer një studim paraprak për të grumbulluar shkurtesat standarde dhe jostandarde të gjuhës shqipe dhe ato në gjuhën e huaj. Fondi i këtyre fjalëve dhe shkurtesave u krye nëpërmjet skedave të përmendura më lart, prej të cilave u përzgjedhën fjalët dhe shkurtesat më të përdorura nga nxënësit. Vlerësimet për këto shkurtime janë bërë nëpërmjet alternativave të përgjigjeve (1. E di kuptimin, 2.Nuk e di kuptimin, 3.E marr me mend kuptimin, 4.E përdor, 5.Nuk e përdor, 6.Pa përgjigje).

Gjithashtu në këtë seksion janë përfshirë edhe disa pyetje lidhur me përdorimin e këtyre shkurtesave standarde dhe jostandarde të gjuhës shqipe si:

A i respektoni rregullat standarde të shqipes së shkruar në detyrat tuaja me shkrim?

A janë të pranishme *fjalët e huaja* gjatë punës suaj në shkollë?

A i zëvendësoni ato me fjalë të standardit të shqipes gjatë përdorimit në shkrimet standarde? etj.

Vlerësimi i tyre është bërë sipas alternativave të përgjigjeve (1.Po, 2.Jo, 3.Ndonjëherë, 4.Asnjë përgjigje).

Pjesa II – Përdorimi dhe kuptimi i shkurtesave standarde - përmban pyetje të cilat lidhen pikërisht me njohjen dhe përdorimin e shkurtesave standarde të gjuhës shqipe të cilat janë përgjendhur nga literatura përkatëse e gjuhës shqipe dhe që janë të lejuara në përdorimin e tyre. Si të tilla mund të përmendim: *P.sh, Mjek., Treg, Zoo.,Fig.* etj. Janë përgjendhur pikërisht këto shkurtesa standarde që nuk përdoren shumë në komunikimin

elektronik dhe nuk janë pjesë e fjalorit të shumicës së nxënësve gjithashtu. Edhe në këtë pjesë përgjigja e tyre merret nëpërmjet alternativave përkatëse (1. E di kuptimin, 2. Nuk e di kuptimin, 3. E marr me mend kuptimin, 4. E përdor, 5. Nuk e përdor, 6. Pa përgjigje).

SEKSIONI C – *Shkurtesat e fjalëve të huaja*, edhe ky seksion ka dy pjesë në përbërje të tij.

Pjesa I – Duke qenë se fjalët e huaja që përdoren në gjuhën shqipe, sa vijnë e bëhen më të pranishme ne kemi menduar të analizojmë disa prej këtyre fjalëve, pasi ashtu siç dihet, globalizimi si në shumë fusha të jetës edhe në atë të komunikimit ka sjellë pasojat e veta në përdorimin e shumë fjalëve të huaja në vend të sinonimeve të tyre në shqip. Edhe në këtë pjesë kemi përgjedhur 20 fjalë si më të përdorshmet nga nxënësit gjatë komunikimit si p.sh: selektoj, suportoj, vakant, net, show etj, ku secili prej tyre ka bërë vlerësimin sipas opinionit të tij, nëse e di kuptimin e tyre dhe nëse i përdor ato.

Pjesa II - Shkurtesat jostandarde në gjuhë të huaj janë shkurtesa të cilat përdoren më së shumti gjatë komunikimit elektronik, pothuaj në të gjitha rrjetet sociale dhe kuptohen nga të gjithë. Pra, në njëfarë mënyre komunikimi midis këtyre shkurtesave në gjuhë të huaj është ndërkombëtar dhe tregon reagimin e secilit në komunikim me shprehje minimaliste. Edhe në këtë pjesë përgjigja e tyre merret nëpërmjet alternativave përkatëse (1. E di kuptimin, 2. Nuk e di kuptimin, 3. E marr me mend kuptimin, 4. E përdor, 5. Nuk e përdor, 6. Pa përgjigje).

Në fund të këtij seksioni ashtu sikurse edhe në seksionin për shkurtesat në gjuhën shqipe janë vendosur disa pyetje lidhur me përdorimin e këtyre shkurtesave në gjuhë të huaj. Kështu nxënësit janë pyetur në veçanti:

Zakonisht a dërgoni shumë mesazhe gjatë ditës?

A përdorni zhargone kur dërgoni mesazhe, apo kur komunikoni elektronikisht?

A ndikoheni nga komunikimi elektronik në punët tuaja me shkrim ose detyrat e shtëpisë?

4.3.2 Testimi i pyetësorit

Parapakisht u krye testi pilot për pyetësorin e përgatitur. Pyetësi u testua parapakisht me 50 nxënës të zgjedhur nga dy shkolla, një e qendrës dhe tjetra e perferisë, për të parë nëse kishte probleme apo paqartësi në plotësimin e tij si dhe për të testuar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tij. Rezultati i testit pilot tregoi se pyetjet e pyetësorit ishin të formuluar saktë dhe të qarta për t'u kuptuar. Pyetjet që nuk ishin të qarta, nga të cilat nuk mund të merrej informacioni i duhur u konsultuan me ekspertët e fushës dhe specialistin e statistikës për t'i sjellë ato të formuluar ashtu siç duhej. Pas këtij procesi pyetësorët u hodhën në terren. Puna në terren u krye në bashkëpunim me stafin drejtues të shkollave ku u krye anketimi dhe me një kalendar të përcaktuar më parë në mënyrë që të arrihej koha e përcaktuar për realizimin e tyre me sukses.

4.3.3 Besueshmëria e pyetësorit

Gjatë hartimit të tij u bë kujdes që të mbaheshin parasysht dy elementë kryesore si: *besueshmëria* e cila ka të bëjë me faktin nëse pyetësi do të prodhojë ose jo rezultate të qëndrueshme në kohë të ndryshme dhe për zgjedhje të ndryshme, si dhe *vlefshmëria* e

pyetjeve. Për të vlerësuar vlefshmërinë e përmbajtjes u përdor metoda e “panelit të ekspertëve”, të cilët morën pjesë në hartimin e pyetësorit.

Lidhur me testin e besueshmërisë, një mënyrë për ta vlerësuar atë është matja e qëndrueshmërisë së brendshme psh. nëpërmjet llogaritjes së Koeficientit Crombach Alfa. Bazuar në llogaritjet për koeficientët Cronbach Alfa për matjen e qëndrueshmërisë së brendshme të pyetësorit u arrit në konkluzionin se vlera e tyre ishte më e lartë se 0.7, (norma e lejuar) duke treguar qëndrueshmëri të pyetësorit. Duke ditur se secila nga pyetjet paraqet një variabël, e cili mund të marrë më shumë se një përgjigje, është menduar që në pyetjet e mbyllura alternativat e përgjigjeve të jenë sa më reale në mënyrë që të merret informacioni i nevojshëm.

4.3.4 Esetë

Instrumenti i dytë i përdorur në këtë studim ishin esetë, të cilat nxënësit i përdorin në shkollë gjatë procesit të tyre mësimor. Nxënësit e përfshirë në studim u informuan dhe u sqaruan mbi kriteret e vlerësimit dhe kërkesat për esetë.

Për secilën shkollë të përcaktuar në studim u analizuan nga 30 ese, përkatësisht nga 10 ese për çdo vit studimi. Pra, u studiuan gjithsej 180 ese. Temat e eseve të zhvilluara nga nxënësit, u vendosën në bashkëpunim me mësuesit e shkollave përkatëse si dhe në përshtatje me moshën dhe formimin e tyre. U caktuan nga dy tema për secilin vit studimi, në mënyrë që nxënësit të kishin mundësi zgjedhjeje për të shprehur mendimet dhe idetë e tyre. Konkretisht temat e përcaktuara të eseve ishin:

Klasa X: 1. Cilin tip libri preferoni të lexoni dhe pse?

2. Komuniteti im ideal

Klasa XI 1. A ka atdhetarizëm të deklaruar mes shqiptarëve?

2. Gjuha dhe interneti

Klasa XII 1. Komunikimi virtual është i rëndësishëm për lehtësimin e rrugëve komunikuese.

2. Dhuna në familje

Dua të theksoj se esetë e mbledhura nga nxënësit janë zhvilluar brenda orës së mësimin dhe për pasojë janë realizuar me shkrim dore, pasi në shkollat tona nxënësit nuk kanë mundësi që të përdorin kompjuterin, përjashtuar orë dhe lëndë të veçanta. Gjatë këtij procesi pune u analizuan esetë e shkruara me shkrim dore në tërësinë e tyre, duke u ndalur veçanërisht në strukturën e tyre gramatikore dhe sintaksore. Të dhënat dhe gjetjet e tyre janë analizuar në kapitujt në vazhdim. Këto të dhëna shërbejnë për të vërtetuar dhe testuar hipotezat e ngritura në këtë punim, nëse nxënësit ndikohen apo jo në punët e tyre me shkrim në shkollë nga interneti dhe komunikimi elektronik.

4.3.5 Skedat

Gjithashtu, për qëllime të këtij studimi u përdorën edhe skedat e shkurtesave, që u përgatitën sipas modelit të Crystal 2008 :189, dhe më pas u shpërndanë tek nxënësit për të mbledhur sa më shumë shkurtime fjalësh dhe fjalë e shprehje të huaja nga fondi i fjalëve dhe shprehjeve që ata përdorin në komunikimin e përditshëm të tyre. Në këtë aspekt ne nuk i kushtëzuam ato me faktin që të shkruajnë vetëm në shqipen standarde, pasi kjo e dhënë na siguroi dhe na njohu me fondin e tyre të fjalëve nga bota e internetit për të bërë më pas diferencën mes atyre fjalëve që dinë në përgjithësi dhe atyre që janë ngulitur në fjalorin e tyre të shkruar duke i reflektuar në punët e tyre me shkrim.

Konkretisht skedat e fjalëve të huaja dhe shkurtesave u ndërtuan në këtë formë: nxënësit përbri fjalës së huaj ose shkurtesës së përdorur do të jepnin dhe shpjegonin

edhe kuptimin e saj. Më poshtë po paraqesim disa shkurtesa standarde dhe jostandarde, në shqip dhe në gjuhë të huaj, të cilat u dalluan si më të përdorshme nga nxënësit në komunikimin elektronik në skedat e plotësuara prej tyre gjatë studimit tonë dhe më pas u zgjodhën si material për ndërtimin e pyetësorit, duke u kërkuar nxënësve që të shpjegojnë kuptimin e tyre. Për ta bërë më të lehtë kuptimin e tyre nga ana e lexuesit, përbri tyre po sqaroj edhe kuptimin përkatës, disa prej të cilave kanë më shumë se sa një kuptim.

A) Shkurtesa të gjuhës shqipe

| Shkurtesa jostandarde | Kuptimi | Shkurtesa standard | Kuptimi |
|------------------------------|--------------------------------------|---------------------------|-----------------------|
| Sps | S'jam për sonte S'ka përse | p.sh. | Për shembull |
| Klm | Ke luajtur mensch Kalofsh mire | Etj. | E të tjerë |
| Pz | Pa zgjidhje Për zotin | Antrop. | Antropologji |
| Vër8 | Vërtet | Ek. | Ekonomi |
| 3gim | Tregim | Fig. | Kuptim i figurshëm |
| 2shim | Dyshim | Kr. Pop | Krijimtaria popullore |
| Xc | A je për kafe | Mit. | Mitologji |
| Pc | Kompjuter | Mjek. | Term në mjekësi |
| Mmsh | Më mungon | Num. rresht | Numëror rreshtor |

| | | | |
|----------------|--------------|-------------------|---|
| | shumë | | |
| Tung | Tungjatjeta | Prov. | Proverb |
| Prsh | Përshëndetje | Nr. Sh. | Numri shumë |
| Tdsh | Të dua shumë | Shtypshkr. | shtypshkronjë |
| Flm | Faleminderit | Treg. | Term në tregti |
| Paçim | Mirupafshim | Urdh. | Mënyra urdhërore |
| Puç puç | Të puth | Vetv. | Folje e diatezës vetvetore |
| Prnd | Prandaj | Vjet. | Fjalë ose shprehje e vjetruar |
| Tlt | Të lutem | Zoo. | Term i zoologjisë, emërtim për kafshë. |
| Tkxh | Të kam xhan | Zvog. | Me kuptim zvogëlues |
| Zmr | zemër | Zakon. | Zakonisht |
| Naçut | çunat | Zyrt. | Fjalë ose shprehje e punëve zyrtare |

B) Fjalë dhe shkurtesa jostandarde në gjuhë të huaj

| Fjala e huaj | Kuptimi | Shkurtesa | Kuptimi |
|---------------------|----------------|------------------|------------------------------------|
| Selektoj | përzgjedh | lol | -laughing out loud -lot of love |
| Shokues | tronditës | bf | -best friend |

| | | | |
|------------------|----------------|----------------|---|
| | | | -boyfriend |
| Dedikoj | kushtoj | sms | -short mesage service -see me smile |
| Definitiv | përfundimtar | pc | -personal computer -peace -please come |
| Evitoj | mënjanoj | fyi | -for your information |
| Inspirim | frymëzim | emo | -emotional |
| Kreativ | krijues | roflmao | -rolling on -floor laughing -myass off |
| Dominon | mbizotëron | brb | -be right back |
| Fans | adhurues | jam | -just a minute -jump and move |
| Suportoj | duroj/mbështes | pc | -personal -computer |
| Vakant | i lirë | nagi | -Not a good idea -not again -not a good instict |
| Look | pamje | nb | -not been -no body -no bed |

| | | | |
|---------------------|---------------|-------------|------------------|
| Spostoj | zhvendos | ad | additional |
| Indiferent | mospërfillës | kwim | know what i mean |
| Violencë | dhunë | ps | postscriptum |
| Sensibilizoj | ndërgjegjësoj | 2da | today |
| Net | rrjet | b4 | before |
| Starton | fillon | cos | because |
| Show | shfaqje | c | see |
| Barrierë | pengesë | sys | see you soon |

4.4 Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave

Procedura e kërkimit për mbledhjen e të dhënave u realizua për një kohë relativisht të mjaftueshme për një studim të tillë. Ecuria e punimit ka qenë e kënaqshme duke përfshirë edhe të papriturat që na dolën gjatë rrugës. Vrojtimi në terren zgjati rreth tre muaj, ku fillimisht u mblodh informacioni nga skedat që shërbyen si bazë për hartimin e pyetësorit. Më pas u zhvilluan dhe u mblodhën të dhënat nga pyetësorët, të cilat iu nënshtruan më pas procesit të përpunimit.

Pjesë e këtij procesi ishte krijimi i databazës me të dhënat e grumbulluara si dhe përpunimi dhe analiza e tyre. Përpunimi dhe analiza e tyre u realizuan nëpërmjet paketave të programeve kompjuterike SPSS 17.0 dhe Excel.

Analiza SPSS u realizua përmes këtyre hapave:

a) Analizë për çdo pjesë të pyetësorit: U analizua çdo variabël më vete për çdo seksion për të parë shpërndarjen, mesataren, devijimin standard, frekuencat. Qëllimi i kësaj analize ishte prezantimi i një pasqyre të përgjithshme të të dhënave.

b) Analizë për të gjetur lidhjet ndërmjet faktorëve: U analizuan faktorët që ndikojnë në komunikimin elektronik si dhe lidhja midis tyre. Rezultatet janë paraqitur sipas hipotezave dhe pyetjeve kërkimore të ngritura për secilin prej faktorëve të marrë në shqyrtim.

Analiza e të dhënave është kryer nëpërmjet analizës deskriptive, tabelave të kryqëzuara (crosstabulations), Testeve të Pavarësisë, korrelimet midis variablave, ndërtimit dhe shqyrtimit të hipotezave, Analiza e Variancës (ANOVA) etj. Pra, jo vetëm një analizë përshkruese, por edhe një analizë analitike.

U identifikuan fjalët e përdorura gabim ose në kundërshtim me rregullat e drejtshkrimit, fjalët që ishin shkurtuar më së shumti dhe sa herë janë përdorur, fushat gjuhësore në të cilat ka më shumë probleme, për të qartësuar më tej hipotezat e studimit dhe matur ndikimin e komunikimit elektronik në shqipen standarde.

4.5 Etika e kërkimit

Përsa i përket etikës së studimit janë respektuar të gjitha rregullat etike të studimit. Pati një dakordësi ndërmjet dy palëve për bashkëpunim dhe respekt reciprok. Nxënësve iu bënë të qarta të gjitha procedurat e studimit. Duke pasur parasysh që shkollat janë institucione të rëndësishme është marrë leje nga Drejtoria Arsimore dhe nga Drejtoritë përkatëse të shkollave për bashkëpunimin me mësuesit dhe nxënësit e tyre.

Përpara se pjesëmarrësit të plotësonin të dhënat e pyetësorit, qëllimet e studimit u janë bërë të qarta, natyra vullnetare e pjesëmarrjes në studim, si edhe mundësia e tërheqjes nga studimi nëse nuk kishin dëshirë të merrnin pjesë në të. Pjesëmarrësit janë

njohur me faktin se të gjitha këto të dhëna do të përdoren vetëm për qëllime studimore.

Fatmirësisht kemi pasur mirëkuptimin e plotë dhe për këtë dua të falenderoj edhe njëherë të gjithë bashkëpunëtorët.

4.6 Kufizime të kërkimit

Studimi u zhvillua normalisht, duke respektuar çështjet etike si me subjektet dhe me procesin e mbledhjes së të dhënave. Por, si në çdo studim tjetër dhe këtu janë hasur disa probleme që kanë vështirësuar mbledhjen e informacionit dhe të dhënave.

1. Studimi ynë është i kufizuar vetëm tek nxënësit e shkollave të mesme. Nëse studimi do të shtrihej më tej edhe tek studentët dhe përshtypjet e mësuesve dhe pedagogëve do të ishte më përfaqësues.
2. Studimi është kufizuar në qytetin e Tiranës dhe vetëm në gjashtë shkolla.
3. Instrumenti dikotomik i përdorur në hartimin e pyetjeve të pyetësorit duke kërkuar përgjigje të tilla si; e di kuptimin, nuk e di kuptimin apo e përdor, nuk e përdor, na kufizoi besueshmërinë e përgjigjeve të nxënësve.

KAPITULLI V GJETJET E STUDIMIT DHE DISKUTIMI

Ky kapitull prezanton gjetjet për ndikimin e komunikimit elektronik në standardin gjuhësor. Ndikimi reflektohet në përdorimin e shkurtesave standarde e jostandarde, në përdorimin e fjalëve të huaja gjatë të folurit formal e joformal, si dhe në rolin që luajnë ato gjatë punës së tyre në shkollë dhe jashtë saj. Në këtë proces studimor të dhënat u analizuan mbi bazën e analizës statistikore të pyetësorëve dhe më pas vlerësimit të eseve të zhvilluara nga nxënësit gjatë periudhës së studimi.

Qëllimi kryesor ishte që të evidentonim nivelin e përdorimit të gjuhës standarde nga nxënësit e sotëm, duke pasur parasysh faktin se janë shumë të ndikuar nga teknologjia dhe mosvëmendja ndaj gjuhës.

Shkurtesat e përzgjedhura në pyetësor u përzgjedhën nga një anketim i bërë para se të zhvillohej pyetësori. Kjo na dha mundësinë që secila prej shkurtesave të analizuar të dallonte një problematikë të përdorimit ose mospërdorimit të saj. Vlerësimi i eseve nxori në pah anën subjektive të punës së tyre dhe qëllimi kryesor ishte marrja e një informacioni mbi aftësinë e të shkruarit të nxënësve.


5.1 Gjetjet nga pyetësori dhe diskutimi

Siç e theksua edhe më lart, për nevojat e këtij studimi u përdor një pyetësor, i cili kishte si qëllim grumbullimin e informacionit lidhur me çështje të ndikimit të komunikimit elektronik në përdorimin e shqipes standarde tek nxënësit e shkollave të mesme.

Kampioni ynë përmban informacionin e 900 nxënësve të shkollave të mesme të përgjithshme dhe profesionale në rrethin e Tiranës, ku 60% e tyre janë femra, kjo edhe për faktin se pjesa më e madhe e popullisë në vend janë femra, ndërsa pjesa tjetër me

40% janë meshkuj. (Grafiku 2).

Grafiku 2 Gjinia e nxënësve




Sa i takon moshës së këtyre nxënësve tabela më poshtë tregon se moshja minimale e tyre është 15 vjeç dhe ajo maksimale 19 vjeç me një moshë mesatare prej 16.6 vjeç dhe devijim standard 1.004.

Tabela 1. Statistika përshkruese të moshës së nxënësve

| | Numri | Minimumi | Maksimumi | Mosha mesatare | Devijimi standard | Varianca |
|-------|-------|----------|-----------|----------------|-------------------|----------|
| Mosha | 900 | 15 | 19 | 16.6 | 1.004 | 1.008 |


Grafiku 3 tregon pikërisht shpërndarjen e nxënësve sipas vendndodhjes së shkollave si dhe ndarjen në shkollat profesionale dhe joprofesionale, ku secila prej tyre ka 1/3 ose 33.3% të numrit total të nxënësve.

Grafiku 3 Shpërndarja e nxënësve sipas vendndodhjes, qytet, periferi dhe shkollave profesionale.



Kurse grafiku 4 tregon shpërndarjen e nxënësve sipas profileve të shkollave gjimnaz dhe profesionale, ku 2/3 ose 66.6% e zënë nxënësit e gjimnazeve dhe 1/3 ose 33.3% të numrit total të nxënësve janë të shkollave profesionale.

Grafiku 4. Shpërndarja e nxënësve sipas profileve, gjimnaz, profesionale.



5.1.1 Shkurtesat jostandarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

Ashtu siç u theksua edhe më sipër, nxënësit janë pyetur për shkurtesat në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, si dhe për shkurtesat standarde edhe jostandarde. Kështu, lidhur me shkurtesat jostandarde të gjuhës shqipe, tabela më poshtë tregon faktin se sa nxënësit e anketuar i njohin kuptimet e tyre dhe si është marrëdhënia lidhur me përdorimin apo jo në komunikimin e përgjithshëm dhe atë elektronik në veçanti.

Tabela më poshtë tregon se për shkurtesën e *fjalës ska përse* (sps) 94.7% e nxënësve të anketuar janë shprehur se e dinë kuptimin e saj dhe 3.8% nuk e dinë kuptim, ndërsa një pjesë shumë e vogël prej tyre, 14 nxënës, ose 1.6% e totalit, deklarojnë se e marrin me mend kuptimin. Ndër ata nxënës që dinë kuptimin ose e marrin me mend atë, 77.3% e tyre e përdorin këtë shkurtesë dhe pjesa tjetër prej 22.7% nuk e përdorin atë gjatë komunikimit të përditshëm dhe jo vetëm. Për shkurtesën *kalofsh mirë* (klm), numri i nxënësve që e përdorin atë është 97.7%, 0.7% e tyre e marrin me mend dhe pjesa tjetër vetëm 1.7% nuk e dinë kuptimin. Të pyetur për përdorimin e kësaj shkurtese 89% e përdorin dhe 11%, edhe pse e dinë kuptimin e saj, nuk e përdorin. Shkurtesat *për zotin* (pz), *vërtet* (vër8) dhe *tregim* (3gim) njihen respektivisht nga 94.3%, 94.9% dhe 90.6% e këtyre nxënësve, ndërsa përdorimi i tyre në komunikimin elektronik ka vlerat e 88.3%, 68% dhe 38.4%. Pjesa tjetër e tyre shprehen se nuk i përdorin këto shkurtesa.

Pra, përdorimi dhe njohja masivisht e këtyre shkurtesave tregon se ato janë bërë shumë popullore, gati-gati nuk dallohen nga ato shkurtesa që janë në normën e shqipes standarde.

Kjo gjë reflektohet edhe në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2/1 Shkurtesat jostandarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|-------------|------------------|----------------------|-------------------------------|-------------|-----------------|-----------------|-------|
| Sps | 94.7 | 3.8 | 1.6 | | | | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 77.3 | 22.7 | | 100.0 |
| Klm | 97.7 | 1.7 | .7 | | | | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 89.0 | 11.0 | | 100.0 |
| Pz | 94.3 | 3.9 | 1.7 | | | .1 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 88.3 | 11.7 | | 100.0 |
| Vër8 | 94.9 | 3.7 | 1.4 | | | | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 68.0 | 32.0 | | 100.0 |
| 3gim | 90.6 | 6.3 | 3.0 | | | .1 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 38.4 | 61.6 | | 100.0 |

Duke vazhduar me shkurtesa e fjalëve të tjera si *dyshim* (2shim) shohim se 87.3% e dinë kuptimin e saj dhe 2.9% e marrin me mend, por vetëm 37% e përdorin atë dhe pjesa tjetër, pra 9.7% që nuk e dinë kuptimin ose edhe nga ata që dinë kuptimin e kësaj fjale të shkurtuar, nuk e përdorin atë. Shkurtesa tjetër, *A je për kafe* (Xc) nuk njihet nga 76.6% e nxënësve dhe nuk përdoret nga 83.5%, pavarësisht se disa prej tyre edhe mund ta dinë kuptimin e saj, por nuk e përdorin atë. Madje 37.8% e atyre nxënësve që nuk e përdorin këtë shkurtesë janë nxënës të shkollave të mesme në qytet, 32.9% të shkollave profesionale dhe pjesa tjetër 29.2% i takojnë nxënësve që studiojnë në shkollat e periferisë (Tabela 1 në ANEKS).

Shkurtesat e tjera të këtij grupi janë *personal kompjuter (Pc)*, *Më mungon shumë* (Mmsh) dhe *Tungjatjeta* (Tung), të cilat njihen respektivisht nga 65.4%, 40.6% dhe 83.3% e nxënësve, ndërsa përdorimin më të madh e ka shkurtesa *Pc* me 96.7% të përgjigjeve. Duke ditur se shkurtesa *Tung* është bërë më e përdorshme vitet e fundit edhe për faktin që vetë fjala *Tungjatjeta* është në dialektin geg,

Tabela 2 në ANEKS tregon se 41.5% e nxënësve që e përdorin atë i takojnë periferisë, kjo edhe për arsyen se një pjesë e konsiderushme e këtyre zonave banohet kryesisht nga familje që kanë ardhur nga veriu i Shqipërisë, ku më së shumti përdoret gegërishtja në komunikim. Më pas, me 31.9% renditen përdoruesit e shkollave të qytetit dhe në fund ata të shkollave profesionale me 26.6%. Pra, ajo që vihet re është se, edhe pse nxënësit e dinë kuptimin e disa shkurtesave më të përdorshme jostandarde të gjuhës shqipe, një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk i përdorin ato. Arsyet mund të jenë nga më të ndryshmet, ose këto fjalë nuk i përkasin fjalorit të tyre gjatë përdorimit të komunikimit elektronik, ose komunikimi që ata kanë në përgjithësi nuk përshatet me këto fjalë apo shkurtesa (Tabela 2/2).

Tabela 2/2 Shkurtesat jostandarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|--------------|---------------|-------------------|-------------------------|----------|--------------|--------------|-------|
| 2shim | 87.3 | 9.7 | 2.9 | | | .1 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 37.0 | 63.0 | | 100.0 |
| Xc | 19.3 | 76.6 | 2.4 | | | 1.7 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 16.5 | 83.5 | | 100.0 |

| | | | | | | | |
|-------------|------|------|-----|------|------|-----|-------|
| Pc | 65.4 | 31.2 | 2.3 | | | 1.0 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 69.7 | 30.3 | | 100.0 |
| Mmsh | 40.6 | 54.0 | 3.9 | | | 1.6 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 29.1 | 70.9 | | 100.0 |
| Tung | 83.3 | 12.8 | 3.7 | | | .2 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 52.0 | 48.0 | | 100.0 |

Duke iu referuar Tabelës 2/3 për grupin e tretë të shkurtesave jostandarde në gjuhën shqipe, për të gjitha shkurtesat e këtyre fjalëve njohja e tyre ka vlera të larta. Kështu fjala *Faleminderit* (Flm) njihet nga 96.8% dhe 0.7% e tyre e marrin me mend kuptimin e kësaj shkurtese. E ndjekur nga shkurtesa (Tdsh) *të dua shumë* me 94.% dhe duke vazhduar me shkurtesat (paçim) e fjalës *Mirupafshim* dhe *Përrshëndetje* (prsh), të cilat njihen respektivisht nga 93.1% dhe 92% e nxënësve të anketuar. Në fund të këtij grupi shkurtesash vjen shkurtesa e fjalës, *të puth* (Puç puç), e cila njihet nga 89.6% dhe përdoret vetëm nga 75.5% e tyre. Shkurtesa (Flm) përdoret më së shumti nga 93.2% dhe nuk përdoret nga 6.8% edhe pse një pjesë e mirë e tyre sigurisht që e dinë kuptimin e saj. Ndërsa shkurtesa (paçim) gjen përdorim tek 88.5% e ndjekur nga 76.1% e përdoruesve të shkurtesës (Tdsh). Në fund, sa i takon përdorimit të këtij grupi shkurtesash vjen shkurtesa (Prsh) me 73.8% përdorues ndër ata nxënës që e dinë kuptimin ose e marrin me mend atë.

Siç u theksua edhe më sipër, vlerat e larta të njohjes së këtyre fjalëve, tregojnë popullaritetin në gjuhën e folur të përditshme dhe përdorimin nga një pjesë e mirë e të rinjve. Ky fakt shpjegon tendencën në rritje të shkurtimit të fjalëve të gjuhës shqipe, edhe pse ato nuk janë pjesë e standardit.

Tabela 2/3 Shkurtesat jostandarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|----------------|------------------|----------------------|-------------------------------|-------------|-----------------|-----------------|-------|
| Prsh | 92.0 | 5.9 | 2.0 | | | .1 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 73.8 | 26.2 | | 100.0 |
| Tdsh | 94.0 | 4.6 | 1.4 | | | | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 76.1 | 23.9 | | 100.0 |
| Flm | 96.8 | 2.3 | .7 | | | .2 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 93.2 | 6.8 | | 100.0 |
| Paçim | 93.1 | 5.1 | 1.4 | | | .3 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 88.5 | 11.5 | | 100.0 |
| Puç puç | 89.6 | 7.8 | 2.3 | | | .3 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 75.5 | 24.5 | | 100.0 |

Tabela 2/4 tregon rezultatet e njohjes dhe përdorimit të grupit të fundit të shkurtesave jostandarde të shqipes, nga ku vihet re se njohjet për secilën prej shkurtesave të propozuara janë të larta. Kështu shkurtesa e fjalës *Çfarë po bën* (Çpb) njihet nga 96.3% e tyre, dhe përdoret vetëm nga 88.3%, pjesa tjetër, me 2.6% deklarojnë se nuk e dinë kuptimin e saj dhe sigurisht nuk e përdorin, ndërsa vetë 1% e tyre e marrin me mend kuptimin e saj. Fjala zemër (Zmr), që tashmë ka gjetur përdorim jo vetëm në komunikimin e shkurtuar elektronik, por edhe në atë të folur, njihet nga 95.2% dhe vetëm 3.6% shprehen se nuk e dinë kuptimin e kësaj shkurtese. Shkurtesat (Tkxh) – *të kam xhan*, (Prnd) - *prandaj* dhe (Tlt) – *të lutem*, u njihet kuptimi respektivisht nga

94.6%, 86.7% dhe 93.9%, ndërsa përdorimi i tyre shkon respektivisht i vlerësuar me 77.2%, 71.6% dhe 69.2%. Pjesa tjetër ose nuk e njohim si shkurtesë dhe si rrjedhim nuk e përdorin atë, ose e njohin por nuk e përdorin gjerësisht gjatë komunikimit elektronik.

Tabela 2/4 Shkurtesat jostandarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimi n | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|-------------|----------------------|----------------------|-------------------------------|-------------|-----------------|-----------------|-------|
| Prnd | 86.7 | 10.9 | 2.0 | | | .4 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 71.6 | 28.2 | 0.2 | 100.0 |
| Tlt | 83.9 | 13.1 | 2.6 | | | .4 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 69.2 | 30.8 | | 100.0 |
| Tkxh | 94.6 | 4.1 | 1.2 | | | .1 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 77.2 | 22.6 | 0.2 | 100.0 |
| Zmr | 95.2 | 3.6 | 1.1 | | | .1 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 79.8 | 20.2 | | 100.0 |
| Çpb | 96.3 | 2.6 | 1.0 | | | .1 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 88.3 | 11.7 | | 100.0 |

Pra, arrijmë në përfundimin se një pjesë e mirë e këtyre fjalëve njihen nga nxënësit dhe përdoren gjatë komunikimit elektronik, por ata theksojnë se ato arrijnë t'i shmangin në të shkruarit në shkollë ose në punët e tyre me shkrim.

5.1.2 Shkurtesat standarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

Përveç shkurtesave jostandarde të gjuhës shqipe, të cilat kanë ardhur si pasojë e komunikimit të shpejtë elektronik gjuha shqipe në rregullat e saj ka parashikuar gjithashtu edhe një sërë shkurtesash, të cilat janë standarde dhe që kanë gjetur përdorim të gjerë, jo vetëm në komunikimin e shkruar zyrtar apo jozyrtar, por edhe në atë elektronik gjithashtu. Kështu, në këtë pyetësor janë përzgjedhur sërish 20 shkurtesa standarde, të cilat rezultuan si më të njohurat pas testimit paraprak të tyre nga nxënësit. Sipas të dhënave të tabelës 3/1 shkurtesa (P.sh) - *për shembull* njihet nga 96.6% e tyre dhe përdoret gjithashtu nga 92.1%. Vetëm 2.8% e tyre janë shprehur se nuk e dinë kuptimin e kësaj shkurtese. Shkurtesa (Etj.) – *E të tjera* njihet nga 94% e nxënësve dhe 1.1% e tyre shprehen se e marrin me mend kuptimin e saj, pjesa tjetër me 4.9% kanë deklaruar se nuk e dinë kuptimin dhe si rrjedhim përdorimi apo mospërdorimi i saj në komunikimin elektronik në veçanti, ka vlerat 92.4% dhe 7.6%.

Edhe shkurtesa (Fig.) – *Figurë* me sa duket ka marrë vlerësim të mirë të njohjes së kuptimit të saj me 86.6%, ndërsa dy shkurtesat e tjera (Antrop.) - *antropologji* dhe (Ek) – *ekonomi*, kanë njohje në një nivel më të ulët duke u vlerësuar kështu respektivisht vetëm nga 23% dhe 42.1% e tyre. 71% e nxënësve të anketuar nuk e dinë kuptimin e shkurtesës (Antrop) dhe 52% nuk njohin kuptimin e shkurtesës (Ek.), dhe si rezultat, një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk i përdorin ato dhe respektivisht 85.3% dhe 62.9%. Njohja e ulët e këtyre dy shkurtesave të fundit ndoshta vjen edhe prej faktit se këto janë shkurtesa përgjithësisht të fushave të cilat janë specifike, ku njohja dhe përdorimi i tyre nga nxënësit në përgjithësi është pak më i kufizuar.

Tabela 3/1 Shkurtesat standarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|----------------|------------------|----------------------|-------------------------------|-------------|-----------------|-----------------|-------|
| P.sh. | 96.6 | 2.8 | .7 | | | | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 92.1 | 7.9 | | 100.0 |
| Etj. | 94.0 | 4.9 | 1.1 | | | | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 92.4 | 7.6 | | 100.0 |
| Antrop. | 23.0 | 71.0 | 4.6 | | | 1.4 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 14.7 | 85.3 | | 100.0 |
| Ek. | 42.1 | 52.0 | 5.0 | | | .9 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 37.1 | 62.9 | | 100.0 |
| Fig. | 86.6 | 11.6 | 1.7 | | | .2 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 76.8 | 23.2 | | 100.0 |

Ndërsa në grupin e dytë të shkurtesave standarde të gjuhës shqipe vlerësim më të madh lidhur me njohjen e kuptimit të këtyre shkurtesave ka shkurtesa (Prov.) *proverbë* me 68.4% të këtij vlerësimi, e ndjekur nga shkurtesa (Mjek.) – *Mjekësi* me 66.1% dhe në vend të tretë renditet shkurtesa (Num.rresht) – *numri i rreshtit* me 53.1%. Ndërsa dy shkurtesat e tjera standarde (Kr.pop) *Krijimtaria popullore* dhe (Mit.) *mitologji* njihen respektivisht nga 16.3% dhe 39% e nxënësve. Madje shkurtesa (Kr.pop) nuk përdoret nga një pjesë e konsiderueshme e tyre me vlerë 87.3%, por edhe mospërdorimi i shkurtesës tjetër (Mit.) gjithashtu është e konsiderueshme me 75.8% të atyre që e dinë apo jo kuptimin e kësaj shkurtese. 75.3% e atyre që nuk e përdorin këtë shkurtesë u

takojnë nxënësve të shkollave të qytetit dhe atyre profesionale, ndërsa 24.7% të tjerë u takojnë nxënësve të shkollave në periferi (Tabela 3 në ANEKS). Gjithashtu, pak më tepër se gjysma e nxënësve që e dinë apo nuk e dinë kuptimin e shkurtesës (Mjek.) nuk e përdorin atë duke kapur vlerën e 51.2%. Po kështu, edhe shkurtesa (Num.rresht) ka përdorim të ulët duke mos u përdorur gjatë komunikimit elektronik nga 67.5% e tyre. Kjo edhe për faktin se këto janë shkurtime specifike dhe ndoshta nuk përdoren rëndom nga nxënësit gjatë komunikimit të tyre. Ndërkohë për sa i takon shkurtesës (prov.) përdorimi dhe mospërdorimi i tyre është pothuaj i barabartë, pra saktësisht 50.5% e përdorin këtë shkurtesë dhe 49.5% të tjerë nuk e përdorin, një pjesë e të cilëve edhe për faktin që nuk e dinë kuptimin e saj. Një pjesë e vogël e tyre e marrin me mend kuptimin e këtyre shkurtesave duke variuar nga 2.3% për shkurtesën (Kr.pop), deri në 6.6% për shkurtesën (Num.rresht), (Tabela 3/2).

Tabela 3/2 Shkurtesat standarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|---------------------|---------------|-------------------|-------------------------|----------|--------------|--------------|-------|
| Kr. Pop | 16.3 | 79.2 | 2.3 | | | 2.1 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 12.4 | 87.3 | .4 | 100.0 |
| Mit. | 39.0 | 54.0 | 5.7 | | | 1.3 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 24.2 | 75.8 | | 100.0 |
| Mjek. | 66.1 | 28.0 | 5.0 | | | .9 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 48.8 | 51.2 | | 100.0 |
| Num. rresht. | 53.1 | 39.0 | 6.6 | | | 1.3 | 100.0 |

| | | | | | | | |
|--------------|------|------|-----|------|------|----|-------|
| Përdorimi | | | | 32.5 | 67.5 | | 100.0 |
| Prov. | 68.4 | 25.1 | 6.1 | | | .3 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 50.5 | 49.5 | | 100.0 |

Duke vazhduar më tej me shkurtesat standarde të gjuhës shqipe vërehet se edhe ky grup shkurtesash ndjek pothuaj të njëjtin trend përgjigjesh si ato më sipër lidhur me njohjen e kuptimit të tyre si dhe me përdorimin ose jo të tyre. Kështu, sipas rezultateve të marra nga përgjigjet e nxënësve rezulton se 67.9% e tyre e dinë kuptimin e shkurtesës (Treg.) – *tregti*, por përdoruesit e saj janë vetëm 47.3% e tyre. Gjithashtu edhe shkurtesa (Urdh) – *urdhërore*, njihet nga 70.4% dhe përdoret vetëm nga 45.4% e tyre, ndoshta edhe për faktin se këto janë shkurtesa standarde që nuk i takojnë fjalorit të përditshëm të nxënësve gjatë komunikimit të tyre në përgjithësi dhe atij elektronik në veçanti. Tre shkurtesat e tjera standarde të këtij grupi (Vetv) – *vetvetore*, (Shtypshkr) - *shtypshronjë*, dhe (Nr.sh) *numri shumës* njihen respektivisht nga 62.3%, 57% dhe 43.3%, madje një pjesë e mirë e tyre edhe pse e dinë kuptimin e secilës prej tyre nuk e përdorin atë, duke shtuar këtu edhe ata që shprehen se nuk e dinë kuptimin e tyre apo e marrin me mend atë. Vlerat përkatëse të mospërdorimit të këtyre tre shkurtesave janë respektivisht 61.9%, dy të tjerat nga 67.7%, secila (Tabela 3/3). Megjithëse këto shkurtesa standarde janë të përdorura edhe në tekstet shkollore dhe mësimore, përsëri shohim se ndikimi i komunikimit joformal është më i fortë se ai formal dhe standard.

Tabela 3/3 Shkurtesat standarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|-------------------|------------------|----------------------|----------------------------------|-------------|-----------------|-----------------|-------|
| Nr. Sh. | 43.3 | 50.9 | 4.7 | | | 1.1 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 33.3 | 66.7 | | 100.0 |
| Shtypshkr. | 57.0 | 38.2 | 3.8 | | | 1.0 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 32.3 | 67.7 | | 100.0 |
| Treg. | 67.9 | 26.4 | 5.0 | | | .7 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 47.3 | 52.7 | | 100.0 |
| Urdh. | 70.4 | 23.3 | 5.8 | | | .4 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 45.4 | 54.6 | | 100.0 |
| Vetv. | 62.3 | 30.2 | 6.8 | | | .7 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 38.1 | 61.9 | | 100.0 |

Grupi i fundit i shkurtesave standarde që përbëhet nga (Vjet) – *vjetor*, (Zoo)- *kopësht zoologjik*, (Zvog) – *zvogëlim*, (Zakon) – *zakonisht* dhe (Zyrt) – *zyrtarisht*, rezultatet e të cilit paraqiten në tabelën më poshtë tregojnë se shkurtesa që njihet më së shumti nga ky grup është (Zyrt) nga 74.7% e nxënësve e ndjekur nga 73.6% e tyre që shprehen se e dinë kuptimin e shkurtesës (Zvog), kjo edhe për arsye të përdorimit të saj edhe në tekste të ndryshme shkollore dhe më së shumti në lëndët shkencore. Por edhe shkurtesa (Zakon) ka marrë vlerësim të konsiderueshëm lidhur me njohjen e kuptimit të saj duke kapur vlerën e 70.1% dhe vetëm 3% e tyre janë shprehur se e marrin me mend kuptimin

e kësaj shkurtese, ndërkohë që rreth ¼ e tyre ose 25.7% nuk e dinë kuptimin dhe sigurisht nuk e përdorin atë dhe duke i shtuar këtyre edhe ata të cilët e dinë kuptimin, por nuk e përdorin. Vlera totale e mospërdorimit të kësaj shkurtese shkon në 52.4%, pra pak më shumë se gjysma e atyre që kanë dhënë një përgjigje. Shkurtesa (Zoo) njihet nga 57.9% e tyre dhe përdoret vetëm nga 43.2%. Njëlloj është edhe trendi i përgjigjeve për shkurtesën (Vjet), e cila sipas tyre njihet nga 57.1% dhe përdoret vetëm nga 40.1%, ndërkohë që vetëm 5.2% e tyre shprehen se e marrin me mend kuptimin e saj. (Tabela 3 /4).

Tabela 3/4 Shkurtesat standarde në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|---------------|---------------|-------------------|-------------------------|----------|--------------|--------------|-------|
| Vjet. | 57.1 | 36.4 | 5.2 | | | 1.2 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 40.1 | 59.9 | | 100.0 |
| Zoo. | 57.9 | 35.8 | 5.1 | | | 1.2 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 43.2 | 56.8 | | 100.0 |
| Zvog. | 73.6 | 22.3 | 3.8 | | | .3 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 48.2 | 51.8 | | 100.0 |
| Zakon. | 70.1 | 25.7 | 3.9 | | | .3 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 47.6 | 52.4 | | 100.0 |
| Zyrt. | 74.7 | 21.2 | 3.9 | | | .2 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 41.7 | 58.3 | | 100.0 |

5.1.3 Vlerësimi për respektimin e rregullave të shkrimit të gjuhës shqipe

Pjesë e pyetjeve të këtij pyetësi janë edhe disa alternativa që lidhen me faktin nëse nxënësit i njohin rregullat standarde të shkrimit të gjuhës shqipe dhe vlerësimi sipas tyre për secilën nga alternativat (pyetjet) është paraqitur në Tabelën 4.

Kështu pyetjes; - *A i respektoni rregullat standarde të shqipes së shkruar në detyrat tuaja me shkrim?* Pjesa më e madhe e tyre, me 83.1% shprehen pozitivisht, pra i respektojnë këto rregulla, të ndjekur nga ata që shprehen dhe mendojnë se i respektojnë ndonjëherë dhe pjesa tjetër nuk i respekton me vlerë 4.4%. Më pas renditet pyetja; - *Keni njohuri mbi shkurtesat standarde të gjuhës shqipe dhe përdorimin e tyre?* Ku 69.4% kanë njohuri dhe 17.2% jo, 5.8% të tjerë nuk kanë dhënë përgjigje. Pyetjes tjetër nëse i përdorni shpesh fjalët e huaja apo jo janë përgjigjur se 60.9% e nxënësve i përdorin dhe vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre me 0.8% shprehen se nuk i përdorin ato.

Tre alternativat e tjera kanë edhe vlerësimet pozitive me vlera më të vogla, respektivisht 48.3%, 37.7% dhe 20.7% respektivisht për pyetjet; *A janë të pranishme fjalët e huaja gjatë punës tuaj në shkollë?*, *A i zëvendësoni ato me fjalë të standardit të shqipes gjatë përdorimit në shkrimet standarde?* dhe; *Përdorni shkurtime ose simbole gjatë kryerjes së detyrave, eseve ose shkrimit të dokumenteve formale?*. Pjesa tjetër e nxënësve i përdorin ndonjëherë duke variuar nga 15.7% deri në 34.2% të përgjigjeve.

Tabela 4 Vlerësimi për respektimin e rregullave të shkrimit të gjuhës shqipe

| | Po | Jo | Ndonjëherë | Pa përgjigje | Total |
|---|------|------|------------|--------------|-------|
| A i respektoni rregullat standarde të shqipes së shkruar në detyrat tuaja me shkrim? | 83.1 | 4.4 | 12.1 | .3 | 100.0 |
| A janë të pranishme fjalët e huaja gjatë punës tuaj në shkollë? | 48.3 | 16.4 | 34.2 | 1.0 | 100.0 |
| Po jashtë saj i përdorni shpesh fjalët e huaja? | 60.9 | 8.8 | 29.9 | .4 | 100.0 |
| A i zëvendësoni ato me fjalë të standardit të shqipes gjatë përdorimit në shkrimet standarde? | 37.7 | 34.1 | 25.2 | 3.0 | 100.0 |
| Përdorni shkurtime ose simbole gjatë kryerjes së detyrave, eseve ose shkrimit të dokumenteve formale? | 20.7 | 57.9 | 15.7 | 5.8 | 100.0 |
| Keni njohuri mbi shkurtesat standarde të gjuhës shqipe dhe përdorimin e tyre? | 69.4 | 17.2 | 10.9 | 2.4 | 100.0 |

5.1.4 Fjalët e huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

Ne jemi të vetëdijshëm që komunikimi në përgjithësi dhe ai elektronik në veçanti ka huazuar edhe shumë fjalë të huaja, përdorimi i të cilave për një kohë të gjatë dhe nga të gjithë ka bërë që ato të jenë pjesë e komunikimit të gjithsecilit pa menduar shumë nëse kjo fjalë është e gjuhës shqipe apo nga gjuhë të tjera. Kjo tregon se edhe fjalori dhe komunikimi po “ndërkombëtarizohet” gjithashtu.

Duke iu referuar të dhënave për grupin e parë të këtyre fjalëve vërejmë se fjala *selektoj* njihet nga 85.4% e nxënësve dhe përdoret gjithashtu nga një pjesë e konsiderueshme duke kapur vlerën e 83.3%, ku 71.5% e këtyre përdoruesve janë nxënës që studiojnë në shkollat e qytetit përfshirë këtu edhe ato profesionale dhe 28.5% i takojnë nxënësve të shkollave në periferi (Tabela 4 në ANEKS). Ndërsa 10.6% të tjerë shprehen se nuk e njohin kuptimin e kësaj fjale dhe vetëm 3.7% e marrin me mend kuptimin e saj. Me 81% të përgjigjeve renditet vlerësimi për njohjen e kuptimit të fjalës *shokues*, e ndjekur nga 79.9%, të tjerë të cilët shprehen se e dinë kuptimin e fjalës dedikoj gjithashtu. Ndërsa nxënësit, të cilët kanë deklaruar në përgjigjet e tyre se nuk e njohin kuptimin e këtyre dy fjalëve, zënë respektivisht 14.4% dhe 14.8% të totalit. Madje fjala *dedikoj* përdoret më shumë se fjala *shokues*, e cila përdoret nga 77.9% e këtyre nxënësve. Për fjalën *evituj* vlerësimi për njohjen e kuptimit të saj kap vlerën 76.8%, ndërsa ata që e përdorin janë rreth 71.2%. Fjala e fundit e këtij grupi, *definitiv* njihet nga 69.9% e nxënësve dhe përdoret nga 59.2%, kjo ndoshta edhe për arsyen se kjo fjalë zë më pak vend në fjalorin e tyre të përditshëm apo edhe në shkollë gjithashtu, duke bërë që të mos përdoret nga një numër i konsiderueshëm nxënësish deri në masën 40.8% përfshirë këtu edhe ata nxënës të cilët e njohin kuptimin e kësaj fjale, por nuk e përdorin atë (Tabela 5/1).

Tabela 5/1 Fjalët e huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|------------------|------------------|----------------------|----------------------------------|-------------|-----------------|-----------------|-------|
| Selektoj | 85.4 | 10.6 | 3.7 | | | 0.3 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 83.3 | 16.7 | | 100.0 |
| Shokues | 81.0 | 14.4 | 4.1 | | | .4 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 77.9 | 22.1 | | 100.0 |
| Dedikoj | 79.9 | 14.8 | 4.9 | | | | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 86.7 | 13.3 | | 100.0 |
| Definitiv | 69.9 | 24.3 | 5.3 | | | 0.4 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 59.2 | 40.8 | | 100.0 |
| Evitoj | 76.8 | 17.8 | 4.7 | | | .8 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 71.2 | 28.8 | | 100.0 |

Pothuaj i njëjti trend përgjigjesh ndeshet edhe në grupin e dytë të këtyre fjalëve, nga ku vihet re se fjala *fans* njihet më shumë se fjalët e tjera të këtij grupi dhe përdoret gjithashtu nga 80.7% e tyre. 73.2% e tyre kanë deklaruar se e dinë kuptimin e fjalës *dominon* duke bërë që ajo të gjejë përdorim të gjerë nga 73.5%. Me 70.9% renditet niveli i njohjes për fjalën *inspirim*, e cila përdoret nga 69.2% përfshirë këtu edhe ata nxënës që e dinë kuptimin apo e marrin me mend kuptimin e saj, por nuk e përdorin atë zakonisht në komunikimin elektronik. Dy fjalët e tjera, *kreativ* dhe *suportoj* njihen

secila nga 69.3% e numrit të përgjithshëm të nxënësve, ndërsa përdorimi vërehet më i lartë se tek fjala *kreativ* me 73.2% përdorues, krahasuar me 61.2% përdorues të fjalës *suportoj* . (Tabela 5/2).

Tabela 5/2 Fjalët e huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|-----------------|---------------|-------------------|-------------------------|----------|--------------|--------------|-------|
| Inspirim | 70.9 | 23.2 | 5.8 | | | 0.1 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 69.2 | 30.8 | | 100.0 |
| Kreativ | 69.3 | 26.0 | 4.5 | | | .2 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 73.2 | 26.8 | | 100.0 |
| Dominon | 73.2 | 21.6 | 4.7 | | | 0.6 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 73.5 | 26.5 | | 100.0 |
| Fans | 76.4 | 18.3 | 5.2 | | | | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 80.7 | 19.3 | | 100.0 |
| Suportoj | 63.9 | 30.3 | 4.9 | | | .9 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 61.2 | 38.8 | | 100.0 |

Në grupin e tretë të këtyre fjalëve në gjuhë të huaja shohim se fjala, kuptimi i së cilës njihet më pak nga fjalët e tjera, është fjala *vakant* duke bërë që edhe përdorimi i saj të jetë i kufizuar deri në 36.1%. Ndërsa fjala *look* njihet më së shumti, nga 79.4% e tyre dhe ka gjetur përdorim nga 70% e nxënësve. 78.8% e nxënësve të kampionit shprehen

se e njohin kuptimin e fjalës *spostoj* duke e përdorur atë në 79.1% të rasteve. Fjalët *indiferent* dhe *violencë* njihen respektivisht nga 69.7% dhe 60.3% e nxënësve dhe përdoren nga 72.7% dhe 46.1% e tyre gjithashtu. Vlera e ulët e atyre nxënësve që nuk e përdorin fjalën *violencë*, ndoshta lidhet me faktin se nënkupton dhunën në përgjithësi. Pjesa tjetër nuk e dinë kuptimin e tyre, ose e marrin me mend atë (Tabela 5/3).

Tabela 5/3 Fjalët e huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|-------------------|---------------|-------------------|-------------------------|----------|--------------|--------------|-------|
| Vakant | 44.9 | 49.7 | 4.1 | | | 1.3 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 36.1 | 63.9 | | 100.0 |
| Look | 79.4 | 17.2 | 3.1 | | | .2 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 70.0 | 30.0 | | 100.0 |
| Spotoj | 78.8 | 17.1 | 3.8 | | | 0.3 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 79.1 | 20.9 | | 100.0 |
| Indiferent | 69.7 | 23.6 | 6.2 | | | 0.6 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 72.7 | 27.3 | | 100.0 |
| Violencë | 60.3 | 35.0 | 4.0 | | | .7 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 46.1 | 53.9 | | 100.0 |

Duke vazhduar më tej me 5 fjalët e tjera në gjuhë të huaj shohim se fjala *show* tashmë e përdorur gjerësisht edhe në median e shkruar dhe vizive njihet nga 82.3% e këtyre nxënësve dhe përdoret në komunikimin e tyre në masën 80.7%. Edhe fjala *starton*

njihet gjerësisht nga 79.6%, madje përdorimi i saj kap vlerën 69.8%, ndërsa 17.3% janë shprehur se nuk e dinë kuptimin e kësaj fjale. Fjala *net* edhe pse fjalë teknike ka njohje dhe përdorim të gjerë gjithashtu duke kapur vlerat respektivisht 78.4% dhe 76.7%. Fjala *barrierë* dhe *sensibilizoj* njihen respektivisht nga 75.1% dhe 65.6% e nxënësve, ndërsa përdorimi i tyre kap vlerat 69.7% dhe 68.2%. Por, edhe nxënësit që nuk e njohin kuptimin e tyre nuk janë pak, duke u llogaritur në 27.2% për fjalën *sensibilizoj* dhe 20.8% për fjalën *barrierë* (Tabela 5/4).

Tabela 5/4 Fjalët e huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|---------------------|---------------|-------------------|-------------------------|----------|--------------|--------------|-------|
| Sensibilizoj | 65.6 | 27.2 | 7.0 | | | 0.2 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 68.2 | 31.8 | | 100.0 |
| Net | 78.4 | 18.3 | 3.1 | | | .1 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 76.7 | 23.3 | | 100.0 |
| Starton | 79.6 | 17.3 | 3.0 | | | 0.1 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 69.8 | 30.2 | | 100.0 |
| Show | 82.3 | 14.4 | 3.1 | | | 0.1 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 80.7 | 19.3 | | 100.0 |
| Barrierë | 75.1 | 20.8 | 4.0 | | | .1 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 69.7 | 30.3 | | 100.0 |

5.1.5 Shkurtime të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

Gjuhët e huaja, ashtu sikurse edhe gjuha shqipe, përveç fjalëve dhe shkurtesave standarde kanë edhe fjalë apo shkurtesa jostandarde gjithashtu. Për të parë se deri në çfarë masë njihen këto shkurtesa jostandarde dhe se sa përdoren ato në komunikimin e përgjithshëm në tërësi dhe atë elektronik në veçanti, u përzgjedhën 20 nga shkurtesat me të cilat nxënësit janë më të familjarizuar dhe që hasen edhe më shpesh edhe në përditshmërinë e tyre.

Kështu, referuar të dhënave të Tabelës 6/1 shkurtesa e fjalës *mesazh* (sms) njihet më së shumti nga shkurtesat e tjera të këtij grupi me vlerë 82.8% dhe përdoret gjerësisht nga 85.1%, përfshirë këtu edhe nga ata nxënës që nuk e dinë ende kuptimin e kësaj shkurtese. Shkurtesa (pc) njihet nga 70.6% e nxënësve të intervistuar dhe përdoret nga 78.8%, pra edhe pse një pjesë e tyre, saktësisht 26.9%, janë shprehur se nuk e dinë kuptimin e kësaj shkurtese, apo 1.9% të tjerëve që e marrin me mend atë, deklarojnë se e përdorin atë gjatë komunikimit të tyre elektronik. Shkurtesa (fyi) – *for your information* njihet shumë pak, vetëm nga 15.9% e nxënësve, ndoshta për faktin se kjo shkurtesë përdoret më së shumti në komunikimet zyrtare apo nga një kategori nëpunësish sesa nga nxënësit.

Gjithashtu 76.7% e tyre janë nxënës të shkollave të qytetit dhe të atyre që studiojnë në shkolla të mesme profesionale dhe pjesa tjetër prej 23.3% janë nxënës të shkollave të periferisë (Tabela 6 në ANEKS). Shihet gjithashtu se shkurtesa (bf) ka marrë vlerësimin për njohjen e kuptimit të saj nga 67.1%, ndërsa përdorimi i saj shkon deri në 64.4%, pjesa tjetër prej 35.6% nuk e përdorin. Së fundi shkurtesa (lol) – *lot of laughing* njihet nga 63.7% dhe përdoret nga 67.7%, pra ka edhe një pjesë të atyre që e marrin me mend kuptimin e saj, por edhe nga ata që nuk e dinë kuptimin, por

pavarësisht kësaj e përdorin atë në komunikimin elektronik midis tyre. 74.7% e këtyre nxënësve që e përdorin janë nxënës të shkollave të qytetit dhe ato profesionale gjithashtu, dhe ndërsa pjesa tjetër rreth ¼ i takojnë nxënësve të shkollave periferike (Tabela 5 në ANEKS).

Tabela 6/1 Shkurtime të huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|------------|---------------|-------------------|-------------------------|----------|--------------|--------------|-------|
| Lol | 63.7 | 31.4 | 4.2 | | | 0.7 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 67.7 | 32.3 | | 100.0 |
| Bf | 67.1 | 29.0 | 2.9 | | | 1.0 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 64.4 | 35.6 | | 100.0 |
| Sms | 82.8 | 14.6 | 2.6 | | | 0.1 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 85.1 | 14.9 | | 100.0 |
| pc | 70.6 | 26.9 | 1.9 | | | 0.7 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 78.8 | 21.2 | | 100.0 |
| Fyi | 15.9 | 78.7 | 2.8 | | | 2.7 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 18.9 | 81.1 | | 100.0 |

Tabela 6/2 tregon se shkurtesat e analizuara në këtë grup kanë njohje relativisht të ulët nga nxënësit e anketuar. Kështu, shkurtesa e cila njihet më pak ndër to është (jam) *just a minute* me 24.8%, ndërsa shumica e tyre me 67% shprehën se nuk e njohin këtë shkurtesë dhe përdorues të saj janë vetëm 28.9% e tyre. Shkurtesa e huaj, e cila njihet më shumë nga 42.4% e nxënësve është (Pc) *personal computer* duke patur edhe 44.7%

të përdoruesve të saj. 30.7% e dinë kuptimin e shkurtesës (L8), kurse 31.9% dinë kuptimin e shkurtesës (emo) *emotional*, të ndjekur nga 27.9%, që shprehen se dinë kuptimin e shkurtesës (brb) *be right back*, por vetëm 30.2% e përdorin, ndërsa pjesa tjetër, me 69.8%, deklarojnë se nuk e përdorin asnjëherë këtë shkurtesë në komunikimin e tyre elektronik dhe jo vetëm.

Tabela 6/2 Shkurtime të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|------------|---------------|-------------------|-------------------------|----------|--------------|--------------|-------|
| Emo | 31.9 | 62.0 | 4.6 | | | 1.6 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 32.5 | 67.5 | | 100.0 |
| L8 | 30.7 | 63.2 | 3.6 | | | 2.6 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 28.7 | 71.0 | .4 | 100.0 |
| Brb | 27.9 | 64.7 | 4.8 | | | 2.7 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 30.2 | 69.8 | | 100.0 |
| Jam | 24.8 | 67.0 | 5.4 | | | 2.8 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 28.9 | 71.1 | | 100.0 |
| Pc | 42.4 | 52.2 | 3.1 | | | 2.2 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 55.3 | 44.7 | | 100.0 |

Po kështu edhe shkurtesat jostandarde të paraqitura më poshtë sërish dallohen për nivel të ulët të njohjes së kuptimit të tyre dhe si rrjedhim edhe të përdorimit të tyre elektronik. Shkurtesa, së cilës nxënësit i dinë kuptimin në një nivel pak më të lartë se të tjerat në

këtë grup të tretë shkurtesash është (ps) – *post scriptum* me vlerë 40%, e ndjekur nga shkurtesa (ad)- *shtoj* me 29.6% dhe në vend të tretë renditet shkurtesa (nb) - *no body* me 21.2% të përgjigjeve pozitive. Ndërsa niveli i përdorimit të tyre është respektivisht 49.5%, 33.6% dhe 20.1%, pra edhe përdorimi i tyre është gjithashtu i ulët. Kjo për faktin se një pjesë e mirë e këtyre nxënësve mund të kenë njohje jo të mira në gjuhën e huaj, (anglisht në këtë rast) dhe kjo e bën më të vështirë njohjen e kuptimit të tyre, e aq më tepër përdorimin e vazhdueshëm të këtyre shkurtesave. Dy shkurtesat e tjera jostandarde kanë përgjigje pozitive me vlera akoma më të ulëta. Kështu shkurtesa (kwim) *Know what i mean* dhe (nagi) *Not a good idea* njihen respektivisht vetëm nga 12.8% dhe 11.6%.

Një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk e dinë kuptimin e tyre dhe as i përdorin ato duke mos përjashtuar edhe raste kur edhe pse e dinë kuptimin, nuk e përdorin gjerësisht atë shkurtesë. Gjithashtu, ka edhe nxënës që kanë deklaruar se e marrin me mend kuptimin e tyre, por numri i tyre është shumë u ulët duke variuar nga 2.2% (kwim) deri në 3.1% (nagi) (Tabela 6/3).

Tabela 6/3 Shkurtime të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|-------------|---------------|-------------------|-------------------------|----------|--------------|--------------|-------|
| Nagi | 11.6 | 82.9 | 3.1 | | | 2.4 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 14.3 | 85.7 | | 100.0 |
| Nb | 21.2 | 73.4 | 3.0 | | | 2.3 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 20.1 | 79.9 | | 100.0 |

| | | | | | | | |
|-------------|------|------|-----|------|------|-----|-------|
| Ad | 29.6 | 65.0 | 2.7 | | | 2.8 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 33.6 | 66.4 | | 100.0 |
| Kwim | 12.8 | 82.2 | 2.2 | | | 2.8 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 17.1 | 82.9 | | 100.0 |
| Ps | 40.0 | 55.2 | 2.9 | | | 1.9 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 49.5 | 50.5 | | 100.0 |

Pesë shkurtesat e fundit jostandarde në gjuhën e huaj janë (b4) – *before*, (2day), *-today*, (cos) – *because*, (sys) - *See you soon* dhe (c) *see*, njohja e kuptimit të së cilave është respektivisht: 47.4%, 45.1%, 41.9%, 33.6% dhe 25.4%. Ndërsa niveli i përdorimit të tyre është: 40.7%, 40.6%, 45.8%, 27.1% dhe 25.6%. Pra, aty ku niveli i njohjes së këtyre shkurtesave është i ulët edhe përdorimi i tyre në komunikim reflektohet po njëjloj (Tabela 6/4).

Tabela 6/4 Shkurtime të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe dhe përdorimi i tyre

| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend kuptimin | E përdor | Nuk e përdor | Pa përgjigje | Total |
|------------|---------------|-------------------|-------------------------|----------|--------------|--------------|-------|
| 2da | 45.1 | 50.3 | 2.9 | | | 1.7 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 40.7 | 59.3 | | 100.0 |
| B4 | 47.4 | 48.6 | 2.4 | | | 1.6 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 40.6 | 59.4 | | 100.0 |
| Cos | 41.9 | 53.3 | 3.2 | | | 1.6 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 45.8 | 54.2 | | 100.0 |

| | | | | | | | |
|------------|------|------|-----|------|------|-----|-------|
| C | 25.4 | 69.8 | 2.4 | | | 2.3 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 25.6 | 74.4 | | 100.0 |
| Sys | 33.6 | 60.8 | 3.8 | | | 1.9 | 100.0 |
| Përdorimi | | | | 27.1 | 72.9 | | 100.0 |

5.1.6 Vlerësimi i rregullave të shkrimit të fjalëve në gjuhë të huaj

Edhe në rastin e shkurtesave dhe fjalëve në gjuhë të huaj, ashtu sikurse për shkurtesat në gjuhën shqipe nxënësit vlerësuan edhe alternativat përkatëse të matjes së përdorimit dhe zbatimit të rregullave për shkurtesat në gjuhën e huaj.

Kështu pyetja; - *Zakonisht a dërgoni shumë mesazhe gjatë ditës?* Ka marrë 67.2% përgjigje pozitive, ndërkohë që 15.4% të tjerë e mohojnë këtë fakt, ndërsa ata që dërgojnë ndonjëherë kapin vlerën e 17% të totalit. Pra, përdorimi i mesazheve ka gjetur përdorim shumë të madh tek të gjithë ne, por edhe tek nxënësit në veçanti. Pra, përdorimi i aparateve celularë pothuaj gjatë gjithë ditës, e bën edhe më të përdorshëm këtë mënyrë komunikimi elektronik, jo vetëm thjesht me sms, por edhe në programe e rrjete të tjera sociale si Facebook, Twiter, Whast up, Viber etj. Madje 73.7% e tyre pohojnë se gjatë dërgimit të sms-ve ata përdorin edhe shkurtime dhe vetëm 45.8% shprehen se përdorin edhe zhargone në mesazhet e tyre, ndërsa 26.6% i përdorin këto zhargone ndonjëherë.

Pyetjes;- *A i shkurtoni fjalët kur përdorni shqipen standarde?* i janë përgjigjur pozitivisht 44.4% , ndërkohë që 34% e pohojnë këtë fakt dhe shprehen se nuk i shkurtojnë fjalët gjatë komunikimit me mesazh. Ndërsa pyetjes; - *A ndikoheni nga komunikimi elektronik në punët tuaja me shkrim ose detyrat e shtëpisë?* i janë përgjigjur pozitivisht rreth 1/3 e tyre dhe saktësisht 31.9%, ndërsa 44.3% shprehen se nuk

ndikohen nga komunikimi elektronik, të ndjekur nga 20.3% të tjerë që deklarojnë se ndikohen ndonjëherë, dhe së fundi vetëm për 1% të tyre nuk janë përgjigjur lidhur me këtë fenomen.

Pra, përdorimi i shkurtimeve apo i fjalëve të huaja, qofshin këto standarde apo jo, ka gjetur përdorim të gjerë kudo duke u bërë gati – gati i të pashmangshme në komunikimin elektronik dhe jo vetëm (Tabela 7).

Tabela 7 Vlerësimi i përdorimit të shkurtesave dhe fjalëve në gjuhë të huaj

| | Po | Jo | Ndonjëherë | Pa përgjigje | Total |
|--|------|------|------------|--------------|-------|
| Zakonisht a dërgoni shumë mesazhe gjatë ditës? | 67.2 | 15.4 | 17.0 | .3 | 100.0 |
| Përdorni shkurtime kur i dërgoni sms njëri-tjetrit? | 73.7 | 13.2 | 12.4 | .7 | 100.0 |
| A përdorni zhargone kur dërgoni mesazhe apo kur komunikoni elektronikisht? | 45.8 | 22.6 | 26.6 | 5.1 | 100.0 |
| A i shkurtoni fjalët kur përdorni shqipen standarde? | 44.4 | 34.0 | 20.6 | 1.0 | 100.0 |
| A ndikoheni nga komunikimi elektronik në punët tuaja me shkrim ose detyrat e shtëpisë? | 31.9 | 44.3 | 20.3 | 3.4 | 100.0 |

5.2 Gjetjet nga esetë dhe diskutimi

Në seksionin që vijon do të dallojmë disa nga rezultatet mbi nivelin e aftësisë së nxënësve për të përdorur gjuhën e shkruar standarde në punët e tyre me shkrim që ata zhvilluan për këtë studim. Temat e eseve të zhvilluara nga nxënësit u vendosën në bashkëpunim me mësuesit e shkollave përkatëse si dhe në përshtatje me moshën dhe formimin e tyre. U caktuan nga dy tema për secilin vit studimi, në mënyrë që nxënësit të kishin mundësi zgjedhjeje për të shprehur mendimet dhe idetë e tyre. Konkretisht temat e përcaktuara të këtyre eseve ishin:

Klasa X: 1. *Cilin tip libri preferoni të lexoni dhe pse?*

2. *Komuniteti im ideal*

Klasa XI: 3. *A ka atdhetarizëm të deklaruar mes shqiptarëve?*

4. *Gjuha dhe interneti*

Klasa XII 5. *Komunikimi virtual është i rëndësishëm për lehtësimin e rrugëve komunikuese*

6. *Dhuna në familje*

Gjatë këtij procesi pune u analizuan esetë në tërësinë e tyre, duke u ndalur veçanërisht në strukturën gramatikore dhe sintaksore. Të dhënat dhe gjetjet e tyre janë analizuar në vazhdim. Këto të dhëna ndihmojnë dhe shërbejnë për të vërtetuar dhe testuar hipotezat e ngritura në këtë punim, nëse nxënësit tanë ndikohen apo jo në punët e tyre në shkollë nga interneti dhe komunikimi elektronik.

Termi drejtshkrim është kalk i emrit ortografi (nga greq.orthos- i drejtë + grapho-shkruaj). Është një nga nënsistemet e gjuhës standarde, madje mund të themi baza e tij. Pa një drejtshkrim të njësuar, nuk mund të kemi një gjuhë të përbashkët letrare.

Pra, drejtshkrimi është një sistem rregullash për mënyrën e shkrimit të temave të fjalëve, të formave të ndryshme morfologjike që marrin fjalët gjatë përdorimit, si dhe të morfemave trajtëformuese e fjalëformuese. Në drejtshkrim përfshihen edhe rregullat për shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes, ndarja e fjalëve në fund të rreshtit, shkrimi i datave, shkurtesave, përdorimi i shkronjave të mëdha, transkriptimi i emrave të huaj dhe përdorimi i shenjave të pikësimit. Nevoja e njësimi të drejtshkrimit të shqipes standarde është ndier herët nga lëvruesit dhe gjuhëtarët shqiptarë. Por që të arrihej kjo, në radhë të parë duhej një alfabet i njehsuar, ndryshe duhej përmbushur faza e grafitizimit të gjuhës shqipe (Memushaj R :123.) Kjo detyrë u plotësua me Kongresin e Manastirit(1908). Më pas u ndërmorën disa hapa, të cilët hapën rrugën për afrimin e ortografive (drejtshkrimeve) dialektore. Hapi i parë u shënua nga Komisia Letrare e Shkodrës (1917), e cila bëri përpjekjen e parë për të hequr dorë nga mjaft veçori ortografike dialektore. Pas Luftës së Dytë Botërore, përpjekjet për një drejtshkrim të vetëm, për një formë të vetme të gjuhës letrare u vijua më me këmbëngulje në Tiranë dhe në Prishtinë, duke u kurorëzuar me miratimin e drejtshkrimit të njësuar të shqipes letrare nga Kongresi i Drejtshkrimit, më 1972 (Po aty, :124). Rregullat e drejtshkrimit të shqipes mbështeten në disa parime:

1. Parimi fonetik
2. Parimi morfologjik
3. Parimi etimologjik (historik-tradicional)

Për të shmangur gabimet drejtshkrimore sigurisht që na vijnë në ndihmë fjalorët drejtshkrimorë ose fjalorët normativë, por së pari kujdes të madh duhet t'u kushtojmë mësimi dhe përvetësimit të rregullave drejtshkrimore. Mirëpo, duke pasur parasysh faktin se në shkollën e mesme i është dhënë më shumë rëndësi lëndës së letërsisë sesa

asaj të gjuhës shqipe, vërehen disa mangësi në këtë drejtim. Në shkrimet e ndryshme të nxënësve hasen shpesh gabime të ndryshme drejtshkrimore.

Më poshtë po japim disa prej tyre, që janë nxjerrë gjatë analizës së eseve nga ana drejtshkrimore. Esetë e punuara nga nxënësit u analizuan mbi bazën e disa kritereve që kanë të bëjnë me faktin sesa nxënësit tanë në shkollat e mesme i njohin rregullat standarde të shkrimit të shqipes dhe sa i përdorin ato:

- Shkurtesat standarde të shqipes së shkruar
- Shkurtesat jostandarde të shqipes, të cilat duke u përdorur pa kriter në gjuhën e folur janë bërë edhe pjesë e gjuhës së shkruar
- Fjalë dhe shprehje në gjuhë të huaj, kryesisht nga anglishtja
- Shkurtesa të fjalëve në gjuhë të huaj
- Shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes,
- Ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit,
- Shkrimin e datave,
- Përdorimin e shkronjave të mëdha,
- Transkriptimin e emrave të huaj,
- Përdorimin e shenjave të pikësimit etj..

Përveç kësaj, unë kam parë dhe kam analizuar disa raste të drejtshkrimit jostandard në punët e tyre me shkrim. Disa nga elementet e konstatuar zakonisht ndodhin në tekstet e mesazheve, pasi tekstshkruesi mundohet që të ruajë disa karaktere, por harron se mund të deformojë ose të keqkuptohet ajo që ka shkruar. Për këtë qëllim jam ndalur në disa raste të moszbatimit të shqipes standarde si p.sh. te fjalët e shkruara me shkronja të vogla në vend të përdorimit të shkronjës së madhe, mungesa e apostrofit


në fjalë të kontraktuara, të tilla si; *ç'është, s'e, s'bëj*, në mospërdorimin e saktë të shenjave të pikësimit apo përdorimin e tepërt të tyre aty ku nuk duhet, etj.

Në pjesën më të madhe, në bazë të kontekstit, nuk mund të kuptojmë se çfarë është menduar të thuhet në qoftë se nuk është përdorur apostrofi, pra mund të ndodhin keqkuptime në qoftë se apostrofat lihen pas dore. Këto elemente mund t'i gjejmë në stilin e ligjërimit joformal që përfshin përdorimin e zhargonit të tyre të përditshëm dhe pasqyron sintaksën e gjetur në mënyrë tipike në gjuhën e folur. Vlen të theksohet se esetë e mbledhura janë të shkruara me dorë dhe temat që u zgjodhën ishin tema aktuale dhe u jepnin mundësi nxënësve për të shprehur mendimet dhe idetë e tyre pa u kushtëzuar nga ana mësimore. Gjithashtu nxënësve iu bë e qartë se punët e tyre me shkrim nuk do të korrigjohen dhe vlerësohen nga mësuesi i tyre i lëndës.

Mendoj se kjo ishte një gjë e mirë për studimin tonë, pasi ata, ndoshta nuk u shqetësuan shumë për gjuhën e tyre nga ana e përdorimit të fjalorit, ashtu siç do të shqetësoheshin në qoftë se do t'i korrigjonte mësuesi i tyre i lëndës kundrejt vlerësimit dhe notës. Pra, gjuha e tyre ishte mjaft e natyrshme. Por, nxënësve nuk iu bë e qartë se për çfarë arsyes dhe qëllimesh do të analizoheshin këto ese, deri në momentin që ato i dorëzuan plotësisht ato. Kjo nuk u dha atyre asnjë shans që të ndryshonin gjuhën e tyre, në mënyrë që t'ia përshtatnin atë hulumtimeve të mia, pasi ata nuk e dinin se cilat ishin synimet e mia. Në këtë aspekt shmanget “paradoksi i vëzhgimit”, i cili thotë se në mënyrë që të gjeni diçka në lidhje me gjuhën dhe përdorimin e saj natyror, njeriu duhet të respektojë përdorimin e gjuhës natyrore. Sado e natyrshme që të jetë gjuha, nuk mund të shihet duke e vëzhguar atë, për shkak se informatorët ndryshojnë gjuhën e tyre, kur ata e dinë se janë duke u vërejtur apo vëzhguar (Labov 1972).

Më poshtë po rendisim disa nga gabimet më të shpeshta, të cilat janë hasur gjatë analizës tonë për esetë dhe punët me shkrim duke i klasifikuar këto gabime sipas fushave gjuhësore përkatëse :

Grafiku 5 : Përqindja e gabimeve sipas fushave përkatëse gjuhësore.



5.2.1 Analizë e çështjeve të normës drejtshkrimore

Gjuha e përdorur në esetë e analizuara, edhe pse supozohej se duhej të ishte një gjuhë e një regjistri të mesëm e të lartë (në varësi edhe të nivelit gjuhësor të nxënësve), kishte shumë fjalë të cilat i përkisnin gjuhës joformale dhe elemente të cilat janë karakteristikë e komunikimit elektronik. Për të krijuar një ide më të qartë të këtyre shembujve, veçanërisht nga ana drejtshkrimore, jam munduar që modelet t'i klasifikoj sipas çështjeve më të rëndësishme gjuhësore dhe sipas rezultateve të përfuara për të gjitha punët me shkrim të kryera nga nxënësit. Numrin më të madh të gabimeve e zënë ato drejtshkrimore, kjo ndoshta vjen për shkak të moskujdesjes së tyre gjatë të shkruarit si dhe mosvëmendjes për t'i kushtuar rëndësi standardit të shqipes.

Tabela 8 Numri i gabimeve sipas çështjeve të normës drejtshkrimore

| | Çështje të normës drejtshkrimore | Numri i gabimeve | Përqindja |
|----------|--|-------------------------|------------------|
| 1 | Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit: | 50 (pesëdhjetë) | 24.9 % |
| 2 | Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras: | 30(tridhjetë) | 14.8 % |
| 3 | Shkrimi i fjalëve me vizë në mes: | 14(katërmbëdhjetë) | 6.9 % |
| 4 | Përdorimi i apostrofit dhe kontraktimeve në fjalë | 10(dhjetë) | 4.9 % |
| 5 | Përdorimi i shenjave të pikësimit | 25(njëzet e pesë) | 12.4 % |
| 6 | Përdorimi i shkronjës së madhe | 38(tridhjetë e tetë) | 18.8 % |
| 7 | Përdorimi i gabuar ose mospërdorimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. | 35(tridhjetë e pesë) | 17.3 % |

1. Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit:

Shpesh hasim ndarjen e gabuar të fjalëve në fund të rreshtit, duke mos zbatuar rregullat e drejtshkrimit ose shohim edhe ndarjen e shkronjave të përbëra nga njëra-tjetra. Nga vëzhgimet e bëra janë konstatuar disa gabime të këtij lloji në esetë dhe punimet e nxënësve, duke zënë kështu një peshë të madhe të gabimeve krahasuar me shkrimin e fjalëve njësh dhe ndaras apo me çështje të tjera drejtshkrimore.

Disa nga gabimet më të shpeshta të konstatuar tek nxënësit për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit janë:

Tabela 9 Shembuj të gabimeve të ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit

| Si është shkruar | Si duhet shkruar |
|-------------------------|-------------------------|
| shq- iptarët | (shqip-ta-rët) |
| k-thyen | (kthy-en) |
| puno-j | (pu-noj) |
| persona-zh | (perso- nazh) |
| fl-amuri | (fla-mu-ri) |
| vullneta-r | (vull-ne-tar) |
| thot-ë | (tho-të) |
| seps-e | (sep-se) |
| b-urrëror | (bu-rrë-ror) |
| qyte-t | (qy-tet) |
| f-uqitë | (fu-qi-të) |
| sh-tëpi | (shtë-pi) |
| gj-ëra | (gjë-ra) |
| fisnikërin-ë | (fisnikë-rinë) |
| ar-rin | (arr-in) |

| | |
|-------------------|----------------------|
| shkat-htësi | (shka-thtësi) |
| fil-lon | (fi-llon) |
| mësimd-hënie | (mësim-dhënie) |
| hol-lësisht | (hollë-sisht) |
| jas-htëzakonis-ht | (jashtë-za-ko-nisht) |
| miqësi-sht | (miqë-sisht) |
| mesh-ollë | (mes-hollë) |
| udh-ëkryq | (udhë-kryq) |

2. Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras:

Gabime vërehen edhe në shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me ose pa vizë lidhëse.

Shkruhen gabimisht ndaras: *shpesh herë, pa dyshim me njëherë, deri sa, një farë, mos vazhdim etj.*; dhe njësh: *përshembull, përqind, , përsa*. Gjithashtu, gabime të shumta bëhen edhe në përdorimin e nyjave para gjymtyrëve homogjene. Shpeshherë nuk shkruhet nyja *të*. I njëjti gabim vërehet edhe në mospërdorimin e parafjalëve para gjymtyrëve homogjene si: “Mësuesi foli për rëndësinë e zhvillimit të ekonomisë shqiptare, (për) uljen e borxhit dhe (për) ndryshimet në sistemin ekonomik.

Ndër shembujt e hasur gjatë vëzhgimit mund të përmendim:

Tabela 10 Shembuj të gabimeve të shkrimit të fjalëve njësh dhe ndaras

| Si është shkruar | Si duhet shkruar |
|-------------------------|-------------------------|
| nëqoftëse | (në qoftë se) |
| kur se | (kurse) |
| çdoherëqë | (çdo herë që) |
| me gjithë se | (megjithëse) |

| | |
|-----------------|------------------|
| ndonë se | (ndonëse) |
| as kush | (askush) |
| gjer sa | (gjersa) |
| prapë se prapë | (prapëseprapë) |
| drejt për drejt | (drejtpërdrejt) |
| shumë-katësh | (shumëkatësh) |
| hekur-kthyes | (hekurkthyes) |
| ec e jake | (ecejake) |
| mini-anlizë | (minianlizë) |
| jo- shqiptar | (joshqiptar) |
| dritë-hije | (dritëhije) |
| kurrë farë | (kurrëfarë) |
| kënd drejtë | (kënddrejtë) |
| farë e fis | (farefis) |
| një qind | (njëqind) |
| flokë verdhë | (flokëverdhë) |
| çdo kush | (çdokush) |
| në se | (nëse) |
| jashtë shkollor | (jashtëshkollor) |
| tej për tej | (tejpërtej) |
| mirë po | (mirëpo) |

3. Shkrimi i fjalëve me vizë në mes:

Fjalët e përfituara nga përsëritja e një fjale në të njëjtën trajtë ose në trajta të ndryshme, nga bashkimi i dy antonimeve, i dy numërorëve, tingullimitimet e përfitur nga përsëritja e një fjale a elementi në të njëjtën trajtë ose në trajta të ndryshme shkruhen me

vijë ndarëse në mes (Memushaj R :153). Disa prej këtyre fjalëve ku nxënësit kanë thyer rregullat drejtshkrimore janë:

Tabela 11 Shembuj të gabimeve të shkrimit të fjalëve me vizë në mes

| Si është shkruar | Si duhet shkruar |
|-------------------------|-------------------------|
| njëri tjetri | (njëri – tjetri) |
| herë herë | (herë-herë) |
| shumë shumë | (shumë-shumë) |
| 10 vjeçar | (10-vjeçar) |
| ish deputet | (ish-deputet) |
| 8 orësh | (8-orësh) |
| lloj lloj | (lloj-lloj) |

4. Përdorimi i apostrofit dhe kontraktimeve në fjalë

Në gjuhën shqipe apostrofi përdoret kryesisht në rastet me elizion, d.m.th. për të shënuar rënien e zanores fondore ë të disa fjalëzave kur pas tyre vjen një zanore. Mospërdorimi i tij shpesh sjell paqartësi në kuptimin e fjalëve. (po aty :142). Shkelje e rëndë e rregullave gramatikore është edhe ndarja me apostrof e pjesëzës të të lidhores dhe e gerundit, e cila së bashku me trajtën e shkurtër ka kaluar në *ta*, si dhe veçimi pa asnjë arsye i bashkëtingëllores ç në përemrat e pazbërthyesëm ç'farë, ç'do (çfarë, çdo, etj). Në këtë rast kemi shkelje të rregullave pikësimore. Megjithëse u vu re një rënie e përdorimit gabim të këtij tipari, duhet theksuar se ky gabim fillestar është ende i pranishëm në shkrimet e disa nxënësve në vite të ndryshme studimi.

Trajtat e shkurtra të bashkuara të përemrave, në raste të shpeshta shkruhen gabimisht pa apostrof, si p.sh. *mi* dha, *ti* dha, (m'i dha, t'i dha) etj. Trajta e shkurtër e

vetës së dytë të shumësit e përemrit *ju* ngatërrohet me trajtën e shkurtër të vetës së tretë të shumësit *u*, si në rastet:*ju erdhi keq*.....(....*u erdhi keq*....). Trajta e shkurtër e bashkuar e përemrit vetor, veta e tretë njëjës e dhanores *ia* shkruhet gabimisht me *j* (*ja*), si: ...*ja dhashë librat shokut të dhomës*, në vend të*ia dhashë librat shokut të dhomës*. Gjithashtu, duke shkelur rregullat më elementare të gramatikës së drejtshkrimit shpërbëhen disa fjalë të prejardhura me parashtesat: *jo, pa, mos, sapo, ç*, duke shkruar veç e veç përbërësit e disa fjalëve të përbëra a të përngjitura: *ç'interesim, të pa korruptuar, të pa shoqëruara, kurse një vjeçare, dy ditore* etj. Luhatje u vërejtën edhe në shkrimin e shprehjeve ndajfoljore e lidhëzore, që priren nga trajta shkrimore e përngjitur (*sëbashku, nëqoftëse*, etj).

Si shembuj të anlizës tonë mund të përmendim:

Tabela 12 Shembuj të gabimeve të përdorimit të apostrofit

| Si është shkruar | Si duhet shkruar |
|-----------------------|--------------------------|
| smë duhet | (s' më duhet) |
| tia punoj | (t'ia punoj) |
| tu bë mirë | (t'u bë mirë) |
| çtë bëj më parë | (ç'të bëj më parë) |
| sështë e drejtë | (s'është e drejtë) |
| svij sot | (s'vij sot) |
| tua plotësoj dëshirën | (t'ua plotësoj dëshirën) |
| shamë drekë | (s'hamë drekë) |
| çu bëre | (ç'u bëre) |
| mu duk | (m'u duk) |
| mi dha librat | (m'i dha librat) |
| tju vijë mbarë | (t'ju vijë mbarë) |

| | |
|----------------|-------------------|
| çke kështu? | (ç'ke kështu) |
| sinteresohet | (s'interesohet) |
| çështë kjo gjë | (ç'është kjo gjë) |

5. Përdorimi i shenjave të pikësimit

Gabimet gjatë përdorimit të pikës (.)

Përveç shenjave të zakonshme që përbëjnë alfabetin e një gjuhe, në sistemin grafik kemi edhe shenja të tjera të posaçme të cilat janë: pika, pikëçuditja, pikëpresja, dy pikat, shumëpikëshi, thonjëzat, kllapat dhe viza. Këto shenja pikësimi ndihmojnë për të shënuar pauzat, ngritjen dhe uljen e zërit.

Në analizën tonë na rezultoi se përgjithësisht nxënësit e përdorin pikën në fund të fjalisë dëftore, por ka edhe raste të mospërdorimit të saj si:

- Jeta është e bukur ajo duhet shijuar deri në fund.
- Jeta është e bukur. Ajo duhet shijuar deri në fund.
- E qara e një fëmije të porsalindur, është ndër tingujt më të bukur, ndonëse unë nuk kam jetuar në Elbasan gjithmonë kam mall për atë vend.
- E qara e një fëmije të porsalindur, është ndër tingujt më të bukur. Ndonëse unë nuk kam jetuar në Elbasan gjithmonë kam mall për atë vend.

Ndër problemet e tjera të konstatuara janë:

Shkrimi i datave pa pikë në mes:

13 03 2016 në vend të 13.03.2016

13 III 2016 në vend të 13.III 2016

Mospërdorimi i pikës gjatë shkurtimit të fjalëve si: I Kadare për I. Kadare, P. Marko psh për p.sh etj..

Mjaft të rralla janë përdorimet për titujt dhe gradat si: vep. e cituar apo prof. (profesor) ing. (inxhinier) etj. Këto elementë cilësohen si të parëndësishën nga nxënësit.

Gabimet gjatë përdorimit të presjes (,)

Presja ka një përdorim shumë të gjerë, veçanërisht në fjalitë e përbëra dhe periudhat.

Në disa nga esetë e analizuara janë konstatuar mospërdorime të shumta të presjeve në fjali, të cilat konsiderohen edhe si të papërfillshme. Ata nuk arrijnë të dallojnë pauzën brenda fjalisë dhe kjo vjen nga ritmi i shpejtë i të shkruarit. Gabimet që vërehen më shumë i takojnë përdorimit të prejses, 40% e nxënësve nuk e vendosin presjen para përemrave lidhorë *i cili, e cila*, para lidhëzës kundërshtore *por* dhe para lidhëzës shkakore *sepse*. Ndërkohë që në 22% të rasteve të studiuara u vu re përdorimi i presjes para *etj.*; mungon dendur, (rreth 64 %) presja para përemrave lidhorë, *i cili, e cila*, para lidhëzës kundërshtore *por* dhe para lidhëzës shkakore *sepse*. Ndër rastet e konstatuara në fjali mund të përmendim:

- Sot rrjeti social më i përdorshëm në Shqipëri por edhe në botë është padyshim facebook.
- Sot rrjeti social më i përdorshëm në Shqipëri, por edhe në botë, është padyshim facebook.
- Nxënësit në shkollë marrin edukatën sjelljen dhe diturinë.
- Nxënësit në shkollë marrin edukatën, sjelljen dhe diturinë.
- Njeriu i qytetëruar di të fal i paqytetëruari jo.
- Njeriu i qytetëruar di të falë, i paqytetëruari jo.

Edhe fjalët që bashkohen me lidhëzat kundërshtuese *po, por*, dhe me lidhëzën këpujore *as*, ndahen me presje. Ja disa shembuj ku nxënësit nuk i ndajnë ato:

- As pushkë nuk dëgjoheshin as flakë nuk shkohej.
- As pushkë nuk dëgjoheshin, as flakë nuk shkohej.
- Drita e dytë nuk njihej por dallohej mjaft qartë.
- Drita e dytë nuk njihej, por dallohej mjaft qartë.

Gabimet gjatë përdorimit të pikëpyetjes, pikëçuditjes dhe thonjzave. (? ! “ ”)

Shpesh nxënësit nuk përqëndrohen qartë në intonacionin e fjalisë duke mos arritur të dallojnë nëse është fjali dëshirore, pyetëse apo thirrmore. Madje shprehin vështirësi në dallimin ndërmjet ligjëratës së drejtë dhe pikësimit të saj.

- Çudi, çdo gjë vjen e shkon.
- Çudi! Çdo gjë vjen e shkon!
- Mjaft më ulni ngadalë, – tha ai.
- Mjaft! Më ulni ngadalë! – tha ai.
- Mirësërdhe. Faleminderit. Të lutem .Mirëmbetsh.
- Mirësërdhe! Faleminderit! Të lutem! Mirëmbetsh!
- Po të skuqen faqet, ë, e ke nga turpi.
- Po të skuqen faqet, ë? E ke nga turpi?

6. Përdorimi i shkronjës së madhe

Përdorimi i shkronjës së madhe mbështetet në parimin simbolik: ashtu si në shumë gjuhë të tjera edhe në gjuhën shqipe shkronja e madhe shërben për të dalluar emërtimet e përveçme nga emrat e përgjithshëm. Sipas “Drejtshkrimit...”, “Emërtimet e

funksioneve shtetërore, politike e ushtarake, të gradave, të titujve fetarë etj...shkruhen me shkronjë të vogël, si: deputeti i Kuvendit Popullor, mbretëresha Teuta, doktor, profesor A. Xhuvani, at Shtjefën Gjeçovi etj. Emërtimet zyrtare të institucioneve të shtetit, si dhe emërtimet e organizatave shoqërore e të njësive ushtarake kryesore shkruhen me shkronjë të madhe. Kur këto emërtime përdoren si emra të përgjithshëm, shkruhen me shkronjë të vogël, si: ky universitet nuk ka fakultet mjekësie (Drejtshtkrimi, 1973 :151). Gjatë analizës tonë patëm disa raste kur në vend të shkronjë së madhe ishte përdorur shkronja e vogël. Ndonëse këto raste nuk ishin shumë të shpeshta, vlen për t'u theksuar mungesa e shkronjës së madhe. Kjo tregon nxitimin e madh që kanë nxënësit tanë për të shkruar shpejt, të ndikuar nga ritmi i jetës së tyre të përditshme. Përdorimi i shkronjës së madhe është një nga ato raste ku tregohet dukshëm moskujdesi ndaj drejtshtkrimit të gjuhës shqipe së bashku me përdorimin e zanores fundore –ë. Ndër to mund të përmendim:

Tabela 13 Shembuj të gabimeve të përdorimit të shkronjës së madhe

| Si është shkruar | Si duhet shkruar |
|-------------------------|-------------------------|
| deti mesdhe | (deti Mesdhe) |
| dibër | (Dibër) |
| itali | (Itali) |
| Gjergj fishta | (Gjergj Fishta) |
| viti i ri | (Viti i Ri) |
| 7 marsi | (7 Marsi) |
| Ali pashë tepelena | (Ali Pashë Tepelena) |
| lufta e dytë botërore | (Lufta e Dytë Botërore) |

| | |
|-------------------------------|-----------------------------------|
| rilindja kombëtare | Rilindja Kombëtare |
| universiteti i tiranës | Universiteti i Tiranës |
| Rruga e durrësit | Rruga e Durrësit |
| Bulevardi dëshmorët e kombit” | Bulevardi ”Dëshmorët e kombit” |

Këta shembuj tregojnë se rregulla drejtshkrimore e mësipërme shkelet në masë. Duke parë këtë gjendje të lind ideja, se mos vallë ka ardhur koha që rregullat e drejtshkrimit të rishihen, për t’u përshtatur sadopak me prirjet e reja gjuhësore të kohës. Gjithsesi, duke iu përmbajtur rregullave të Kongresit Drejtshkrimor (përmbajtja e të cilit është ende në fuqi), do t’i vlerësojmë përdorimet e mësipërme si anormative.

7. Përdorimi i gabuar ose mospërdorimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve.

Zanorje -ë e patheksuar

Një nga problemet më të mëdha gjuhësore të të rinjve në ditët e sotme është mospërdorimi i ë-së fundore në shumicën e fjalëve që e kanë këtë zanore në përbërje të tyre, ose përdorimi i gabuar i saj. Shkrimi i zanores –ë fundore mbështetet në rregullën fonetike sipas së cilës, kjo zanore përdoret në të gjitha ato raste kur ndodhet një rrokje larg theksit. Në rast të kundërt ë-ja fundore nuk shkruhet (Memushaj R :134). Një rregull tjetër që keqpërdoret në gjuhën shqipe (konkretisht asaj të shkruar) është dhe ajo sipas së cilës ë-ja paratheksore shkruhet në fjalët e prejardhura, të formuara nga një temë me -ë me anë prapashtesash që nisin me bashkëtingëllore, dhe në fjalë të përbëra e të përngjitura që kanë si pjesë të parë një temë të tillë me –ë, të ndjekur nga një temë që nis me bashkëtingëllore (Drejtshkrimi 1973 :42).

Vërehet përpjekja për riprodhimin e plotë në formë të shkruar të formës së folur,

përdoren format: bon (bën), du (dua), mir (mirë), koma (këmba), ene (edhe), konkam (qenkam), pra forma të cilat individ i përdor në të folurit e tij të zakonshëm. Vërehet mospasqyrimi në shkrim i ë-së së patheksuar dhe shkruhen mir e un në vend të mirë dhe unë. Përdorimi i ë-së së patheksuar në shkrim përbën një nga problemet kyçe, edhe në rastin e përcaktimit të normave drejtshkrimore edhe në procesin e zotërimit të normës.

Zanorja ë përdoret gabimisht në shumë raste:

Ë-ja fundore e emrave të gjinisë femërore, e numërorëve dhe e emrave të gjinisë mashkullore që lakohen si emrat e gjinisë femërore, shkruhen gabimisht në 30% të rasteve, si fjalët e tipit: *fjalë, shtatë, djalë*, shkruhen pa ë-në fundore.

Emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me zanore *i* të theksuar shkruhen gabimisht, pa -ë, në gjinore, në dhanore, në kallëzore dhe në rrjedhore. Shkalla e përdorimit të gabuar të këtyre emrave është rreth 20% e nxënësve të përfshirë në studim për këtë çështje (p.sh. *bukuris-ë, vajzëris-ë*).

Do të ndalemi në një rregull tjetër drejtshkrimore, që mund të thuhet se përbën një problem më vete në gjuhën e shtypit. Bëhet fjalë për të ashtuquajturën “rregulla e ë-së mbështetëse”, sipas së cilës: “Shkruhen me -ë (paratheksore) fjalët e prejardhura, që megjithëse formohen nga tema me bashkëtingëllore, kanë një strukturë fonetiko-fjalëformuese të tipit : armëtar, botëror, vallëzim, etj.. (pra, struktura: Fjalë e prejardhura nga një temë -ë me prapashtesa që nisin me bashkëtingëllore, p.sh : *besnikëri, pafajësi, dobësi*, etj...). Ë-ja mbështetëse vendoset në trup të fjalës, për të lehtësuar shqiptimin. Nga gabimet e konstatuara hasëm përdorime të tilla si: *trashgimtar, përfaqsojnë, mjeksi, mjeksor, brendsi, etj..*

Shkrimi i një ë-je të tepërt para prapashtesës -shëm te forma femërore e mbiemrave, si: *e ardhëshme, të përditëshme, të mundëshme*, etj. dhe te disa fjalë të

veçanta, si: *arësye, tepëron, vjetërohet etj.*, është një ndër gabimet e konstatuara. Shumësi i emrave të gjinisë mashkullore që e formojnë shumësin me zanoren –ë, shkruhen pa këtë zanore në 18% të rasteve, si: *punëtor-ë, qytetar-ë etj.* Ndërkohë që, në shkrimin e fjalëve me prejardhje të huaj që kanë grupe zanoresh si *ia* dhe *io* bëhen gabime drejtshkrimore duke vendosur në mes të tyre një bashkëtingëllore, duke e kthyer *i* në *j*, p.sh.: *pejzazh, materjal, mobilje etj.* për *material, mobilie, peizazh etj.*

Si shembuj të disa prej këtyre përdorimeve mund të përmendim:

Tabela 14 Shembuj të gabimeve të përdorimit të shkronjës –ë

| Si është shkruar | Si duhet shkruar |
|------------------|------------------|
| shqipris | (Shqipërisë) |
| gjat | (gjatë) |
| i sinqert | (i sinqertë) |
| dëshir | (dëshirë) |
| an | (anë) |
| kan marr | (kanë marrë) |
| ktë | (këtë) |
| hapsirë | (hapësirë) |
| çelsi | (çelësi) |
| ksaj | (kësaj) |
| qendra | (qendra) |
| bashkpunim | (bashkëpunim) |
| njerzit | (njerëzit) |
| t'vdes | (të vdes) |
| njerzit | (njerëzit) |
| mjeksi | (mjekësi) |

| | |
|------------|---------------|
| përmënd | (përmend) |
| t'bahem | (të bëhem) |
| marrdhenie | (marrëdhënie) |
| ëndërrat | (ëndrrat) |
| i veçant | i veçantë |
| shpi | shtëpi |
| pun | punë |

Bashkëtingëlloret

Gabimet në shkrimin e bashkëtingëlloreve janë të shumta, por më të pakta në krahasim me gabimet e tjera. Ndër përdorimet më të shpeshta të tyre bien në sy:

1. Ngatërimi i shkronjës *r* me shkronjën *rr* është i shpeshtë, sikurse paraqitet në shembujt në vijim: *burë* për *burrë*, *bira* për *birra*, etj. gjithashtu, shkruhen gabimisht me *r*: *rallë*, *resht*, *konkurues*; përkundrazi me *rr*: *rradhë*, *rregjistroj* etj. Gabimet e evidentuara në esetë, detyrat e klasës dhe shënimet e nxënësve paraqesin një situatë aspak të favorshme për gjuhën letrare dhe nivelin gjuhësor të tyre. Shtrohet detyra që gjuha shqipe të jetë lëndë e detyruar edhe në ciklin e lartë dhe duhet punuar më shumë me nxënësit dhe nga nxënësit për të eliminuar ose zvogëluar gabimet drejtshkrimore dhe për të ngritur kulturën e tyre gjuhësore.

2. Mungesa e shkronjës *j* te fjalë si: *ndërgjegja*, *përgjigja*, *idea*.

3. Shkrimi me *j* në vend të *i*-së te format e zgjedhimit të foljes *ndjej*, si: *ndjejnë*, *ndjehem*, *ndjehet* etj.

4. Në disa raste u vërejtën gabime në shkrimin e bashkëtingëlloreve *ç-/sh-/zh-*nistore: *çfaqje*, *shmallem*, *çfarros*, *çduk*, *çvesh*, *çpoj*, etj.

5. Asimilimin e grupeve të bashkëtingëlloreve mb/ nd/ në fjalë të tilla si : maj, (mbaj), mshtjell, (mbështjell), mrrij(mbërrij) marësi (mbarësi), etj..

Gabime të shumta drejtshkrimore u vërejtën edhe në shkrimin e kompozitave, në shkrimin e fjalëve me parashtesa si p.sh. *i pa ditur* (i paditur), *i pa matur* (i pamatur), *jo amtare* (joamtare). Edhe në shkrimin e lidhëzave, të pjesëzave e të pasthirmave, përmerave të pacaktuar, të përngjitur bëhen shumë gabime.

5.2.2 Analizë e çështjeve të normës morfologjike

Norma gramatikore përfshin normën morfologjike dhe atë sintaksore. Norma letrare gramatikore është tërësia e mjeteve dhe e rregullave të përdorimit të drejtë të formave e të kuptimeve të ndryshme gramatikore, e lidhjeve të fjalëve në fjali ose të fjalive në periudha, sipas natyrës ose ligjeve të brendshme të një gjuhe. Norma morfologjike në veçanti përfshin tërësinë e mjeteve dhe rregullave të përdorimit të drejtë të formave e kuptimeve të ndryshme gramatikore. Në shqipen e sotme letrare, pothuajse në të gjitha hallkat e strukturës gramatikore janë vendosur norma unike e të ngulitura. Pavarësisht nga ky fakt i rëndësishëm, ne hasim shmangie të normës morfologjike dhe llojeve të ndryshme, çka do të thotë se ka ende punë për të bërë, në drejtim të ngulitjes së normës letrare të gjuhës shqipe.

Nga hulumtimet e bëra, përta u përket çështjeve morfologjike në esetë e mbledhura nga nxënësit u konstatuan disa gabime, rezultatet e të cilave janë paraqitur në tabelat e mëposhtme :

Tabela 15 Numri i gabimeve sipas çështje të normës morfologjike

| | Çështje të normës morfologjike | Numri i gabimeve | Përqindja |
|---|--|---------------------|-----------|
| 1 | Përdorimi i shumësit të emrave | 30 (tridhjetë) | 34 % |
| 2 | Përdorimi i gabuar i kallëzuesve foljor | 15 (pesëmbëdhjetë) | 17 % |
| 3 | Përdorimi i gabuar i përemrave | 12 (dymbëmbëdhjetë) | 13.6 % |
| 4 | Përdorimi i “nyjave të përparme” | 18 (tetëmbëdhjetë) | 20.4 % |
| 5 | Përdorimi jo i saktë i parafjalëve | 5 (pesë) | 6 % |
| 6 | Përdorimi i trajtës së shkurtër njëjës <i>i</i> ër shumësin <i>u</i> | 8 (tetë) | 9 % |

Përdorimi i shumësit të emrave është një nga problemet më të dallueshme përsa u përket çështjeve morfologjike. Disa nga emrat mashkullorë që e bëjnë shumësin me prapashtesën –ra, me temë të njëjtë me shumësin, ose me ndërrim tingujsh nxënësit përdorin trajta të gabuara të tyre si psh. *një mësues- disa mësuesa, për disa mësues, një student- disa studenta për disa studentë, një polic- disa polica për disa policë, etj..*

Në shumicën e rasteve përdoret gabimisht lidhorja. Kështu, e tashmja e vetës së parë njëjës e lidhores ngatërrohet me të tashmen e vetës së tretë njëjës e anasjelltas, si: *unë të mësoj, ai të punoj* . Po kështu ndodh edhe me një numër të konsiderueshëm nxënësish nga Shqipëria e Veriut, të cilët përdorin paskajoren dhe shpeshherë kjo formë ndërtohet pa mbaresën –uar, p.sh. me punu në vend të, *për të punuar*.

Përdorimi i gabuar i kallëzuesit të përbërë foljor me strukturën folje gjysmëndihmëse *duhet+pjesore*, ndjekur nga një emër a përemër në rasën kallëzore pa parafjalë, pra ndërtimi pësor foljor merr një kundrinë të drejtë. P.sh.: *do ta kërkosh brenda apo do të dalësh jashtë*. E pakryera veprorë e foljeve ndonjëherë

dëgjohej e shkruhej në formë sigmatike (punojsha) në vend të formës josigmatike (punoja); vërehen edhe pjesoret e foljeve pa mbaresa: (kam) *lexu.*, *shku.*, *shkru:etj*; Gabime jo pak të rëndësishme hasen edhe në përdorimin e përemrave pyetës, vetorë apo dëftorë. Shpesh përemri pyetës kush përdoret në vend të përemrit pyetës *cili*, *Ja kush është zgjidhja.* për *Ja cila është zgjidhja.* Apo *shoku jonë për shoku ynë, shoqja tuaj për shoqja juaj, etj.*

Së fundi, u has edhe një grup tjetër shmangiesh që shprehin një prirje të re në gjuhë. Këto shmangie vërehen në disa rrafshë: fonetike, drejtshkrimore ose gramatikore. Të tilla janë: përdorimi i trajtës së shkurtër njëjës *i* për shumësin *u*; mospërdorimi i “nyjave të përparme” ; përdorimi i numërorit *tre* edhe për femëroren *tri*; përdorimi i ndërtimit *lidhore* + *kallëzore* në vend të *lidhore* + *emërore*; përdorimi i parafjalës *pavarësisht* + *dhanore* në vend të lokucionit parafjalor *pavarësisht nga* + *emërore*, etj.

5.2.3 Analizë e çështjeve të normës sintaksore

Gjatë përvojës së punët time kam vërejtur se nxënësit gjatë ligjërimit të folur dhe të shkruar shprehen me fjalë dhe fjali, të cilat nuk janë ndërtuar në mënyrë të saktë dhe nuk kujdesen sa duhet për rendin e gjymtyrëve. Në punimet e tyre shpesh mbizotërojnë fjali shumë të thjeshta me ndërtime jo të rregullta sintaksore. Kështu, gjatë analizës tonë, kemi hasur disa raste të përmbysjes së rendit normal të gjymtyrëve në fjali. Si rregull, në fjalinë dëftore grupi emëror (kryefjala) vendoset para grupit foljor (kallëzuesit) kur shpreh diçka të njohur si prej folësit, ashtu edhe prej dëgjuesit dhe si rrjedhim theksi logjik bie mbi kallëzuesin (Memushaj, R. 2005 :101). Gjithashtu hasim edhe përmbysjen e rendit të zakonshëm të plotësorëve në grupin foljor, ose gabohet në

rendin e përcaktorëve që shoqërojnë emrin, mbiemrin ose përemrin.

Sintaksa përfshin tërësinë e mënyrave të bashkimit në ligjërim të fjalëve të një gjuhe sipas kuptimit e natyrës gramatikore, bashkë me marrëdhëniet e vendosura midis njësive të formuara prej tyre, me rregullat përkatëse, për të shprehur mendimet e për t'ua bërë ato të njohura të tjerëve. (Gramatika 2003 :51). Të shpeshta janë *ndërtimet sintaksore* të gabuara, përdoret një ndërtim në vend të tjetrit, vendosen gjymtyrët në rend të gabuar, përdoret një strukturë e cunguar, përdoren konstrukte të huaja, përdoren gabim shenjat e pikësimit. Këto shembuj dëshmojnë për mosnjohuri të theksuar në shprehjen e në njohjen e përciptë të shqipes. Përdorimi i gabuar i përemrit *që* si: *Ky është shoku që të folat!* në vend të: *Ky është shoku për të cilin të folat!*; *Ta thashë që në klasë!* Në vend të: *Ta thashë kur ishim në klasë!*

Përdorimi i ndërtimeve të huaja në vend të ndërtimeve shqipe është shumë i pranishëm në shumë prej eseve dhe punëve me shkrim që u analizuan. Shpesh përdoren ndërtime të panevojshme, të cilat sigurisht që janë pasojë e mungesës së kulturës gjuhësore të nxënësve dhe që duhen mënjeluar, pasi gjuha shqipe ka mjete për t'i zëvendësuar ato në të gjitha përdorimet e tyre.

Tipare dhe gabime të tjera gramatikore do të ishin: ndikime të sintaksës së huaj në ndërtimin e fjalive dhe të periudhave; përdorimi i panevojshëm i periudhave të gjata e të ndërlikuara, ku pësjtjellohet mendimi deri në moskuptim. Ndikime nga gjuhët e huaja shihen edhe në rendin e fjalëve. Rendi i zakonshëm i shqipes në fjalinë kryesore është kryefjalë-kallëzues, në fjalitë e varura rendi i zakonshëm është kallëzues-kryefjalë.

Ndërkaq, në ditët e sotme nën ndikimin e gjuhëve të huaja rendi i fjalëve kryefjalë-kallëzues po merr përparësi edhe në fjalitë e varura, kryesisht filluese. Në

ligjërimin bisedor, por edhe në atë të lirë, gjithmonë e më shpesh dëgjoen ndërtime si: *siç shokët kanë kërkuar, se sa Miri kishte folur...nuk e dinim, etj*, prirje që shkon deri në një renditje të panatyrshme të fjalëve, si p.sh.: *kur ajo, si të gjithë i thoshim ne, në vend të rendit të zakonshëm: si i thoshnim ne të gjithë*. Gjithashtu është mirë që në vend të shprehjes në sajë të me prejardhje nga turqishtja të përdoret parafjala falë shoqëruar nga një emër në rrjedhore, ose shprehja si pasojë e, me ndihmën e:

- Ata arritën rezultate të larta **në sajë të** punës së tyre të palodhur.
- Ata arritën rezultate të larta **falë** punës së tyre të palodhur.
- Ata arritën rezultate të larta **si pasojë e** punës së tyre të palodhur.(po aty :108)
- Ata punuan shumë **në drejtim të realizimit** të projektit përfundimtar.
- Ata punuan shumë **për realizimin** e projektit përfundimtar.
- **Pavarësisht detyrimeve** që kishte, nuk u tregua korrekt.
- **Pavarësisht nga detyrimet** që kishte, nuk u tregua korrekt.

5.2.4 Analizë e çështjeve të normës leksikore

Norma leksikore e një gjuhe pasqyron realizimin e të gjitha mundësive të sistemit leksiko-semantik dhe përfshin të gjitha fjalët dhe frazeologjitë, si dhe marrëdhëniet kuptimore midis tyre. Norma leksikore ka të bëjë pikërisht me përdorimin e drejtë të fjalëve dhe të frazeologjive sipas kuptimeve në gjuhën letrare. Norma letrare leksikore përfshin në gjirin e saj pothuaj të gjithë fjalët, që i takojnë truallit gjuhësor të shqipes. (Samara M. 2006 :154)

Akademiku. Gj. Shkurtaç flet për shkaqet dhe pasojat e vërshimit të fjalëve të huaja: *”Vrulli për të mësuar sa më shpejt e sa më mirë gjuhët e huaja, sidomos*

anglishten dhe italishten; kujdesi shumë i pakët e ndonjëherë, edhe shpërfillje e gjuhës shqipe letrare.... Pasoja është një vërshim i përshtuar dhe i pafrenueshëm i fjalëve të huaja të panevojshme, shtim i termave të huaj në vend të termave shqip, që përdroreshin normalisht dhe nuk ka pse mënjanohen” (Gj. Shkurtaç, 2003, :77)

Ndërsa prof. E. Lafe vëren: ”Përdorimi i fjalëve të huaja të panevojshme ka qenë kaherë një sëmundje e shtypit. Hapja me botën, marrja e informacionit nga shumë burime të huaja, janë rrethanat objektive që kanë sjellë në leksikun e publicistikës sonë të sotme një numër fjalësh të huaja të panjohura më parë... Ndërkaq kanë hyrë në përdorim një numër fjalësh të huaja që nuk njiheshin fare ose përdroreshin rrallë, si: agravim, axhendë, akses, donacion, draft, ekskluzivitet etj..(E.Lafe, 2000, :18-19).

Sot leksiku i shqipes po i nënshtrohet një zhvillimi shumë të përshpejtuar, dhe jo çdo dukuri në këtë fushë është tregues pozitiv i pasurimit të gjuhës. Përmes mediave hapen dyert për derdhjen e prurjeve të ndryshme tek lexuesit e shikuesit dhe këto prurje të ”pafiltruara”, sidomos nga gjuhët huaja, në shumë shkrime të gazetave tona, e kanë shpërfytyruar shqipen në shkallë shqetësuese. Shpesh vetëm lidhëzat janë shqipe, psh: ”licensimi i produkteve inovuese”, “receptimi i objektivitetit aktual dhe perspektiv”... Mesa shihet problemi i dyndjes së fjalëve të huaja është i pranishëm, jo vetëm për shqipen brenda kufijve tanë, por edhe jashtë tyre.

1. Përdorimi i fjalëve të huaja në vend të fjalës shqipe

Ajo që vihet re më së shumti në analizën e studimit tonë është tendenca e nxënësve të shkollave të mesme për të përdorur fjalët e huaja gjatë ligjërimit të folur, por me këtë mënyrë përdorimi dhe ritmi të përhapjes së tyre, ato nuk do të mund t’i dallojë më nga fjalët e shqipes standarde. Përveç të dhënave të mbledhura nga pyetësorët, gjatë analizë

së esëve rezultuan edhe disa fjalë të huaja, të cilat janë bërë pjesë e shkrimeve të tyre në shkollë.

Tabela 16 Numri i gabimeve sipas çështjeve të normës sintaksore dhe leksikore

| | Çështje të normës sintaksore dhe leksikore | Numri i gabimeve | Përqindja |
|----------|--|-------------------------|------------------|
| 1 | Ndërtimet sintaksore të gabuara | 18 (tetëmbëdhjetë) | 17.3 % |
| 2 | Përdorimi i ndërtimeve të huaja në vend të ndërtimeve shqipe | 15 (pesëmbëdhjetë) | 14.4 % |
| 3 | Rendin e fjalëve në fjali | 16 (gjashtëmbëdhjetë) | 15.4% |
| 4 | Përdorimi i huazimeve dhe fjalëve të huaja | 30 (tridhjetë) | 28.9 % |
| 5 | Shkurtime të fjalëve | 25 (njëzet e pesë) | 24% |

Ajo që të bën më tepër përshtypje, është tendenca e tyre në rritje, me gjithë ndërgjegjësimin e nxënësve se ato nuk duhen përdorur, pasi ata e shkatërrojnë gjuhën standarde shqipe. Por , ata shpesh e shohin këtë gjë si një mënyrë të shpejtë komunikimi dhe lidhjeje me botën e madhe globale.

Në anën tjetër, vlen të theksohet se kjo formë e komunikimit është e ndikuar mjaft nga anglishtja. Ndryshimi i kodit është dukuri që haset shpesh, sidomos kalimi nga shqipja në anglisht, ose ndonjë gjuhë tjetër (gjermanisht, italisht etj.). Ndikimi i anglishtes është mjaft i dendur, sidomos përmes disa formave gjuhësore të ngurta e shkurtesave, të cilat kanë përdorim tipik në chat dhe në mesenxherë, pra janë pjesë e stilit të komunikimit të këtij mediumi. Këtu po përmendim disa njësi, të cilat janë futur nga anglishtja, sikur edhe në shumë gjuhë të tjera, edhe në shqipe: ok (në rregull, mirë), np (no problem – s’ka problem), brb (be right back- kthehem menjëherë), lol (laughing out loud - qesh me të madhe), yeah (yes- po), whazz up (whats up - ç’kemi), u (you - ti), u 2 (you too - ti gjithashtu), 4 u (for you- për ty) etj.

Përsa i përket analizës sonë, kjo dukuri, veçanërisht vihet re tek esetë që kanë të bëjmë me temën e teknologjisë dhe komunikimit virtual. Ndër fjalët më të përdorura mund të përmendim:

Tabela 17 Shembuj të përdorimit të fjalëve të huaja në vend të fjalës shqipe.

| Fjala e huaj | Kuptimi në shqip |
|---------------------|-------------------------|
| miksim | (përzierje) |
| spirituale | (shpirtërore) |
| kofidencë | (vetëbesim) |
| live | (drejtpërdrejt) |
| Website | (rrjet) |
| aplikacion | (program) |
| oportunitet | (mundësi) |
| smog | (tym) |

| | |
|-----------|---------------|
| Wireles | (valë) |
| party | (festë) |
| like | (pëlqej) |
| dedikoj | (përkushtoj) |
| fans | (adhurues) |
| evitoj | (shmang) |
| look | (pamje) |
| inspirim | (frymëzim) |
| s'ka sens | (s'ka kuptim) |
| violencë | dhunë |
| dominon | (mbizotëron) |
| aludoj | (hamendësoj) |
| kreativ | (krijues) |
| suportoj | (mbështes) |
| dawlodoj | (shkarkoj) |
| ciao | (mirupafshim) |
| Ok | (mirë) |
| Parti | (festë) |
| Share | (ndaj) |

2. Shkurtime e fjalëve

Shumica e shkurtesave që nxënësit kishin përdorur në esetë dhe punët e tyre me shkrim ishin pak të vështira për t'u kuptuar, ose mund t'i kuptoje vetëm duke u bazuar në kontekstin e fjalive, ose nga përmbajtja e esesë. Shkurtesat më të shpeshta që u përdorën janë; pc (kompjuter), net(internet) Fb(facebook) dhe këto shkurtesat janë të

lidhura me temat e eseve. Prandaj, lidhur me këto shkurtesa nuk mund të themi se shihen si tipike të teksteve të mesazheve. Megjithatë, ato janë gjetur shpesh në tekstet e mesazheve.

Duke u bazuar edhe në shembujt e dhënë më poshtë, unë mendoj se këto tekste të mesazheve e kanë ndryshuar qëndrimin e njerëzve ndaj gjuhës së shkruar, duke parë se si nxënësit shkurtojnë fjalët që janë zakonisht pjesë e teksteve të mesazheve si. Flm (për faleminderit), Klm (për kalofsh mirë), por që nuk janë pjesë e standardit të shqipes. Më poshtë po japim disa modele të shkurtimeve në gjuhën shqipe, të cilat përdoren gjerësisht në gjuhën e folur dhe dalëngadalë po bëhen pjesë e shkrimeve standarde. Pra, janë disa shkurtesa, të cilat nuk janë pjesë e standardit të shqipes, por thjesht kanë gjetur përdorim në të folurit e përditshëm:

Tabela 18 Shembuj të përdorimit të shkurtesave në vend të fjalës së plotë.

| Shkurtime në shqip | Kuptimi i fjalës |
|--------------------|---------------------|
| flm | (faleminderit) |
| Nsr | (nesër) |
| nk | nk |
| tdf | (të dua fort) |
| shm | (shumë mirë) |
| nkr | (nuk ka rëndësi) |
| tkshxh | (të kam shumë xhan) |
| Prz | (për zotin) |
| Net | internet |
| d.sh | detyrë shtëpie |
| mat | matematikë |

Por, ato mund të zëvendësohen edhe me bashkërendime shkronjash e numrash si, zëvendësimi i fjalës (numrit, nyjës) një-ni me numrin 1, p.sh.

| Si është shkruar | Si duhet shkruar |
|-------------------------|-------------------------|
| 1 her | (një herë) |
| k2 | (këtu) |
| çk3 | (çfarë ka të re) |
| ndo1 | (ndonjë) |
| as1 | (asnjë) |
| vër8 | (vërtet) |
| 3gim | (tregim) |
| 2shim | (dyshim) |

Gjithashtu, po japim disa modele të shkurtimeve në anglisht, të cilat kanë tendenca për t'u përdorur:

Tabela 19 Shembuj të përdorimit të shkurtimeve të huaja në vend të fjalës shqipe.

| Shkurtesat e huaja | Kuptimi i fjalës |
|---------------------------|-------------------------|
| U2 => (you too) | (gjithashu) |
| 4u => (for you) | (për ty) |
| ok => (okay) | (mirë) |
| x => (for) | (për) |
| L8 => (late) | (vonë) |
| ok => (okay) | (mirë) |
| Bbl => (be back later) | (Vij më vonë) |
| Cu => (see you,) | (shihemi) |

| | |
|-----------------------------------|------------------------|
| Bf => (best friends) | (miku më i mirë) |
| Np => (no problem) | (s'ka problem) |
| Hru => (how are you) | (si je) |
| Ily => (I love you) | (të dua) |
| Cee 2cu => (cant wait to see you) | (nuk pres të të shoh) |
| Atm => (at the moment) | (për momenti) |
| Brb => (be right back) | (kthehem menjëherë) |
| Cu => (see you,) | shihemi |
| baby | e dashur |

Me gjithë gabimet e lartpërmendura, pjesa më e madhe e nxënësve i kanë përvetësuar njohuritë gjuhësore. Ata shkruajnë në mënyrë të kënaqshme në gjuhën letrare. Duhet theksuar se ata bëjnë më tepër gabime gramatikore në të folur sesa në të shkruar. Kjo mund të shpjegohet nëpërmjet faktorëve që kushtëzojnë ligjërimin verbal dhe ndikimi i të folmes joformale. Pra, dukuri e përgjithshme është se nxënësit përpiqen t'i zotërojnë dhe t'i zbatojnë njohuritë për normën drejtshkrimore.

5.3 Gjetjet nga hipotezat dhe pyetjet kërkimore dhe diskutimi

Duke u nisur nga qëllimi dhe objektivat kryesore të këtij studimi, sipas analizës statistikore, rezultatet e hipotezave dhe pyetjeve kërkimore janë paraqitur si më poshtë:

5.3.1 Rezultatet e hipotezave dhe pyetjeve kërkimore

H 1: *Nxënësit e shkollave të mesme e përdorin gjuhën e mesazheve telefonike dhe të chat-it në punët e tyre me shkrim në shkollë duke mos u kujdesur për përdorimin e shqipes standarde.*

Hipoteza bazë mbi të cilën ngrihet ky studim është hipoteza mbi ndikimin e komunikimit elektronik me SMS dhe Chat në standardin e gjuhës shqipe të shkruar.

Për të analizuar këtë hipotezë dhe për të treguar varësinë e përdorimit të shkurtesave standarde të gjuhës shqipe në komunikimin e përgjithshëm dhe atë elektronik në veçanti i referohemi testit të pavarësisë Chi Square. Testi i pavarësisë Chi Square përdoret për të testuar nëse dy variabla cilësore janë të pavarur apo jo nga njëra-tjetra. Një vlerë e vogël e Chi Square tregon se hipoteza zero (që variablat janë të pavarur), nuk pranohet dhe se dy variablat janë të varur nga njëra-tjetra. Procedura përfshin krahasimin e frekuencave të vrojtuar të qelizave me frekuencat e pritura. Frekuencat e vrojtuar të qelizave janë vlerat aktuale që u takojnë qelizave përkatëse dhe frekuencat e pritura janë vlerat që priteshin të ishin në këto qeliza nëse midis këtyre dy variablave cilësore nuk do të kishte asnjë marrëdhënie (lidhje). Thelbi i këtij testi është diferenca midis frekuencave të vrojtuar dhe atyre të pritura në secilën prej qelizave të tabelës. Ndërkohë që vlerat e frekuencave të vrojtuar merren drejtpërdrejt nga të dhënat, frekuencat e pritura llogariten duke shumëzuar totalin e rreshtit me totalin e kolonës dhe duke e pjesëtuar me totalin e përgjithshëm.

Teknika që përdoret në këtë rast, është Testi i Pavarësisë Chi Square, i cili përdoret kryesisht për të dhënat cilësore ashtu sikurse janë edhe variablat tona. Testi Chi Square (χ^2) është një nga metodat më të përhapura për testimin e hipotezave për të dhënat cilësore. Ashtu siç edhe ne e dimë, analiza e të dhënave cilësore është shumë e

rëndësishme. Të vetmet statistika përmbledhëse për këtë lloj të dhënash janë frekuenca dhe përqindja. Tabelat e testit Chi Square janë pikërisht të përshatshme për këto lloje të dhënash. Koeficienti të cilit ne i referohemi, është *Koeficienti Pearson Chi Square*. Supozimi ynë është që të dy variablat janë të pavarur nga njëra-tjetra dhe kjo hipotezë hidhet poshtë nëse vlera e koeficientit Chi Square, e cila shprehet nëpërmjet Asymp.Sig. (2-sided) është më e vogël se $p=0.05$ (5%), duke ditur se kemi marrë një interval besueshmërie 95%.

Në rastin e variablave tona vlera e Asymp.Sig. (2-sided) e koeficientit Pearson Chi Square është $0.014 > 0.05$ (Tabela 7 në ANEKS), *gjë që tregon se komunikimi elektronik dhe përdorimi i standardit në gjuhën shqipe janë variabla që varen nga njëra-tjetra ose thënë ndryshe; nxënësit e përdorin gjithnjë e më shumë komunikimin elektronik me sms, chat etj, dhe ata shpeshherë nuk tregojnë vëmendje në përdorimin e standardit të gjuhës shqipe*. Kjo lidhet me faktet dhe të dhënat e nxjerra nga pyetësorët, ku nxënësit i njihnin shumë pak shkurtesat standarde të gjuhës shqipe, ose nuk arrinin t'i dallonin ato nga shkurtesat jostandarde që mund të përdornin gjatë punës së tyre.

Pyetja kërkimore 1: *A ndikon stili i komunikimit me SMS dhe Chat në standardin e gjuhës shqipe të shkruar?*

Pra, ajo që do të analizojmë është fakti se a varet përdorimi i standardit të gjuhës shqipe nga stili i komunikimit të këtyre nxënësve me SMS dhe Chat? Për të marrë përgjigjen e kësaj pyetjeje kërkimore sigurisht iu drejtuam Testit të pavarësisë Chi Square. Në këtë rast vlera e Asymp. Sig. (2-sided) e koeficientit Pearson është $0.04 < p=0.05$ që tregon se këto dy variabla janë të varura statistikisht. Pra, stili i

komunikimit elektronik ndikon në standardin e shqipes së shkruar (Tabela 9 në ANEKS).

H2. *Nxënësit nuk i njohin shkurtesat e shqipes së shkruar.*

Sipas rezultateve që morëm nga tabela e përdorimit të shkurtesave jostandarde të gjuhës shqipe na rezultoi se të rinjtë ndikohen shumë nga shkrimi elektronik dhe mënyra sesi komunikojnë me njëri-tjetrin në sitet e ndryshme, ndaj edhe njohja e këtyre shkurtesave jostandarde apo reflektimi i një pjese të tyre edhe në punët me shkrim, e nxjerrin në pah këtë ndikim. Gjatë komunikimit elektronik ata duhet të përgjigjen shpejt dhe sa më shkurt dhe për këtë arsye fjalitë e tyre nuk janë gramatikusht të sakta.

Komunikimi i shpejtë dhe komod është shumë i rëndësishëm në këto raste dhe vetëm një shkrim i shpejt dhe i pakontrolluar mund të arrijë të plotësojë funksionin kryesor të komunikimit elektronik. Nga ana tjetër, kur komunikojmë me mesazhe shpeshherë përdorimi i shkurtimeve të tilla është i domosdoshëm, pasi të krijon mundësinë të kursesh sa më shumë karaktere, gjë që ndikon edhe në kohë edhe në buxhet. Të gjitha këto, nëse përsëriten disa herë brenda ditës, kthehen në një rutinë dhe nxënësit shpeshherë e kanë të vështirë të bëjnë ndryshimin mes një shkrimi formal dhe atij joformal gjatë një komunikimi.

Mjafton të shohim shkurtime fjalësh të tilla si; Sps (sepse), Klm (kalofsh mirë), Vër8 (vërtet), 3gim (tregim), të cilat njihen nga një përqindje e konsiderueshme nxënësish, rreth 80%, dhe mund të themi që është e vështirë t'i ndash ato nga shkurtesat standarde të gjuhës shqipe. Po kështu, një përdorim mjaft i madh na rezulton edhe në shkurtesa të tjera si; Zmr (zemër), Tlt (të lutem), Tkxh (të kam xhan) apo Tung (tungjatjeta). Ajo që të bie në sy gjatë këtij studimi është fakti se, megjithëse nxënësit

kanë një njohje shumë të madhe të shkurtesave jostandarde, përsëri përqindja e përdorimit të tyre në punët me shkrim dhe detyrat e dhëna në standard nuk është shumë e madhe. Kjo tregon ndërgjegjësimin e nxënësve se duhet të respektojnë rregullat e shqipes standarde, me gjithë vështirësitë e përmendura më lart. Ndërkohë, e kundërta ndodh me shkurtesat që janë në normën e gjuhës shqipe, ato njihen shumë pak nga nxënësit e përfshirë në studimin tonë.

Përveç shkurtesave si; p.sh (për shembull) dhe etj. (e të tjerë), që kanë një njohje dhe përdorim shumë të gjerë, rreth 90%, pjesa tjetër e shkurtesave të përfshira në pyetësor njihen dhe përdoren më pak nga nxënësit. Madje, ata shpesh nuk mund të dallojnë nëse janë në normën e shqipes standarde apo jo. Kjo mund të shpjegohet edhe me faktin se një pjesë e tyre vijnë edhe nga fusha të caktuara që janë më specifike dhe për pasojë edhe njohja e tyre nuk është shumë e madhe.

Shkurtesat që duket se janë relativisht më të përdorura në tekstet e mesazheve (gjithashtu edhe në gjuhën e folur) ishin po ato që u interpretuan nga shumica e pjesëmarrësve në anketim. Shkurtesat të cilat përdoren më pak në tekstet e mesazheve, patën një nivel më të ulët njohjeje dhe përdorimi dhe me siguri kanë krijuar edhe keqkuptime në shumë raste, nëse ato përdoren dhe janë pjesë e gjuhës shqipe apo jo. Shkurtesat standarde nuk u kuptuan sipas shpjegimit të tyre në normën standarde, gjë që na tregon se të rinjtë e sotëm nuk i kuptojnë dhe nuk i përdorin disa prej këtyre shkurtesave standarde.

Në rastet kur të anketuarit e merrnin me mend se çfarë mund të nënkuptojë shkurtesa e dhënë (dhe ata e treguan këtë duke nënvizuar në kutinë përkatëse në pyetësor), interpretimi i tyre mund të shpërfilllet. Megjithatë, në rastet kur ata treguan një kuptim të caktuar, interpretimi i tyre ofron një pasqyrë të përgjithshme për mënyrën

e komunikimit në të folur dhe në të shkruar dhe njohuritë gjuhësore që kanë nxënësit tanë, si dhe aftësitë e tyre për të interpretuar shkurtesat e dhëna në pyetësor .

Pyetjet që u përfshinë në fund të pyetësorit na treguan se edhe pse ata dërgonin disa qindra mesazhe me tekst në ditë, nuk është se ndikoheshin aq shumë nga shkurtimeve e teksteve të këtyre mesazheve, të cilët i interpretojnë shkurtesat sipas asaj që është pranuar zakonisht brenda gjuhës së mesazheve (Crystal 2008). Rezultatet e tyre ishin pothuajse të njëjlojta me ato të cilët dërgonin më pak mesazhe gjatë ditës.

Lidhur me pyetjen: *A i respektoni apo jo rregullat standarde të shqipes së shkruar në punët me shkrim në shkollë?* Pjesa më e madhe e nxënësve janë përgjigjur se i respektojnë ato dhe janë korrekt në zbatimin e tyre gjatë punës së tyre në shkollë. Këtu vlen për t'u theksuar fakti se, me gjithë dëshirën e mirë për të qenë korrekt ndaj kësaj pjese, ata përsëri e kanë të vështirë të shmangin gabimet drejtshkrimore dhe përdorimin e shkurtesave dhe fjalëve të huaja. Këto fakte janë më të evidentueshme në analizën e bërë në esetë e tyre dhe punët me shkrim.

Edhe në këtë rast i referohemi përgjigjeve të tyre për njohjen ose jo të kuptimit të shkurtesave standarde të gjuhës shqipe dhe përdorimit të tyre në komunikimin elektronik të përditshëm nëpërmjet analizës së testit të pavarësisë Chi Square. Kështu duke iu referuar të dhënave të Koeficientit Pearson Chi Square (Tabela 8 në ANEKS) shohim se vlera e Asymp. Sig. (2-sided) =0.072, pra më e madhe nga vlera $p=0.05$ duke na lejuar të themi se këto variabla, pra njohja e kuptimit të këtyre shkurtesave standarde të gjuhës shqipe dhe përdorimi në komunikim nuk varen nga njëri-tjetri.

Pyetja kërkimore 2: *A i përdorin nxënësit shkurtesat e reja të formuara pa bazë në standardin e shqipes?*

Duke iu referuar të dhënave të Tabelës 10 në ANEKS, e cila tregon vlerën e koeficientit Pearson në testin e pavarësisë Chi Square vihet re se vlera e tij është Asymp. Sig. (2-sided) = 0.034 < 0.05. Kjo tregon se futja e shkurtesave të reja në komunikimin e përgjithshëm dhe kryesisht atë elektronik dhe përdorimi i tyre janë variabla statistikisht të varur midis tyre, ashtu sikurse edhe pritej pasi “shpikja” e këtyre shkurtesave të reja jostandarde ka gjetur gjithashtu një përdorim të gjerë, përfshirë edhe faktin se një pjesë e këtyre fjalëve të shkurtuara janë më të përdorshme gjatë komunikimit të përditshëm të tyre. Ndoshta këto shkurtesa të reja kanë dalë si domosdoshmëri e këtij lloji komunikimi elektronik si një ndër komunikimet më të shpejta gjithashtu.

H 3 *Shkurtesat e fjalëve në gjuhë të huaj janë bërë pjesë e kulturës gjuhësore të nxënësve.*

Për të parë nëse përdorimi i shkurtimeve të fjalëve në gjuhë të huaj dhe kultura gjuhësore e komunikimit varen apo jo nga njëra-tjetra përsëri përdorim Testin Chi Square. Vlera e koeficientit Pearson tregon se Asymp. Sig. (2-sided) = 0.627 (Tabela 11 në ANEKS) shumë më e madhe se $p=0.05$. Kjo tregon se pavarësisht se ata mund t'i përdorin ndonjëherë, ato ende nuk janë plotësisht pjesë e kulturës gjuhësore të tyre.

Nga analiza e fakteve dhe të dhënave, iu kushtua rëndësi edhe dallimeve që ekzistojnë midis nxënësve të shkollave të marra në studim, si dhe nxënësve sipas niveleve të studimit. Rezultatet u paraqitën mbi bazën e këtyre pyetjeve:

Pyetja kërkimore 3.1: *A ka dallime dallime midis nxënësve të shkollave të ndryshme lidhur me njohjen e shkurtesave standarde në gjuhën shqipe? Nëse po, nga cilët nxënës njohen ato më shumë?*

Për të marrë përgjigjen e saktë të kësaj pyetjeje do përdorim *analizën ANOVA* e cila është analiza e variancës dhe përdoret për të treguar nëse ka dallime midis vlerës mesatare të këtyre grupeve në lidhje me vlerësimin e njohjes së shkurtesave standarde të gjuhës shqipe. Analiza ANOVA përdor koeficientin e Fisherit ose siç njihet ndryshe (Statistika F), i cili teston nëse mesataret e grupeve, të formuara nga një variabël e pavarur apo nga një kombinim i tyre, kanë diferenca të rëndësishme. Ajo bazohet në krahasimin e variancave të llogaritura – ku njëra paraqet variancën brenda grupeve, dhe tjetra variancën midis grupeve.

Nëse këto dy varianca nuk kanë ndonjë dallim të rëndësishëm, atëherë ne mund të themi se mesataret e gjithë grupeve që kemi marrë nga i njëjti kampion nuk kanë dallime të rëndësishme. Nëse mesataret e grupeve kanë diferenca të mëdha, për shkak të gabimeve të rastit, nuk ka arsye për të besuar se ato janë zgjedhur nga kampione të ndryshme. Statistika $-F$ llogaritet si raport i variancës midis grupeve me variancën e gabimit.

$$F = \text{Varianca midis grupeve} / \text{variancën e gabimit}$$

Fillimisht shohim statistikën e leven test për të parë homogjenitetin e tyre. Kështu të dhënat e Tabelës 13 në ANEKS tregojnë se vlera e Sig.=0.001<0.05 gjë që tregon se grupet nuk janë homogjene midis tyre edhe pse me diferenca shumë të vogla midis tyre. Gjithashtu ky fakt vërehet edhe nga vlerat përkatëse të devijimeve standarde të tyre ku $DS_{sh.periferi} = 0.436$, $DS_{sh.qytet} = 0.432$ dhe $DS_{sh.profesionale} = 0.476$.

Por sipas analizës ANOVA për $F(2:897)=2.013$ vlera e $\text{Sig.}=0.134>0.05$ gjë që tregon se midis këtyre grupeve të nxënësve nuk ka dallime të rëndësishme statistikore lidhur me njohjen e shkurtesave standarde të gjuhës shqipe, pra nxënësit e këtyre shkollave nuk ndryshojnë aq shumë nga njëri –tjetri në këtë drejtim, apo thënë ndryshe njohuritë e tyre për standardet e gjuhës shqipe janë pothuaj të njëjta (Tabela 14 në ANEKS). Ky fakt konfirmohet gjithashtu edhe nga procedura Tukey, e cila tregon se vlerat përkatëse të Sig. (të domethënies statistikore) midis grupeve janë të gjitha më të mëdha se 5%, duke treguar se midis grupeve në krahasimet në çift midis tyre nuk ka dallime lidhur me njohjen e shkurtesave standarde të gjuhës shqipe (Tabela 15 në ANEKS). Madje edhe vlerësimet mesatare sipas këtyre shkollave janë pothuaj të barabarta (Tabela 16 në ANEKS).

Pyetja kërkimore 3.2: *A vërehen dallime lidhur me përdorimin e shkurtesave standarde në gjuhën shqipe në nivel të nxënësve (klasave). Nëse po, cilët nxënës i përdorin ato më shumë nxënësit e klasave më të ulëta apo ata të klasave më të larta?*

Analizën e kësaj pyetjeje kërkimore për të dy pjesët e saj do e realizojmë sërish nëpërmjet analizës ANOVA. Fillimisht shohim testin e homogjenitetit ku sipas të dhënave të Tabelës 18 në ANEKS kemi se vlera e $\text{Sig.}=0.002<0.005$ gjë që tregon se grupet nuk janë homogjene midis tyre. Ndërkohë që sipas analizës ANOVA kemi që vlera e domethënies statistikore $\text{Sig.}(\text{midis grupeve})=0.257$, (Tabela 19 në ANEKS), pra shumë më e madhe nga 0.05 gjë që na lejon të arrijmë në përfundimin se midis këtyre grupeve të nxënësve të ndarë sipas klasave nuk ka dallime statistikisht të rëndësishme lidhur me përdorimin e shkurtesave standarde të gjuhës shqipe. Këtë fakt e konfirmon gjithashtu edhe *Proceduar Tukey* dhe *testi Post Hoc* nga i cili vihet re se vlerat e Sig. në krahasimet e secilit grup me njëri –tjetrin janë të gjitha më të mëdha se 5% (Tabela 20

në ANEKS). Gjithashtu duke iu referuar të dhënave për mesataret e këtij vlerësimi për nxënësit e secilës klasë, respektivisht nxënësit e klasave të X, XI, dhe XII shohim se vlerësimi mesatar i tyre është pothuajse i njëjtë (Tabela 21 në ANEKS).

Pyetja kërkimore 3.3: *A vërehen dallime në përdorimin e shkurtesave jostandarde në gjuhën e huaj midis nxënësve të klasave të ndryshme? Nëse po, ku janë më të përdorshme këto shkurtesa?*

Analiza ANOVA edhe në këtë rast na tregon se pavarësisht se sipas statistikave të *Levene Test* grupet janë homogjene midis tyre pasi vlera e Sig. $0.061 > 0.05$ (Tabela 22 në ANEKS), sipas kësaj analize për $F(2;487)=0.982$ (Tabela 22 në ANEKS), kemi se vlera e Sig= 0.375 një vlerë kjo shumë më e madhe se 0.05 duke na lejuar të themi se midis klasave X, XI dhe XII lidhur me përdorimin e shkurtesave jostandarde në gjuhën e huaj nuk ka dallime të rëndësishme midis tyre. Pra, të gjithë nxënësit pavarësisht nga klasa ku studiojnë, i përdorur pothuaj njëjloj këto shkurtesa jostandarde të gjuhës së huaj duke nënkuptuar kështu faktin se këto shkurtesa që shihen dhe lexohen kudo edhe në rrjetet sociale tashmë janë bërë tepër familjare nga të gjithë nxënësit e shkollave të mesme. Kjo konfirmohet edhe nga fakti se të gjitha vlerat e Sig., edhe në këtë rast në krahasimet midis klasave kanë vlera tepër të larta krahasuar me kufirin $p=0.05$ (Tabela 23 në ANEKS).

Madje duke e vazhduar më tej këtë përfundim i referohemi gjithashtu edhe vlerave mesatare të këtij vlerësimi, të cilat për të tre klasat janë pothuajse të njëjta (Tabela 24 në ANEKS).

H 4 *Përdorimi i fjalëve të huaja gjatë komunikimi elektronik ka ndikuar në devijimin nga drejtshkrimi i gjuhës standarde.*

Për ta vërtetuar nëse kjo hipotezë është e vërtetë apo jo i referohemi vlerave të testit Chi Square, të cilat na tregojnë se vlera e Asymp. Sig. (2-sided) = 0.682 > 0.05. Pra, kjo na lejon të pohojmë se komunikimi elektronik nëpërmjet përdorimit të fjalëve të huaja nuk e pengon drejtshkrimin sipas rregullave standarde (Tabela 12 në ANEKS

Pyetja kërkimore 4: *A ka dallime midis nxënësve të shkollave të qytetit dhe atyre në periferi lidhur me përdorimin e fjalëve të huaja? Nëse po, kush i përdor ato më shumë nxënësit e shkollave të qytetit apo ata të shkollave në periferi?*

Për të marrë përgjigjen e saktë i referohemi Testit t për zgjedhjet e pavaruara midis dy grupeve të nxënësve, atyre që studiojnë në shkollat e qytetit (qytet dhe profesionale) dhe shkollave që gjenden në zonat periferike të Tiranës. Fillimisht kryhet testi i homogjenitetit të këtyre dy grupeve sa i takon njohjes dhe përdorimit të fjalëve të huaja dhe më pas i drejtohem testit të krahasimit të mesatareve të tyre. Kështu, sipas statistikave të *Levene Test* kemi se Sig.=0.296 > 0.05, duke treguar se grupet janë homogjene midis tyre.

Tani i drejtohem testit të krahasimit të mesatareve duke iu referuar faktit të homogjenitetit të këtyre dy grupeve lidhur me vlerësimin e përdorimit të fjalëve të huaja, Kështu sipas këtij testi për t(-0.514) dhe shkallë lirie df=546 kemi se Sig. (2-tailed)=0.607 > 0.05 gjë që na lejon të themi se nuk ka dallime statistikisht domethënëse në përdorimin e fjalëve të huaja nga nxënësit e këtyre grupeve, pra përdorimi i tyre, si për nxënësit e shkollave të qytetit ashtu edhe për ata të shkollave periferike, përdorimi i këtyre fjalëve të huaja të përzgjedhura në pyetësor është i njëjtë, pra pothuaj në të njëjtin nivel, kjo edhe për faktin se fjalori i komunikimit mbetet pothuaj i njëjtë për të gjithë

nxënësit (Tabela 17 në ANEKS). Kjo konfirmohet gjithashtu edhe nga vlerësimet mesatare të këtyre dy grupeve të nxënësve të cilat janë pothuajse të barabarta.

Kështu $M_{sh.periferi}=4.25$ dhe $M_{sh.qyteti}=4.27$.

5.3.2 Verifikimi i hipotezave

Lidhur me verifikimin e hipotezave të ngritura në këtë studim, në bazë të gjetjeve të pyëtësorëve, eseve, hipotezave dhe pyetjeve kërkimore, kemi arritur në përfundimin se:

H.1 Për verifikimin e *Hipotezës H.1*, siç u pa edhe më lart, komunikimi elektronik dhe përdorimi i standardit në gjuhën shqipe janë variabla që varen nga njëra-tjetra dhe për pasojë hipoteza se nxënësit e shkollave të mesme e përdorin gjuhën e mesazheve telefonike dhe të chat-it në punët e tyre me shkrim në shkollë duke mos u kujdesur për përdorimin e shqipes standarde është e qëndrueshme. Këtë gjë e konfirmon edhe fakti se stili i komunikimit elektronik ndikon në standardin e shqipes së shkruar, vërtetuar kjo në bazë të të dhënave dhe rezultateve të pyetjes kërkimore 1 dhe eseve të analizuara më sipër.

Pra, Nxënësit e shkollave të mesme e përdorin gjuhën e mesazheve telefonike dhe të chat-it në punët e tyre me shkrim në shkollë duke mos u kujdesur për përdorimin e shqipes standarde.

H.2. Rezultatet për *Hipotezën H.2* tregojnë se variablat, njohja e kuptimit shkurtesave standarde të gjuhës shqipe dhe përdorimi në komunikim nuk varen nga njëri-tjetri, rrjedhimisht hipoteza e dytë është e qëndrueshme. *Pra, përgjithësisht mund të pohojmë se nxënësit nuk i njohin plotësisht shkurtesat standarde të gjuhës shqipe, duke konfirmuar kështu edhe hipoteza e dytë se nxënësit nuk i njohin shkurtesat e shqipes së shkruar.*

H.3 Në *Hipotezën e tretë, H.3*, përdorimi i shkurtesave të fjalëve në gjuhë të huaj dhe kultura gjuhësore e nxënësve nuk varen nga njëra-tjetra. *Pra, hipoteza e tretë se shkurtesat e fjalëve në gjuhë të huaj janë bërë pjesë e kulturës gjuhësore të nxënësve nuk është vërtetuar.* Kjo ndoshta ndodh edhe për faktin se fjalori i komunikimit të tyre nuk i përfshin shumicën e këtyre shkurtimeve të fjalëve të huaja, ose një pjesë e tyre kanë ende mangësi në përdorimin e gjuhës së huaj.

H.4. Dhe së fundi, për verifikimin e *Hipotezës H.4* rezultatet e vlerës Asymp. Sig. (2-sided) = 0.682 > 0.05 tregojnë se komunikimi elektronik nëpërmjet përdorimit të fjalëve të huaja nuk e pengon drejtshkrimin sipas rregullave standarde, rrjedhimisht hipoteza se përdorimi i fjalëve të huaja gjatë komunikimi elektronik ka ndikuar në devijimin nga drejtshkrimi i gjuhës standarde nuk u konfirmua.

Pra, hipoteza se: Përdorimi i fjalëve të huaja gjatë komunikimit elektronik ka ndikuar në devijimin nga drejtshkrimi i gjuhës standarde, nuk rezultoi e qëndrueshme. Nxënësit tanë në përgjithësi arrijnë që të shmangin përdorimin e fjalëve të huaja nga esetë apo punët e tyre me shkrim duke iu referuar rregullave standarde të gjuhës, por është një fenomen që duhet studiuar në vazhdimësi, pasi tendenca e përdorimit të tyre në gjuhën e folur është në rritje.

KAPITULLI VI PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

6.1 Përfundime

Nga vëzhgimet e bëra gjatë punës tonë mbi komunikimin në internet dhe mënyrën e ligjërimit të të folurit formal dhe joformal na rezultoi se kjo mënyrë komunikimi është shumë e përhapur në ditët e sotme, është bërë pjesë e ligjërimit dhe stilit të gjithsecilit prej nesh. Gjuha shërben për të formësuar dhe komunikuar mendimet, duke përdorur një sistem mjetesesh (tinguj, morfema, fjalë, trajta) dhe rregullash për vargëzimin e tyre (për ndërtimin e fjalëve, togfjalëshave e fjalive) (Long, D. 1996, f. 118). Ndërthurja e tyre në përputhje me pasqyrimin e realitetit, me vijueshmërinë logjike, me synimet e folësit në rrethanat e komunikimit, rezulton në një bashkëbisedim të suksesshëm. Pavarësisht nga qëllimi i komunikimit (si shprehja e ndjenjave dhe e botës së brendshme, ndikimit mbi të tjerët, veprimi në shoqëri, etj.), gjuha nuk i nënshtrohet një ndryshimi rrënjësor, por i shfrytëzon më tej mundësitë e brendshme të sistemit duke përfutur kështu komunikim më të pasur, më të efektshëm që është i hapur edhe për modelet vetjake. Kjo lejon që të shprehet individualiteti i ligjëruesit dhe origjinaliteti i tij. (Lloshi, 2001:8). Pra, ndodh gërshetimi i modelit dhe veçantisë.

Gjuha globale, procesi intensiv i globalizimit, ka shtruar shumë çështje për diskutim edhe në rrafshin gjuhësor. Duke qenë i lidhur ngushtë me zhvillimin tekniko-teknologjik, me zhvillimin informativ- komunikues, globalizimit i referohen edhe ndryshimet që po ndodhin në hartën gjuhësore të botës. Situata botërore gjuhësore dhe ndryshimet që shfaqen sot janë të kushtëzuara sidomos nga mbizotërimi i gjuhës globale, anglishtes. Globalizimi madje sot ka krijuar simbolin e vet dhe ky simbol është gjuha angleze. Anglishtja është gjuha e komunikimit ndërkombëtar në të gjitha fushat

kryesore të zhvillimit shoqëror, politik, ekonomik, tekniko-teknologjik, informatik, kulturor, medial etj. (Islamaj Sh. Globalizmi 2010).

Si pasojë e këtyre zhvillimeve shohim një përdorim shumë të gjerë të fjalëve të huaja në vend të sinonimeve të tyre në shqip. Po aq të përdorura në ditët e sotme janë edhe shkurtime të fjalëve, jo vetëm në gjuhë të huaj, por edhe në gjuhën shqipe. Një nga arsyet kryesore se pse përdoren këto, shkurtesa është përhapja e madhe e komunikimit elektronik, pothuajse në të gjitha rrjetet sociale, nga të gjitha shtresat shoqërore dhe veçanërisht nga të rinjtë. Pra, në një farë mënyre njerëzit kanë krijuar varësi nga interneti dhe kjo varësi nuk nënkupton vetëm atë që ne sot e njohim si konotacion negativ. Varësia, e cila është edhe më e rëndësishme, është varësia kulturore dhe gjuhësore që krijohet mes përdoruesit dhe mjetit. Me siguri që as edhe një përdorues nuk do ta merrte dot me mend se pikërisht nga komoditeti që ofronte ky lloj komunikimi ata do ta praktikonin gjithnjë e më shumë. Sa më shumë që të përdoret komunikimi elektronik, aq më shumë opsione dhe mundësi të reja komunikimi zhvillohen.

Për mendimin tim, komunikimi elektronik ka sjellë me vete një zhanër krejt të ri të gjuhës, që ka nevojë për vëmendje dhe që duhet t'i kushtohet më shumë kohë gramatikës së mësimdhënies dhe gjuhës në përgjithësi. Tekstet e mesazheve kanë evoluar dhe janë kthyer në një fenomen të shekullit të njëzetë, janë bërë një stil shumë i veçantë grafik, me plot shkurtesa dhe përdorime devijuese të gjuhës, të cilat shfrytëzohen nga një brez i ri që nuk kujdeset për standardin (Crystal 2008: 7).

Rezultatet nga esetë e shkollave të mesme sugjerojnë se mund të ketë disa të vërteta në lidhje me gjuhën e teksteve të mesazheve dhe se kjo është diçka që patjetër duhet studiuar më shumë në të ardhmen. Lufta për standardin e shqipes do të vazhdojë

të zhvillohet më tej nga shumë njerëz dhe tekstet e mesazheve si fenomen global do të vazhdojnë të provokojnë mbështetësit e standardit. Nuk ka asnjë dyshim se tekstet e mesazheve kanë një ndikim të madh në standardin e shqipes, pasi njerëzit kanë filluar të përdorin shkurtesa në gjuhën e folur. Këtë gjë e tregoi edhe puna ime në terren, ku gjatë studimit u vërejt se nxënësit e shkollave tona të mesme kanë filluar që të bëjnë pjesë të punës së tyre në shkollë këto fenomene të reja. Disa prej shkurtesave që ata përdorin, me kalimin e kohës mund të përfshihen si një pjesë e gjuhës standarde , siç ka ndodhur me FLM apo ÇPB etj. Shkurtime të tjera mund të bëhen dalëngadalë pjesë e standardit, duke mos u dalluar fare nga brezat dhe gjeneratat e ardhshme.

Megjithatë, standardi i gjuhës shqipe do të vazhdojë të mësohet në shkolla dhe nxënësit tanë duhet të jenë gjithmonë të gatshëm për të përvetësuar rregullat e gjuhës, normat standarde të drejtshkrimit dhe shenjat e pikësimit. Disa nxënës duket se e kanë të vështirë të mbajnë gjuhën e teksteve të mesazheve larg nga standardi. Pra, mbetet për t'u parë nëse do të kemi ndryshime të rëndësishme në zhvillimet e mëvonshme gjuhësore si rrjedhojë e ndikimit të komunikimit elektronik, por megjithatë, një gjë është e sigurt, që tekstet e mesazheve kanë një ndikim të rëndësishëm në standardin e gjuhës, sado i vogël apo i madh të duket ai.

Situata e sotme gjuhësore paraqitet mjaft problematike në lidhje me fushën e zbatimit të kulturës gjuhësore. Jo në çdo aspekt të përdorimit të vet gjuha njih saktësinë dhe normativitetin standard. Struktura sintaksore e gjuhës letrare nuk ka dallime të rëndësishme, as nga struktura sintaksore e varianteve letrare dialektore, as nga sturuktura e të folmeve të veçanta. Ndryshimi i vetëm i rëndësishëm me dialektin e veriut është mungesa e ndërtimeve me paskajore të tipit “me punue” në gjuhën letrare (Çeliku, M., Tiranë, 2003, f. 182). Sipas, S. Mansaku (2003:109), kufiri midis normës

dhe jonormës në sintaksë dhe në leksik nuk është aq i përcaktuar sa në drejtshkrim dhe në morfologji.

Lëvizjet nga jonorma te norma janë më të zakonshme në sintaksë dhe në leksik. Gjithashtu, edhe rregullat që përcaktojnë normën sintaksore nuk mund të jenë aq të prera sa në morfologji dhe në drejtshkrim. Ndërkohë, këto rregulla sado të plota të jenë, është e vështirë të mbulojnë gamën e gjerë të përdorimeve sintaksore dhe të lëvizjeve semantike që kushtëzohen nga faktorë të shumtë gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë. Gjithashtu janë të shpeshta ndërtimet sintaksore të gabuara; përdoret një ndërtim në vend të një tjetri, vendosen gjymtyrët në rend të gabuar, përdoret një strukturë e cunguar, përdoren konstrukte të huaja, përdoren gabim shenjat e pikësimit. Këto raste e të tjera si këto dëshmojnë për një varfëri në shprehje e njohje jo të mirë të normës gjuhësore.

Një grup tjetër shmangiesh nga norma, të cilat u kundërvihen kodeve ekzistuese duke shprehur një prirje të re në gjuhë (nuk i përkasin vetëm bashkësisë gjuhësore të nxënësve e studentëve, por të rinjve shqiptarë në përgjithësi) janë shmangiet gramatikore në të folur e në të shkruar, të cilat ndonjëherë kushtëzohen nga prurjet e reja në gjuhë, nga huazimet e ndryshme, sidomos nga anglishtja, italishtja, etj., por më së shumti nga moszotërimi i njohurive shkencore dhe normative.

Shmangiet kanë origjinë të ndryshme, disa kanë prejardhje dialektore e këto janë tipike e me shtrirje të gjerë dhe më të qëndrueshme, disa janë rezultat i prurjeve nga fusha e teknologjisë, etj., shumica e tyre janë thjesht gabime gjuhësore dhe përdoren si pasojë e mosnjohjes së kodeve dhe e moszbatimit të tyre nga padituria. Shmangiet në gjuhë mënjanojnë kryesisht nëpërmjet zotërimit të standardit dhe kodeve të tij. Interpretimet kanë të bëjnë me rezultatet e përfuara nga esetë e nxënësve. Siç edhe u

paraqitën më lart, përqindjen më të madhe të gabimeve të konstatuara , rreth 40% të tyre, e zënë ato drejtshkimore.

Shumica e fjalëve të shkurtuara mund të kuptoheshin fare thjesht, jo vetëm nga mënyra sesi ishin shkurtuar fjalët, por edhe nga konteksti, ndërsa disa të tjera ishin më të vështira për t'u deshifruar. Megjithatë, disa shkurtime të tjera ishin më të komplikuar dhe e patëm disi të vështirë të kuptonim se cila ishte në fakt forma e saktë e fjalës. Për shembull, disa nga shkurtime më të paqarta për t'u deshifruar ishin; XC, PRZ, apo SKGJ që u korespondojnë togfjalëshave; *a je për kafe, për zotin, s'ka gjë*. Ajo që vihet re më së shumti në këto rezultate është fakti se duke u nisur nga mania për të shkurtuar fjalët dhe të frymëzuar nga mënyra e shkrimit elektronik me mesazhe, shumë nxënës shkurtojnë edhe fjalë apo togfjalësha që në fakt nuk kanë pse të shkurtohen, sepse në këtë mënyrë ata i humbasin kuptimin fjalës në formën origjinale. Përdorimi i gabuar i shkronjës së madhe në esetë e analizuara është çuditërisht shumë i shpeshtë, me rreth tridhjetë e tetë raste. Kjo vjen edhe nga fakti që nxënësit nuk përdorin si duhet shenjat e pikësimit dhe nuk respektojnë rregullat e shkrimit të emrave të përveçëm.

Por, një dukuri tjetër që është vënë re gjatë punës tonë, është edhe fakti se nxënësit përdorin gjatë shkrimit të tyre edhe shkronja kapitale. Disa nxënës e kanë më të lehtë për të shkruar me shkronja kapitale sesa me ato të dorës dhe për pasojë ngatërrojnë shkronjat e vogla me ato të mëdha. Një ndikim të madh në këtë aspekt ka edhe përdorimi i kompjuterit, pasi është më e lehtë të dallosh fjalët që janë shkruar në mënyrë jo të saktë, apo përdorimin e shkronjës së madhe, për shkak të komandave që bëjnë të mundur korrektimin e gabimeve, ndërsa në detyrat dhe esetë e shkruara me dorë, disa njerëz mund të hasin vështirësi në mënyrën e të shkruarit.

Rezultatet e mësipërme tregojnë se disa nga këto karakteristika, që janë përdorur shpesh në tekstet e mesazheve, janë gjetur edhe në punët me shkrim të nxënësve. Disa prej shkurtesave ishin tipike të gjuhës së teksteve të mesazheve. Përdorimin e shkronjës së madhe unë e shoh si një pasojë të mesazheve dhe zakonit të shkruarit në internetin, ku adoleshentët dhe të rinjtë e kanë të vështirë të përdorin shkronjat kapitale në fillim të fjalisë, pasi në ekranin e një kompjuteri apo telefoni celular kjo gjë ndodh automatikisht. Përsa u përket gabimeve drejtshkrimore të gjetura në esetë e analizuara, këtu kemi të bëjmë me një mungesë informacioni në lidhje me rregullat gjuhësore.

Për mendimin tim, këto lloj gabimesh vijnë si rezultat i mësimin të pakët të rregullave gramatikore të gjuhës standarde. Prandaj, duke u bazuar edhe në rezultatet e gjetura më sipër, mendoj se shpeshherë ajo për të cilën kanë më shumë nevojë disa nxënës është një njohje dhe praktikim sa më i mirë i gjuhës standarde që përdorin në shkollë dhe në institucionet zyrtare, duke e shmangur atë sa të jetë e mundur nga gjuha joformale dhe ajo e komunikimit të tyre elektronik.

Heqja e shkronjave për t'i shkurtuar sa më shumë fjalët është absolutisht një ndikim i shkrimit elektronik dhe kjo sigurisht që përbën një shqetësim për gjuhëtarët dhe studiuesit, të cilët mendojnë se çdo fjalë që shkurtohet dhe përdoret si e tillë edhe në gjuhën standarde është një rrezik i madh për shkatërrimin e gjuhës. Për shumë prej nesh, përdorimi i fjalëve të shkurtuara mund të mos jetë shqetësues, por për sa kohë ne e dimë shkakun e këtij fenomeni, studiuesit dhe gjuhëtarët do të prirën për të renditur disavantazhet e këtij lloj shkrimi.

Gjatë analizës së eseve rezultoi se vetëm disa shembuj pasqyronin një përdorim të shtuar të shenjave të pikësimit. Edhe pse ky lloj përdorimi është ndikim i

shkrimit elektronik, ai nuk ishte dominues dhe duke qenë se numri i shembujve në këtë rast ishte i vogël. Pra, shenjat e pikësimit në shkrimin elektronik nuk luajnë ndonjë rol të rëndësishëm, madje evitohet përdorimi i tyre sa më shumë të jetë e mundur. Gabimet që vërehen më shumë i takojnë përdorimit të prejses. Rreth 40 % e nxënësve nuk e vendosin presjen para përemrave lidhorë *i cili, e cila*, para lidhëzës kundërshtore *por* dhe para lidhëzës shkakore *sepse*. Përdorimi i ë-së së patheksuar në shkrim përbën një nga problemet kyçe edhe në rastin e përcaktimit të normave drejtshkrimore edhe në procesin e zotërimit të normës.

Nga ana tjetër përdorimi i shkurtimeve të tilla nga studentët apo çdo lloj shkruesi, i cili përveç cilësisë së tekstit duhet të respektojë edhe disa rregulla dhe kritere teknike, nuk i favorizon shumë ata, duke i bërë të humbasin përdorimin e një numri të madh karakteresh dhe të kenë shumë hapësira boshe në dokumentet e tyre.

Për shumë gjuhëtarë dhe studiues ruajtja e gjuhës standarde është padyshim një çështje e rëndësishme dhe thelbësore, e cila nuk duhet të anashkalohej apo trajtohet pa interes, por kjo nuk do të thotë që çdo risi kulturore dhe sociale do të ndikojë medoemos negativisht në aspektin gjuhësor. Është e rëndësishme që gjuha standarde të ndahet nga gjuha e përdorur në komunikimin elektronik dhe këto dy forma komunikimi të mos përzihen apo të ndikojnë tek njëra-tjetra, por nuk duhet të harrojmë që kjo është shumë e vështirë të realizohet duke qenë se çdo ditë e më shumë shtohen rastet ku fëmijët më parë bien në kontakt me këtë lloj gjuhe sesa me shkrimin e dokumenteve në gjuhën standarde. Nuk mund ta mohojmë faktin se komunikimi elektronik ka sjellë ndryshime thelbësore, jo vetëm në gjuhë, por edhe tek mënyra se si ne jetojmë, si mendojmë dhe më pas se si shprehemi me njëri-tjetrin. (Milroy, James

and Lesley Milroy. 2003. :22) Për mendimin tim është shumë e rëndësishme që të studiohen të gjitha ndikimet që mund të ketë ky lloj komunikimi.

Sipas Cristal, hipoteza se komunikimi elektronik ndikon negativisht në performancën e punëve me shkrim të nxënësve të shkollave të mesme, mund të jetë e vërtetë deri në momentin që flasim për nxënës të cilët nuk janë të arsimuar. Por, kjo nuk është e vërtetë për ata të cilët janë të arsimuar apo që kanë njohuri shumë të mira të gjuhës në të cilën shkruajnë (Crystal 2008 :26). Në një studim të kryer nga Crystal, pasi pyeti një numër të konsiderueshëm studentësh, të cilët punonin me kompjuter, ai konkludoi se shumica e tyre mbetën të habitur kur u pyetën nëse e ngatërrojnë shkrimin elektronik me detyrat e shkollës. Për shumë studentë këto të dyja janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme dhe nuk mund të ngatërrohen aq lehtësisht. Kështu sipas tij, ajo që po ndodh në të vërtetë është një ekzagjerim i këtij fenomeni duke u munduar të përhapin sa më shumë efektet negative të shkrimit elektronik tek nxënësit. Një gjë e tillë sipas Crystal nxitet më së shumti nga media, e cila e kthen këtë çështje në një temë debati për të tërhequr vëmendjen duke i dhënë më shumë rëndësi se ç' duhet.

Përfundimet e dala nga analiza që iu bë përdorimit të komunikimit elektronik, nxorën në pah tendencat e fundit për shkurtime të fjalëve, fjalive, gabimet drejtshkrimore dhe ekzagjerimet në shenjat e pikësimit, të cilat nëse përdoren në dokumentet e shkruara në gjuhën standarde kthehen në një problem shqetësues.

Nga vëzhgimet e bëra dhe rezultatet e mbledhura gjatë studimit tonë na rezultoi se nxënësit përdorin gjithnjë e më shumë komunikimin elektronik me sms, chat etj, ata shpesh herë nuk tregojnë vëmendje në përdorimin e shkurtesave standarde të gjuhës shqipe.

Një tjetër fakt i evidentuar, është mosnjohja e nxënësve me shkurtesat standarde të gjuhës shqipe, të cilat janë teknike dhe në normë të gjuhës shqipe. Ato kanë njohje dhe përdorim më të vogël gjatë komunikimit elektronik krahasuar me shkurtesat e tjera. Kjo ndodh për faktin se, çdo ditë e më shumë nxënësit po u shmangen normave standarde, duke mos marrë parasysh rregullat përkatëse. Aty ku niveli i njohjes së këtyre shkurtesave është i ulët edhe përdorimi i tyre në komunikim reflektohet po njëjloj. Kjo edhe për faktin se këto janë shkurtime specifike dhe ndoshta nuk përdoren rëndom nga nxënësit gjatë komunikimit të tyre.

Për shembull, për sa i takon shkurtesës (prov.) përdorimi dhe mospërdorimi i tyre është pothuaj i barabartë, pra saktësisht 50.5% e përdorin këtë shkurtesë dhe 49.5% të tjerë nuk e përdorin, një pjesë e të cilëve edhe për faktin që nuk e dinë kuptimin e saj. Një pjesë e vogël e tyre e marrin me mend kuptimin e këtyre shkurtesave duke variuar nga 2.3% për shkurtesën (Kr. pop) deri në 6.6% për shkurtesën (Num. rresht). Pra, një pjesë e mirë e këtyre shkurtesave, duket se po dalin gradualisht nga njohja dhe përdorimi i tyre në shkollë apo jashtë saj. Këtë mendim e përforcon më tej edhe përdorimi i shkurtimeve apo i fjalëve të huaja qofshin këto standarte apo jo, të cilat kanë gjetur përdorim të gjerë kudo, duke u bërë gati – gati të pashmangshme në komunikimin elektronik dhe jo vetëm.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm se interneti po ushtron një ndikim të madh në standardin leksikor, fonetik, sintaksor të gjuhës. Nga ana tjetër shkolla përpiqet t'i mësojë nxënësit të përdorin gjuhën standarde. Interneti duket se po ushtron ndikim të madh edhe në mësimin e gjuhës. Gjuha e përdorur në disa nga llojet e komunikimeve elektronike nuk i përmbahet rregullave të standardit gjuhësor dhe normave bazë të drejtshkrimit të shqipes së shkruar.

Komunikimi elektronik që përdoret nga të rinjtë e ditëve të sotme ndikon shumë në formimin gjuhësor të tyre, pasi ata janë edhe përdoruesit më të mëdhenj të këtyre formave të ligjëritit gjuhësor. Komunikimi elektronik po ushtron ndikim të dukshëm te nxënësit, saqë shpesh gjuha elektronike bëhet gjuha e komunikimit të tyre të përditshëm edhe në shkollë. Ai ka një ndikim të fuqishëm, jo vetëm si mjet për shkëmbimin e informatave, por edhe në kuptim të ndryshimeve shoqërore që është duke shkaktuar.

Në këtë kuadër, interneti e ka revolucionarizuar edhe komunikimin gjuhësor duke i dhënë dimensione të reja, dhe në kuadër të këtij revolucioni komunikues, edhe gjuha shqipe është duke u përballur me një sërë situatash që shpesh bëhen problematike për zbatimin e normave dhe rregullave gjuhësore. Duke parë ritmet me të cilat po zhvillohet dhe pasurohet ky lloj komunikimi gjuhësor, vijmë në konkluzioni që, nëse nuk përpiqesh t'i mësosh këto forma komunikimi dhe të bëhesh pjesë e tyre, atëherë je i përjashtuar nga komunikimi i sotshëm virtual. Në një farë mënyre kemi krijuar varësi nga interneti dhe nuk po marrim parasysh problemet dhe pasojat që sjell ky lloj komunikimi në gjuhën tonë standarde.

Pra, nxënësit po përdorin gjithnjë e më shumë komunikimin elektronik me sms, chat etj, dhe ata shpeshherë nuk tregojnë vëmendje në përdorimin e shkurtesave standarte të gjuhës shqipe dhe zbatimit të rregullave bazë të drejtshkrimit. Nxënësit nuk i njohin plotësisht shkurtesat standarde të gjuhës shqipe. Në këto kushte mund të themi se shoqëria shqiptare sot ka nevojë për një politikë gjuhësore të shpejtë, të qartë e të mirëpërcaktuar, që duhet të mbajë mirë parasysh jo vetëm profilin sociolinguistik të shoqërisë shqiptare, por edhe kontekstet kulturore, politike, kombëtare e globale, ku kjo shoqëri gjallon. Përparësi e kësaj politike, padyshim që duhet të jetë gjuha shqipe:

mbrojtja, ruajtja, zhvillimi, kultivimi dhe përdorimi i saj në të tërë ato sfera të shoqërisë, ku përdoret normalisht çdo gjuhë zyrtare e një shteti.

Një problem tjetër me të cilin po përballet çdo ditë gjuha shqipe dhe të nxënësve janë edhe mjetet e teknologjive moderne, që i janë drejtuar vrullshëm mbarë shoqërisë botërore. Shkolla shqiptare ka nisur ta ndiejë erën e përdorimit dhe të vlerës së tyre. Mësuesit dhe nxënësit janë jo shumë pranë përdorimit të tyre, përse u përket kualifikimeve. Duhet ndërtuar praktika kualifikuese që t'ju vijnë në ndihmë mësuesve dhe nxënësve. Megjithatë duhet të jemi shumë të kujdesshëm edhe në shmangien e ndikimit që kanë ato në komunikimin tonë të përditshëm gjuhësor.

Çdo nxënës ka nevojë për një prind, për një mësues, për një gjuhë. Fëmijët dhe nxënësit tanë duhet të bëhen pjesë e botës së madhe globale të komunikimit. Brenda saj mund të integrohemi vetëm duke përvetësuar rregullat e gjuhës amtare, duke gjetur rrugë të vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së formimit gjuhësor dhe të nxënësve përmes lexim-shkrimit. Lidhur me të dhënat e mbledhura mbi këtë çështje ka rezultuar se stili i komunikimit me SMS dhe Chat ndikon në standartin e shqipes së shkruar.

Përse i përket ndikimit të fjalëve të huaja, pavarësisht se nxënësit mund t'i përdorin fjalët e huaja ndonjëherë, ato ende nuk janë pjesë plotësisht e kulturës gjuhësore të tyre dhe për pasojë komunikimi elektronik nëpërmjet përdorimit të fjalëve të huaja nuk e pengon drejtshkrimin sipas rregullave standarde. Megjithatë, duke pasur parasysh të gjitha problemet dhe çështjet e shtruara më sipër, mund të themi se është e nevojshme që të merren një sërë masash në funksion të kurrikulës së lëndës së gjuhës dhe leximit, për të mos lejuar në asnjë mënyrë futjen dhe të bërit pjesë e fjalëve të huaja në gjuhën shqipe dhe ndikimin e saj nga faktorët e jashtëm.

Gjuha e mbingarkuar me terminologji, me fraza e me tekste të gjata, vështirëson të mësuarin e nxënësve, e bën tekstin jo tërheqës dhe të vështirë. Për këtë, duhet që t'i kushtohet një vëmendje e veçantë bibliotekave të shkollave, që janë një problem tjetër serioz në arsimin tonë parauniversitar. Fjalorët terminologjikë, shkollorë, janë një fushë tjetër zhvillimesh, të cilat duhet të gjejnë vend në mjediset tona shkollore. Gjithashtu, përdorimi i gjuhës në nivele jo të përshtatshme me moshën e nxënësve krijon probleme serioze për të mësuarin e tyre. Gjuha e medias, krahas kontributit që jep për përdorimin e gjuhës në formën më të mirë standarde të saj, përcjell në forma dhe struktura nga më të larmishmet, duke strehuar në leksikun e shqipes fjalë e strukturuara që emigrojnë nga gjuhët fqinje apo edhe më larg, për arsye objektive dhe subjektive. Këto elemente ndikojnë në formimin gjuhësor të nxënësve duke shtuar ndjeshëm mangësitë, përsa i përket përdorimit të gjuhës dhe formave standarde.

Globalizimi është dukuri që ndikimin e tij e shtrin edhe në proceset gjuhësore dhe ky ndikim nuk mund të ngushtohet vetëm në ndikimin që anglishtja, si gjuhë e sotme globale, është duke ushtruar në gjuhët e tjera dhe as si ndikim në kuptim e përhapjes së huazimeve prej saj në gjuhët e ndryshme të botës. Ky drejtim madhor i ecjes së sotme të njerëzimit në mbarë rruzullin tokësor nuk mund të shihet vetëm si dukuri që rrezikon t'i gërryëjë e t'i zhdukë dalëngadalë gjuhët kombëtare të popujve të vegjël. Aq më pak mund të shihet sot përhapja e gjerë dhe e shpejtë e internetit dhe e ndikimeve që vijnë me të si "armik" i përparimit dhe zhvillimit të kulturës e gjuhës kombëtare. Mjetet e reja të komunikimit masiv kanë marrë shtrirje të gjerë. Shumica e brezave aktivë sot shërbehen jo vetëm nga telefonia fikse, por edhe nga telefonia e lëvizshme a celulare, përfshihen përherë e më shumë në hapësirat e internetit, qoftë me anë të e-maileve, sistemit të chatimeve me të shkruar, apo edhe me ato pamore "skypes" etj.

Globalizimi dhe proceset integruese janë të lidhura fort edhe me aspektet e zhvillimeve të përgjithshme politike, ekonomike, kulturore, letrare dhe pa dyshim, gjuhësore, që kanë ndikuar edhe në llojshmërinë e ligjërimeve a diskurseve të shqipes së sotme, duke i pasqyruar të gjitha këto procese ekonomike, politike dhe kulturore nëpër të cilat po kalon shoqëria shqiptare. Në këto rrethana, sigurisht shqiptarëve u bie detyra, që ashtu si të gjitha kombet e tjera, krahas ecjes përpara në rrjedhat globalizuese, të mbahen edhe më tej me forcë në ruajtjen e mbërritjeve madhore të praktikës shkrimore dhe të normave të shqipes standarde. Në mënyrë të veçantë merr rëndësi njohja e kaheve të reja të kulturës së gjuhës shqipe mbas Kongresit të Drejtshkrimit (1972). Kongresi i Drejtshkrimit mbetet ngjarje me rëndësi themelore në historinë e kombit shqiptar dhe përbën gurin e themelit të kaheve të reja të njësimin gjuhësor, kulturor e shpirtëror të shqiptarëve në të gjitha trojet e veta etnike dhe në diasporat e hershme e të reja në botë. Prej kësaj ideje burojnë edhe vlerësimet e tjera e pikërisht: Drejtshkrimi i njësuar si bazë për praktikën shkrimore e botuese me karakter zyrtar e publik, po edhe si udhëheqës për vijën përbashkuese të drejtshqiptimit dhe të kaheve më largvajtëse të shqipes së folur.

Nga rezultatet e analizuara ndërmjet shkollave midis njëra-tjetrës, lidhur me përdorimin ose jo të shkurtesave dhe fjalëve të huaja rezulton se nuk ka dallime të rëndësishme statistikore lidhur me njohjen e shkurtesave standarde të gjuhës shqipe nga nxënësit e këtyre shkollave. Si për nxënësit e shkollave të qytetit ashtu edhe për ata të shkollave periferike përdorimi i këtyre fjalëve të huaja të përzgjedhura në pyetësor, është i njëjtë.

Kështu nga përpunimi i të dhënave statistikore pamë që testi për $t(-0.514)$ dhe shkallë lirie $df=546$ kemi se $\text{Sig. (2-tailed)}=0.607 > 0.05$ gjë që na lejon të themi se nuk

ka dallime statistikisht domethënëse në përdorimin e fjalëve të huaja nga nxënësit e këtyre grupeve, pra përdorimi i tyre si për nxënësit e shkollave të qytetit ashtu edhe për ata të shkollave periferike është i njëjtë, pra pothuaj në të njëjtin nivel. Kjo edhe për faktin se fjalori i komunikimit mbetet pothuaj i njëjtë për të gjithë nxënësit (Tabela 17 në ANEKS). Kjo konfirmohet gjithashtu se vlerësimet mesatare të këtyre dy grupeve të nxënësve janë pothuajse të barabarta .Kështu $M_{sh.periferi}=4.25$ dhe $M_{sh.qyteti}=4.27$.

Gjithashtu, midis grupeve të nxënësve të ndarë sipas klasave nuk ka dallime statistikisht të rëndësishme lidhur me përdorimin e shkurtesave standarde të gjuhës shqipe. Kjo gjë vërehet edhe midis klasave X, XI dhe XII lidhur me përdorimin e shkurtesave jostandarde në gjuhën e huaj, pra nuk ka dallime të rëndësishme midis tyre. Pra, të gjithë nxënësit, pavarësisht nga klasa ku studiojnë, i përdorin pothuaj njëloj këto shkurtesa jostandarde të gjuhës së huaj duke nënkuptuar kështu faktin se këto shkurtesa që shihen dhe lexohen kudo edhe në rrjetet sociale, tashmë janë bërë tepër familjare nga të gjithë nxënësit e shkollave të mesme. Kjo konfirmohet edhe nga fakti se të gjitha vlerat e Sig., edhe në këtë rast në krahasimet midis klasave, kanë vlera tepër të larta krahasuar me kufirin $p=0.05$.

Nga sa u parashtrua më sipër mund të themi se gjuha shqipe ka kaluar një proces të gjatë standardizimi duke u përballur me një sërë problemesh dhe sfidash. Megjithatë ajo zotëron të gjitha cilësitë e një mjete mbarëkombëtar komunikimi, është e aftë për të përmbushur të gjitha funksionet e një gjuhe moderne. Zotërimi, lëvrimi, pasurimi dhe mbrojtja e saj janë detyra të shenjta për këdo që e ka shqipen gjuhë amtare.

Detyrë po aq të rëndësishme kanë edhe institucionet arsimore në vend. Pavarësisht arritjeve të deritanishme dhe përcaktimit e hartimit të një vizioni të ri kurikular në drejtim të mësimi të gjuhës shqipe, mbetet ende shumë punë për të bërë. Edhe pse

programet e lëndës së gjuhës shqipe kanë një vend qendror në programet shkollore, janë rikonceptuar, përmirësuar dhe ristrukturuar, janë mbështetur në parime të reja gjuhësore dhe didaktike, duhen ende përpjekje për të rritur kulturën gjuhësore të nxënësve, kulturën e të folurit , të shkruarit, e jo vetëm të tyre, por edhe të të gjithë shqipfolësve. Shkolla duhet të mbështesë nxënësit për ta njësuar mësimin e gjuhës shqipe standarde, pasi nëpërmjet saj zhvillohen shprehjet komunikative që realizojnë aktin e komunikimit në tërësi. Përmes shprehive synohet të aftësohen nxënësit:

- Për zhvillimin e dëgjimit të kujdesshëm,
- Për zhvillimin e të folurit saktë dhe me përpikmëri,
- Për zhvillimin e të lexuarit dhe të kuptuarit të tij,
- Për zhvillimin e të shkruarit standard të gjuhës dhe të modeleve të veta përfaqësuese.(Gjokutaj, M. 2012 :46-47).

Ky studim, duke qenë se i përket një fushe jo shumë të studiuar në gjuhësinë shqiptare, duke mos pasur as modele të trajtimeve ka vlerën e gurit të parë, por edhe vështirësitë e një hapi të tillë, gjithsesi sa të lakmueshëm, aq edhe të guximshëm. Besoj të kemi arritur të evidentojmë dhe të prekim disa prej problemeve themelore të gjuhës shqipe në mjetet e komunikimit elektronik duke dhënë një pamje të përgjithshme tërësore të shqipes së shkruar e të folur në shkollat tona dhe trajtuar rolin modeldhënës dhe kodifikues të gjuhës së shkruar e të folur nga mediumet e ndryshme elektronike, por edhe ndikimet e trysnitë prej gjuhëve të huaja dhe prej kujdesit të pamjaftueshëm ndaj gjuhës shqipe në periudha të caktuara historike.

6.2 Rekomandime

Mbi bazën e gjetjeve, analizës së tyre dhe përfundimeve të arritura, ky studim parashtron disa rekomandime për institucionet arsimore, mësuesit e gjuhës dhe letërsisë, ekspertët e gjuhës shqipe.

Rekomandime për institucionet arsimore

- a) Nevojitet që MAS të rishikojë planin mësimor dhe programet e lëndës së gjuhës shqipe në arsimin parauniversitar duke shtuar orët e gjuhës shqipe edhe në shkollat e mesme, sepse mungesa e lëndës së gjuhës shqipe në këtë nivel arsimor, apo edhe reduktimi i formimit gjuhësor në shkollat 9-vjeçare, ka sjellë përdorimin e pasuksesshëm të gjuhës shqipe nga nxënësit, duke mos e respektuar standardin e gjuhës shqipe.
- b) Rekomandohet që MAS dhe IZHA të kryejnë vlerësime periodike për lëndën e gjuhës shqipe në mënyrë që të ndërmarrin masa konkrete për përmirësim në kohën e duhur.
- c) Institucionet arsimore që kanë përgjegjësi trajnimin e mësuesve do të duhet të përfshijnë në programet e trajnimit çështje që kanë të bëjnë me zgjidhjen e problematikave të ndikimit të komunikimit elektronik në të shkruarit e gjuhës shqipe nga nxënësit, të përdorimit të fjalëve të huaja, të përdorimit të shkurtesave nga nxënësit.

Rekomandime për mësuesit e gjuhës dhe letërsisë shqipe

- a) Lipset që mësuesit ta shikojnë ngulitjen e normave të të shkruarit si një proces që përmban njohjen e rregullave të drejtshkrimit, përvetësimin e tyre dhe formimin

e shprehive të të shkruarit sipas standardit të gjuhës shqipe. Nëse njohuritë për normën gjuhësore kthehen në shprehi, atëherë nxënësit arrijnë të shkruajnë sipas normës.

- b) Krahas punës për formimin e shprehive të të shkruarit sipas standardit të gjuhës shqipe, rekomandohet që mësuesit të punojnë për të korrigjuar shprehitë e gabuara të ndikuara nga komunikimi elektronik, veçanërisht nga përdorimi i shkurtesave dhe i fjalëve të huaja. Ky rekomandim vlen për moshën e nxënësve të arsimit të mesëm, pasi në këtë moshë rregullat që lidhen me drejtshkrimin përvetësohen më mirë me përpjekje të qëllimshme dhe me ushtrim sistematik.
- c) Lipset që mësuesit të tregojnë më shumë vëmendje për njohjen dhe përdorimin e shkurtesave standarde të gjuhës shqipe, duke u bazuar në drejtshkrimin standard të tyre, pasi nxënësit të ndikuar nga komunikimi elektronik përdorin shkurtesa jashtë normës.

Rekomandime për ekspertët e gjuhës shqipe

Gjuhët e huaja fliten në masë, sidomos prej rinisë. Zotërimi i këtyre gjuhëve, pa njohur mirë strukturën dhe vlerat e shqipes, ka pasoja, sepse shpesh e vë në pozitë të vështirë, duke i kërcënuar së pari funksionin emërtues e shprehës. Kjo trysni duket të vërshimi i fjalëve të huaja, të cilat mund të kenë hyrë sidomos nga anglishtja ose italishtja, duke ia zënë frymën shqipes. Shumë studiues shqiptarë i cilësojnë një pjesë të madhe të këtyre fjalëve si të panevojshme, të cilat duhen zëvendësuar me fjalët shqipe ekzistuese. Kërkohet një qëndrim i qartë nga ekspertët e gjuhës për përdorimin e fjalëve të huaja, veçanërisht ndaj termave tekniko-shkencorë në gjuhë të huaj, numri i të cilëve është shtuar dhe përdorimi i tyre është i shpeshtë.

Lipset që ekspertët e gjuhës shqipe të luajnë më mirë rolin që kanë në lëvrimin e gjuhës shqipe dhe zbatimin e normave standarde të gjuhës shqipe, veçanërisht për përdorimin e fjalëve të huaja, pasi shkurtesat jostandarde dhe fjalët e panevojshme në gjuhë të huaj deformojnë komunikimin e saktë në gjuhën shqipe, në formën e duhur dhe letrare gjithashtu. Me rëndësi është roli i *mbrojtjes shtetërore dhe institucionale* të gjuhës shqipe dhe standardizimit të saj të mëtejshëm si:

- nëpërmjet studimeve,
- pasurimit të rregullave,
- fjalorëve,
- veprimtarisë botuese,
- të folurit publik për të ruajtur pastërtinë e gjuhës

REFERENCA

- Agnihotri, R. K., Labov's "Concept of the Vernacular Speech": The Site of Language
"Structure, Acquisition and Change" United States, 2013, f. 101.
- Ajai S. Gaur & Sanjaya S. Gaur "Statistical methods for Practice and Research" (second
edition), Sage Publication, 2009.
- Ajeti I, *Gjuha dhe mjete e informimit*, në "Çështje të nomës letrare", Prishtinë, 1980.
- Akademia e Shkencave "Fjalor i gjuhës shqipe", Tiranë 1980
- Akademia e Shkencave "Fjalor i gjuhës së sotme shqipe", Tiranë 2002
- Akademia e Shkencave "Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë 2007
- Adams, M. Slang: "The people's poetry", United States, 2004, f. 6.
- Bali Sharl "Gjuha dhe jeta" Përkthyer nga M. Samara, Albatros 2006
- Balla M., "Marrëdhëniet e sotme gjuhë standarde-dialekt në shkolla" Tiranë, 2011,
f . 268- 271.
- Beci, B. "Gjuha letrare shqipe dhe bazat e saj dialektor" Tiranë, 1995, f. 53.
- Beci B. "Historia e standardizimit të shqipes" SHBLSH E RE 2010.
- Bendaj G. "Shqipja e sak@tuar e internetit" 15 Tetor 2010, Revista MAPO
- Bently, H., "Slang today and yesterday"; dictionary of American slang; Slang, phrases
and idiom in colloquial english and their use. United States 1935
- Bernstein, B., "Language and Social Class". England, 1960, f. 271-276
- Berryman, C. L., dhe Eman, V. A., "Language and Gender Communication", United
States, 1983, f. 30-35.
- Berson, M. J. (2000), "Rethinking research and pedagogy in the social studies": The
creation of caring connections through technology, Theory & Research in Social

- Education, 28(1).
- Bernard, H. R. (1992). "Preserving language diversity", Computers can be a tool for making the survival of languages possible. *Cultural Survival Quarterly*, 16(2),13-21.
- Brandt, E. A. (1988): Applied linguistic anthropology and American Indian language renewal. *Human Organization*, 47(4), 322-329.
- Bitter, G. G. & Legacy, J. M. (2006) (Brief eds.), "Using technology in the classroom"
Boston: Pearson Education.
- Bhasin, K., "Të kuptosh përkatësinë gjinore". Tiranë, 2006, f. 14-15.
- Bishop, L. ., "Investigating idiolect and youth sociolect",
- Bodine, A., "Reviw of Male/Female Language" . Cambridge , 1977 , f. 104-110
- Bosanquet, H. D.,. "The family". Chicago, 1907, f. 399
- Briscoe, R. E., "Individualism, Externalism and Idiolectical Meaning". United States,
2006 , f. 98.
- Brown, R., "Complexity and order in teenagers' speech in Psycholinguistics", New
York, 1970, f. 85.
- Bucholts, M., Globalization: "Language and youth culture". North Carolina, 2000,
- Block, David (2004), "Globalization, Transitional Communication and the Internet",
International Journal on Multicultural Societies (IJMS), Vol. 6, No.1., UNESCO.
- Bitter, G. G. & Legacy, J. M. (2006) (Brief eds.), "Using technology in the classroom",
Boston: Pearson Education.
- Caka, Nebi – Dika Avni – Rodiqi, Seb (2005). "Fjalori i Informatikës anglisht-shqip/
shqip-anglisht", Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë.
- Cameron, D., "Gender and Language Ideologies"
- Cardona, G. R., " I ntroduzione al' etnoliguistica", Milano, 1976, f. 92.

- Caton, S. C., Review of: Contributions of Roman Jakobson. United States, 1987.
- Chomsky, Noam, « Gjuha dhe problemet e njohjes » . Tiranë, 2008.
- Cristian Baylon, Xavier Mignot. “Komunikimi” (Përkthim Xhevat LLoshi.) .
- Crowley, Tony: “Standard English and the Politics of Language”, New York, 2003.
- Conrad, S., & Goldstein, L. (1999). ESL student revision after teacher written comments: Texts, contexts, and individuals. *Journal of Second Language Writing*, 8, 147-177.
- Crystal, David “Language and the internet” 2001: Cambridge University Press .
- Chrystal, David “ *Investigating English Style*”, London, 1969, f. 64
- Crystal, David 2004. “*A Glossary of Netspeak.*” Edinburgh University Press Ltd.
- Crystal, David 2005. “*The Language Revolution.*” Cambridge: Polity Press.
- Crystal, David 2007. “*The Fight for English: How Language Pundits ate, shot and left*” . Oxford: Oxford University Press.
- Crystal, David. (2008.) “*Txtng: the gr8 deb8*”. Oxford: Oxford University Press.
- Crystal, David (2001). “Languages on the Internet”, *Lingua Franca*, March, ABC, Internet: http://www.davidcrystal.com/DC_articles/Internet1.pdf ,
- Crystal, David (2005). “The scope of Internet Linguistics, Paper viven online to the American Association for the Advancement of Science meeting”, Internet :http://www.davidcrystal.com/DC_articles/Internet2.pdf ,
- Cuban, L. (2002), *Undersold & Underused: “Computers in the classroom”*, Cambridge Mass: Harvard University Press
- Çabej, E.: *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, Fonetika historike e shqipes*, Tiranë, 1963.
- Çabej, E.: *Për pastërtinë e gjuhës*, “Gjuha jonë”, 1, 1981.

- Çeliku M. “Çështje të shqipes standarde”, Tiranë, 2001
- Çeliku M “Çështje të normës letrare”, Tiranë, 1980
- Çeliku, M.; Karapinjalli M., & Stringa R., “Gramatika praktike e gjuhë shqipe”.
Tiranë, 1998, f. 125.
- Çerkezi, E., & Billa, E., “Norma letrare e shqiptimit dhe tipare dalluese dialektore që
hyjnë në gjuhën letrare”. Korçë, 2013, f. 310.
- Dodi A. “Kultura e gjuhës dhe shqiptimi letrar”, :Gjuha jonë”1 1981 (f 58 -64)
- Drejtkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973.
- Duro A. “Studime gjuhësore”, Botime albanologjike 2012
- Eckert, P., “*Adolescent language*”. New York, 2003 f. 52003.
- Field A , Sage Publication, 2005
- Ferguson, N., “Simultaneous Speech, Interruptions and Dominance”, England, 1977,
f. 295-302.
- Fiedler, W., “Tendencat e formimit të shumësit në shqipen e sotme”, Tiranë, 2011,
f. 154.
- Fishman J., A. (1972). “The Relationship between Micro – and Macro-Sociolinguistics
in the Study of Who Speaks What Language to Whom and When, Sociolinguistics”,
Edited by J.B. Pride and J. Holmes, Ringwood, Victoria, Australia.
- Fishman, J. (1973) Language Modernization and planning in comparison in othertypes
of National Modernization and planing, in “Language in society”,
vol. III nr.1 p 23-43
- Fishman, J. A. (1991). *Reversing language shift: Theoretical and empirical foundations
of assistance to threatened languages*. Clevedon, UK: Multilingual Matters.
- Fishman, J., *Who speaks what language to whom and when?* Paris, 1965, f. 49.

- Fullan Michael “Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim” -Bot. i tretë, Tiranë , Edualba
2001
- Gerrard, Helen (2004). Japanese Speakers and the Internet, International Journal on
Multicultural Societies (IJMS), Vol. 6, No.1., UNESCO.
- Gidens, Entoni (Anthony Giddens) “Pasojat e modernitetit” UETPREES, Tiranë, prill
2013
- Goetting, A., Review of: You Just Don't Understand: Women and Men in Conversation
by Deborah Tannen Journal. United States, f. 99.
- Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002, f. 170.
- Gumpers, J. S., “Linguistic and social interaction in two communities”, United States,
1964 f. 137.
- Goodman, Morris: “Languages in Contact, Current Trends in Linguistics, Vol. 7.
Mouton, 1971, pp. 664-679.
- Gjokutaj, M., ”Didaktika e gjuhës shqipe” SHBLU, Tiranë 2010
- Gjinari, J., & Shkurtaj, Gj., “Dialektologjia”, Tiranë. 2003 .
- Hinkin T.R., (1995), ‘A review of scale development practices in the study of
organizations”, *Journal of Management*, vol 21, no 5, 967-988.
- Haugen, Einar: “The Analysis of Linguistic Borrowing, Language” Vol.26, No. 2,
Baltimore, 1950, pp. 210-231.
- Haugen, Einar: “Language Conflict and Language Planning”; The case of Modern
Norwegian, Harward University Press, Cambridge, Mass., 1966.
- Holmes, Hellen Kelly (2004). “An Analysis of the Language Repertoires of Students in
Higher Education and their Language Choices on the Internet” (Ukraine, Poland,
Macedonia, Italy, France, Tanzania, Oman and Indonesia), International Journal

- on Multicultural Societies (IJMS), Vol. 6, No.1., UNESCO.
- Hudson, Richard A.(2002). “Sociolinguistika”, Cambridge University Press,
1980,1996, Botimi në shqip: Dituria, Tiranë.
- Hymes D, “The ethnography of speching”, 1962
- Holmes and Meyerhoff “Handbook of Language and Gender”. Oxford, 2003, f. 159
- Islamaj Shefkie “Aspekti gjuhësor i globalizmit dhe shqipja standarde” Sesioni
shkencor në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën
Shqiptare, 2008, Prishtinë
- Islamaj, SH., “Shqipja standarde dhe modernizimi i saj). Revista “ Gjuha shqipe”
(Instituti Albanologjik), 3/2008
- Islamaj, Sh.: *Gjuha, ligjërimi dhe fjala*, Instituti Albanologjik i Prishtinës,
Prishtinë, 2004.
- IKT “ Standardi i gjuhës shqipe dhe letërsisë në klasat 10-12” Tiranë, nëntor 2008.
- ISP “Kultura e edukimit” Jerome Bruner, Erik, Tiranë 2003
- ISP “Gjuha shqipe dhe letërsia” Tiranë 2004
- ISP. Programe të lëndës së gjuhës shqipe Kl. 1-9
- IZHA, Udhëzues kurrikular. Tiranë, gusht 2010.
- IZHA , Standardet e të nxëniet. Tiranë, 2012
- IZHA, Standardet e gjuhës dhe letërsisë, Tiranë 2011-2012
- IZHA, Kurrikula kombëtare e arsimit bazë. Program lëndor: Gjuhë shqipe dhe letërsi,
Tiranë 2012
- KONSULTA GJUHËSORE E PRISHTINËS(1968); Prishtinë 2008
- Kostallari A. “Gjuha e sotme letrare shqipe dhe drejtshkrimi i saj”, 1973, Tiranë.
- Kostallari A. “Gjuha letrare shqipe dhe epoka jonë”, 1988, Tiranë.

- Kostallari Androkli (1984). “Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë”, (Materiale të Konferencës shkencore të mbajtur në Tiranë më 7-8 dhjetor 1984), Tiranë 1988
- Khandealla P., (1976), “*The Design of Organizations*”. New York: Harcourt Brace Jovanovich.
- Labov, T., “Social and language boundaries among adolescents”. United States. 1992, f. 340.
- Labov, T., “*American Speech*,” Vol. 67, No. 4 339-366, 1992, f. 65.
- Labov, W., “*Sociolinguistic Patterns*,” Philadelphia, 1972, f. 277.
- Lafe, E., “Gjuha e medias sot, probleme dhe detyra”, Tiranë, 2000, f.14.
- Long, D., “*Quasi ,standard as a linguistic concept*” United States. 1996, f. 118.
- Louwerse, M., *Semantic variation in idiolect and sociolect: Corpus linguistics. Evidence from literary texts*, Memphis, 2004
- Lloshi, Xh., “Stilistika gjuhësore” ShBLU, Tiranë 1985.
- Lloshi, Xh., “Shqipja standarde në rrethanat e dygjuhësisë”, :St. Fil” 1-2 f. 47-58
- Marashi, A., “Shqipja në etapën e sotme: sfidat e gjuhës dhe të gjuhëtarëve” Tiranë, 2011, f. 10.
- Memushaj R. “Shqipja standarde” (Si ta flasim dhe ta shkruajmë), Toena, Tiranë, 2005.
- Memushaj, R. “Gjuhësia gjenerative”. Tiranë 2003.
- Memushaj, R. “Për shqipen standarde” II, Çështje të normës morfologjike dhe drejtshkimore. Infobotues Tiranë 2012
- Murati, Q. «Standardi gjuhësor dhe kultura e shprehjes », Prishtinë 2004
- Musai, Bardhyl., « Psikologji Edukimi ». Tiranë, 1999.
- Munishi, Shkumbin (2009), Gjuha shqipe dhe Interneti, Filologji, 16, Universiteti i

Prishtinës, Prishtinë, 2009

Nikoliq, Stanish: « Bota e psikikës fëmijërore ». Botimi i dytë shqip, Shkup, 2006.

Programi PISA 2009 www.co.int/t/dg4/linguistic/Source/CEFR Albanian

Piaget, « Psikologjia e Inteligjencës ». Tiranë 2004.

Qosja, R. “*Nocione të reja Albanologjike*”, Prishtinë, 1983, f.146

Raka F., “*Historia e shqipes letrare*”, Prishtinë 1997

Raka F., “*Normëzimi i shqipes ndër shekuj*”, Prishtinë 2004

Rrokaj Sh. “*Çështje të gjuhës shqipe*”, Albatros 2007

Rrokaj, Sh.: *Shqipja në epokën e globalizmit dhe identiteti i saj*, Konferencë

Ndërkombëtare, Imazhi shqiptar, Tiranë 2008.

Rrokaj, Sh. “*Gjuha standarde dhe roli i dialekteve*”, Konferenca Ndërkombëtare, UT,

Tiranë, 2011

Rrokaj, Sh.: “*Probleme të drejshkrimit të shqipes standarde*”, Konferenca

Ndërkombëtare, UT, Tiranë, 2012.

Rrokaj, Sh., “*A janë të nevojshme ndryshimet në shqipen standarde*”, Konferenca

Ndërkombëtare, USHT, Tetovë, 2012

Samara, M. « Historia e gjuhës letrare shqipe », SHBLU , Tiranë 2005

Saussure F. « Cours de linguistique generale » Paris, përkthyer nga R. Ismajli « Kurs i

gjuhësisë së përgjithshme », Prishtinë, 1997.

Saunders M., Lewis P., Thornhill A., (2009), “*Research Methods for Business*

Students”, FT-Prentice Hall, botimi i pestë.

Shehu Hajri, “*Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit*” në Konferenca

shkencore: “*Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*”, Tiranë , 2003.

Shkurtaj Gj. “*Sociolinguistik e shqipes*”, Morava , Tiranë ,2009

- Shkurtaç Gj. “Shqipja e sotme: Kulturë të shkruari dhe të foluri”; Tiranë, 2010.
- Shkurtaç Gj. “Etnografi e të folurit të shqipes”. Tiranë, 2004
- Shkurtaç Gj. “Kultura e gjuhës” SHBLSH, Tiranë 2006
- Shkurtaç Gj. “*Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*”, Tiranë, 2003.
- Shkurtaç Gj., “*Pesha e fjalës shqipe*”. Tiranë, 2009, f. 65.
- Shkurtaç Gj. Kumtesë e mbajtur në Konferencën e Albanian University, qershor, 2009
- Shkurtaç Gj. “Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran”, Tiranë, 1988
- “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”: Konferencë shkencore, redaktuar nga
 J. Bulo, E. Lafe, S. Mancaku, E. Hysa, Tiranë, 2002,
- “Shqipja në etapën e sotme”: Politika e përmirësimit dhe pasurimit të standardit, Botime
 Albanologjike, Tiranë 2011
- Tony Bex & Richard J. Watts,. “Standard English: The widening debate”, London 2002.
- Topalli T, Haxhi A “Historia e gjuhës së shkruar” Shkodër 1998 : 208
- Thomai, J. “Leksikologjia e gjuhës shqipe”, Tiranë 1984
- (UT, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Akte të konferencës shkencore, 16 dhjetor 2004).
- Vygotskij, S. Levi; Lurije, R. Aleksader, “La scimmia, l’uomo primitivo, il bambino”.
- Xhafa, D., *Language and society in context of globalism*, Korçë, 2013,
- Xhuvani, A., *Për pastertinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1956.
- Xhuvani, A., *Mbi thjeshtësinë e gjuhës*, “Norma letrare kombëtare dhe kultura e
 gjuhës”, Tiranë, 1973.
- Weinreich, Uriel: *Language in Contact: “Findings and Problems”*, New York,
 Linguistic Circle of New York, No. 1, Mouton, The Hague, 1953.
- Warschauer, M. Healey, D. (1998) Computer and language learning: An
 overview. *Language Teaching*, 31 (2), 57-71.

SHTOJCA I

Tabela 1 Shpërndarja e përdorimit të shkurtesës **Xc** në gjuhën shqipe sipas llojit të shkollave

| Shkolla ku ju studioni ndodhet në | Shkurtesa Xc | | Total |
|-----------------------------------|--------------|--------------|--------|
| | E përdor | Nuk e përdor | |
| Periferi | 22 | 95 | 117 |
| % | 34.4% | 29.2% | 30.1% |
| Qytet | 19 | 123 | 142 |
| % | 29.7% | 37.8% | 36.5% |
| Profesionale | 23 | 107 | 130 |
| % | 35.9% | 32.9% | 33.4% |
| Total | 64 | 325 | 389 |
| % | 100.0% | 100.0% | 100.0% |

Tabela 2 Shpërndarja e përdorimit të shkurtesës **Tung** në gjuhën shqipe sipas llojit të shkollave

| Shkolla ku ju studioni ndodhet në | Shkurtesa Tung | | Total |
|-----------------------------------|----------------|--------------|-------|
| | E përdor | Nuk e përdor | |
| Periferi | 117 | 55 | 172 |
| % | 41.5% | 21.2% | 31.7% |
| Qytet | 90 | 116 | 206 |
| % | 31.9% | 44.6% | 38.0% |

| | | | |
|--------------|--------|--------|--------|
| Profesionale | 75 | 89 | 164 |
| % | 26.6% | 34.2% | 30.3% |
| Total | 282 | 260 | 542 |
| % | 100.0% | 100.0% | 100.0% |

Tabela 3 Shpërndarja e përdorimit të shkurtesës **Kr. Pop** në gjuhën shqipe sipas llojit të shkollave

| Shkolla ku ju studioni ndodhet në | Shkurtesa Kr. Pop | | Total |
|-----------------------------------|-------------------|--------------|--------|
| | E përdor | Nuk e përdor | |
| Periferi | 19 | 61 | 1 |
| % | 54.3% | 24.7% | 100.0% |
| Qytet | 10 | 102 | 0 |
| % | 28.6% | 41.3% | .0% |
| Profesionale | 6 | 84 | 0 |
| % | 17.1% | 34.0% | .0% |
| Total | 35 | 247 | 1 |
| % | 100.0% | 100.0% | 100.0% |

Tabela 4 Shpërndarja e përdorimit i fjalës **Selektoj** në gjuhën e huaj sipas llojit të shkollave

| Shkolla ku ju studioni ndodhet në | Fjala selektoj | | Total |
|-----------------------------------|----------------|--------------|-------|
| | E përdor | Nuk e përdor | |
| Periferi | 108 | 27 | 135 |

| | | | |
|--------------|--------|--------|--------|
| % | 28.5% | 35.5% | 29.7% |
| Qytet | 145 | 27 | 172 |
| % | 38.3% | 35.5% | 37.8% |
| Profesionale | 126 | 22 | 148 |
| % | 33.2% | 28.9% | 32.5% |
| Total | 379 | 76 | 455 |
| % | 100.0% | 100.0% | 100.0% |

Tabela 5 Shpërndarja e përdorimit e shkurtesës **Lol** në gjuhën e huaj sipas llojit të shkollave

| Shkolla ku ju studioni ndodhet në | Shkurtesa lol | | Total |
|-----------------------------------|---------------|--------------|--------|
| | E përdor | Nuk e përdor | |
| Periferi | 62 | 32 | 94 |
| % | 25.3% | 27.4% | 26.0% |
| Qytet | 105 | 42 | 147 |
| % | 42.9% | 35.9% | 40.6% |
| Profesionale | 78 | 43 | 121 |
| % | 31.8% | 36.8% | 33.4% |
| Total | 245 | 117 | 362 |
| % | 100.0% | 100.0% | 100.0% |

Tabela 6 Shpërndarja e përdorimit e shkurtesës **Fyi** në gjuhën e huaj sipas llojit të shkollave

| Shkolla ku ju studioni ndodhet në | Shkurtesa fyi | | Total |
|-----------------------------------|---------------|--------------|------------|
| | E përdor | Nuk e përdor | |
| Periferi | 10 | 48 | 58 |
| % | 23.3% | 25.9% | 25.4% |
| Qytet | 17 | 78 | 95 |
| % | 39.5% | 42.2% | 41.7% |
| Profesionale | 16 | 59 | 75 |
| % | 37.2% | 31.9% | 32.9% |
| Total | 43 | 185 | 228 |
| % | 100.0% | 100.0% | 100.0% |

Tabela 7 Testi Chi Square lidhur me përdorimin e shkurtesave standarde në gjuhën shqipe dhe komunikimit elektronik

| Komunikimi elektronik shkurtesa me | Shkurtesat standarde të gjuhës shqipe | | Total |
|------------------------------------|---------------------------------------|--------------|------------|
| | E përdor | Nuk e përdor | |
| Po | 321 | 211 | 532 |
| Jo | 36 | 23 | 59 |
| Total | 357 | 234 | 591 |

| Chi-Square Tests | | | | | Exact Sig. (1-sided) |
|------------------------------------|-------------------|----|--------------------------|-----------------------------|-------------------------|
| | Value | df | Asymp. Sig. (2-sided) | Exact Sig. (2- sided) | |
| Pearson Chi-Square | .010 ^a | 1 | .014 | | |
| Continuity Correction ^b | .000 | 1 | 1.000 | | |
| Likelihood Ratio | .010 | 1 | .919 | | |
| Fisher's Exact Test | | | | 1.000 | .519 |
| Linear-by-Linear Association | .010 | 1 | .920 | | |
| N of Valid Cases | 591 | | | | |

a. 0 cells (.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 23.36.

b. Computed only for a 2x2 table

Tabela 8 Testi Chi Square lidhur me njohjen e kuptimit të shkurtesave standarde në gjuhën shqipe dhe komunikimit elektronik

| Komunikimi me shkurtesat standarde të gjuhës shqipe | Njohja e kuptimit të shkurtesave standarde shqip | | | Total |
|---|--|-------------------|-----------------------|-------|
| | E di kuptimin | Nuk e di kuptimin | E marr me mend | |
| Po | 240 | 84 | 3 | 327 |
| Jo | 425 | 148 | 0 | 573 |
| Total | 665 | 232 | 3 | 900 |
| Chi-Square Tests | | | | |
| | Value | df | Asymp. Sig. (2-sided) | |
| Pearson Chi-Square | 5.275 ^a | 2 | .072 | |
| Likelihood Ratio | 6.093 | 2 | .048 | |
| Linear-by-Linear Association | .297 | 1 | .586 | |
| N of Valid Cases | 900 | | | |

a. 2 cells (33.3%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 1.09.

Tabela 9 Testi Chi Square lidhur me përdorimin e shkurtesave standarde në gjuhën shqipe dhe ndikimit në stilin e komunikimit elektronik me SMS dhe Chat

| Stili i komunikimi elektronik me SMS dhe Chat | Shkurtesat standarde të gjuhës shqipe | | Total |
|---|---------------------------------------|--------------|-----------------------|
| | E përdor | Nuk e përdor | |
| Po | 325 | 217 | 542 |
| Jo | 32 | 17 | 49 |
| Total | 357 | 234 | 591 |
| Chi-Square Tests | | | |
| | Value | df | Asymp. Sig. (2-sided) |
| Pearson Chi-Square | .536 ^a | 1 | .04 |
| Likelihood Ratio | .336 | 1 | .02 |
| Linear-by-Linear Association | .544 | 1 | .461 |

a. 0 cells (.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 19.40.

b. Computed only for a 2x2 table

Tabela 10 Testi Chi Square lidhur me përdorimin e shkurtesave jo standarde në gjuhën shqipe dhe ndikimit në komunikimit elektronik

| Komunikimi elektronik | Shkurtesat jo standarde të gjuhës shqipe | | Total |
|------------------------------|--|--------------|-----------------------|
| | E përdor | Nuk e përdor | |
| Po | 441 | 163 | 604 |
| Jo | 52 | 32 | 84 |
| Total | 493 | 195 | 688 |
| Chi-Square Tests | | | |
| | Value | df | Asymp. Sig. (2-sided) |
| Pearson Chi-Square | 4.481 ^a | 1 | .034 |
| Likelihood Ratio | 3.950 | 1 | .047 |
| Linear-by-Linear Association | 4.263 | 1 | .039 |

a. 0 cells (.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 23.81.

b. Computed only for a 2x2 table

Tabela 11 Testi Chi Square lidhur me përdorimin e fjalëve të huaja dhe ndikimit në kulturën gjuhësore

| Kultura gjuhësore e përdorimit të fjalëve të huaja | Përdorimi i fjalëve të huaja | | Total |
|--|------------------------------|--------------|-----------------------|
| | E përdor | Nuk e përdor | |
| Po | 240 | 83 | 323 |
| Jo | 163 | 62 | 225 |
| Total | 403 | 145 | 548 |
| Chi-Square Tests | | | |
| | Value | df | Asymp. Sig. (2-sided) |
| Pearson Chi-Square | .236 ^a | 1 | .627 |
| Likelihood Ratio | .150 | 1 | .699 |
| Linear-by-Linear Association | .235 | 1 | .628 |

a. 0 cells (.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 59.53.

b. Computed only for a 2x2 table

Tabela 12 Testi Chi Square lidhur me përdorimin e fjalëve të huaja dhe ndikimit në drejtshkrimin standard

| Drejtshkrimi standard | Përdorimi i fjalëve të huaja | | Total |
|-----------------------|------------------------------|--------------|-------|
| | E përdor | Nuk e përdor | |
| Po | 366 | 130 | 496 |
| Jo | 37 | 15 | 52 |

| | | | |
|------------------------------|-------------------|-----|-----------------------|
| Total | 403 | 145 | 548 |
| Chi-Square Tests | | | |
| | Value | df | Asymp. Sig. (2-sided) |
| Pearson Chi-Square | .168 ^a | 1 | .682 |
| Likelihood Ratio | .060 | 1 | .807 |
| Linear-by-Linear Association | .165 | 1 | .684 |

a. 0 cells (.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 13.76.

b. Computed only for a 2x2 table

Tabela 13 Levene test për vlerësimin e shkurtesave standarde në gjuhën shqipe sipas shkollave

| Levene Statistic | df1 | df2 | Sig. |
|------------------|-----|-----|------|
| 7.588 | 2 | 897 | .001 |

Tabela 14 ANOVA për njohjen e shkurtesave standarde të gjuhës shqipe sipas shkollave

| | Sum of Squares | df | Mean Square | F | Sig. |
|----------------|----------------|-----|-------------|-------|------|
| Between Groups | .809 | 2 | .404 | 2.013 | .134 |
| Within Groups | 180.253 | 897 | .201 | | |
| Total | 181.062 | 899 | | | |

Tabela 15 Procedura Tukey

| (I) Shkolla ku ju studioni ndodhet në | (J) Shkolla ku ju studioni ndodhet në | Mean Difference (I-J) | Std. Error | Sig. | 95% Confidence Interval | |
|--|--|-----------------------------|------------|-------------|----------------------------|----------------|
| | | | | | Lower Bound | Upper Bound |
| Periferi | Qytet | -.007 | .037 | .982 | -.09 | .08 |
| | Profesionale | -.067 | .037 | .163 | -.15 | .02 |
| Qytet | Periferi | .007 | .037 | .982 | -.08 | .09 |
| | Profesionale | -.060 | .037 | .230 | -.15 | .03 |
| Profesionale | Periferi | .067 | .037 | .163 | -.02 | .15 |
| | Qytet | .060 | .037 | .230 | -.03 | .15 |

Tabela 16 Vlerësimet mesatare sipas shkollave lidhur me njohjen e shkurtesave standarde në gjuhën shqipe

| Shkollat | Numri | Mesatarja | Devijimet standarde |
|--------------|-------|-----------|------------------------|
| Periferi | 300 | 1.24 | .436 |
| Qytet | 300 | 1.25 | .432 |
| Profesionale | 300 | 1.31 | .476 |
| Total | 900 | 1.26 | .449 |

Tabela 17 Testi t për përdorimin e fjalëve të huaja sipas shkollave

| Levene's Test for Equality of Variances | | t-test for Equality of Means | | | | | | | |
|---|-------|------------------------------|-------|---------|-----------------|-----------------|-----------------------|---|-------|
| | | | | | | | | 95% Confidence Interval of the Difference | |
| | F | Sig. | t | df | Sig. (2-tailed) | Mean Difference | Std. Error Difference | Lower | Upper |
| Equal variances assumed | 1.095 | .296 | -.514 | 546 | .607 | -.021 | .041 | -.101 | .059 |
| Equal variances not assumed | | | -.519 | 327.024 | .604 | -.021 | .041 | -.101 | .059 |

Tabela 18 Levene test për vlerësimin e shkurtesave standarde në gjuhën shqipe sipas klasave

| Levene Statistic | df1 | df2 | Sig. |
|------------------|-----|-----|------|
| 6.094 | 2 | 588 | .002 |

Tabela 19 ANOVA për njohjen e shkurtesave standarde të gjuhës shqipe sipas klasave

| | Sum of Squares | df | Mean Square | F | Sig. |
|-----------------------|----------------|-----|-------------|-------|------|
| Between Groups | .651 | 2 | .326 | 1.361 | .257 |
| Within Groups | 140.699 | 588 | .239 | | |
| Total | 141.350 | 590 | | | |

Tabela 20 Procedura Tukey- Testi Post Hoc

| (I) Klasa | (J) Klasa | Mean Difference (I-J) | Std. Error | Sig. | 95% Confidence Interval | |
|-----------|-----------|-----------------------|------------|-------------|-------------------------|-------------|
| | | | | | Lower Bound | Upper Bound |
| X | XI | -.029 | .047 | .818 | -.14 | .08 |
| | XII | .054 | .051 | .542 | -.07 | .18 |
| XI | X | .029 | .047 | .818 | -.08 | .14 |
| | XII | .083 | .050 | .228 | -.04 | .20 |
| XII | X | -.054 | .051 | .542 | -.18 | .07 |
| | XI | -.083 | .050 | .228 | -.20 | .04 |

Tabela 21 Vlerësimet mesatare sipas klasave lidhur me njohjen e shkurtesave standarde në gjuhën shqipe

| Klasat | Numri | Mesatarja | Devijimet standarde |
|--------|-------|-----------|---------------------|
| X | 205 | 4.40 | .491 |
| XI | 224 | 4.43 | .496 |
| XII | 162 | 4.35 | .477 |
| Total | 591 | 4.40 | .489 |

Tabela 22 Levene test për vlerësimin e shkurtesave jostandarde në gjuhën e huaj sipas klasave

| Levene Statistic | df1 | df2 | Sig. |
|------------------|-----|-----|------|
| 2.820 | 2 | 487 | .061 |

Tabela 23 ANOVA për përdorimin e shkurtesave jostandarde të gjuhës së huaj sipas klasave

| | Sum of Squares | df | Mean Square | F | Sig. |
|----------------|----------------|-----|-------------|------|------|
| Between Groups | .488 | 2 | .244 | .982 | .375 |
| Within Groups | 121.024 | 487 | .249 | | |
| Total | 121.512 | 489 | | | |

Tabela 24 Procedura Tukey- Testi Post Hoc

| (I) Klasa | (J) Klasa | Mean Difference (I-J) | Std. Error | Sig. | 95% Confidence Interval | |
|-----------|-----------|-----------------------------|------------|-------------|----------------------------|----------------|
| | | | | | Loëer Bound | Upper Bound |
| X | XI | .042 | .053 | .706 | -.08 | .17 |
| | XII | .080 | .057 | .344 | -.05 | .21 |
| XI | X | -.042 | .053 | .706 | -.17 | .08 |
| | XII | .037 | .056 | .783 | -.09 | .17 |
| XII | X | -.080 | .057 | .344 | -.21 | .05 |
| | XI | -.037 | .056 | .783 | -.17 | .09 |

Tabela 25 Vlerësimet mesatare sipas klasave lidhur me përdorimin e shkurtesave jostandarde në gjuhën e huaj

| Klasat | Numri | Mesatarja | Devijimet standarde |
|--------|-------|-----------|------------------------|
| X | 168 | 4.58 | .494 |
| XI | 183 | 4.54 | .500 |
| XII | 139 | 4.50 | .502 |
| Total | 490 | 4.54 | .498 |

SHTOJCA II

PYETËSOR

Unë quhem **Elida Kurti** dhe jam duke përgatitur temën e doktoraturës me titull: “**Ndikimi i komunikimit elektronik në respektimin e standardit të të shkruarit të gjuhës shqipe nga nxënësit e arsimit të mesëm të lartë**”. Ju jeni përzgjedhur si një individ i përshtatshëm për të ofruar të dhëna konkrete rreth kësaj teme. Informacioni që ju do të jepni është tërësisht anonim dhe do të përdoret vetëm për qëllime studimi.

SEKSIONI A TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

P.1 Moshë _____ vjeç

P.2 Klasa 1.X, 2.XI, 3.XII (1) (2) (3)

P.3 Gjinia 1.Femër, 2 Mashkull (1) (2)

P.4. Shkolla ku ju studioni ndodhet në: 1.Fshat, 2.Qytet, 3.Periferi (1)(2)(3)

SEKSIONI B PËR SHKURTESAT E GJUHËS SHQIPE

Pjesa I - Përdorimi dhe kuptimi i shkurtesave jostandarde

P.5 Ju lutem jepni opinionin tuaj lidhur me shkurtesat jostandarde të mëposhtme duke dhënë edhe kuptimin e tyre:

| Nr | Shkurtesa | Kuptimi | 1. E di kuptimin, 2.Nuk e di kuptimin, 3.E marr me mend kuptimin, 4.E përdor, 5.Nuk e përdor, 6.Pa përgjigje |
|-----------|------------------|----------------|---|
| 1 | Sps | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |

| | | | |
|----|---------|--|-------------------------|
| 2 | Klm | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 3 | Pz | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 4 | Vër8 | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 5 | 3gim | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 6 | 2shim | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 7 | Xc | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 8 | Pc | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 9 | Mmsh | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 10 | Tung | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 11 | Prsh | | (1) (2) (3)(4) (5) (6) |
| 12 | Tdsh | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 13 | Flm | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 14 | Paçim | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 15 | Puç puç | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 16 | Prnd | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 17 | Tlt | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 18 | Tkxh | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 19 | Zmr | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 20 | Çpb | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |

Pjesa II- Përdorimi dhe kuptimi i shkurtesave standarde

P.6 Ju lutem jepni opinionin tuaj lidhur me shkurtesat standarde të mëposhtme duke dhënë edhe kuptimin e tyre:

| Nr | Shkurtesa | Kuptimi | 1. E di kuptimin, 2.Nuk e di kuptimin, 3.E marr me mend kuptimin, 4.E përdor, 5.Nuk e përdor, 6.Pa përgjigje) |
|----|--------------|---------|---|
| 1 | p.sh. | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 2 | Etj. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 3 | Antrop. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 4 | Ek. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 5 | Fig. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 6 | Kr. Pop | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 7 | Mit. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 8 | Mjek. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 9 | Num. rresht. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 10 | Prov. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 11 | Nr. Sh. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 12 | Shtypshkr. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 13 | Treg. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 14 | Urdh. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |

| | | | |
|----|--------|--|-------------------------|
| 15 | Vetv. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 16 | Vjet. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 17 | Zoo. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 18 | Zvog. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 19 | Zakon. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 20 | Zyrt. | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |

P.7 Ju lutem jepni opinionin tuaj për alternativat e mëposhtme:

| Nr | Alternativat | 1.Po, 2.Jo, 3.Ndonjëherë, 4.Asnjë përgjigje |
|----|--|--|
| 1 | A i respektoni rregullat standarde të shqipes së shkruar në detyrat tuaja me shkrim? | (1)(2) (3) (4) |
| 2 | A janë të pranishme fjalët e huaja gjatë punës tuaj në shkollë? | (1) (2) (3) (4) |
| 3 | Po jashtë saj i përdorni shpesh fjalët e huaja? | (1) (2) (3) (4) |
| 4 | A i zëvendësoni ato me fjalë të standardit të shqipes gjatë përdorimit në shkrimet standarde? | (1) (2) (3) (4) |
| 5 | Përdorni shkurtime ose simbole gjatë kryerjes së detyrave, eseve ose shkrimit të dokumenteve formale? | (1) (2) (3) (4) |
| 6 | Keni njohuri mbi shkurtesat standarde të gjuhës shqipe dhe përdorimin e tyre? | (1) (2) (3) (4) |

SEKSIONI C PËR SHKURTESAT E FJALËVE TË HUAJA

Pjesa I - Fjalët e huaja që përdoren në gjuhën shqipe

P.8 Ju lutem jepni opinionin tuaj lidhur me fjalët e huaja që përdoren në gjuhën shqipe duke dhënë edhe kuptimin e tyre:

| Nr | Fjala e huaj | Kuptimi | 1. E di kuptimin, 2.Nuk e di kuptimin, 3.E marr me mend kuptimin, 4.E përdor, 5.Nuk e përdor, 6.Pa përgjigje) |
|-----------|---------------------|----------------|--|
| 1 | Selektoj | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 2 | Shokues | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 3 | Dedikoj | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 4 | Definitiv | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 5 | Evitoj | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 6 | Inspirim | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 7 | Kreativ | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 8 | Dominon | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 9 | Fans | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 10 | Suportoj | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 11 | Vakant | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 12 | Look | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 13 | Spostoj | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |

| | | | |
|----|--------------|--|------------------------|
| 14 | Indiferent | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 15 | Violencë | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 16 | Sensibilizoj | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 17 | Net | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 18 | Starton | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 19 | Show | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 20 | Barrierë | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |

Pjesa II - Shkurtesat jostandarde në gjuhë të huaj

P.9 Ju lutem jepni opinionin tuaj lidhur me shkurtesat jostandarde në gjuhë të huaj

duke dhënë edhe kuptimin e tyre:

| Nr | Shkurtesa | Kuptimi | 1. E di kuptimin, 2.Nuk e di kuptimin, 3.E marr me mend kuptimin, 4.E përdor, 5.Nuk e përdor, 6.Pa përgjigje) |
|-----------|------------------|----------------|--|
| 1 | lol | | (1)(2) (3) (4) (5) (6) |
| 2 | bf | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 3 | sms | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 4 | pc | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 5 | fyi | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 6 | emo | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 7 | L8 | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |

| | | | |
|----|------|--|-------------------------|
| 8 | brb | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 9 | jam | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 10 | pc | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 11 | nagi | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 12 | nb | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 13 | ad | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 14 | kwim | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 15 | ps | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 16 | 2da | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 17 | b4 | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 18 | cos | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 19 | c | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |
| 20 | sys | | (1) (2) (3) (4) (5) (6) |

P.10 Ju lutem jepni opinionin tuaj për alternativat e mëposhtme:

| Nr. | Alternativat | 1.Po, 2.Jo, 3.Ndonjëherë, 4.Asnjë përgjigje |
|------------|---|--|
| 1 | Zakonisht a dërgoni shumë mesazhe gjatë ditës? | (1)(2) (3) (4) |
| 2 | Përdorni shkurtime kur i dërgoni sms njëri-tjetrit? | (1) (2) (3) (4) |

| | | |
|---|--|-----------------|
| 3 | A përdorni zhargone kur dërgoni mesazhe, apo kur komunikoni elektronikisht? | (1) (2) (3) (4) |
| 4 | A i shkurtoni fjalët kur përdorni shqipen standarde? | (1) (2) (3) (4) |
| 5 | A ndikoheni nga komunikimi elektronik në punët tuaja me shkrim ose detyrat e shtëpisë? | (1) (2) (3) (4) |

Faleminderit!

SKEDA E SHKURTESAVE

Mosha _____ Klasa _____ Gjinia _____

Shkolla ku studioni _____

Shkruani disa **fjalë të huaja dhe shkurtesa fjalësh** (në shqip apo në gjuhë të huaj), të cilat i përdorni gjatë punës tuaj në shkollë, apo gjatë komunikimit me njëri-tjetrin në chat, internet dhe me mesazhe.p.sh. flm (faleminderit), sms (short message servis), party (festë), selejktuj (përzgjedh).

| Nr. | Fjalë të huaja | Shkurtesa fjalësh |
|-----|----------------|-------------------|
| 1. | | |
| 2. | | |
| 3. | | |
| 4. | | |
| 5. | | |
| 6. | | |
| 7. | | |
| 8. | | |
| 9. | | |
| 10. | | |
| 11. | | |
| 12. | | |
| 13. | | |
| 14. | | |
| 15. | | |
| 16. | | |

| | | |
|-----|--|--|
| 17. | | |
| 18. | | |
| 19. | | |
| 20. | | |
| 21. | | |
| 22. | | |
| 23. | | |
| 24. | | |
| 25. | | |

Faleminderit!